



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të
Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë**

RAPORT

(Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë)

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE
NDRIÇIMIT PUBLIK, BASHKIA TIRANË**

Tiranë 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	6
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	10
II	HYRJA	12
1	Objektivat e auditimit	12
2	Qëllimi i auditimit	12
3	Identifikimi i çështjes	13
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	13
5	Përgjegjësitë e audituesve	13
6	Kriteret e vlerësimit	14
7	Standardet e auditimit	15
8	Metoda e auditimit	15
9	Dokumentimi i auditimit	17
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	18
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Rrogozhinë	18
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	19
2.1	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.	19
2.2.-2.2.5	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.	43
2.2.6	Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.	60
2.3	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2023.	65
2.4-2.4.3	Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit	132
2.4.4	Auditim mbi hartimin e zbatimit të projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.	271
IV	GJETJE DHE REKOMANDIME	282
V	ANEKSE	300

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
DPRrNP	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik u krijua me Vendim të Këshillit Bashkiak Tiranë nr.13, datë 10.03.2004 me Vendim të Këshillit Bashkiak Tiranë nr.7 datë 30.03.2009.

Drejtoria e Përgjithshme, organizohet dhe funksionon mbi bazën e Vendimit nr.157 datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak Tiranë dhe Vendimit nr.22, dt 17.03.2020, të Këshillit Bashkiak; në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligjit 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.9131 datë 08.09.2003 “Për Rregullat e etikës në Administratën Publike”; Ligjin Nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (të ndryshuar); Ligjin Nr.120/2014 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.511, datë 24.10.2002 “Për Kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” (i ndryshuar), Ligjin Nr.7961 datë 12.07.1995 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”; në Ligjin nr.7986 datë 13.09.1995 “Për Inspektoriatin Shtetëror të Punës”, në Ligjin nr.7995 datë 20.09.1995 “Për nxitjen e Punësimit”, në Ligjin Nr.7651 datë 21.12.1992 “Për Festat Zyrtare”, Vendimin Nr.390 datë 06.08.1993 Këshillit të Ministrave “Për Rregullat e Prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare” Vendimi nr.159, dt 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak për “Emërtimin dhe Ndryshimin e Stemave të Drejtorive të Përgjithshme të Qytetit”, Urdhërit të Kryetarit nr. 12249, datë 09.04.2020 për “Miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës”, dhe në dispozita të tjera ligjore e nënligjore.

Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik fokusohet në mirëmbajtjen e rrugëve kryesore dhe jo kryesore, rrugë të sistemit parësor, dytësor dhe tretësor në shtresë asfaltike, në mirëmbajtjen e trotuarëve me pllaka të tipeve të ndryshme, beton, asfalto – beton, mirëmbajtjen e bordurave kufizuese dhe blloqeve të banimit, në mirëmbajtjen dhe pastrimin e zgarave dhe kunetave të ujrave të bardha (sistemimin e ujërave të shiut), mirëmbajtjen dhe zëvendësimin të pusetave të tipeve të ndryshme në rrugë e trotuare. Miraton leje punimesh për ndërhyrje në hapësirën publike në rrjetin e infrastrukturës nëntokësore dhe leje punimesh për ndërhyrje për mirëmbajtjen e këtyre hapësirave dhe zhvillimin e tyre.

Në fuqizimin dhe modernizimin e ndriçimit elektrik publik dhe në mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e rrjetit të semaforit dhe sinjalistikës rrugore, administrimit të ujërave, kanaleve kulluese dhe rrugëve rurale.

Në bashkëpunim me drejtoritë e tjera në varësi të Bashkisë Tiranë, vë në zbatim dhe ndjek vendimet dhe projektet të miratuara nga Bashkia Tiranë.

Synimi kryesor i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (DPRrNP) është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin e Bashkisë Tiranë.

Buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik financohet Bashkia Tiranë, nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar 97% dhe nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve 3%.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni merr rëndësi të veçantë për arsye se administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë Tiranë, të miratuar nga Këshilli Bashkiak, me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, përperiudhën 01.01.2019 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga DPRrNP, Bashkia Tiranë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar transaksionet e likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 16 gjetje dhe ka dhënë 22 rekomandime, nga ku masa organizative me 13 gjetje dhe 19 rekomandime, 2 gjetje-rekomandime shpërblim dëmi në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve në vlerën 1,481,320 lekë, 1 (një) gjetje-rekomandim si efekt negativ në vlerën **14,801,939 lekë** në fushën e detyrimeve të paarkëtuara.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

a. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ ***Procedurat e zbatimit të kontratave të punimeve të ndertimit***

- Në **2 raste** janë konstatuar punime të pakryera me një **dëm ekonomik në vlerën 896,280 lekë** projektet e investimit me objekt: *“Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të*

ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik të rezervuarit Gjyslikonjë” dhe “Përmirësimi i ndriçimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi i korsive të biçikletave në sheshin “Nënë Tereza”.

- Në rastin e kontratës së punimeve me objekt: *“Përmirësimi i ndriçimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi i korsive të biçikletave në sheshin “Nënë Tereza”* nuk është bërë marrja e përkohshme në dorëzim e objektit.

- Për të dyja kontratat nuk është hartuar openenca teknike.

▪ ***Procedurat e prokurimit publik*** për punë publike, mallra dhe shërbime:

Nga auditimi i **28** procedurave me fond limit **1,199,572,751** lekë pa TVSh, u konstatuan shkelje të LPP, legjislacionit të fushës sipas natyrës së objekteve të prokuruarra dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

➤ **Për aktivitetin e vitit 2019**, nga auditimi i **8** procedurave me fond limit **361,586,075** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

- Në 2 procedura me vlerë totale të kontraktuar 90,264,833 lekë pa TVSh, u konstatuan shkelje në lidhje me hartimin e fondit limit;

- Në 6 procedura me vlerë totale të kontraktuar 240,299,135 lekë pa TVSh, u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, veprime të cilat mbartin riskun të pengojnë pjesëmarrjen e OE;

- Në 3 procedura me vlerë totale të kontraktuar 115,616,288 lekë pa TVSh, zbatimi i kontratës ka patur probleme me dokumentacionin justifikues për sasinë e hyrjeve dhe daljeve nga magazina dhe mosngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave sipas specifikimeve teknike;

➤ **Për aktivitetin e vitit 2020**, nga auditimi i **6** procedurave me fond limit **250,677,752** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

- Në 3 procedura me vlerë totale të kontraktuar 160,858,032 lekë pa TVSh, u konstatuan shkelje në lidhje me hartimin e fondit limit;

- Në 6 procedura me vlerë totale të kontraktuar 250,677,752 lekë pa TVSh, u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, veprime të cilat mbartin riskun të pengojnë pjesëmarrjen e OE;

- Në 4 procedura me vlerë totale të kontraktuar 186,911,532 lekë pa TVSh, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre;

➤ **Për aktivitetin e vitit 2021**, nga auditimi i **9** procedurave, me fond limit **688,899,017** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

- Në 3 procedura me vlerë totale të kontraktuar 60,040,250 lekë pa TVSh, u konstatuan shkelje në lidhje me hartimin e fondit limit;

- Në 8 procedura me vlerë totale të kontraktuar 229,399,970 lekë pa TVSh, u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, veprime të cilat mbartin riskun të pengojnë pjesëmarrjen e OE;

- Në 2 procedura me vlerë totale të kontraktuar 73,198,460 lekë pa TVSh, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre.

➤ **Për aktivitetin e vitit 2022**, nga auditimi i **5** procedurave, me fond limit **292,432,231** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

- Në 2 procedura me vlerë totale të kontraktuar 197,456,082 lekë pa TVSh, u konstatuan shkelje në lidhje me hartimin e fondit limit;
- Në 5 procedura me vlerë totale të kontraktuar 277,549,466 lekë pa TVSh u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK, të cilat nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat mbartin riskun të pengojnë pjesëmarrjen e OE.

▪ ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave***

Drejtoria e Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, për periudhën e audituar ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, të dhënat mbi evidencën mujore të të ardhurave çdo muaj. Duke filluar nga muaji mars i vitit 2021 dhenë vazhdim ka nxjerr Urdhër të Brendshëm mbi likuidimet e ndalesa sipas rekomandimeve të KLSH-së dhe auditit të brendshëm.

Të ardhurat rezultojnë për vitin:

- 2019 në vlerën 605,820 lekë, nga të cilat të ardhurat si pasojë e një aksidenti automobilistik 21,936 lekë, ndalesat nga auditit i brendshëm 202,194 lekë dhe ngandalesat e KLSH në vlerën 379,129 lekë.
- 2020 në vlerën 581,323 lekë, nga të cilat ndalesat nga auditit i brendshëm 202,194 lekë dhe nga ndalesat e KLSH në vlerën 379,129 lekë.
- 2021 në vlerën 678,016 lekë, nga të cilat ndalesat nga auditit i brendshëm 127,813 lekë dhe nga ndalesat e KLSH në vlerën 307,977 lekë dhe sekuestro/ zhdëmtim sigurim kontrate 242,226 lekë.

2022 në vlerën 326,907 lekë, nga të cilat ndalesat nga auditit i brendshëm 104,693 lekë dhe nga ndalesat e KLSH në vlerën 222,214 lekë.

▪ ***Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe rregjistrimin e asetëve***

Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, **rezultoi** se:

- Është realizuar inventari fizik nga komisioni i inventarizimit fizik për aktivet “ndërtesa /godina”;
- Nga titullari i njësisë nuk është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve “ndërtesa/godina” në mungesë të komunikimit dhe bashkëveprimit edhe me Nëpunësin Zbatues të njësisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Rubrika “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi” pikat 95-106;
- Nga titullari i njësisë nuk është ngritur komisioni për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit për arsye tjetërsimi në këtë rast të pesë (5) objekteve në mungesë të komunikimit dhe bashkëveprimit edhe me Nëpunësin Zbatues të njësisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Rubrika “Dhënia në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve” pika 107-120;
- U konstatua se për lirim të pesë objekteve për tjetërsim, ka patur komunikim dhe dakortësi vetëm verbalisht, pa dokumentuar asnjë takim apo diskutim rreth tyre si nga Titullari i njësisë, ashtu edhe nga Drejtoria juridike dhe prokurimeve të DPRRNP Tiranë;
- U konstatua se praktika dokumentare për tjetërsimin e 5 objekteve nuk është e plotë në formë e në përmbajtje, pasi edhe pse në komisionet respektive janë anëtarë edhe juristë, për marrjen në dorëzim të objektit “zyra” nga ana e DPRRNP Tiranë, dy komisionet duhet të kishin lidhur

një kontratë përdorimi, ku ndër të tjera përcaktohet edhe afati i përdorimit të objektit me të gjithë dokumentacionin e listuar bashkëngjitur saj. Ky mosveprim është në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë i përditësuar, Pjesa V “Kontratat”.

b. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- DPRRNP Bashkia Tiranë në lidhje me *zbatimin e kontratave të punimeve të ndërtimit* të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, nga sipërmarrësit e punimeve arkëtimin e vlerës prej **1,481,320 lekë** të faturuara dhe të paguara nga AK, të konstatuar dëm ekonomik nga mos kryerja e punimeve. Të merren masa që për të gjitha punët publike, të merret Oponenca Teknike para fillimit të procedurës së prokurimit.

- DPRRNP Bashkia Tiranë në lidhje me *procedurat e prokurimeve publike* të marrin masat e nevojshme, që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet. AK për punët/mallrat/shërbimet të cilat është e mundur ndarja e saj në lote, të marrë masa për hartimin e kërkesave të veçanta për secilin lot, për rritjen e konkurrencës dhe efikasitetin. Në procedurat e prokurimit në vijim, të kryejë përllogaritjen e saktë të vlerës së kontratës. Gjatë hartimit të regjistrave të prokurimit, të grupojë emërtimin e procedurave me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve buxhetore. Titullari i AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST në kualifikimin e OE, e cila përbën risk real për mos realizimin me sukses të kontratës.

- Në lidhje me *inventarizimin, përditësimin dhe regjistrimin e asetëve në ASHK* Drejtoria Juridike në DPRRNP Tiranë në bashkëpunim strukturën përgjegjëse Drejtorinë e Përgjithshme Juridike, të Aseteve dhe Liçensimit/Bashkia Tiranë të nisin procedurat pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për pajisjen me certifikata pronësie të aktiveve dhe të rivlerësojnë aktivet, me qëllim kontabilizimin e vlerave të sakta të tyre në llogaritë 210 dhe 212 të AAGJM në pasqyrat financiare;

- Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve në DPRRNP Tiranë t’i kërkojë Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, të Aseteve dhe Liçensimit/Bashkia Tiranë praktikën e plotë dokumentare të ndjekur nga Bashkia Tiranë lidhur me përfshirjen e pesë objekteve të saj në [PdyV], lidhjen e një marrëveshjeje ku të qartësohen efektet e vendimarrjes së Bashkisë Tiranë për pesë objektet ndaj DPRRNP Tiranë; si dhe për t’i hapur rrugë Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve/Sektorit të financës shkarkimin e tyre nga kontabiliteti i njësisë;

- Drejtoria e Transportit në DPRRNP Tiranë, referuar tabelës së mjeteve të përpunuar nga grupi i auditimit, të verifikojë pesë mjetet pa targa dhe të përfundojë procedurën e çrregjistrimit të përhershëm të dhjetë mjeteve, të cilat nga auditimi kanë rezultuar pa informacion në sistemin e mjeteve.

- Titullari i DPRRNP Tiranë në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të plotësojnë praktikën me dokumentacionin përkatës apo të argumentojnë çdo kërkesë të mospërbushjes së saj dhe t’i rikërkojnë Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, të Aseteve dhe Liçensimit/Bashkia Tiranë, konfirmimin për të vijuar me procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit/me tjetërsim apo asgjësim të mjeteve të amortizuara teknikisht, me qëllim largimin e tyre nga territori i njësisë për skrap dhe shkarkimin nga kontabiliteti; të ngrënë grup pune për vlerësimin e aktiveve dhe

inventareve me vlerë të mbetur të papërfillshme ose "zero", të cilat janë në përdorim dhe në gjendje pune për shërbimet që ofron njëzia publike.

• Në lidhje *me hartimin e PBA-ve*, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe e Ndriçimit Publik:

- të ngrejë Grupin e Menxhimit Strategjik si dhe të mbajë procesverbale mbi takimet e kryera
- Të ngrejë Urdhrin e Brendshëm për të gjitha fazat e ndjekura të PBA-së.
- Të ngre grupet e punës mbi përgatitjen e PBA-ve, pasi të gjitha drejtoritë të paraqesin kërkesat mbi nevojat e tyre në planifikim buxhetor afatmesëm.

3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

a- Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar/kualifikuar, me rezervë, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Baza për opinionin e modifikuar me rezervë:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga DPRRNP Tiranë, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISSAI 1700.7).

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej **33,592,830 lekë**, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve, si dhe faktin se disa llogari në pasqyrat financiare nuk paraqesin vlerën e tyre reale, si vijon:

-Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është pasqyruar më pak për vlerën 782,094 lekë;

- Llog.470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” është pasqyruar pa vlerë dhe më pak në shumën 14,382,457 lekë;

- Llog 202 “studime dhe kërkime” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në shumën 215,474,992 lekë, për asnjë vit nga dalja e Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 i MFE i ndryshuar e në vijim,

nuk i është llogaritur amortizimi sipas normës përkatëse prej 15%; pra është mbivlerësuar për shumën 102,995,697 lekë;

- Llog. 24 "aktive të dëmtuara" paraqitet në vlerën 61,893,470 lekë ku përfshihen edhe grup aktivesh në vlerën 4,434,245 lekë, të cilat nuk janë specifikuar sipas llogarive kontabël që përfaqësojnë, rrjedhimisht dhe llogaritja e amortizimit nuk është bërë sipas normës përkatëse të amortizimit;

- Llog. 107 "aktive të caktuara në përdorim" nuk ka vlerë, pasi për objektin e marrë në përdorim nuk janë ndjekur gjithë hapat ligjorë, dhe rrjedhimisht kjo llogari është nënvlerësuar pasi nuk ka të pasqyruar vlerën e objektit të marrë në përdorim nga DPRRNP Tiranë;

- Llog. 4342 "operacione me shtetin (të drejta)" e cila në pasqyrat e vitit 2022 është nënvlerësuar për shumë 20,931,287 lekë;

- Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm", është nënvlerësuar për shumën 29,566,365 lekë;

- Llog 212 dhe llog. 210 nuk paraqiten në vlera reale të aktiveve të tyre, pasi nuk janë me titull pronësie dhe nuk i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit të tyre.

b. Opinioni mbi përputhshmërinë.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2019-31.12.2022. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e DPRRNP, Bashkia Tiranë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin", të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar** për përputhshmërinë.

Baza për dhënien e opinionit të modifikuar, mbi përputhshmërinë:

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

-Nga auditimi i 28 procedurave me fond limit 1,199,572,751 lekë të vlerësuar për auditim për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2022, në 6 procedura me vlerë të fondit limit 269,151 mijë lekë dhe vlerë totale të kontratave 258,764 mijë lekë janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, ku OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK.

- Nga auditimi i 28 procedurave, rezulton se në 25 procedura është konstatuar aplikimi i kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit. Ky veprim, mbart riskun për mospjesëmarrje të OE në garë ose në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme, veprime të cilat ndikojnë në mospërdorimin e fondeve me efektivitet nga mungesa eventuale e konkurrencës.

- Nga auditimi u konstatua se janë nxjerrë nga regjistri i aktiveve të njësisë publike DPRRNP Tiranë, pesë objekteve në pronësi apo menaxhim të saj me praktikë dokumentare jo të e plotë në formë e në përmbajtje.

- Janë konstatuar punime të pakryera me një dëm ekonomik në vlerën 896,280 lekë në dy projektet e investimit me objekt: "Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik të rezervuarit Gjyslikonjë" dhe "Përmirësimi i

ndriçimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi i korsive të biçikletave në sheshin “Nënë Tereza”.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të programit të auditimit nr. 1063/1 Prot., datë 20.12.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 20.12.2023, deri më 21.03.2024, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, për periudhën 01.01.2019 deri me datën 31.12.2022, u krye auditimi “Mbi auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.Z. (Përgjegjës grupi)
2. S.J, anëtar
3. E.M, anëtar
4. K.P, anëtar
5. K.H, anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat e auditimit

Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Bashkinë Tiranë, kishte si objektiva kryesore:

-Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

-Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹;

-Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

-Dhënien e opinionit dhe hartimin e Projektraportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve,

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Projektraporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Tiranë dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për periudhën 2019-2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- Auditim mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën nga data 01.01.2019, deri më 31.12.2022.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;

- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).
- fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në DPRrNP, Bashkinë Tiranë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019, “Për buxhetin e vitit 2020” i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016, “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzim i MFE nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njëjësive të Vetëqeverisjes Vendore”;

- Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;
- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë në Bashkinë Tiranë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Peshat specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve

justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët:

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.,.

7. Intervistimi:

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Tiranë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione:

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale².

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

² ISSAI 1315

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{ja} aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur, *dhe së fundi kërkimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt-konstatimeve, u përgatit Projektraporti i Auditimi i cili u dërgua në subjekt me shkresën nr. 1063/2, datë 29.04.2024. Nga ana e subjektit me shkresën nr. 1775/3, datë 03.06.2024 është dërguar konfirmimi i marrjes së projektraportit dhe observacionet përkatëse. Në përfundim nga audituesit u përgatit Raporti i Auditimit.

³ *Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit*

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik u krijua me Vendim të Këshillit Bashkiak Tiranë nr.13, datë 10.03.2004 me Vendim të Këshillit Bashkiak Tiranë nr.7 datë 30.03.2009.

Drejtoria e Përgjithshme, organizohet dhe funksionon mbi bazën e Vendimit nr.157 datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak Tiranë dhe Vendimit nr.22, dt 17.03.2020, të Këshillit Bashkiak; në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligjit 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.9131 datë 08.09.2003 “Për Rregullat e etikës në Administratën Publike” ; Ligjin Nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (të ndryshuar); Ligjin Nr.120/2014 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.511, datë 24.10.2002 “Për Kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” (i ndryshuar), Ligjin Nr.7961 datë 12.07.1995 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”; në Ligjin nr.7986 datë 13.09.1995 “Për Inspektoriatin Shtetëror të Punës”, në Ligjin nr.7995 datë 20.09.1995 “Për nxitjen e Punësimit”, në Ligjin Nr.7651 datë 21.12.1992 “Për Festat Zyrtare”, Vendimin Nr.390 datë 06.08.1993 Këshillit të Ministrave “Për Rregullat e Prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare” Vendimi nr.159, dt 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak për “ Emërtimin dhe Ndryshimin e Stemave të Drejtorive të Përgjithshme të Qytetit”, Urdhërit të Kryetarit nr. 12249, datë 09.04.2020 për “Miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës”, dhe në dispozita të tjera ligjore e nënligjore.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

1. Mbi mjedisin e kontrollit

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, është institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, krijuar me VKB nr.7, datë 30.03.2009, që funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të institucionit, hartuar dhe miratuar në vitin 2020 me Vendim Nr. 16330/2, datë 8.6.2020, “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë”, nr. 1162/1 prot., datë 09.06.2020.

Kjo është rregullorja me të cilën ky institucion vazhdon të funksionojë edhe sot. Megjithatë ajo çfarë vihet re është se rregullorja nuk është e përditësuar me ndryshimet që kanë ndodhur në strukturën organizative të institucionit gjatë periudhës 2019 – 2022, pasi në Nenin 7, pika

7.7 citohet se *'Drejtoria e Përgjithshme ka në përbërjen e saj katër drejtori dhe janë përgjegjës për mbarëvajtjen e këtyre drejtorive, sipas strukturës administrative të miratuar.'*, ndërkohë që për vitet 2021 dhe 2022 evidentohet se numri dhe përbërja e drejtorive, pjesë e strukturës organizative të institucionit, ka ndryshuar qoftë brenda vitit 2021, por edhe nga njëri vit (viti 2021) te tjetri (viti 2022). Këto ndryshime të reja, nuk janë reflektuar në krijimin dhe miratimin e një rregulloreje të re, e cila do të ishte konform me ndryshimet përkatëse të realizuara, për periudhën objekt auditimi. *Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.*

Përsa i takon vitit 2019, DPRrNP ka funksionuar me rregulloren e hartuar dhe miratuar me Vendim Nr.12022/1, datë 11.04.2019 "Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së drejtorisë së përgjithshme Nr.2 të punëtorëve të qytetit, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë". Grupi i punës ngarkuar për zbatimin e këtij vendimi ka qenë gjithë administrata e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Referuar formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, përsa i përket pjesës së strukturës (formatit) për Rregulloren e Brendshme të këtij institucioni, vihet re se përgjithësisht është hartuar bazuar në këtë manual dhe mbështetet në legjislacionin përkatës, duke përmbajtur disa nga elementët thelbësore, që çdo rregullore duhet të ketë.

- Lidhur me Organizimin dhe Funksionimin e Sigurimit Teknik dhe Shëndetit në Punë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, është hartuar dhe miratuar "Rregullore e Brendshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik mbi Organizimin dhe Funksionimin e Sigurimit Teknik dhe Shëndetit në Punë" nr. 3451 prot., datë 24.12.2020, duke u referuar ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë".

- Regjistri i aktiveve në DPRrNP është përgatitur dhe përditësuar për të gjitha vitet objekt auditimi.

- Lidhur me miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, nuk është hartuar dhe miratuar një rregullore specifike për ndjekjen e procedurave të ruajtjes, mbrojtjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike. *Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Neni 8, pika ç); Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar rubrika Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike, pika 5; dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 2.2.5, pika d) e rubrikës "Përgjegjësitë e Titullarëve të Njësisë Publike".*

- Lidhur me Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve IT, institucioni nuk ka një sektor më vete për Teknologjinë e Informacionit, referuar edhe strukturës organizative të miratuar për vitet objekt auditimi. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, është i punësuar vetëm një Specialist i IT-së, i cili bën pjesë në Sektorin e Burimeve Njerëzore, që ka qenë pjesë e Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (referuar periudhës objekt auditimi). Evidentohet se për periudhën e viteve 2019 – 2022, nuk është hartuar asnjë manual apo rregullore specifike për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve të IT-së. *Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010,*

“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; dhe Nenin 44, të Rregullores së Brendshme të DPRrNP, në rubrikën Specialist i Teknologjisë dhe Informacionit - Detyrat dhe përgjegjësitë, pika 5, ku citohet “Realizon trajnime dhe përgatit manuale me varietete të gjëra mbi përdorimin e paisjeve kompjuterike”; dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3. “Aktivitetet e Kontrollit”, Rubrika “Aktivitetet e kontrollit që lidhen me teknologjinë e informacionit⁴”.

▪ Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik për periudhën objekt auditimi 2019 - 2022, nuk ka hartuar dhe miratuar “Rregulloren e Posaçme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit”. Mungesa e “Rregullores së posaçme për parandalimin e konfliktit të Interesit” është në mospërputhje me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar; dhe Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Parandalimi i Konfliktit të Interesave është i përmendur vetëm si një nga parimet kryesore të Rregullores së Brendshme të institucionit, te Neni 5, pika c.

▪ Përsa i takon auditit të brendshëm, DPRrNP nuk ka Drejtori/ Njësi të Auditit të Brendshëm, pasi është institucion varësie i Bashkisë Tiranë dhe auditohet nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm e Bashkisë Tiranë. Auditimi i fundit që është realizuar në DPRrNP nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm Bashkia Tiranë, është kryer për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2023. Nga auditimi evidentohet se, pas përfundimit të auditimit nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm Bashkia Tiranë, deri në këtë fazë DPRrNP-së i është përcjellë vetëm Projekt Raporti i Auditimit, me shkresën nr. 5966 prot., datë 06.02.2024, protokolluar nga DPRrNP me nr. 565 prot., datë 07.02.2024, ku institucionit i janë lënë gjithsej 38 (tridhjetë e tetë) rekomandime.

Kodi i Etikës

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, nuk ka hartuar një kod etike të funksionimit të institucionit, si dokument më vete. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” neni 1 dhe 2 pika 1,4; dhe Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Kodi i Etikës së institucionit është i përfshirë në Nenin 12, të Rregullores së Brendshme, krijuar me Vendim Nr. 16330/2, datë 08.06.2020, “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë”, nr. 1162/1 prot., datë 09.06.2020.

Mbi rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës:

Mënyra e rekrutimit që ndiqet në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, për pjesën e punonjësve të administratës së kësaj drejtorie, siç citohet edhe në Nenin 7 të Rregullores së Brendshme të institucionit “Administrata e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik përbëhet nga punonjësit pa statusin e nëpunësit civil, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës (i ndryshuar)”, realizohet bazuar në ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”; dhe ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Publikimi i njoftimeve të vendeve vakante në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik bëhet në stendat që ndodhen në ambientet e institucionit dhe faqen zyrtare të

⁴ Sistemet e TI-së kërkojnë lloje specifike të kontrollit, që duhet të miratohen nga titullarët e njësive.

Bashkisë Tiranë. Procedura e rekrutimit ndiqet e gjitha nga DPRrNP, bazuar në kuadrin ligjor të sipërcituar.

▪ Nga auditimi evidentohet se, shpalljet për vend të lirë pune në DPRrNP, nuk dërgohen zyrtarisht për tu publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, *veprim ky në mospërputhje me Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 19, pika 1 dhe 2.*

▪ Nga auditimi i personelit, lidhur me strukturën organizative të DPRrNP, rezultoi se për vitet 2019 – 2022, në strukturën organizative të miratuar për këto vite, nuk ka pasur të parashikuara dhe përcaktuara pozicione me prioritet, për kategorinë e personave të cilësuar me statusin PAK. *Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, Neni 2, pika b) dhe Neni 5, pika c); dhe Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”.*

▪ Nga auditimi evidentohet se, përsa i takon ngritjes së komisioneve për procedurat e punësimit, për vitet objekt auditimi 2019 – 2022, janë hartuar Urdhërat si më poshtë vijon:

- Urdhër Nr. 04, datë 03.01.2019 “Për ngritjen e komisionit për procedurat e punësimit”, nr.04 prot., datë 03.01.2019;

- Urdhër Nr. 2748, datë 24.09.2019 “Për zëvendësim të Kryetarit të Komisionit për procedurat e punësimit të punonjësve”, nr. 2748 prot., datë 24.09.2019.

- Urdhër Nr. 37, datë 08.01.2020 “Për ngritjen e komisionit lidhur me rekrutimet, procedurat dhe kontrollin e dokumentacionit të punonjësve”, nr. 37 prot. datë 08.01.2020;

- Urdhër nr. 37/1 prot., datë 17.11.2020 “Për zëvendësimin e Kryetarit të Komisionit lidhur me rekrutimet, procedurat dhe kontrollin e dokumentacionit të punonjësve”.

- Urdhër nr. 03 prot., datë 05.01.2021 “Për ngritjen e komisionit lidhur me punësimet, procedurat dhe kontrollin e dokumentacionit të punonjësve”.

- Urdhër Nr. 03, datë 05.01.2022 “Për ngritjen e komisionit lidhur me punësimet, procedurat dhe kontrollin e dokumentacionit të punonjësve”, nr. 03 prot., datë 05.01.2022.

Për vitin 2019, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka funksionuar me strukturën e miratuar me Urdhër Nr. 3097/2, datë 21.1.2019, nr. 266/1 prot., datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 të punëtorëve të qytetit, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë”. Numri i punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik referuar Strukturës së Detajuar përcaktuar në këtë urdhër ka qenë gjithsej **448 punonjës** gjithsej. Kjo strukturë organizohej në 4 (katër) drejtori, specifikisht si vijon:

- Drejtoria e Administratë Financës;
- Drejtoria e Prodhimit dhe Mirëmbajtjes;
- Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale;
- Drejtoria e Ndriçimit Publik.

Për vitin 2020, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka funksionuar me strukturën e miratuar me Urdhër Nr. 4984, datë 31.01.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë”. Numri i punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik referuar Strukturës së Detajuar përcaktuar në këtë urdhër ka qenë gjithsej **468 punonjës** gjithsej.

Për vitin 2021, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka funksionuar me strukturën e miratuar me Urdhër Nr. 1084/1, datë 11.01.2021, nr. 59/1 prot., datë 11.01.2021 “Për riorganizimin e strukturës dhe klasifikimin e vendeve të punës në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë”. Numri i punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik referuar Strukturës së Detajuar përcaktuar në këtë urdhër ka qenë gjithsej **475 punonjës** gjithsej. Në fillim të këtij viti struktura përbëhej nga 4 (katër) drejtori, specifikisht si vijon:

- Drejtoria e Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve;
- Drejtoria e Prodhimit dhe Mirëmbajtjes;
- Drejtoria e Ndriçimit Publik;
- Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale.

Konstatohet se ky vit ka pasur ndryshime të strukturës në muajt qershor dhe tetor, konkretisht si vijon:

- Ndryshimi i strukturës dhe organikës që është bërë në muajin qershor, bazuar në Urdhër Nr. 23612/1, datë 18.06.2021, nr. 1709 prot., datë 23.09.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik”. Nga ky ndryshim rezulton se është krijuar një drejtori më vete, që është Drejtoria e Sinjalistikës Rrugore. Pra nga 4 (katër) drejtori që ishin në strukturën fillestare, me ndryshimet e urdhërit të sipërcituar, është kaluar në një strukturë me 5 (pesë) drejtori.

- Ndryshimi i strukturës dhe organikës që është bërë në muajin tetor, bazuar në Urdhër Nr. 37547/1, datë 01.10.2021, nr. 2628 prot., datë 01.10.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik”. Nga ky ndryshim rezulton se janë krijuar 2 (dy) drejtori të reja, që janë Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve; dhe Drejtoria e Mirëmbajtjes së Trotuareve e Ujrave të Shiut. Pra nga 5 (pesë) drejtori që ishin në strukturën e ndryshuar në muajin qershor, me ndryshimet e urdhërit të sipërcituar, është kaluar në një strukturë me 7 (shtatë) drejtori, specifikisht si vijon:

- Drejtoria e Financës, Transportit dhe Burimeve Njerëzore;
- Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve;
- Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve Urbane;
- Drejtoria e mirëmbajtjes së trotuareve e ujrave të shiut;
- Drejtoria e Ndriçimit;
- Drejtoria e Sinjalistikës Rrugore;
- Drejtoria e Kullimit dhe Rrugët Rurale.

Për vitin 2022, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka funksionuar me strukturën e miratuar me Urdhër Nr. 3879/1, datë 31.01.2022, nr. 257 prot., datë 31.01.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik”. Numri i punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik referuar Strukturës së Detajuar përcaktuar në këtë urdhër ka qenë gjithsej **495 punonjës** gjithsej. Konstatohet se ky vit ka pasur ndryshime të strukturës në muajt prill dhe tetor, konkretisht si vijon:

- Ndryshimi i strukturës dhe organikës që është bërë në muajin prill, bazuar në Urdhër Nr. 16282/1, datë 29.04.2022, nr. 1278 prot., datë 29.04.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik”. Nga ky ndryshim

rezulton se është shtuar numri total i punonjësve nga 495 punonjës që ishte përcaktuar fillimisht, në **505 punonjës** gjithsej.

- Ndryshimi i strukturës dhe organikës që është bërë në muajin tetor, bazuar në Urdhër Nr. 34868/1, datë 06.10.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik”. Nga ky ndryshim rezulton se është shtuar numri total i punonjësve nga 505 punonjës që ishte përcaktuar me ndryshimet e muajit prill, në **525 punonjës** gjithsej.

Referuar shkresës nr. 35 prot., datë 05.01.2024, për marrjen informacion nga DPRRNP, lidhur me pozicionet e punës trajtuar sipas Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të dhënat paraqiten si vijon:

- Në muajin janar 2019 kanë qenë 434 punonjës me kontratë pune bazuar në Kodin e Punës dhe 5 vakanca, ndërsa numri i përgjithshëm ka qenë 434. Ndërsa në dhjetor 2019 kanë qenë 448 punonjës me kontratë pune bazuar në Kodin e Punës dhe 3 vakanca, ndërsa numri i përgjithshëm ka qenë 448.

- Në muajin janar 2020 kanë qenë 448 punonjës me kontratë pune bazuar në Kodin e Punës dhe 6 vakanca, ndërsa numri i përgjithshëm ka qenë 448. Ndërsa në dhjetor 2020 kanë qenë 468 punonjës me kontratë pune bazuar në Kodin e Punës dhe 2 vakanca, ndërsa numri i përgjithshëm ka qenë 468.

- Në muajin janar 2021 kanë qenë 468 punonjës me kontratë pune bazuar në Kodin e Punës dhe 2 vakanca, ndërsa numri i përgjithshëm ka qenë 468. Ndërsa në dhjetor 2021 kanë qenë 475 punonjës me kontratë pune bazuar në Kodin e Punës dhe 0 vakanca, ndërsa numri i përgjithshëm ka qenë 475.

- Në muajin janar 2022 kanë qenë 475 punonjës me kontratë pune bazuar në Kodin e Punës dhe 0 vakanca, ndërsa numri i përgjithshëm ka qenë 475. Ndërsa në dhjetor 2022 kanë qenë 525 punonjës me kontratë pune bazuar në Kodin e Punës dhe 3 vakanca, ndërsa numri i përgjithshëm ka qenë 525.

Tabela.1. Të dhënat numrit të punonjësve për periudhën 2019 – 2022

Nr.	Viti 2019	Kontratë Pune (Kodi i Punës RSH)	Nr. Përgjithshëm	Vakanca
1	Janar 2019	434	434	5
2	Dhjetor 2019	448	448	3

Nr.	Viti 2020	Kontratë Pune (Kodi i Punës RSH)	Nr. Përgjithshëm	Vakanca
1	Janar 2020	448	448	6
2	Dhjetor 2020	468	468	2

Nr.	Viti 2021	Kontratë Pune (Kodi i Punës RSH)	Nr. Përgjithshëm	Vakanca
1	Janar 2021	468	468	2
2	Dhjetor 2021	475	475	0

Nr.	Viti 2022	Kontratë Pune (Kodi i Punës RSH)	Nr. Përgjithshëm	Vakanca
1	Janar 2022	475	475	0
2	Dhjetor 2022	525	525	3

Burimi: Drejtoria e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (Sektori i Burimeve Njerëzore); Përpunoi grupi i auditimit të KLSH

- Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve për punonjësit e emëruar, gjatë periudhës objekt auditimi vitet 2019 - 2022, evidentohet se përgjithësisht dokumentacioni është në dosjet e punonjësve duke filluar nga inventari i dosjes, fleta prezantuese e dosjes së nëpunësit, urdhër për emërim në detyrë, kontrata individuale e punës për periudhën me dhe pa afat, certifikata familjare, vërtetim banimi, dëshmi penaliteti etj.
- Nga auditimi konstatohet se, disa nga dosjet e personelit nuk kanë pasur të përfshira fotokopje të noterizuara të diplomave bachelor dhe/ose master bashkë me listën e notave për programin përkatës të studimit, por kanë pasur vetëm fotokopje të pa noterizuar të tyre, sipas rastit; dhe raportin e aftësisë në punë, që nuk është përditësuar në mënyrë periodike, që nga momenti i fillimit të punës. Ky veprim është në mospërputhje me VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”; dhe VKM Nr. 639, datë 7.9.2016 “Për përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”, të ndryshuar.
- Përsa i takon trajnimeve të punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Sektori i Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar dhe miratuar një program trajnimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore, si dhe nuk ka pasur të planifikuara fonde të dedikuara për trajnimin e punonjësve për vitet 2019 - 2022. Të vetmet trajnime që ndiqen nga stafi janë ato të planifikuara nga ASPA dhe trajnime që realizohen nga Bashkia Tiranë. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.1, Rubrika “Politikat dhe praktikatat që lidhen me burimet njerëzore”⁵ dhe “Profesionalizmi i stafit”⁶.
- Në DPRrNP është hartuar Urdhër Nr. 31, datë 07.01.2020, nr. 31 prot., “Për marrjen e masave nga drejtoritë për trajnim stafi”, lidhur me zhvillimin e trajnimeve të stafit.
- Sektori i Burimeve Njerëzore, për secilin vit objekt auditimi, ka përcaktuar vetëm në bazë të disa listave shkresore nevojat për trajnim të stafit, ku parashikohen nevojat për trajnim të punonjësve kryesisht për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese, për trajnime të ofruara nga ASPA, Bashkia Tiranë etj.

2. Mbi menaxhimin e riskut Regjistri i Riskut për vitet 2019 – 2022

- Për vitin 2019, është përgatitur regjistri i riskut sipas formatit që përcaktohet në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, bazuar në shkresën nr. 3739 prot., datë 31.12.2018, në të cilin janë përfshirë risqet e secilit prej sektorëve, të katër drejtorive pjesë përbërëse e DPRrNP për vitin 2019. Në këtë regjistër janë përshkruar disa nga risqet kryesore për këtë vit duke krijuar një pamje më analitike të situatave, duke përcaktuar edhe nivelin e secilit prej risqeve para dhe pas kontrollit. Gjithashtu janë përcaktuar nevojat për kontrollet e

⁵ Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë:

- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur.

⁶ Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për:

- Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre.

mëtejshme, veprimet për të zgjidhur mangësitë, duke identifikuar në të njejtën kohë edhe zotëruesit e riskut. Disa nga risqet e identifikuara kanë të bëjnë me objektiva si vijon:

➤ **Drejtoria e Administratë Financës:**

A. Sektori i Financës

1. Administrimi i të gjithë asetëve në përdorim, magazinimi, ruajtja dhe qarkullimi i materialeve për përmbushjen e detyrave të DPRRNP;
2. Implementimi i sistemit financiar për administrimin e të gjithë dokumentave financiare dhe standartizimin e tyre;
3. Ndjekja e realizimit të kontratave të blerjes së mallarave, zbatimi dhe likuidimi i tyre;
4. Likuidimi i gjithë kontratave mallra, shërbime dhe punime në kohë dhe brenda vitit buxhetor për të synuar realizimin në masën 100%.

B. Sektori i Transportit

1. Hartimi i normativave për materialet shpenzuese si karburant;
2. Gadishmëria e mjeteve të transportit në mbështetje të proceseve të mirëmbajtjes dhe lëvizjen e bazës materiale;
3. Plotësimi me mjete specifike transporti për të mbushur funksionet shtesë të drejtorisë.

C. Sektori Juridik dhe Prokurimeve

1. Mosrealizimi në kohë i procedurave të prokurimit;

D. Sektori i Administratës

1. Garantimi i menaxhimit të burimeve njerëzore duke zbatuar rekrutimin, trajnimin, vlerësimin;
2. Administrimi i dokumentacionit;
3. Miradministrim sistemi IT, pajisje.

➤ **Drejtoria e Prodhim Mirëmbajtjes:**

E. Sektorët: Teknik, asfaltit, pllakave, zgarave dhe prodhimit

1. Mirëmbajtje e shtresave asfaltike në rrugët e qytetit të Tiranës;
2. Mirëmbajtje e trotuareve dhe shesheve publike;
3. Mirëmbajtje dhe sistemim të rrjetit K.U.SH, puseta në rrugë e trotuare;
4. Përballimi i emergjencave të ndryshme në varësi të kushteve atmosferike;
5. Evidentimi dhe ndërhyrja në kohë e problematikave të ndryshme në rrugë dhe trotuare;
6. Planifikimi dhe përlogaritja e bazës materiale dhe volumeve që kërkon çdo ndërhyrje;
7. Mbulimi dhe kontrolli i gjithë territorit që administrohet nga Bashkia Tiranë.

➤ **Drejtoria e Ndrçimit Publik dhe sinjalistikës rrugore:**

F. Sektori: Teknik, i ndriçimit publik, i sinjalistikës rrugore

1. Planifikimi i mirëmbajtjes së rrjetit elektrik dhe semaforik, riparimi i defekteve të ndodhura në rrjet;
2. Plotësimi me staf të specializuar dhe me mjete specifike transporti për të mbushur funksionet shtesë të Drejtorisë;
3. Kontroll, koordinim dhe menaxhim i problematikave të ndryshme të ndodhura nga faktorë të jashtëm.

➤ **Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale:**

1. Monitorimi i vazhdueshëm dhe menaxhimi, nëpërmjet ndërhyrjeve teknike në diga për rritjen e sigurisë së rezervuarëve;

2. Sigurimi i gjendjes optimale të sistemeve vaditëse dhe kulluese, në tërësinë e tyre dhe veçanërisht në rrjetet me probleme teknike, me qëllim shtimin e sipërfaqeve të ujitura dhe të kulluara;
3. Përmirësimi në tërësi i gjendjes teknike të rrugëve rurale lidhëse midis fshatrave, rindërtimi i shtesave rrugore dhe i veprave të artit dhe mbrojtëse të trasesë së rrugës.

▪ Për vitin 2020, është përgatitur regjistri i riskut sipas formatit që përcaktohet në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, bazuar në Urdhër i brendshëm Nr. 3612, datë 05.12.2019, nr. 3612 prot., datë 05.12.2019 “Për hartimin e regjistrit të përditësuar për menaxhimin e riskut”.

Regjistri i riskut, nr. 3612/1 prot., datë 31.12.2019, që është hartuar për të gjitha drejtoritë që kanë qenë pjesë përbërëse e strukturës organizative të DPRrNP për vitin 2020, ka pasur të përfshirë risqet e secilit prej sektorëve përbërës të katër drejtorive pjesë përbërëse e DPRrNP për vitin 2020 dhe strukturave të reja të formuara brenda drejtorive përkatëse. Në këtë regjistër janë përshkruar disa nga risqet kryesore për këtë vit duke krijuar një pamje më analitike të situatave, duke përcaktuar edhe nivelin e secilit prej risqeve para dhe pas kontrollit. Gjithashtu janë përcaktuar nevojat për kontrollet e mëtejshme, veprimet për të zgjidhur mangësitë, duke identifikuar në të njëjtën kohë edhe zotëruesit e riskut. Disa nga risqet e identifikuar kanë të bëjnë me objektiva, si vijon:

➤ **Drejtoria e Administratë Financës:**

G. Sektori i Financës

1. Administrimi i të gjithë asetëve në përdorim, magazinimi, ruajtja dhe qarkullimi i materialeve për përmbushjen e detyrave të DPRrNP;
2. Implementimi i sistemit financiar për adiministrimin e të gjithë dokumentave financiare dhe standartizimin e tyre;
3. Ndjekja e realizimit të kontratave të blerjes së mallarave, zbatimi dhe likuidimi i tyre;
4. Likuidimi i gjithë kontratave mallra, shërbime dhe punime në kohë dhe brenda vitit buxhetor për të synuar realizimin në masën 100%.

H. Sektori i Transportit

1. Hartimi i normativave për materialet shpenzuese si karburant;
2. Gadishmëria e mjeteve të transportit në mbështetje të proceseve të mirëmbajtjes dhe lëvizjen e bazës materiale;
3. Plotësimi me mjete specifike transporti për të mbushur funksionet shtesë të drejtorisë.

I. Sektori Juridik dhe Prokurimeve

1. Mosrealizimi në kohë i procedurave të prokurimit;

J. Sektori i Monitorimit

1. Marrje dhe përpunim informacioni në bashkëpunim me Drejtoritë pjesë e DPN2;
2. Kontroll dhe respektimi nga Drejtoritë e DPN 2 të afateve të zgjidhshmërisë/kthim përgjigjeve të ankesave.

K. Sektori i Administratës

1. Garantimi i menaxhimit të burimeve njerëzore duke zbatuar rekrutimin, trajnimin, vlerësimin;
2. Administrimi i dokumentacionit;
3. Miradministrim sistemi IT, pajisje.

➤ **Drejtoria e Prodhim Mirëmbajtjes:**

- Sektorët: Teknik, asfaltit, pllakave, zgarave dhe prodhimit
- 1. Mirëmbajtje e shtresave asfaltike në rrugët e qytetit të Tiranës;
- 2. Mirëmbajtje e trotuareve dhe shesheve publike;
- 3. Mirëmbajtje dhe sistemim të rrjetit K.U.SH, pusetave në rrugë e trotuare;
- 4. Përballimi i emergjencave të ndryshme në varësi të kushteve atmosferike;
- 5. Evidentimi dhe ndërhyrja në kohë e problematikave të ndryshme në rrugë dhe trotuare;
- 6. Planifikimi dhe përlllogaritja e bazës materiale dhe volumeve që kërkon çdo ndërhyrje;
- 7. Mbulimi dhe kontrolli i gjithë territorit që administrohet nga Bashkia Tiranë.

➤ **Drejtoria e Ndrëçimit Publik dhe sinjalistikës rrugore:**

Sektori: Teknik, i ndrëçimit publik, i sinjalistikës rrugore

1. Planifikimi i mirëmbajtjes së rrjetit elektrik dhe semaforik, riparimi i defekteve të ndodhura në rrjet;
2. Plotësimi me staf të specializuar dhe me mjete specifike transporti për të mbushur funksionet shtesë të Drejtorisë;
3. Kontroll, koordinim dhe menaxhim i problematikave të ndryshme të ndodhura nga faktorë të jashtëm.

➤ **Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale:**

1. Monitorimi i vazhdueshëm dhe menaxhimi, nëpërmjet ndërhyrjeve teknike në diga për ritjen e sigurisë së rezervuarëve;
2. Sigurimi i gjendjes optimale të sistemve vaditëse dhe kulluese, në tërësinë e tyre dhe veçanërisht në rrjetet me probleme teknike, me qëllim shtimin e sipërfaqeve të ujitura dhe të kulluara;
3. Përmirësimi në tërësi i gjendjes teknike të rrugëve rurale lidhëse midis fshatrave, rindërtimi i shtesave rrugore dhe i veprave të artit dhe mbrojtëse të trasesë së rrugës.

Ajo çfarë vihet re nga regjistri i riskut është se të gjitha risqet e parashikuara për vitin 2020, të paraqitura nga sektorët e drejtorive përkatëse, janë të njëjta me ato të paraqitura edhe një vit më parë, pra në 2019. Nga ky fenomen përjashtohet Sektori i Monitorimit pjesë e Drejtorisë Administratë Financë, i cili ka qenë sektor i ri i krijuar dhe bërë pjesë e strukturës organizative të DPRrNP, në vitin 2020. Përveç përgatitjes së regjistrit të riskut në rang institucioni për gjithë drejtorinë përbërëse të DPRrNP, janë përgatitur edhe regjistrat e riskut më vete për secilën drejtori me shkresat si vijon:

- nr. 3695 prot., datë 17.12.2019 – Drejtoria e Administratë Financës;
- nr. 3695/1 prot., datë 24.12.2019 – Drejtoria e Ndrëçimit Publik dhe Sinjalistikës Rrugore;
- nr. 3695/2 prot., datë 24.12.2019 – Drejtoria Prodhim Mirëmbajtje;
- nr. 3695/3 prot., datë 24.12.2019 – Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale.
- Për vitin 2021, është përgatitur regjistri i riskut sipas formatit që përcaktohet në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, bazuar në Urdhër i brendshëm nr. 3328 prot., datë 04.12.2020 “Për hartimin e regjistrit për menaxhimin e riskut”. Regjistri i riskut, nr. 3328/1 prot., datë 23.12.2021 (***Sgarim:*** *Përsa i takon datës 23.12.2021, të cilën ka shkresa bashkëlidhëse e regjistrit të riskut e vitit 2021, u verifikua me regjistrat e protokollit që shkresa me nr. 3328/1 prot., është regjistruar me datën 23.12.2020 në protokoll, ndërkohë që në*

shkresën fizike, data është vendosur gabimisht si 23.12.2021, si pasojë e një lapsusi.), që është hartuar për të gjitha drejtoritë që kanë qenë pjesë përbërëse e strukturës organizative të DPRrNP për vitin 2021, ka pasur të përfshirë risqet e secilit prej sektorëve përbërës të katër drejtorive pjesë përbërëse e DPRrNP për vitin 2021 dhe strukturave të reja të formuara brenda drejtorive përkatëse. Në këtë regjistër janë përshkruar disa nga risqet kryesore për këtë vit duke krijuar një pamje më analitike të situatave, duke përcaktuar edhe nivelin e secilit prej risqeve para dhe pas kontrollit. Gjithashtu janë përcaktuar nevojat për kontrollin e mëtejshme, veprimet për të zgjidhur mangësitë, duke identifikuar në të njëjtën kohë edhe zotëruesit e riskut. Disa nga risqet e identifikuar kanë të bëjnë me objektiva, si vijon:

➤ **Drejtoria e Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve:**

Sektori i Financës

1. Administrimi i të gjithë asetëve në përdorim, magazinimi, ruajtja dhe qarkullimi i materialeve për përmbushjen e detyrave të DPRrNP;
2. Implementimi i sistemit financiar për administrimin e të gjithë dokumentave financiare dhe standartizimin e tyre;
3. Ndjekja e realizimit të kontratave të blerjes së mallarave, zbatimi dhe likuidimi i tyre;
4. Likuidimi i gjithë kontratave mallra, shërbime dhe punime në kohë dhe brenda vitit buxhetor për të synuar realizimin në masën 100%.

Sektori i Transportit

1. Hartimi i normativave për materialet shpenzuese si karburant;
2. Gadishmëria e mjeteve të transportit në mbështetje të proceseve të mirëmbajtjes dhe lëvizjen e bazës materiale;
3. Plotësimi me mjete specifike transporti për të mbushur funksionet shtesë të drejtorisë.

Sektori Juridik dhe Prokurimeve

1. Mosrealizimi në kohë i procedurave të prokurimit;

Sektori i Monitorimit

1. Marrje dhe përpunim informacioni në bashkëpunim me Drejtoritë pjesë e DPN2;
2. Kontroll dhe respektimi nga Drejtoritë e DPN 2 të afateve të zgjidhshmërisë/kthim përgjigjeve të ankesave.

Sektori i Burimeve Njerëzore

1. Garantimi i menaxhimit të burimeve njerëzore duke zbatuar rekrutimin, trajnimin, vlerësimin;
2. Administrimi i dokumentacionit;
3. Miradministrim sistemi IT, pajisje.

➤ **Drejtoria e Prodhim Mirëmbajtjes:**

L. Sektorët: Teknik, asfaltit, pllakave, zgarave dhe prodhimit

1. Mirëmbajtje e trotuareve dhe shesheve publike;
2. Mirëmbajtje e shtresave asfaltike në rrugët e qytetit të Tiranës;
3. Mirëmbajtje dhe sistemim të rrjetit K.U.SH, puseta në rrugë e trotuare;

4. Evidentimi dhe ndërhyrja në kohë e problematikave të ndryshme në rrugë dhe trotuare;
5. Përballimi i emergjencave të ndryshme në varësi të kushteve atmosferike;
6. Planifikimi dhe përlogaritja e bazës materiale dhe volumeve që kërkon çdo ndërhyrje;
7. Mbulimi dhe kontrolli i gjithë territorit që administrohet nga Bashkia Tiranë.

➤ **Drejtoria e Ndrëimit Publik dhe Sinjalistikës Rrugore:**

- M. Sektori: Teknik, i ndrëimit publik, i sinjalistikës rrugore
1. Planifikimi i mirëmbajtjes së rrjetit elektrik dhe semaforik, riparimi i defekteve të ndodhura në rrjet;
 2. Plotësimi me staf të specializuar dhe me mjete specifike transporti për të mbushur funksionet shtesë të Drejtorisë;
 3. Kontroll, koordinim dhe menaxhim i problematikave të ndryshme të ndodhura nga faktorë të jashtëm.

➤ **Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale:**

1. Monitorimi i vazhdueshëm dhe menaxhimi, nëpërmjet ndërhyrjeve teknike në diga për rritjen e sigurisë së rezervuarëve;
2. Sigurimi i gjendjes optimale të sistemeve vaditëse dhe kulluese, në tërësinë e tyre dhe veçanërisht në rrjetet me probleme teknike, me qëllim shtimin e sipërfaqeve të ujitura dhe të kulluara;
3. Përmirësimi në tërësi i gjendjes teknike të rrugëve rurale lidhëse midis fshatrave, rindërtimi i shtesave rrugore dhe i veprave të artit dhe mbrojtëse të trasesë së rrugës.

Ajo çfarë vihet re nga regjistri i riskut është se të gjitha risqet e parashikuara për vitin 2021, të paraqitura nga sektorët e drejtorive përkatëse, janë të njëjta me ato të paraqitura edhe një vit më parë, pra në 2020. Përveç përgatitjes së regjistrit të riskut në rang institucioni, evidentohet se është përgatitur edhe regjistri i riskut më vete për Drejtorinë e Ndrëimit Publik dhe Sinjalistikës Rrugore, me shkresën nr. 3328/2 prot., datë 23.12.2020.

▪ Për vitin 2022, është përgatitur regjistri i riskut sipas formatit që përcaktohet në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, bazuar në Urdhër nr. 3628 prot., datë 31.12.2021 “Për hartimin e regjistrit për menaxhimin e riskut dhe Raportit vjetor për hapat e kontrollit të brendshëm”. Në këtë regjister janë përshkruar disa nga risqet kryesore për këtë vit duke krijuar një pamje më analitike të situatave, duke përcaktuar edhe nivelin e secilit prej risqeve para dhe pas kontrollit. Gjithashtu janë përcaktuar nevojat për kontrollet e mëtejshme, veprimet për të zgjidhur mangësitë, duke identifikuar në të njëjtën kohë edhe zotëruesit e riskut.

Duke qenë se për këtë vit, regjistrat janë përgatitur nga secila drejtori e institucionit, disa nga risqet e identifikuar kanë të bëjnë me objektiva, si vijon:

➤ **Drejtoria e Financës, Transportit dhe Burimeve Njerëzore:** shkresa nr. 3628/1 prot., datë 07.01.2022

Sektori i Financës

1. Administrimi i të gjithë asetëve në përdorim, magazinimi, ruajtja dhe qarkullimi i materialeve për përmbushjen e detyrave të DP;
2. Implementimi i sistemit financiar për administrimin e të gjithë dokumentave financiare dhe standartizimin e tyre;
3. Ndjekja e realizimit të kontratave të blerjes së mallarave, zbatimi dhe likuidimi i tyre;

4. Likujdimi i gjithë kontratave mallra, shërbime dhe punime në kohë dhe brenda vitit buxhetor për të synuar realizimin në masën 100%.

Sektori i Transportit

1. Hartimi i normativave për materialet shpenzuese si karburant;
2. Gadishmëria e mjeteve të transportit në mbështetje të proceseve të mirëmbajtjes dhe lëvizjen e bazës materiale;
3. Plotësimi me mjete specifike transporti për të mbushur funksionet shtesë të drejtorisë.

Sektori i Burimeve Njerëzore

1. Garantimi i menaxhimit të burimeve njerëzore duke zbatuar rekrutimin, trajnimin, vlerësimin;
2. Ruajtja e dokumentacionit;
3. Miradministrim sistemi IT, pajisje.

➤ **Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale:** shkresa nr.3628/2 prot., datë 07.01.2022

1. Monitorimi i vazhdueshëm dhe menaxhimi, nëpërmjet ndërhyrjeve teknike në diga për rritjen e sigurisë së rezervuarëve;
2. Sigurimi i gjendjes optimale të sistemve vaditëse dhe kulluese, në tërësinë e tyre dhe veçanërisht në rrjetet me probleme teknike, me qëllim shtimin e sipërfaqeve të ujitura dhe të kulluara;
3. Përmirësimi në tërësi i gjendjes teknike të rrugëve rurale lidhëse midis fshatrave, rindërtimi i shtesave rrugore dhe i veprave të artit dhe mbrojtëse të trasesë së rrugës.

➤ **Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve Urbane dhe Drejtoria e Mirëmbajtjes së Trotuareve dhe Ujrave të shiut:** shkresa nr.3628/3 prot., datë 07.01.2022

Sektorët: Teknik, asfaltit, pllakave, zgarave dhe prodhimit

1. Mirëmbajtje e trotuareve dhe shesheve publike;
2. Mirëmbajtje e shtresave asfaltike në rrugët e qytetit të Tiranës;
3. Mirëmbajtje dhe sistemim të rrjetit K.U.SH, pusetave në rrugë e trotuare;
4. Evidentimi dhe ndërhyrja në kohë e problematikave të ndryshme në rrugë dhe trotuare;
5. Përballimi i emergjencave të ndryshme në varësi të kushteve atmosferike;
6. Planifikimi dhe përlllogaritja e bazës materiale dhe volumeve që kërkon çdo ndërhyrje;
7. Mbulimi dhe kontrolli i gjithë territorit që administrohet nga Bashkia Tiranë.

➤ **Drejtoria e Ndricimit Publik:** shkresa nr.3628/4 prot., datë 07.01.2022

Sektori: Teknik, i ndriçimit publik zona A dhe zona B

1. Planifikimi i mirëmbajtjes së rrjetit elektrik, riparimi i defekteve të ndodhura në rrjet;
2. Plotësimi me staf të specializuar dhe me mjete specifike transporti për të mbushur funksionet shtesë të Drejtorisë.

➤ **Drejtoria e Sinjalistikës Rrugore:** shkresa nr.3628/5 prot., datë 07.01.2022

Sektori: Sinjalistika vertikale dhe sinjalistika horizontale

1. Planifikimi i mirëmbajtjes së rrjetit semaforik, riparimi i defekteve të ndodhura në rrjet;
2. Plotësimi me staf të specializuar dhe me mjete specifike transporti për të mbushur funksionet shtesë të Drejtorisë;

3. Kontroll, koordinim dhe menaxhim i problematikave të ndryshme të ndodhura nga faktorë të jashtëm.

➤ **Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve:** shkresa nr.3628/6 prot., datë 08.01.2022

Sektori Juridik dhe Prokurimeve

1. Mosrealizimi në kohë i procedurave të prokurimit;

Sektori i Monitorimit

1. Marrje dhe përpunim informacioni në bashkëpunim me Drejtoritë pjesë e DP;

2. Kontroll dhe respektimi nga Drejtoritë e DP të afateve të zgjidhshmërisë/kthim përgjigjeve të ankesave.

Ajo çfarë vihet re nga regjistri i riskut është se të gjitha risqet e parashikuara për vitin 2022, të paraqitura nga sektorët e drejtorive përkatëse, janë të njëjta me ato të paraqitura edhe një vit më parë, pra në 2021.

Konkluzion:

Nga auditimi evidentohet se, në regjistrin e riskut të përgatitur për secilin nga sektorët e drejtorive të DPRrNP, për vitet objekt auditimi 2019 – 2022, janë paraqitur të njëjtat risqe çdo vit, që lidhen me veprimtarinë e këtyre sektorëve. Regjistri i riskut për vitet objekt auditimi nuk është përditësuar, duke mos evidentuar dhe përfshirë risqe të reja, të cilat mund të jenë konstatuar nga njëri vit në tjetrin. Për më tepër, duke marrë në konsideratë edhe faktin që periudha e mos ndryshimit të këtyre risqeve, është periudha 4 – vjeçare, ku përfshihen vitet 2019 – 2022. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 11, pika 2; dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 2.2. “Rolet dhe aktorët në sistemin e MFK-së”, Rubrika 2.2.9 “Menaxherët e tjerë të njërive publike”, pika c)⁷.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut për periudhën 2019 - 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 8, pika a).

Plani Strategjik për vitet 2019 - 2022

Plani strategjik është përgatitur për një periudhë 5 – vjeçare, konkretisht periudha nga 2019 – 2023, shkresa nr. 158 prot., datë 17.01.2019, bazuar në Urdhër të Brendshëm Nr. 2757, datë 26.09.2018 “Për përgatitjen e planit strategjik 5 - vjeçar 2019 – 2023 dhe planit vjetor 2019”. Ky plan strategjik është përgatitur referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 8, pika a).

3. Mbi veprimtaritë e kontrollit

Grupi i Menaxhimit Strategjik

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik nuk është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik në asnjë nga vitet objekt auditimi, periudha 2019 – 2022. Ky veprim

⁷ Menaxherët e tjerë në njësitë publike janë përgjegjës për:

c) identifikimin dhe zhvillimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që rrezikojnë arritjen e objektivave dhe përmbushjen e suksesshme të veprimtarive të structures për të cilën janë përgjegjës brenda njësisë.

është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 8, pika b).

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nuk ka një urdhër ku të përcaktohet Koordinatori i Riskut. Mungesa e një urdhëri për caktimin e Koordinatorit të Riskut, është veprim në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 10; dhe Udhëzim Nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Vendime të GMS

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nuk janë të dokumentuara në formë shkresore minutat e takimit për vitet 2019 – 2022, për mbledhjet që kryen GMS, si rrjedhojë e mos krijimit të këtij grupi për periudhën objekt auditimi. Nisur nga ky fenomen, vihet re mospërgatitja e disa dokumentave si plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm, të cilat janë rezultat i mbledhjeve që duhet të realizojë GMS dhe vendimeve që merren në to. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 27, pika 1.

Deklarata e Cilësisë për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm, vitet 2019 - 2022

Deklarata e Cilësisë për vitin 2019, është hartuar referuar shkresës nr. 3684/6 prot., datë 31.01.2020, bazuar në Ligjin Nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Neni 18, pika 1.

Deklarata e Cilësisë është hartuar gjithashtu edhe për vitet 2020, 2021 dhe 2022, por dokumenti nuk përmban numër protokollit për asnjë nga vitet. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Neni 15, pikat 1, 2 dhe 3; VKM Nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e rregullores së njëzuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”; “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 13.

Pyetësi i Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për vitet 2019 – 2022, nuk është hartuar dhe miratuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 24, pika 1 dhe 2; dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.5, rubrika “Procedura e vetëvlerësimit”

Raporti Vjetor i Cilësisë për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, 2019 – 2022

■ Për vitin 2019 është hartuar, referuar shkresës nr. 3684/7 prot., datë 31.01.2020 “Raport përfundimtar për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik”, bazuar në Ligjin Nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Neni 18, pika 1. Në këtë raport janë paraqitur konstatimet për Drejtorinë e Administratë Financës, Drejtorinë e Ndriçimit Publik, Drejtorinë e Prodhim Mirëmbajtjes dhe Drejtorinë e Kullimit dhe Rrugëve Rurale, gjatë vitit 2019. Për secilën nga drejtoritë pjesë bërëbërëse e strukturës së DPRrNP, janë hartuar shkresat si vijon:

- nr. 3684/1 prot., datë 24.01.2020 - Drejtoria e Prodhim Mirëmbajtjes;
- nr. 3684/2 prot., datë 24.01.2020 - Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale;

- nr. 3684/3 prot., datë 24.01.2020- Drejtoria e Ndriçimit Publik dhe Sinjalistikës Rrugore;
 - nr. 3684/4 prot., datë 24.01.2020 - Drejtoria e Administratë Financës.
- Gjithashtu bashkëlidhur është përgatitur edhe manuali për sistemin e kontrollit të brendshëm për DPRRNP, pra manual i përgjithshëm për institucionin nr. 3684/5 prot., datë 31.01.2020.
- Për vitin 2020 është hartuar për secilën nga drejtoritë më vete, bazuar në Urdhër i Brendshëm nr. 3326 prot., datë 11.12.2020 “Për raportin vjetor të hapave të kontrollit të Brendshëm”, si më poshtë vijon:
 - nr. 3437 prot., datë 22.12.2020 – Drejtoria e Administratë Financës;
 - nr. 3326/1 prot., datë 18.12.2020 – Drejtoria e Ndriçimit Publik dhe Sinjalistikës Rrugore;
 - nr. 3430 prot., datë 22.12.2020 – Drejtoria Prodhim Mirëmbajtje;
 - nr. 3422 prot., datë 22.12.2020 – Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale.
 - Për vitin 2021 është hartuar për secilën nga drejtoritë më vete, bazuar në Urdhër nr. 3628 prot., datë 31.12.2021 “Për hartimin e Regjistrimit për Menaxhimin e Riskut dhe Raportit vjetor për hapat e kontrollit të brendshëm”, si më poshtë vijon:
 - nr. 3628/1 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Financës, Transportit dhe Burimeve Njerëzore;
 - nr. 3628/2 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale.
 - nr. 3628/3 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Mirëmbajtjes së Trotuareve dhe Ujrave të Shiut; dhe Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve Urbane;
 - nr. 3628/4 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Ndriçimit Publik;
 - nr. 3628/5 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Sinjalistikës Rrugore;
 - nr. 3628/6 prot., datë 08.01.2022 – Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve.
 - Për vitin 2022 është hartuar për secilën nga drejtoritë më vete, bazuar në Urdhër nr. 3619 prot., datë 07.12.2022 “Për hartimin e Regjistrimit për Menaxhimin e Riskut dhe Raportit vjetor për hapat e kontrollit të brendshëm”, si më poshtë vijon:
 - nr. 3619/1 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve;
 - nr. 3619/2 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale.
 - nr. 3619/3 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria e Ndriçimit Publik;
 - nr. 3619/4 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria e Sinjalistikës Rrugore;
 - nr. 3619/5 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve Urbane
 - nr. 3619/6 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria e Mirëmbajtjes së Trotuareve dhe Ujrave të Shiut;
 - nr. 3619/7 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve.

Konkluzion:

Nga auditimi rezulton se, në këto raporte të përgatitura për secilin nga vitet 2019 – 2022, përgjithësisht kanë qenë të përcaktuara fushat në të cilat është ushtruar kontrolli, lidhur me përmbushjen e detyrave përkatëse për secilën nga drejtoritë e sipërpërmendura. Është specifikuar edhe shpeshësia e kontrollit gjatë vitit, muaji në të cilin është kryer kontrolli, dosjet që janë kontrolluar dhe rezultatet e parregullsive të konstatuara për secilin sektor, apo edhe punonjësit e kontrolluar, kryesisht për sektorët e punës së terrenit.

Në disa raste evidentohet se disa sektorë nuk kanë specifikuar në raportin e kontrollit të brendshëm procedurat e sektorit apo fushat përkatëse, mbi të cilat është ushtruar kontrolli. Gjithashtu disa sektorë të drejtorive përkatëse, nuk kanë paraqitur asnjë të dhënë për parregullsitë e gjetura ose jo (nëse s'ka pasur të tilla), si rezultat i kontrollit të kryer. Në mjaft raste, disa sektorë të drejtorive të DPRrNP kanë paraqitur te raporti i kontrollit të brendshëm, se kontrolli ka qenë periodik 12 (dymbëdhjetë) herë në vit, ndërkohë që kontrolli ka qenë vetëm për një, dy ose tre muaj gjithsej, gjatë gjithë vitit. Lidhur me muajin apo muajt e kontrolluar nga disa sektorë, ka pasur pasaktësi në paraqitjen e vitit të cilit i përkasin këta muaj, ky konstatim referuar dhe bazuar te periodha, për të cilën ka qenë i përgatitur ky raport.

Harta e Proceseve të Punës për periudhën 2019 - 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pika 3.3.

Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin për periudhën 2019 - 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Kapitulli IV.

Plani për Kontrollin e Brendshëm për vitet 2019 - 2022, nuk është hartuar dhe miratuar, e si rrjedhim nuk figuron si dokument në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar Neni 22, pika 1; dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pika 3.3.

Plani i Veprimit për Arritjen e Objektivave për periudhën 2019 - 2022, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në DPRrNP. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 8, pika 8 a).

Gjurmët standarde të auditimit për periudhën 2019 - 2022, si gjurma e zbatimit të Buxhetit, gjurma për prokurimet me vlerë nën 1.000.000 lekë dhe mbi 1.000.000 lekë pa TVSH etj., për procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në DPRrNP, nuk janë hartuar dhe miratuar. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 16, pika 2 dhe 3.

Plani vjetor i punës, për vitet 2019 - 2022

▪ Plani vjetor i punës për vitin 2019, është hartuar për të gjitha drejtoritë dhe sektorët përbërës të DPRrNP, bazuar në Urdhër i Brendshëm Nr. 2757, datë 26.09.2018, pa numër protokoll “Për përgatitjen e Planit Vjetor 2019”, referuar shkresës nr. 157 prot., datë 17.01.2019. Në këtë plan vjetor janë përcaktuar detyrat për sektorët përkatës të çdo drejtorie dhe janë përshkruar objektivat në terma sasimore dhe cilësore, sipas rastit.

▪ Plani vjetor i punës për vitin 2020, është hartuar për të gjitha drejtoritë dhe sektorët përbërës të DPRrNP, bazuar në Urdhër i Brendshëm Nr. 3163, datë 05.12.2019, nr. 3613 prot, datë 05.12.2019 “Për përgatitjen e Planit Vjetor 2020”. Evidentohet se planet vjetore janë përgatitur në mënyrë specifike nga secila drejtori pjesë e DPRrNP për vitin 2020, gjithashtu është përgatitur edhe një plan vjetor pune në rang institucioni, që përmbledh të gjitha planet vjetore të drejtorive pjesë përbërëse e DPRrNP.

Planet vjetore të punës për secilën drejtori paraqiten si vijon:

- nr. 3613/4 prot., datë 27.12.2019 – Drejtoria e Administratë Financës;
- nr. 3613/2 prot., datë 27.12.2019 – Drejtoria e Ndriçimit Publik dhe Sinjaistikës Rrugore;
- nr. 3613/1 prot., datë 27.12.2019 – Drejtoria Prodhim Mirëmbajtje;
- nr. 3613/3 prot., datë 27.12.2019 – Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale.

Në planin vjetor të përgjithshëm të përgatitur në rang institucioni, shkresa nr. 3613/6 prot., datë 31.12.2019, konstatohet se janë përcaktuar detyrat për çdo sektor dhe janë përshkruar objektivat në terma sasiore dhe cilësore, sipas rastit.

▪ Plani vjetor i punës për vitin 2021, është hartuar për të gjitha drejtoritë dhe sektorët përbërës të DPRrNP, bazuar në Urdhër i Brendshëm nr. 3327 prot., datë 11.12.2020 “Për hartimin e planit vjetor të punës dhe objektivat 2021”. Evidentohet se nuk ka një plan të përgjithshëm pune të përgatitur në rang institucioni. Ndërsa përse i takon planeve vjetore, janë përgatitur në mënyrë specifike nga secila drejtori, pjesë e DPRrNP për vitin 2021. Planet vjetore të punës për secilën drejtori paraqiten si vijon:

- nr. 3327/1 prot., datë 12.01.2021 – Drejtoria e Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve;

(**Shënim:** shkresa nr. 3327/1 prot., datë 12.01.2021, në regjistrin e protokollit nuk figuron me datën 12.01.2021, por figuron si shkresa nr. 3327/1 prot., datë 18.12.2020)

- nr. 3327/2 prot., datë 18.12.2020 – Drejtoria e Ndriçimit Publik dhe Sinjaistikës Rrugore;
- nr. 3432 prot., datë 22.12.2020 – Drejtoria Prodhim Mirëmbajtje;
- nr. 3423 prot., datë 22.12.2020 – Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale.

▪ Plani vjetor i punës për vitin 2022, është hartuar për të gjitha drejtoritë dhe sektorët përbërës të DPRrNP, bazuar në Urdhër nr.3629 prot., datë 31.12.2021 “Për hartimin e planit vjetor të punës dhe objektivat 2022”. Evidentohet se planet vjetore janë përgatitur në mënyrë specifike nga secila drejtori pjesë e DPRrNP për vitin 2022.

- nr. 3629/1 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Financës, Transportit dhe Burimeve Njerëzore;
- nr. 3629/2 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale;
- nr. 3629/3 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria Prodhim Mirëmbajtje;
- nr. 3629/4 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Ndriçimit Publik;
- nr. 3629/5 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Sinjalistikës Rrugore;
- nr. 3629/6 prot., datë 08.01.2022 – Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve.

Nga këto plane janë evidentuar fenomene si vijon:

*Plani i përgatitur nga Drejtoria e Ndriçimit Publik dhe Sinjaistikës Rrugore nuk ka pasur specifikme për kohën e realizueshmërisë së punimeve në shumicën e rasteve.

*Plani i përgatitur nga Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale nuk ka pasur specifikme për kryerjen e punimeve dhe mirëmbajtjen, duke përcaktuar zonat konkrete, sipas nevojës.

*Plani i përgatitur nga Drejtoria Prodhim Mirëmbajtje ka pasur të specifikuar volumin e punimeve dhe asfaltimet që do kryheshin në zonat e përcaktuara, duke specifikuar edhe periudhën e parashikuar për realizimin e këtyre punimeve.

*Plani i përgatitur nga Drejtoria e Financës, Transportit dhe Burimeve Njerëzore ka pasaktësi në datën e paraqitjes së planit, nuk ka objektiva të matshëm dhe të monitorueshëm në aspektin kohor, ka një paraqitje jo të qartë midis objektivave dhe detyrave që ka secili sektor.

*Plani i përgatitur nga Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale ka objektiva jo të mirë përcaktuar, të paplotë, të paspecifikuar, përse i takon faktorit kohë. Ka të dhëna përse i takon punimeve për sistemet e kullimit, ujitjes, mirëmbajtjen e rrugëve rurale, sistemet e vaditjes dhe afatin e punimeve. Jo të gjithë sektorët e kësaj drejtorie kanë përcaktuar objektiva. Ato janë përcaktuar vetëm në rang drejtorie.

*Plani i përgatitur nga Drejtoria Prodhim Mirëmbajtje, ka pasur përcaktime me anë të të dhënave sasiore për parashikimet e punimeve të vitit dhe gjithashtu për periudhën e punimeve për njësitë specifike. Objektiva të përcaktuar nuk ka pasur, përse i takon faktorit kohë.

*Plani i përgatitur nga Drejtoria e Ndriçimit Publik ka pasaktësi në vitin e paraqitur te tabelat që përmban plani. Përmban parashikime për mirëmbajtjen dhe pajisjen me aksesore ndriçimi gjatë vitit.

*Plani i përgatitur nga Drejtoria e Sinjalistikës Rrugore, ka pasaktësi në vitin e paraqitur te tabelat që përmban plani.

*Plani i përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve nuk ka afate kohore të përcaktuara për objektivat.

Konkluzion:

Nga auditimi rezulton se identifikimi dhe formulimi i një pjese të madhe të objektivave të drejtorive dhe sektorëve që janë pjesë përbërëse e DPRrNP, nuk ka qenë specifik duke adresuar mënyrën si është parashikuar të arrihet çdo objektivi. Nuk është përcaktuar në mënyrë specifike periudha/ koha e parashikuar e realizimit për secilin prej tyre, në mënyrë që t'i bëjë këto objektiva të matshëm, të arritshëm, të përshtatshëm dhe të përcaktuar në kohë, me qëllim kjo që monitorimi i zbatueshmërisë së tyre të jetë efektiv. Kjo për arsye se jo të gjitha objektivat mund të duan një vit kohë të realizimit, pavarësisht se plani i punës është i hartuar për një hark kohor vjetor. *Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pika 3.2, rubrika "Vendosja e objektivave".*

Për periudhën objekt auditimi është evidentuar se planet vjetore të punës së Drejtorisë së Prodhim Mirëmbajtjes, kanë të përcaktuar afatin e parashikimit të kryerjes së punimeve dhe volumin e këtyre punimeve (të dhënat sasiore), si psh. për sistemimin e rrugëve, mirëmbajtje të trotuareve, asfaltime, mirëmbajtje dhe sistemim të rrjetit të ujrave të shiut etj. Përcaktim të periudhës së parashikuar të kryerjes së punimeve konstatohen edhe në Sektorin e Sinjalistikës Rrugore – Drejtoria e Ndriçimit Publik dhe Sinjalistika Rrugore në raste të pakëta; dhe për disa nga sektorët e Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale.

Analiza Vjetore e Punës për periudhën 2019 – 2022

▪ Analiza vjetore e punës për vitin 2019, është përgatitur për secilën nga drejtoritë më vete, si vijon:

- Drejtoria e Administratë Financës;
- Drejtoria Prodhim Mirëmbajtje;
- Drejtoria e Ndriçimit Publik dhe Sinjalistikës Rrugore;
- Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale.

Asnjë nga shkresat takuese për secilën nga drejtoritë e lartpërmendura nuk përmban numër protokollit dhe nuk është hartuar një Urdhër, mbi të cilin të bazohet përgatitja e këtyre planeve.

▪ Analiza vjetore e punës për vitin 2020, është hartuar bazuar në Urdhër i brendshëm nr. 3329 prot., datë 11.12.2020 “Për analizën vjetore të punës”.

Analiza vjetore është përgatitur për secilën nga drejtoritë më vete, si vijon:

- nr. 3329/1 prot., datë 12.01.2021 – Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale;
- nr. 3329/2 prot., datë 12.01.2021 – Drejtoria e Ndriçimit Publik dhe Sinjalistikës Rrugore;
- nr. 3329/3 prot., datë 13.01.2021 dhe nr. 3329/4 datë 13.01.2021 – Drejtoria e Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve;
- nr. 82 prot., datë 12.01.2021 – Drejtoria Prodhim Mirëmbajtje.

▪ Analiza vjetore e punës për vitin 2021, është hartuar bazuar në Urdhër nr. 3630 prot., datë 31.12.2021 “Për hartimin e analizës vjetore të punës për vitin 2021”.

Analiza vjetore është përgatitur për secilën nga drejtoritë më vete, si vijon:

- nr. 3630/1 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve;
- nr. 3630/2 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale;
- nr. 3630/3 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve Urbane dhe Drejtoria e Mirëmbajtjes së Trotuareve dhe Kullimit të Ujrave të Shiut;
- nr. 3630/4 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Ndriçimit Publik;
- nr. 3630/5 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria e Sinjalistikës Rrugore;
- nr. 3630/6 prot., datë 07.01.2022 – Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve.

▪ Analiza vjetore e punës për vitin 2022, është hartuar bazuar në Urdhër nr. 3618 prot., datë 07.12.2022 “Për hartimin e analizës vjetore të punës për vitin 2022”.

Analiza vjetore është përgatitur për secilën nga drejtoritë më vete, si vijon:

- nr. 3618/1 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve;
- nr. 3618/2 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale;
- nr. 3618/3 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria e Ndriçimit Publik;
- nr. 3618/4 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria e Sinjalistikës Rrugore;
- nr. 3618/5 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve Urbane;
- nr. 3618/6 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria e Mirëmbajtjes së Trotuareve dhe Kullimit të Ujrave të Shiut;
- nr. 3618/7 prot., datë 05.01.2023 – Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve.

Konkluzion:

Nga auditimi rezultoi se në shumicën e dokumentave shkresore, të përgatitura për periudhën 2019 – 2022, nuk janë ndjekur rregullat dhe normat tekniko-profesionale të protokoll arkivës. Ky fenomen rezulton pasi në disa raste shkresa e parë e dokumentit të përgatitur rezulton të ketë marrë një numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të nuk janë identifikuar me të njëjtin numër rendor dhe renditjen progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Neni 15, pikat 1, 2 dhe 3; VKM Nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”; “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19, pika 1; dhe me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për

4. Informacioni dhe komunikimi

Mjetet e komunikimit për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik janë forma shkresore dhe email-et. Në aspektin organizativ dhe funksional, çdo drejtori raporton te Drejtori i Përgjithshëm i institucionit nëpërmjet planeve, relacioneve, raporteve të ndryshme etj. Informacioni shkëmbehet në nivel horizontal dhe vertikal. Për mënyrën e realizimit të komunikimit të brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, evidentohet se komunikimi zyrtar realizohet nëpërmjet sistemit elektronik. Komunikimi dhe shkëmbimi elektronik i dokumenteve zyrtare, brenda institucionit realizohet duke përdorur postën elektronike (e-mail) dhe dërgesa në institucionet e tjera bëhet në formë shkresore zyrtare, me shërbim postar. Ajo çfarë evidentohet nga praktika është se punonjësit përdorin më tepër postën elektronike personale, ndërkohë që duhet bërë e mundur që të mund të përdorin postën elektronike të institucionit, për përmbushjen e detyrave të tyre funksionale.

DPRrNP garanton transparencën e veprimtarisë së saj për publikun, vetëm nëpërmjet afishimit të njoftimeve publike në stendat e caktuara të institucionit, gjë që vlen edhe për njoftimet e rekrutimeve për pozicione vakante. Të gjitha publikimet e njoftimeve për rekrutime shpallen në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë dhe në stendat që ndodhen në ambientet e DPRrNP. Kjo pasi DPRrNP nuk ka një faqe zyrtare të përditësuar. Njoftime të kësaj kategorie, pra lidhur me punësimin, ky institucion i afishon vetëm në ambientet e institucionit. Ndërsa pjesa e procedurës së rekrutimit ndiqet e gjitha nga DPRrNP.

Për periudhën objekt auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare.

5. Monitorimi

Mungesa e GMS dhe mos caktimi i një menaxheri në cilësinë e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatorit të Riskut, mos hartimi i strategjisë së menaxhimit të riskut, mos hartimit të planit për kontrollin e brendshëm, planit të veprimit për arritjen e objektivave, mospërditësimi i Rregullores së Brendshme etj., ka sjellë mungesë efektiviteti në procesin e monitorimit, pasqyruar kjo si rrjedhojë edhe mbi ecurinë e njësisë publike në tërësi dhe realizimin e objektivave të saj.

Një nga format për realizimin e monitorimit, është edhe pyetësori i vetëvlerësimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, që në këtë institucion nuk është hartuar. Gjatë auditimit u konstatua se funksionimi i kontrollit të brendshëm në DPRrNP për vitet 2019 - 2022, nuk ka qenë i organizuar dhe plotësisht funksional, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Kjo vihet re edhe nga mospërmbushja e objektivave në mënyrë jo të plotë për komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Situata: Në DPRrNP, për vitet objekt auditimi 2019 - 2022, Rregullorja e Brendshme e institucionit, nuk ka qenë e përditësuar me ndryshimet që kanë ndodhur në strukturën organizative të institucionit, ku gjatë këtyre viteve është vënë re se numri dhe përbërja e drejtorive të DPRrNP ka ndryshuar.

Nuk është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik, si dhe nuk ka pasur një urdhër ku të përcaktohej koordinatori i riskut dhe koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik. Mungesa e GMS ka sjellë mos përgatitjen e dokumentacionit shkresor që pasqyron minutat e takimit dhe marrjen e vendimeve të këtij grupi. Si rrjedhojë e kësaj, nuk është hartuar plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, pyetëtori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, strategjia e menaxhimit të riskut, plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm.

Gjithashtu nuk është përgatitur harta e proceseve të punës dhe gjurmët standarde të auditimit për procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore të DPRrNP.

Nuk është hartuar një rregullore specifike për ndjekjen e procedurave të ruajtjes, mbrojtjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, nuk është hartuar asnjë manual apo rregullore specifike për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve të IT-së, si dhe nuk është hartuar Rregullorja e Posaçme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Kodi i etikës së institucionit nuk është hartuar si dokument më vete, por disa pika të tij kanë qenë të përfshira në Nenin 12, të Rregullores së Brendshme të DPRrNP. Shpalljet për vende të lira pune, nuk janë dërguar zyrtarisht për tu publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Në strukturën organizative të miratuar për këto vite, nuk ka pasur të parashikuara dhe përcaktuara pozicione me prioritet, për kategorinë e personave të cilësuar me statusin PAK. Në disa nga dosjet e personelit, për periudhën objekt auditimi, nuk kanë qenë të përfshira fotokopje të noterizuara të diplomave bachelor dhe/ose master bashkë me listën e notave për programin përkatës të studimit, por kanë pasur vetëm fotokopje të pa noterizuar të tyre. Gjithashtu është evidentuar se raporti i aftësisë në punë, nuk ka qenë i përditësuar në mënyrë periodike.

Përsa i takon trajnimeve të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Sektori i Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar dhe miratuar një program trajnimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore, si dhe nuk ka pasur të planifikuara fonde të dedikuara për trajnimin e punonjësve.

Regjistri i riskut i përgatitur për secilin nga sektorët e drejtorive të DPRrNP, për vitet objekt auditimi nuk ka pasur përditësime, duke mos evidentuar dhe përfshirë risqe të reja, të cilat mund të jenë konstatuar nga njëri vit në tjetrin. Gjithashtu është evidentuar se raporti vjetor i cilësisë për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm i përgatitur për periudhën objekt auditimi, në disa raste nuk ka pasur të specifikuar procedurat apo fushat përkatëse mbi të cilat është ushtruar kontrolli, duke mos paraqitur asnjë të dhënë për parregullsitë e gjetura, si rezultat i kontrollit të kryer. Nga disa sektorë, lidhur me periudhën e kontrolluar, ka pasur pasaktësi në paraqitjen e vitit në të cilin është kryer kontrolli.

Në planet vjetore të punës të përgatitura nga drejtoritë e DPRrNP për vitet 2019 - 2022, identifikimi dhe formulimi i një pjese të madhe të objektivave të drejtorive dhe sektorëve, nuk ka qenë specifik duke adresuar mënyrën për realizimin e secilit objektiv. Nuk është përcaktuar periudha/ koha e parashikuar e realizimit për secilin prej objektivave, në mënyrë që t'i bëjë këto objektiva të matshëm, të arritshëm, të përshtatshëm dhe të përcaktuar në kohë, me qëllim që monitorimi i zbatueshmërisë së tyre të jetë efektiv.

Përsa i përket shumicës së dokumentave shkresore të përgatitura për periudhën objekt auditimi, nuk janë ndjekur rregullat dhe normat tekniko-profesionale të protokoll arkivës. Kjo pasi në disa raste shkresa e parë e dokumentit të përgatitur rezulton të ketë marrë një numër rendor të

plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të nuk janë identifikuar me të njëjtin numër rendor dhe renditjen progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenet 8, 10, 11, 16, 22, 24, 27 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin pikat 2.2, 2.2.5, 3.1, 3.2, 3.3, 3.5 dhe Kapitulli IV; gjithashtu dhe baza ligjore si më poshtë vijon:

- Udhëzim Nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;
- Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, rubrika Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike, pika 5;
- Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” neni 1 dhe 2 pika 1, 4;
- Ligji nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 19, pika 1 dhe 2;
- Ligji nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, Neni 2, pika b) dhe Neni 5, pika c);
- Ligji nr.15/2019 dt.13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”;
- VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”;
- VKM Nr. 639, datë 7.9.2016 “Për përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”, të ndryshuar.
- Ligji nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Neni 15, pikat 1, 2 dhe 3; VKM Nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”; “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 13 dhe Neni 19, pika 1.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

- Drejtori i Përgjithshëm i DPRrNP për periudhën (15.10.2020 – 04.09.2023), z. H.RR ;
- Drejtori i Përgjithshëm i DPRrNP për periudhën (25.02.2016 – 15.10.2020), z. E.K ;
- Nëpunës zbatues, Drejtor i Financës për periudhën (07.03.2016 – 23.09.2019), znj. L.C ;
- Nëpunës zbatues, Drejtor i Financës për periudhën (23.09.2019 – 16.11.2020), znj. E.M ;
- Nëpunës zbatues, Drejtor i Financës për periudhën (17.11.2020 – vazhdim), z. S.M .

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Akt Konstatimit Nr. 1 nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 1775/3 prot., datë 03.06.2024, administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr.1 dhe në Rekomandimin nr. 1.1;1.2 të Projekt Raportit sqarojmë se:

Përsa i përket rekomandimeve të tjera, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka nxjerrë një sërë urdhrash ku urdhëron strukturat përgjegjëse për marrjen e masave të menjëhershme me qëllim zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, si mëposhtë vijon:

Nr. 2134 Prot., datë 28.05.2024 Urdhër për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit Nr.1.2 për hartimin e Kodit të Etikës dhe Rregullores së Posaçme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;

Nr. 2134/1 Prot., datë 28.05.2024 Urdhër për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Kodit të Etikës dhe Rregullores së Posaçme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;

Nr.04 Prot., datë 03.01.2024 Urdhër për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik dhe rolit të tij në Sistemin e Menaxhimit Strategjik dhe të Kontrollit;

Nr.2114 prot., datë 28.05.2024 Urdhër për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit Nr.1.2 për hartimin e Manualit të përdorimit të paisjeve kompjuterike;

Nr.434 Prot., datë 31.01.2024 Urdhër për rishikimin e Rregullores së Brendshme;

Nr.1641 Prot., datë 23.04.2024 Urdhër për mbledhjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), për caktimin e koordinatorit të riskut, hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut dhe Regjistrimit të Riskut, hartimin e gjurmës së auditit;

Nr.1641/2 Prot., datë 23.04.2024 Urdhër për hapat e marra për trajnimin e stafit;

Nr.1641/3 Prot., datë 23.04.2024 Urdhër për marrje masash për hartimin e hartave të proceseve të punës;

Nr.1641/4 Prot., datë 23.04.2024 Urdhër për marrje masash në lidhje me zbatimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit si dhe rritjen e cilësisë së proceseve të këtij Sistemi;

Nr.1641/5 Prot., datë 23.04.2024 Urdhër për identifikimin e risqeve në përshtatje të objektivave vjetore;

Nr.1641/16 Prot., datë 23.04.2024 Urdhër për hartimin e rregullave dhe procedurave për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të ndryshme;

Nr.1641/21 Prot., datë 23.04.2024 Urdhër për krijimin e sistemeve të informacionit dhe komunikimit sipas procedurave për MFK-në.

-Përsa i përket gjetjes se në disa prej dosjeve në periudhën e auditimit, nuk kanë qënë të përfshira fotokopjet e noterizuara të diplomave bch/ose master, konfirmojmë se anomali të tilla mund të ketë patur në dosjet e të larguarve, të cilët kanë tërhequr dokumentat origjinale dhe gjatë procesit, fotokopjimi i dokumentacionit nuk është kryer i plotë dhe i saktë.

Lidhur me azhurnimin e dosjeve të personelit, kryesisht me raportet e aftësisë për punë, janë marrë masa nga sektori i Burimeve Njerëzore për rifreskimin e tyre në vijueshmëri. Konkretisht Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore u ka kërkuar drejtorëve të drejtorive që të marrin masa për njoftim mbi përditësimin e dokumentacionit për stafin e tyre. Ky veprim verifikohet me Procesverbal Mbledhje, datë 09.02.2024, mbajtur në bllokun nr. 601 prot, datë 09.02.2024. Specialisti i personelit i ngarkuar me këtë detyrë ka kontakt të vazhdueshëm me punonjësit për azhurnimin e dosjeve në vijimësi. Po ashtu po vijon procesi krijimit të fashikujve brenda dosjeve të personelit, nga punonjësit që janë lëvizuar brenda organikës.

-Përsa i përket gjetjes ku DPRRNP nuk ka hartuar dhe miratuar një program trajnimi dhe zhvillimi të BNJ, si dhe nuk ka patur të planifikuar fonde të dedikuara për trajnimin e punonjësve, nga institucioni përveç Planit Vjetor të Trajnimit dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Bashkinë Tiranë, me email zyrtar , është dërguar dhe shkresa nr. 1664 prot., datë 24.04.2024 me lëndë “Kërkesë për planifikim trajnimi”. Po ashtu në shkresën nr 1666/5 prot., datë 29.04.2024, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm nr. 1666/1 prot , datë 25.04.2024 për “Krijimin e komisionit për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-27”, është kërkuar planifikimi i fondeve për trajnimin e stafit për tema specifike trajnimi që lidhen kryesisht me MFK dhe Prokurimet Publike, Sistemi i Fiskalizimit, të cilat nuk na janë ofruar nga Bashkia Tiranë.

-Përsa i përket hartimit të dokumentave shkresore konform rregullave dhe normave tekniko-profesionale sipas ligjit “Për arkivën”, vërejmë që në vitin 2020 janë protokolluar me numra të rinj prot., përcjelljet e shkresave, për urdhërat: “Për raportin vjetor të hapave të kontrollit të brëndshëm”, “Për hartimin e planit vjetor të punës dhe objektivat për vitin 2021”, “Për hartimin e Rregjistrit dhe Menaxhimit të Riskut”, “Për Analizën Vjetore të Punës”.

Kjo praktikë është sistemuar në vitet në vijim. Punonjësit e Protokoll/Arkivës janë informuar për mënyrën e protokollimit të dokumentacionit sipas rregullit (numër progresiv dhe fraksionet përkatëse sipas të njëjtës procedurë).

Përsa i përket gjetjes nga auditimi për njoftimin dhe publikimin e vendeve vakante, kemi marrë masa për publikimin e vendeve vakante në faqen e AKPA, që nga data 01.02.2024. Ky veprim verifikohet me mail zyrtar dhe numrat e gjurmimit si më poshtë:

/vlp 202402/8245; vlp 202402/8246; /vlp 202402/8247; /vlp 202403/9668; /vlp 202403/9669 /vlp/202403/9670; /vlp/202403/9671;

1.Për gjetjen nr 1, në faqen 31 të Projekt raportit thuhet se: “ Në regjistrin e riskut të përgatitur për secilin nga sektorët e drejtorive të DPRRNP, për vitet objekt auditimi 2019-2022 janë paraqitur të njëjtat rrisqe çdo vit”, sqarojmë se DPRRNP është një drejtori që merret me mirëmbajtje dhe nuk ka ndryshim të objektit të saj, rrisqet janë pothuajse të njëjta, por mund të ketë vënd për parashikim më të hollësishëm të rrisqeve.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Për sa më sipër, në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacionin e dërguar nga përfaqësuesit e subjektit të audituar, grupi i auditimit sqaron si vijon:

- Lidhur me nisjen e marrjes së masave nga ana juaj si institucion, për të përmirësuar funksionimin dhe organizimin e punës suaj mbështetur në komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, duke ngritur urdhrat bashkëlidhur për një pjesë të pikave që u janë lënë në rekomandimet përkatëse, theksojmë se nisja e këtij procesi është vetëm faza e parë e ndërmarrjes së iniciativës nga ana e institucionit tuaj për të iniciuar fillimin dhe më tej zhvillimin e secilit proces deri në krijimin e praktikave dhe dokumentacioneve përkatëse. Kjo do të thotë se të gjitha pikat e rekomandimeve vazhdojnë të qëndrojnë në fuqi nga grupi i auditimit, deri në përmbushjen e tyre.

Për arsyet sa më sipër, observacioni juaj për këtë pretendim pranohet pjesërisht për në raportin e auditimit.

2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet si pas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj.

2.5. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

- Programimi PBA dhe programim i i buxhetit vjetor. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar),
Ligji nr. 10296, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"
Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor,
Ligji nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore",
Udhëzimi nr. 10 datë 28.02.2020, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023",
VKM nr. 123 datë 28.09.2020 "Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Tiranë dhe të tavanëve përgatitore të PBA- s për 2021-2023"
Udhëzimi nr. 07 datë 26.02.2021, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024",
VKM nr. 58 datë 06.04.2021 "Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Tiranë dhe të tavanëve përgatitore të PBA- s për 2022-2024"
Udhëzimi nr. 8 datë 28.02.2021, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025",
VKM nr. 33 datë 06.04.2022 "Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Tiranë dhe të tavanëve përgatitore të PBA- s për 2023-2025"

Viti 2019

Përgatitja e PBA 2020-2022

Kërkesat për planifikimin buxhetor afatmesëm për periudhën 2020- 2022 janë të mbështetura në objektivat e caktuara nga Bashkia Tiranë, në ankesat e qytetarëve, ankesat e ardhura nga portali Tirana ime shkresat e ardhura nga vetë qytetarët, ku Drejtoria e Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit i vuri në dispozicion grupit auditues dokumentin e Bashkisë Tiranë ku janë rradhitur këto ankesa te portali Tirana Ime, nga qytetarët, Numri i Gjelbërt, nga insitucionet e vartësisë.

Më datë 31.05.2019, me nr. 22875 prot., Bashkia Tiranë, i ka nisur të gjitha institucioneve të varësisë shkresën mbi "Përgatitjen e PBA-s 2020-2022". Në përgjigje të shkresës nr. 22875 prot., datë 31.05.2019, të Bashkisë të Tiranës, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, ka ngritur Urdhërin e Brendshëm nr. 1778, datë 06.06.2019 Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2020- 2022.

Më datë 21.06.2019, me shkresën nr. 1778/5 prot., Drejtoria e Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit i ka nisur Bashkisë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar Projekt Buxhetin Vjetor dhe Afatmesëm 2020-2022 si dhe relacion të buxhetit për periudhën janar- maj 2019. Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 159, datë 26.12.2019, Drejtoria e Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, i krijuar me aktin perkates të miratuar nga Këshilli Bashkiak, ka ndryshuar emërtimin në Drejtoria e Pergjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Programimi i shpenzimeve për vitin 2020-2022 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimetsipasprogrameve	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	04520(Rjeti Rrugor)	1,241,085	82.8	910,049	74.8	1,077,658	74.7
2	04240(Menaxhimi I infrastruktures se ujitjes dhe kullimit)	18,658	1.2	18,658	1.5	19,591	1.4
3	04520(transferta specifike)	19,318	1.3	23,181	1.9	27,817	1.9
4	06440(Ndricim rruges)	220,000	15	264,000	22	316,800	21.97
	TOTALI	1,499,061		1,215,888		1,441,866	

Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2020-2022, paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

\	Shpenzimetsipasprogrameve	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	273,903	18%				
2	Sigurime (601)	45,757	3%				
3	Shpenzime operative (602)	834,556	56%	997,735		1,194,483	
	Shpenzime (603)						
	Shpenzime (604)						
	Shpenzime (606)	13,695	1%				
	Shpenzime (609)						
	Shpenzime për investime (230-231)	331,150	22%	218,153		247,383	
	Tot.	1,499,061					

Shenim :Parashikimi i pagave dhe sigurimeve plotesohet vetem për vitin e parë të PBA

Burimet e fondeve

Burimet e financimit të këtij buxheti janë në total në vlerën 1,393,671,257 lekë:

- 1,346,759,763 lekë Fonde nga të ardhurat e Bashkisë, zënë 97 % të totalit të të ardhurave
- 46,911,494 lekë Fonde nga transferta specifike, zënë 3 % të totalit të të ardhurave.

Emertimi	Plani	Çelja	Fakti	Diferenca
Fondetëkushtëzuara				0
Fondetëpakushtëzuara				0
Fondengatransfertaspecifike	67,909,788	67,909,788	46,911,494	20,998,294
Fondengateardhur e Bashkisë	1,622,031,077	1,398,574,694	1,346,759,763	51,814,931
Fondengatëardhur e veta				0
Fondetëtjera				0
Shuma	1,689,940,865	1,466,484,482	1,393,671,257	72,813,225

Burimi: DPRRNP, përpunoi Grupi i Auditimit

Shpenzimet buxhetor sipas klasifikimit ekonomik

Art	Emertimi	Buxheti 2019	Celje 2019	Fakt
600	Paga	287,258,291	271,434,502	257,367,681

601	Sigurime	45,739,827	43,400,000	42,940,254
602	Ujitja&Kullimi	31,150,615	31,150,615	31,084,563
602	RrugetRurale	36,759,173	36,759,173	36,324,521
602		961,414,168	781,094,928	779,434,423
606	Trans. Per Buxh. Fam. dhe Ind.	565,498	565,498	565,498
231	Investimet	327,053,293	302,079,766	302,079,760
Totali		1,689,940,865	1,466,484,482	1,449,796,700

Burimi: DPRRNP, përpunoi Grupi i Auditimit

Buxheti për vitin 2019 është realizuar në vlerën 1,449,796,700 lekë nga të cilat 58 % e vlerës së shpenzimeve zë llogaria 602 Mallra dhe Shërbime të Tjera, 21 % llogaritë 600- 601 Paga dhe sigurime dhe 21 % për investimet. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e Sheshit Skenderbej nuk është përfshirë në llogarinë 602 Mallra dhe shërbime të tjera.

Investimet

Planifikimi vjetor i investimeve për vitin 2019 është në vlerën 327,053,293 lekë për 32 kode projektsh nga të cilat realizimi është kryer për 24 kode projektsh në vlerën 302,079,760 lekë, ose 92.3 % nga ajo çfarë është planifikuar. Në planin e rishikuar vlera është ulur në 306,739,430 nga e cila 98.48 % është realizuar.

Viti 2020

Përgatitja e PBA 2021-2023

Kërkesat për planifikimin buxhetor afatmesëm për periudhën 2021- 2023 janë të mbështetura në objektivat e caktuara nga Bashkia Tiranë, në ankesat e qytetarëve, ankesat e ardhura nga portali Tirana ime shkresat e ardhura nga vetë qytetarët, ku DPRRNP i vuri në dispozicion grupit auditues dokumentin e Bashkisë Tiranë ku janë rradhitur këto ankesa te portali Tirana Ime, nga qytetarët, Numri i Gjellbërt, nga insitucionet e vartësisë.

Më datë 21.06.2019, me shkresën nr. 1778/5 prot., Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i ka nisur Bashkisë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar Projekt Buxhetin Vjetor dhe Afatmesëm 2020-2022 si dhe relacion të buxhetit për periudhën janar- maj 2019. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është drejtori nëvarësi të Bashkisë Tiranë. Më datë 22.10.2020, me nr. 36685 prot., Bashkia Tiranë, i ka nisur të gjitha institucioneve të varësisë shkresën mbi “Përgatitjen e PBA-s 2021-2023”. Në përgjigje të shkresës nr. 36685 prot., datë 22.10.2020, të Bashkisë të Tiranës, Drejtori ka ngritur Urdhërin e Brendshëm nr. 2817, datë 26.10.2020 Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021- 2023.

NZ është caktuar z. S.M , Drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Menaxhimit të Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik në shkresën e nisur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me nr. 21613/1, datë 25.11.2020.

Programimi i shpenzimeve për vitin 2021-2023 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	04520(Rjeti Rrugor)	1,020,995	74.5	679,287	61.8	866,887	63.3

2	04240(Menaxhimi I infrastruktures se ujitjes dhe kullimit)	20,407	1.5	24,489	2.2	29,386	2.1
3	04520(transferta specifike)	23,170	1.7	27,805	2.5	33,366	2.4
4	06440(Ndricim rruges)	305,930	22	367,117	33	440,540	32.15
	TOTALI	1,370,502	100	1,098,698	100	1,370,179	100

Burimi: DPRRNP, përpunoi Grupi i Auditimit

Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2021-2023, paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	290,219	21%				
2	Sigurime (601)	48,430	4%				
3	Shpenzime operative (602)	842,793	61%	1,000,698		1,190,179	
	Shpenzime (603)						
	Shpenzime (604)						
	Shpenzime (606)	14,443	1%				
	Shpenzime (609)						
	Shpenzime për investime (230-231)	174,617	13%	98,000		180,000	
	Tot.	1,370,502					

Shenim: Parashikimi i pagave dhe sigurimeve plotësohet vetëm për vitin e parë të PBA

Burimet e fondeve:

Burimet e financimit të këtij buxheti, janë:

- 1,330,405,883 lekë Fonde nga të ardhurat e Bashkisë dhe zë 97 % të totalit të të ardhurave
- 39,199,890 lekë Fonde nga transferata specifike dhe zë 3 % të totalit të të ardhurave.

Emertimi	Plani	Çelja	Fakti	Diferenca
Fondetëkushtëzuara				0
Fondetëpakushtëzuara				0
Fondengatransfertaspecifike	40,558,491	40558491	39,199,890	1,358,601
Fondengateardhurat e Bashkisë	1,451,089,560	1,352,895,311	1,330,405,883	22,489,428
Fondengatëardhurat e veta				0
Fondetëtjera				0
				0
Shuma	1,491,648,051	1,393,453,802	1,369,605,773	23,848,029

Burimi: DPRRNP, përpunoi Grupi i Auditimit

Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik

Art	Emertimi	Buxheti 2020	Celje 2020	Fakt
600	Paga	299,050,568	282,550,568	271,694,936
601	Sigurime	47,710,000	45,750,000	45,329,943
602	Ujitja&Kullimi	20,496,028	20,496,028	20,392,907
602	Rrjetirrugor	20,062,463	20,062,463	18,806,983
602		470,000,000	442,000,002	441,763,716
602	NdricimRruges	276,000,000	276,000,000	275,997,340

Art	Emertimi	Buxheti 2020	Celje 2020	Fakt
602	Menaxhimidhemirembajtja e Qytetit	49,811,422	49,811,422	38,836,630
606	Trans. Per Buxh. Fam. dhe Ind.	933,432	933,432	933,432
231	Investimet	307,584,138	255,849,887	255,849,886
	Totali	1,491,648,051	1,393,453,802	1,369,605,773

Burimi: DPRRNP, përpunoi Grupi i Auditimit

Buxheti për vitin 2020 është realizuar në vlerën 1,369,605,773 lekë nga të cilat 58 % e vlerës së shpenzimeve zë llogaria 602 Mallra dhe Shërbime të Tjera, 23 % llogaritë 600- 601 Paga dhe sigurime dhe 19 % për investimet. Në llogarinë 602 Menaxhimi dhe mirëmbajtja e Sheshit Skenderbej zë 5 % të llogarisë 602.

Investimet

Planifikimi vjetor i investimeve për vitin 2020 është në vlerën 307,584,138 lekë për 22 kode projektsh nga të cilat realizimi është kryer për 19 kode projektsh në vlerën 255,849,887 lekë ose 83.1 % nga ajo çfarë është planifikuar.

Viti 2021

Përgatitja e PBA 2022-2024

Kërkesat për planifikimin buxhetor afatmesëm për periudhën 2022- 2024 janë të mbështetura në objektivat e caktuara nga Bashkia Tiranë, në ankesat e qytetarëve, ankesat e ardhura nga portali Tirana ime shkresat e ardhura nga vetë qytetarët, ku DPRRNP i vuri në dispozicion grupit auditues dokumentit e Bashkisë Tiranë ku janë rradhitur këto ankesa te portali Tirana Ime, nga qytetarët, Numri i Gjellbërt, nga insitucionet e vartësisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është drejtori nëvarësi të Bashkisë Tiranë. Më datë 14.04.2021, me nr. 15631 prot., Bashkia Tiranë, i ka nisur të gjitha institucioneve të varësisë shkresën mbi “Përgatitjen e PBA-s 2022-2024”.

Më datë 31.05.2021, me shkresën nr. 1115/1 prot., Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i ka nisur Bashkisë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar Projekt Buxhetin Vjetor dhe Afatmesëm 2022-2024 (faza e 1) si dhe relacion të buxhetit për periudhën janar- prill 2021.

Më datë 19.08.2021, me nr. 32070 prot., Bashkia Tiranë, i ka nisur të gjitha institucioneve të varësisë shkresën mbi fazën e dytë mbi “Përgatitjen e PBA-s 2022-2024”.

Në përgjigje të shkresës nr. 32070 prot., datë 19.08.2021, të Bashkisë të Tiranës, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, ka ngritur Urdhërin e Brendshëm nr. 2319, datë 27.08.2021 Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022- 2024 (faza e dytë).

Më datë 22.09.2021, me shkresën nr. 2319/3 prot., Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i ka nisur Bashkisë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar Projekt Buxhetin Vjetor dhe Afatmesëm 2022-2024 (faza e dytë).

Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standard të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2022-2024 si, objektivat, qëllimi, roli i PBA, prioritet kryesore, parashikimi i investimeve dhe i shpenzimeve operative. Nevojat e shpenzimeve që parashikohen për punimet dhe

shërbimet në mbarëvajtjen e aktivitetit të DPRRNP, janë hartuar në bazë të kërkesave të drejtorive të varësisë.

Programimi i shpenzimeve për vitin 2022-2024 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimetsipasprogrameve	Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	04520(Rjeti Rrugor)	925,116	70.7	615,580	60.9	632,088	60.6
2	04240(Menaxhimi I infrastruktures se ujitjes dhe kullimit)	20,430	1.6	21,247	2.1	25,496	2.4
3	04520(transferta specifike)	23,182	1.8	24,109	2.4	25,000	2.4
4	06440(Ndricim rruges)	340,000	26	350,000	35	360,000	34.53
	TOTALI	1,843,642	100	1,092,358	100	1,122,516	100

Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2022-2024, paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Shpenzimetsipasprogrameve	Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	305,224	20%				
2	Sigurime (601)	50,972	3%				
3	Shpenzime operative (602)	934,271	62%	1,010,936		1,042,584	
	Shpenzime (603)						
	Shpenzime (604)						
	Shpenzime (606)	15,261	1%				
	Shpenzime (609)						
	Shpenzime për investime)230-231)	190,000	13%	190,000		190,000	
	Tot.	1,495,728					

Shenim: Parashikimi i pagave dhe sigurimeve plotësohet vetëm për vitin e parë të PBA

Burimet e fondeve

Burimet e financimit të këtij buxheti janë në total në vlerën 1,300,298,152 lekë:

- 1,237,898,732 lekë Fonde nga të ardhurat e Bashkisë, nga të cilat 339,671,066 lekë janë shpenzuar për llogarinë 600- 601, 773,812,287 lekë për llogarinë 602- 609 dhe 124,415,379 lekë për llogarinë 23. Këto fonde zënë 95 % të të ardhurave;

- 62,399,420 lekë Fonde të pakushtezuara (grant dhe transferte specifike), janë shpenzuar për llogarinë 602-609 dhe zënë 5 % të totalit të të ardhurave.

Emertimi	Kap	Plani	Çelja	Fakti	Diferenca per tumbartur
Shpenzime Personeli 6009999 Art. (600-601)		351,813,075	342,913,075	339,671,066	3,242,009
Fondengate ardhurat e Bashkisë	5	351,813,075	342,913,075	339,671,066	3,242,009
Fondet e pakushtezuara (grant dhe transferte specifike)	1				-
Fondet e kushtezuara	1				-
Fondet e ardhurave jashtë limiti (donator etj)	6				-

Emertimi	Kap	Plani	Çelja	Fakti	Diferenca per tumbartur
Shpenzime Operative 6029999 Art. (602-609)		901,716,612	897,711,587	836,211,707	61,499,880
Fondengateardhurat e Bashkisë	5	798,784,350	794,779,325	773,812,287	20,967,038
Fondetëpakushtezuara (grant dhe transferespecifike)	1	102,932,262	102,932,262	62,399,420	40,532,842
Fondetëkushtëzuara	1				-
Fondetëardhurajashtëlimiti (donator etj)	6				-
ShpenzimeKapitale 2319999 Art. (230-231)		231,641,515	171,262,379	124,415,379	46,847,000
Fondengateardhurat e Bashkisë	5	184,794,515	124,415,379	124,415,379	-
Fondetëpakushtezuara (grant dhe transferespecifike)	1				-
Fondetëkushtëzuara	1	46,847,000	46,847,000		46,847,000
Fondetëardhurajashtëlimiti (donator etj)	6				-
TOTAL		1,485,171,202	1,411,887,041	1,300,298,152	111,588,889

Shpenzimet buxhetor sipas klasifikimit ekonomik.

Art	Emertimi	Buxheti 2021	Celje 2021	Fakt
600	Paga	303,383,575	295,383,575	292,576,584
601	Sigurime	48,429,500	47,529,500	47,094,482
602	Ujitja&Kullimi	21,743,614	21,743,614	20,068,549
602	Rrjetirrugor	20,883,291	20,883,291	18,226,596
602	DPRRNP	468,218,434	468,000,000	448,076,437
602	NdricimRruges	60,305,357	60,305,357	24,104,275
602	NdricimRruges	276,000,000	276,000,000	276,000,000
602	Menaxhimidhemirembajtja e SheshitSkenderbej	53,286,591	49,500,000	48,456,525
606	Trans. Per Buxh. Fam. dhe Ind.	1,279,325	1,279,325	1,279,325
231	Investimet	231,641,515	171,262,379	124,415,379
Totali		1,485,171,202	1,411,887,041	1,300,298,152

Burimi: DPRRNP, përpunoi Grupi i Auditimit

Buxheti për vitin 2021 është realizuar në vlerën 1,300,298,152 lekë nga të cilat 64 % e vlerës së shpenzimeve zë llogaria 602 Mallra dhe Shërbime të Tjera, 26 % llogaritë 600- 601 Paga dhe sigurime dhe 10 % për investimet. Në llogarinë 602 Menaxhimi dhe mirëmbajtja e Sheshit Skenderbej zë 6 % të llogarisë 602.

Investimet

Planifikimi vjetor i investimeve për vitin 2021 është në vlerën 231,641,515 lekë për 19 kode projektsh nga të cilat realizimi është kryer për 12 kode projektsh në vlerën 124,415,379 lekë ose 53.7 % nga ajo çfarë është planifikuar.

Viti 2022

Përgatitja e PBA 2023-2025

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është drejtori në varësi të Bashkisë Tiranë. Kjo drejtori ka në përbërje të saj: Drejtorinë e Mirëmbajtjes së Rrugëve Urbane, Drejtorinë e Mirëmbajtjes së Trotuarëve e Ujërave të shiut, Drejtorinë e Ndriçimit, Drejtorinë e sinjalistikës rrugore, Drejtorinë e financës burimeve njerëzore dhe shërbimeve, Drejtoria juridike dhe prokurimeve, Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale.

Bashkia Tiranë me urdhërin nr. 14961, datë 20.04.2022 ka ngritur grupin e menaxhimit strategjik ku NZ është Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar.

Bashkia Tiranë me urdhërin nr. 14962, datë 20.04.2022 ka ngritur ekipet e menaxhimit të programeve.

Në zbatim të shkresës së ardhur nga Bashkia Tiranë, me nr. 15199 prot., datë 21.04.2022, mbi “Përgatitjen e PBA-s 2023-2025”, janë ngritur grupet e punës, sipas urdhërit të brendshëm nr. 1190/1 prot., datë 29.04.2022. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i ka nisur Bashkisë Tiranë si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, më datë 08.06.2022, me nr. 1680 prot. Programin buxhetor afatmesëm 2023- 2025 si dhe relacionin e buxhetit për periudhën janar- prill 2022.

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i ka nisur Bashkisë Tiranë si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, më datë 06.09.2022, me nr. 2542 prot. Programin buxhetor afatmesëm 2023- 2025 si dhe relacionin e buxhetit për periudhën janar-gusht 2022.

Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimetsipasprogrameve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	04520(Rjeti Rrugor)	1,499,842	81.4	748,558	68.5	778,716	69.4
2	04240(Menaxhimi I infrastruktures se ujitjes dhe kullimit)	22,500	1.2	22,500	2.1	22,500	2.0
3	04520(transferta specifike)	21,300	1.2	21,300	1.9	21,300	1.9
4	06440(Ndricim rruges)	300,000	16	300,000	27	300,000	26.73
	TOTALI	1,843,642	100	1,092,358	100	1,122,516	100

Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2023-2025, paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Shpenzimetsipasprogrameve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	314,380					
2	Sigurime (601)	52,502					
3	Shpenzime operative (602)	1,075,177		1,092,358		1,122,516	
	Shpenzime (603)						
	Shpenzime (604)						
	Shpenzime (606)	15,719					
	Shpenzime (609)						
	Shpenzime për investime)230-231)	385,864		351,632		300,808	
	Tot.						

Shenim: Parashikimi i pagave dhe sigurimeve plotësohet vetëm për vitin e parë të PBA

Burimet e fondeve

Burimet e financimit të këtij buxheti janë në total në vlerën 1,593,291,726 lekë:

- 1,154,632,899 lekë Fonde nga të ardhurat e Bashkisë, nga të cilat 358,256,030 lekë janë shpenzuar për llogarinë 600- 601; 564,784,738 lekë për llogarinë 602- 609 dhe 231,592,131 lekë për llogarinë 231. Këto fonde zënë 72.4 % të totalit të të ardhurave.

- 397,351,277 lekë Fonde të pakushtezuara (grant dhe transferte specifike), janë shpenzuar për llogarinë 602-609 dhe zënë 25 % të totalit të të ardhurave.

- 41,307,550 lekë Fonde të kushtezuara, janë shpenzuar për llogarinë 231 dhe zënë 2.6 % të totalit të të ardhurave.

Emertimi	Kap	Plani	Çelja	Fakti	Diferenca per tumbartur
Shpenzime Personeli 6009999 Art. (600-601)		367,949,971	362,297,531	358,256,030	4,041,501
Fondengate ardhurat e Bashkisë	5	367,949,971	362,297,531	358,256,030	4,041,501
Fondetë pakushtezuara (grant dhe transferte specifike)	1				0
Fondetë kushtezuara	1				0
Fondetë ardhurajashtëlimiti (donator etj)	6				0
Shpenzime Operative 6029999 Art. (602-609)		1,001,778,482	977,991,482	962,136,015	15,855,467
Fondengate ardhurat e Bashkisë	5	592,469,469	568,682,469	564,784,738	3,897,731
Fondetë pakushtezuara (grant dhe transferte specifike)	1	409,309,013	409,309,013	397,351,277	11,957,736
Fondetë kushtezuara	1				0
Fondetë ardhurajashtëlimiti (donator etj)	6				0
Shpenzime Kapitale 2319999 Art. (230-231)		309,913,032	272,899,681	272,899,681	0
Fondengate ardhurat e Bashkisë	5	268,605,482	231,592,131	231,592,131	0
Fondetë pakushtezuara (grant dhe transferte specifike)	1				0
Fondetë kushtezuara	1	41,307,550	41,307,550	41,307,550	0
Fondetë ardhurajashtëlimiti (donator etj)	6				0
TOTAL		1,679,641,485	1,613,188,694	1,593,291,726	19,896,968

Shpenzimet buxhetor sipas klasifikimit ekonomik

Art	Emertimi	Buxheti 2022	Celje 2022	Fakt
600	Paga	315,981,017		306,997,426
601	Sigurime	51,968,954		51,258,604
600-601	Paga, sigurime		362,297,531	
602	Ujitja & Kullimi	24,181,178	24,181,178	24,105,278
602	Rrjetirrugor	23,926,753	23,926,753	23,883,409
602	Shpenzim materiale	125,000,000	125,000,000	124,998,838
602	Ndricim Rrugesh	336,201,082	236,201,082	304,363,752
602	Drejtoria e përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik	428,700,000		425,236,969

602	Menaxhimidhemirembajtja e SheshitSkenderbej	53,287,000		49,065,300
602	Mallra dhe sherbime te tjera (tot.)		568,682,469	
606	Transferimfondesh	10,482,469		10,482,469
231	Investimet	309,913,032	272,899,681	272,899,681
Totali		1,679,641,485	1,613,188,694	1,593,291,726

Buxheti për vitin 2022 është realizuar në vlerën 1,593,291,726 lekë nga të cilat 60 % e vlerës së shpenzimeve zë llogaria 602 Mallra dhe Shërbime të Tjera, 22 % llogaritë 600- 601 Paga dhe sigurime, 17 % për investimet dhe 1 % llogaria 606 Trans per Buxh. Fam. & Individ. Në llogarinë 602 Menaxhimi dhe mirëmbajtja e Sheshit Skenderbej zë 5 % tëllogarisë 602.

Mirëmbajtja dhe menaxhimi i Sheshit Skenderbej:

- Vendimi i Këshillit Teknik nr. 3, 20.02.2019 Projekt- zbatimi Mirembajtja dhe menaxhimi i Sheshit Skënderbej, e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë.
- Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike i ka nisur shkresën nr. 33366, më datë 10.09.2019, mbi marrjen e masave për planifikimin e buxhetit për vitin 2020 për mirëmbajtjen e Sheshit “Skënderbej” pas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve ku citohet nga viti buxhetor 2020 do të lind nevoja për mirëmbajtje të vazhdueshme nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit.
- Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit me shkresën nr. 2579/1, datë 11.09.2019 i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike planifikim të saktë të fondeve buxhetore që do i nevojiten për periudhën e mbetur (shtator- dhjetor) të vitit 2019 (shtesë buxheti) dhe vitit 2020.
- Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike me shkresën nr. 33366/2, më datë 12.09.2019 i ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit projektin, studimin e fizibilitetit të detajuar në lidhje me mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Sheshit Skenderbej për një periudhë 3 vjeçare.
- Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit me shkresën nr. 2579/2, më datë 03.10.2019 i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme e Punëve Publike projektin, mbi nevojën e marrjes së masave për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Sheshit Skenderbej duke rivlerësuar nevojën që ka ky shesh për mirëmbajtje të veçantë, ku kanë shprehur se kanë pamundësi të burimeve njerëzore, financiare, teknologjisë së përdorur për ofrimin e këtyre shërbimeve të nevojshme.
- Këshilli Bashkiak i ka nisur Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit Vendimin me nr. 109, më datë 25.10.2019, “Për kalimin në administrin të Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit të pasurisë me sipërfaqe prej 9000 m², nr. 127/2, zk 3471, me status pronë shtet, në pronësi të Bashkisë Tiranë”.

Viti	Objektii prokurimeve	Vlera e Kontrates (me TVSH)	FirmaFituese	Fatura/Date	Vlera eFatures	Likuiduar total ngakont ratagjat evitit	DIFERE NCA qembetet per Vitinpasardhes	Likuidime		
								Nr.urdhershpen zimt	Data	Vlera

							2020/2021/ 2022/2023			
2020	Mirëmbajtja e Sheshit Skenderbej	22,188,840	F.SHPK	Fatura nr.10 serial 77431910 date 31.12.2020	3,758,677	18,430,162	3,758,677	19	16.02.2021	3,758,677
2021	Mirëmbajtje e sheshit Skenderbej	23,837,340	F.SHPK	Fatura nr.294/2021 dt.31.12.2021	3,466,706	20,370,634	3,466,706	13	14.02.2022	3,466,706

Mirëmbajtja e Sheshit Skënderbej për vitin 2020 dhe 2021 është kryer nga firma fituese, subjekti “F” SHPK. Vlera e kontratës sipas viteve është:

- Në vitin 2020, 22,188,840 lekë, likuaduar nga financa përgjatë vitit 2020 vlera 18,420,162 lekë dhe diferencën 3,758,677 lekë në shkurt të vitit 2021.
- Në vitin 2021, 23,837,340 lekë, likuaduar nga financa përgjatë vitit 2021 vlera 20,370,634 lekë dhe diferencën 3,466,706 lekë në shkurt të vitit 2022.

Edhe pse është kërkuar që të përfshihet Mirëmbajtja dhe menaxhimi i Sheshit Skenderbej duke filluar nga viti 2020, vetëm në vitin buxhetor të vitit 2022 është përfshirë.

Investimet

Planifikimi vjetor i investimeve për vitin 2022 është në vlerën 398,950,972 lekë për 17 kode projektsh nga të cilat realizimi është kryer për 13 kode projektsh në vlerën 272,899,681 lekë ose 68.4 % nga ajo çfarë është planifikuar fillimisht.

Nga auditimi i dokumentacionit të hartimit të PBA 2020- 2022, 2021- 2023, 2022- 2024 dhe 2023- 2025 u konstatua se:

- Mbi planifikimin e nevojave të institucionit, tëshpenzimeve për të gjithë periudhën e audituar nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik si dhe nuk janë kryer takime, të dokumentuara duke qënë senuk ka proces verbale që ta vërtetojnë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (i ndryshuar), dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat të koordinatorit MFK-s dhe koordinatorit në njësitë publike” të MFE, pika 2.2.4.
- Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i ka nisur Bashkisë Tiranë Projekt Buxhetin Afatmesëm vetëm për një fazë, po ashtu edhe Urdhëri Brendshëm është ngritur vetëm për një fazë të PBA 2020- 2022 dhe 2021- 2023.
- Mungojnë kërkesat e paraqitura për planifikimin, hartimin buxhetor afatmesëm për të gjithë periudhën e audituar.Duke përjashtuar PBA-n 2022- 2024 ku kanë paraqitur disa nga drejtoritë si: Drejtoriae Ndriçimit Publik dhe Sinjalistikës Rrugore e cila ka paraqitur kërkesat e saj mbi llog. 602 dhe 231 me shkresën nr. 2319/1, Drejtoria e Transportit vetëm për llogaritjen e kërkesës për karburant dhe Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve Urbane një shkresë mbi

kërkesat e materialeve të drejtorisë, të cilat rezultojnë jo të plota. Nuk ka patur mbledhje të dokumentuara ku të paraqiteshin dhe të diskutoheshin Planifikimet e Buxhetit Afatmesëm mbi nevojat e secilës drejtori.

- Nuk është ngritur grupi i punës mbi përgatitjen e buxhetit afatmesëm për të gjithë periudhën e auditimit përvec PBA 2022- 2024, faza e dytë.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (i ndryshuar), dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat të koordinatorit MFK-s dhe koordinatorit në njësitë publike” të MFE, pika 2.2.4.

Udhëzimi nr. 9, datë 28.02.2022 të MFE “Për përgatitjen e Planifikimit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025” Pika 8/b, Neni 8 të Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:

Ligjin nr. 10296 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (i ndryshuar), dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat të koordinatorit MFK-s dhe koordinatorit në njësitë publike” të MFE, pika 2.2.4.

Udhëzimi nr. 9, datë 28.02.2022 të MFE “Për përgatitjen e Planifikimit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025”

a. Pika 8/b, Neni 8 të Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

b. Për mangësitë e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi, punonjësit si më poshtë:

-Z. E.K , me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik për priudhën 2019- 2020,

-Z. H.RR , me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik për priudhën 2021- 2022,

-Znj. L.C , me detyrë Drejtor i Administratë Financës, për vitin 2019.

-Znj. E.M , me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve, për vitin 2020.

-Z. S.M , me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve, për priudhën 2021- 2022.

Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka nisur observacionet sipas Projektraportit të KLSH prot.,1775/3 datë 03.06.2024, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Sqarojmë se nga ana e DPRRNP për çdo vit ka dalë urdhëri i brëndshëm për hartimin e kërkesave nga çdo drejtori për planifikimin buxhetor afatmesëm, të cilat kanë sjellë kërkesat përkatëse të shoqëruara me relacion, dhe nga sektorët e finances dhe buxhetit në Drejtorinë e Financës është bërë plotësimi i formularëve standart të PBA, relacioni përkatës dhe janë dërguar në Bashkinë Tiranë brënda afatit të kërkuar. PBA nuk është kërkuar nga Bashkia të bëhet për cdo vit në dy faza, në moment që është kërkuar është dorëzuar nga ana jonë brënda afatit të përcaktuar.

PBA 2020-2022

- kërkesa Nr.1778/1 Prot.datë 18.06.2019 nga “Drejtorja e Ndriçimit dhe Sinjalistikës Rrugore”

- kërkesa Nr.1778/2 Prot.datë 18.06.2019 nga “Drejtorja e Kullimit dhe Rrugëve Rurale”

- kërkesa Nr.1778/3 Prot.datë 18.06.2019 nga “Drejtorja Prodhim Mirëmbajte”

- kërkesa Nr.1778/4 Prot.datë 18.06.2019 nga “Drejtorja Administratë Financë”

PBA 2021-2023

- kërkesa Nr.2817/1 Prot.datë 30.10.2020 nga “Drejtoria e Ndriçimit Publik dhe Sinjalistikës Rrugore”
- kërkesa Nr.2817/2 Prot.datë 30.10.2020 nga “Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale”
- kërkesa Nr.2817/3 Prot.datë 30.10.2020 nga “Drejtoria Prodhim Mirëmbajte”
- kërkesa Nr.2817/4 Prot.datë30.10.2020 nga “Drejtoria e Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve”

PBA 2022-2024(Faza I)

- kërkesa Nr.1115/2 Prot.datë 31.05.2021 nga “Drejtoria e Ndrimit Publik dhe Sinjalistikës Rrugore”

PBA 2022-2024(Faza II)

- kërkesa Nr.2319/1 Prot.datë 30.08.2021 nga “Drejtoria e Ndrimit Publik”
- kërkesa Nr.2319/2 Prot.datë 01.09.2021 nga “Drejtoria e Sinjalistikës Rrugore”

PBA 2023-2025(Faza I)

- kërkesa Nr.1190/2 Prot.datë 09.05.2022 nga “Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve Urbane”
- kërkesa Nr.1190/3 Prot.datë 09.05.2022 nga “Drejtoria e Mirëmbajtjes së Trotuarëve dhe Kullimit të Ujërave të Shiut”
- kërkesa Nr.1190/4 Prot.datë 09.05.2022 nga “Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale”
- kërkesa Nr.1190/5 Prot.datë 09.05.2022 nga “Drejtoria e Ndrimit Publik”
- kërkesa Nr.1190/6 Prot.datë 09.05.2022 nga “Drejtoria e Sinjalistikës Rrugore”

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet tuaja mbi hartimin e kërkesave nga çdo drejtori sqarojmë se Grupi Auditues i ka kërkuar subjektit që në fillim të auditimit që ti viheshin në dispozicion këto kërkesa. Në observacion keni nisur këto kërkesa me nr. Prot. dhe data si më lart megjithatë ky observacion merret pjesërisht në konsideratë duke ritheksuar se kërkesat nuk janë përpiluar nga të gjitha drejtoritë përkatëse për të gjitha fazat.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Drejtoria e Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit i dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar evindencat e shpenzimeve për çdo muaj. Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 44 ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 30.07.2018 “Mbi procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore” janë përgatitur raportime të buxhetit vjetore, të cilat janë dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, Bashkisë Tiranë si vijon:

- Më datë 24.01.2020 i ka nisur për muajin dhjetor 2019 si dhe progresivin nga muaji janar deri në dhjetor 2019
- Më datë 28.01.2021 i ka nisur për muajin dhjetor 2020 si dhe progresivin nga muaji janar deri në dhjetor 2020.
- Më datë 26.01.2022 i ka nisur për muajin dhjetor 2021 si dhe progresivin nga muaji janar deri në dhjetor 2021.
- Më datë 26.01.2023 i ka nisur për muajin dhjetor 2022 si dhe progresivin nga muaji janar deri në dhjetor 2022.

2.4 Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj.

Drejtoria e Financës i vuri në dispozicion grupit auditues, materialin e punuar ne programin e excel-it detyrimet e prapambetura nga viti 2012- 2015 në Drejtorinë e Përgjithshme të Qytetit. Të likujduara sipas viteve:

- në vitin 2020 janë paguar në total 109,584,321 lekë, fatura të vitit 2019
- në vitin 2021 janë paguar në total 11,843,452 lekë, fatura të vitit 2020
- në vitin 2022 janë paguar në total 20,028,336 lekë, fatura të vitit 2021

Në total nga viti 2020- 2022 janë paguar 141,456,109 lekë, fatura të lëshuara gjatë periudhës së viteve 2019- 2022. Më 31.12.2022 detyrimet rezutojnë në vlerën 20,931,287 lekë të cilat janë pasqyruar po në të njëjtën vlerë në pasqyrat financiare të vitit 2022 të institucionit në llogarinë 486- Shpenzime te periudhave te ardhshme.

DETYRIMET DERI ME 2012- 2015		
602	BlerjePofileHekuri	119,520.00
602	Pjesekembimi	7,500.00
602	Disk preres	104,398.00
602	Sherbim internet	141,600.00
602	Blerjekarburanti	3,934,380.00
602	Blerjematerialeelektrike	106,229.00
602	Sigurimi I mjeteve TPL	371,100.00
602	Sigurimi I mjeteve TPL	106,300.00
	Vendingjyqesor	40,562.00
Totali		4,931,589.00

DETYRIMET DERI ME 31.12.2022 (2016- 2022)							
	Objektiiprokurimeve	Vlera e Kontrates (me TVSH)	FirmaFituese	Fatura/Date	Vlera e fatures	paguar 2022	Diferenca qembetet per Vitin 2023
231	Permiresimi I ndricimitpubliknëBulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhendërtimi I korsivetëbicikletavenësheshin “Nënë Tereza” deritekhyrja e liqenitArtificial.(Plani 2022)	37,641,883	I SH.P.K	2525/2022 Dt.30.11.202 2	37,640,835	20,900,000	15,640,835
	Mbajtjegarancie 5%					1,100,000	
231	Mbikqyrja I ndricimitpubliknëBulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhendërtimi I korsivetëbicikletavenësheshin “Nënë Tereza” deritekhyrja e liqenitArtificial.(Plani 2022)	558,569	G SHPK	68/2022 dt.23.11.202 2	558,569	244,960	313,609

231	Kolaudimi I punimevepërojektin "Permiresimi I ndricimitpubliknëBulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhendërtimi I korsivetëbikiletavenësheshin "Nënë Tereza" deritekhyrja e liqenit Artificial.	45,254	R shpk	104/2022 dt.23.11.2022		45,254
	Totali					15,999,698

Nga auditimi mbi të ardhurat u konstatua sedetyrimet e prapambeturangaviti 2012 në 2015 në Drejtorinë e Përgjithshme të Qytetit janë në vlerën 4,931,589 lekë, ku 80 % të totalit të detyrimeve e zë blerja e karburantit. Këto detyrime rezultojnë po në të njëjtën vlerë që nga viti 2015 duke qënë se nuk është paguar më asnjë detyrim që i përket periudhës 2012- 2015. Detyrimet duke filluar nga viti 2016 e deri në fund të vitit 2022 arrijnë në vlerën 15,999,698 lekë, vlerë e faturavetëvitit 2022. Më 31.12.2022 detyrimet në total rezultojnë në vlerën 20,931,287 lekë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:

- Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit", pika 101 "Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim".

- Për mangësitë e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi, punonjësit si më poshtë:

-Z. E.K , me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik për priudhën 2019- 2020.

-Z. H.RR , me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik për priudhën 2021- 2022.

-Znj. L.C , me detyrë Drejtor i Administratë Financës, për vitin 2019.

-Znj. E.M , me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve, për vitin 2020.

-Z. S.M , me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve, për priudhën 2021- 2022.

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka nisur observacionet sipas Projektraportit të KLSH, me prot.,1775 datë 02.05.2024, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për gjetjen "Rrisqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likujduara mbi detyrimet e prapambetura" ju sqarojmë se janë detyrime të lindura nga viti 2012-2015 me vlerë 4.931.589 lekë për të cilat nuk disponojmë dokumenta të rregullta për të likujduar, kemi tentuar të hyjmë në lidhje me operatorët që të sjellin dokumentat për të kryer likujdimet. Kjo është arsyeja e mos likujdimit të këtyre detyrimeve. Pa dokumenta të sakta nuk kemi pranuar të bëjmë likujdim të asnjë lloji.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet tuaja mbi rrisqet buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara mbi detyrimet e prapambetura, grupi auditues nuk e merr në konsideratë pretendimin e subjektit duke qënë se regjistrimi i këtyre detyrimeve është kryer pa u pajisur me dokumentacionin e saktë justifikues dhe si pasojë ju nuk mund të kryeni likujdimin e tyre. Përsa i përket

viteve të cilat i përkasin këto detyrime të prapambetura është paraqitur saktësisht periudha nga grupi i auditues në Projekt Raport po ashtu edhe në Raportin Përfundimtar.

2.5 Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Drejtorja e Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, për periudhën e audituar ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, të dhënat mbi evidencën mujore të të ardhurave çdo muaj. Duke filluar nga muaji mars i vitit 2021 dhenë vazhdim ka nxjerr Urdhër të Brendshëm mbi likuidimet e ndalesa sipas rekomandime vetë KLSH- s dhe auditit të brendshëm. Grupi auditues konstaton se për vitet 2019, 2020 dhe 2022 nuk janë bashkangjitur urdhër-shpenzimet.

Pershkrimi	2019	2020	2021	2022
Te ardhura si pasoje e nje aksidenti automobilistik	21,936			
Ndalese nga auditi I brendshem	200,884	202,194	127,813	104,693
Ndalese nga KLSH	383,000	379,129	307,977	222,214
Sekuestro/ Zhdemtimesigurimkontrate			242,226	
Totali	605,820	581,323	678,016	326,907

Burimi: DPRRNP, përpunoi Grupi i Auditimit

Të ardhurat rezultojnë për vitin:

- 2019 në vlerën 605,820 lekë, nga të cilat të ardhurat si pasojë e një aksidenti automobilistik 21,936 lekë, ndalesat nga auditi i brendshem 202,194 lekë dhe ngandalesat e KLSH në vlerën 379,129 lekë.
- 2020 në vlerën 581,323 lekë, nga të cilat ndalesat nga auditi i brendshem 202,194 lekë dhe nga ndalesat e KLSH në vlerën 379,129 lekë.
- 2021 në vlerën 678,016 lekë, nga të cilat ndalesat nga auditi i brendshem 127,813 lekë dhe nga ndalesat e KLSH në vlerën 307,977 lekë dhe sekuestro/ zhdëmtim sigurim kontrate 242,226 lekë.
- 2022 në vlerën 326,907 lekë, nga të cilat ndalesat nga auditi i brendshem 104,693 lekë dhe nga ndalesat e KLSH në vlerën 222,214 lekë.

VITI	AUDITI I BASHKISE TIRANE (Nr.17151/6 Prot date 19.11.2018)	KLSH (Nr.242 Prot date 26.02.2013)	SHUMA TOTALE	NDALESE SEKUESTRO	TOTAL TE ARDHURA
2019	5,722,045	10,423,914	16,145,959		
ndalesatotale per vitin 2020	182,194	399,129	581,323		581,323

2020	5,539,851	10,024,785	15,564,636		
ndalesatotale per vitin 2021	127,260	308,530	435,790	242,226	678,016
2021	5,412,591	9,716,255	15,128,846		
ndalesatotale per vitin 2022	104,693	222,214	326,907		326,907
2022	5,307,898	9,494,041	14,801,939		

Ndalesat deri më 31.12.2022 janë në vlerën 14,801,939 lekë nga të cilat 5,307,898 lekë, ndalesa mbi llogaritjen e shtesave mbi page për turnin e III- të të punonjësve, vlerë e lënë nga auditimi I kryer nga Auditimi I Bashkisë Tiranë në vitin 2018 dhe 9,494,041 lekë, ndalesa mbi llogaritjen e shtesave mbi page për turnin e III- të të punonjësve, vlerë e lënë nga auditimi I kryer nga Auditimi I Kontrollit të Lartë të Shtetit në vitin 2013.

Nga auditimi mbi të ardhurat u konstatua se të ardhurat rezultojnë për vitin:

- 2019 në vlerën 605,820 lekë, nga të cilat të ardhurat si pasojë e një aksidenti automobilistik 21,936 lekë, ndalesat nga auditimi I brendshëm 202,194 lekë dhe nga ndalesat e KLSH në vlerën 379,129 lekë.

- 2020 në vlerën 581,323 lekë, nga të cilat ndalesat nga auditimi i brendshëm 202,194 lekë dhe nga ndalesat e KLSH në vlerën 379,129 lekë.

- 2021 në vlerën 678,016 lekë, nga të cilat ndalesat nga auditimi i brendshëm 127,813 lekë dhe ngandalesat e KLSH në vlerën 307,977 lekë dhe sekuestro/ zhdëmtim sigurim kontrate 242,226 lekë.

- 2022 në vlerën 326,907 lekë, nga të cilat ndalesat nga auditimi i brendshëm 104,693 lekë dhe nga ndalesat e KLSH në vlerën 222,214 lekë.

Ndalesat deri më 31.12.2022 janë në vlerën 14,801,939 lekë nga të cilat 5,307,898 lekë, ndalesa mbi llogaritjen e shtesave mbi page për turnin e III- të punonjësve, vlerë e lënë nga auditimi I kryer nga Auditimi I Bashkisë Tiranë në vitin 2018 dhe 9,494,041 lekë, ndalesa mbi llogaritjen e shtesave mbi page për turnin e III- të punonjësve, vlerë e lënë nga auditimi I kryer nga Auditimi I Kontrollit të Lartë të Shtetit në vitin 2013.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:

-Ligji nr.154/2014, datë27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Shtetit"neni 15, germa j; neni 30.

Për mangësitë e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi, punonjësit si më poshtë:

-Z. E.K, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik për priudhën 2019- 2020.

-Z. H.RR, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik për priudhën 2021- 2022.

-Znj. L.C, me detyrë Drejtor i Administratë Financës, për vitin 2019.

-Znj. E.M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve, për vitin 2020.

-Z. S.M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve, për periudhën 2021- 2022.

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka nisur observacionet sipas Projektraportit të KLSH, me prot.,1775 datë 02.05.2024, ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Referuar gjetjes në lidhje me arkëtimin e detyrimeve që vijnë si pasojë e ndalesave të llogaritura nga KLSH dhe Auditi i Brëndshëm Tiranë për shtesat mbi pagë nga turnet e treta, ju bëjmë me dije se kemi hasur vështirësi sepse disa prej punonjësve janë larguar nga puna dhe është e pamundur tju mbahet kjo ndalesë. Për këtë kemi dërguar shkresën me nr. 381 prot datë 05.02.2019 Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si dhe shkresën me nr.380 prot datë 05.02.2019 Institucioneve të varësisë së Bashkisë për të na konfirmuar nëse ndonjë prej personave të larguar është në marrdhënie pune në këto Institucione.

Gjithashtu për punonjësit aktual është vendosur një vlerë prej 1,000 lekësh në mënyrë që të mos preket minimum jetik referuar pagës që ato marrin që shumica prej tyre janë punëtor te klasës së III.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet tuaja mbi arkëtimin e detyrimeve që vijnë si pasojë e ndalesave të llogaritura nga KLSH dhe Auditi i Brëndshëm Tiranë, masat e marra nga ju i kemi paraqitur në Projekt Raport dhe Raport Përfundimtar. Grupi auditues nuk e merr në konsideratë pretendimin tuaj duke qënë se masat nuk janë marr nga ana juaj në kohën e duhur dhe duke qënë se ato vazhdojnë të jenë detyrime të mbartura prej shumë vitesh.

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, opinionin mbi pasqyrat financiare për vitin 2022

1. Pasqyrat financiare të periudhës nga viti 2019 deri në vitin 2022 të DPRRNP Tiranë;
2. Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, i arkës, magazinës, pagave (borderotë), të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj.
3. Praktika e Inventarizimit të aktiveve, regjistri i aktiveve.
4. Urdhër shpenzimet dhe dokumentecioni bashkëlidhur.
5. Akt rakordimet me degën e thesarit Tiranë.
6. Dokumentecion mbështetës për vendimet gjyqësore, investimet, shpenzimet e të ardhurat etj.

➤ **Hartimi i pasqyrave financiare**

Bashkia DPRRNP Tiranë për periudhën 2019-2022, ka plotësuar pasqyrat financiare të njësisë sipas formateve nga 1-8 si njësi e varësisë e Bashkisë Tiranë, të cilat i ka dorëzuar në Degën e Thesarit Tiranë.

Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuara pasqyrat si vijon:

Format 1 - Pasqyra e Pozicionit Financiar.

Format 2 - Pasqyra e Performancës Financiare.

Format 3 - Pasqyra e Flukseve Monetare.

Format 4 - Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivitet Neto/Fondet Neto.

Format 5 – Pyetësori dhe Shënime Shpjeguese.

Format 6 - Pasqyra Investimet dhe Burimet e Financimit.

Format 7/a - Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me kosto historike.

Format 7/b – Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me vlera neto.

Format 8 - Pasqyra Numri i Punonjësve dhe Fondi i Pagave.

Veprimet janë mbartur nga dokumentecioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Përgatitja e të dhënave për pasqyrat financiare të çdo viti ushtrimor 2019-2022 janë bërë duke kryer paraprakisht regjistrimin në mënyrë kronologjike sipas natyrës të të gjitha veprimeve financiare të realizuara gjatë secilit vit ushtrimor; kontabiliteti mbahet në programin *Microsoft Excel*.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare

Viti	Nr. regjistrimit dhe data në subjekt	Dorëzimi në Degën e Thesarit	Afati	Detyrime të prapambetura llog.486
2019	852 dt. 30.03.2020	852 dt.30.03.2019	√	139,732,945
2020	896 dt. 29.03.2021	2065 dt. 30.03.2021	√	16,775,041
2021	924 dt. 29.03.2022	2163 dt. 30.03.2022	√	24,951,875
2022	865 dt. 24.03.2023	787/229 dt. 29.03.2023	√	20,931,287

Punoi: Grupi i auditimit

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga sektori i financës dhe janë nënshkruar nga NA dhe NZ; janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë brenda afatit ligjor.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin ushtrimor 2022 rezulton verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë të ektstrakteve të bankës (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total, mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditar i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për tu siguruar nëse regjistrimet kantabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi, u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të vërtetuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike, deri në mbyllje të ushtrimit të mëparshëm;

Nëse informacioni kontabël mundëson në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazim i lëvizjes së ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e informacionit bazë dhe justifikues.

Në këtë njësi publike, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në programin “Microsoft Excel”.

Përditësimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletëkontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje/daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, aktmarrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentecioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar, Pohimet mbi saktësinë e përgatitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të njësisë për aktivitetin ekonomik –financiar të periudhës 01.01.2022-31.12.2022. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga sektori i financës së Drejtorisë së Financës, Burimeve njerëzore dhe Shërbimeve. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatuan se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivitet neto janë të barabarta me Aktivitet-Pasivitet

	2019	2020	2021	2022
Aktivet (A)	8,393,693,269	7,013,393,636	5,881,893,059	5,086,507,444
Pasivet (B)	171,373,427	104,270,761	84,263,814	86,808,590
Aktivet Neto (C=A-B)	8,222,319,842	6,909,122,875	5,797,629,245	4,999,698,854

▪ Aktivet afatshkurtra

- Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2019 paraqiten në vlerën 402,822,443 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 586,128 lekë.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 231,449,016 lekë.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 56,311,951 lekë dhe

“Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 114,475,348 lekë.

- Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2020 paraqiten në vlerën 346,843,947 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 1,5473,690 lekë.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 242,573,186 lekë.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 85,922,030 lekë dhe

“Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 16,775,041 lekë.

- Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën 32,746,573 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 2,067,823 lekë.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 248,201,817 lekë.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 57,244,116 lekë dhe

“Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 24,951,875 lekë.

- Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën 331,487,748 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 3,585,377 lekë.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 244,679,158 lekë.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 62,291,926 lekë dhe

“Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 20,931,287 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” sipas bilancit në mbyllje të vitet 2019 është në vlerën e 586,128 lekë; në mbyllje të vitet 2020 është në shumën 1,573,690 lekë, në mbyllje të vitet 2021 është në shumën 2,067,823 lekë dhe në mbyllje të vitet 2022 është në shumën 3,585,377 të cilat rakordojnë me llog.466 “kreditorë për mjete në ruajtje” në Pasiv, rubrikën IV “Rritja neto e mjeteve monetare” dhe rubrikën VI “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr. 3 “Pasqyra e Flukseve Monetare”(cash-flow), që sipas metodës direkte përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Periudha ushtrimore			
		Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
531	Mjete monetare ne arkë	0	0		0
512	Mjete monetare në bankë	0	0		0
520	Disponibilitete në thesar	586,128	1,573,690	2,067,823	3,585,377
50	Letra me vlerë	0	0		0
532	Vlera të tjera	0	0		0
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0		0

59	Provigjone zhvlerësimi	0	0	0	0
Totali		586,128	1,573,690	2,067,823	3,585,377
Diferenca		-987,562	-494,133	-1,517,554	

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” paraqiten në tabelë në shumën respektive të secilit vit dhe përbëhet gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje". Llog.466 “Mjetet në ruajtje” përbën garancinë e punimeve e cila e shpërndarë sipas viteve është: *për vitin 2019* ka vlerën 586,128 lekë, për vitin 2020 ka vlerën 1,573,690 lekë, për vitin 2021 ka vlerën 2,067,823 lekë dhe për vitin 2022 është në vlerën 3,585,377 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit **rezultoi** se janë paguar 3 fatura të kontratave të punëve të lidhura në vitin 2021 (2) dhe 2022 (1), për të cilat janë ngurtësuar 5% e vlerës së tyre, nga të cilat për kontratën nr. 1767/8 datë 16.08.2022 në vlerën 37,641,883 lekë vlera e llog.466 është llogaritur në shumën 1,100,000 lekë kur në fakt duhet të ishte në shumën 1,882,094 lekë. Me një diferencë prej (-)782,094 lekë është nënvlerësuar llog. 466 si vlera e 5% e garancisë për këtë kontratë.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Periudha ushtrimore			
		2019	2020	2021	2022
31	Materiale	231,168,074	242,292,244	248,201,817	243,524,550
32	Objekte inventari/Inventar imët	280,942	280,942	280,942	1,154,608
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0		0
34	Produkte	0	0		0
35	Mallra	0	0		0
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri	0	0		0
37	Gjendje te pambritura ose pranë të tretteve	0	0		0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0		0
39	Provigjone për zhvlerësim e inventarit(-)	0	0		0
Totali		231,449,016	242,573,186	248,482,759	244,679,158
Difrenca		11,124,170	5,909,573	(-)3,803,601	

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të DPRRNP Tiranë në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 244,679,158 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 243,524,550 lekë dhe nga llogaria kontabel 32 “Objekte/inventari imët” në vlerën 1,154,608 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit, vlerë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 3,803,601 lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, në fillim të vitit 2022 ka vlerën 20,228,967 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në
Gjendje në 01.01.2022	248,201,817
Hyrje gjatë vitit 2022	563,803,012
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	568,480,279
Gjendja në 31.12.2022	243,524,550

Llogaria 327 “Objekte inventari”, në fund të vitit 2022 ka vlerën 1,154,608 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime.

Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	280,942
Hyrje gjatë vitit 2022	873,666
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	-
Gjendja në 31.12.2022	1,154,608

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve, llog 63 evidencuar në pasqyrën e performancës financiare. Për kryerjen e tyre është zbatuar Udhëzimi i MFE nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Nr		1	2	3	Totali
Emertimi i llogarive		Magazina nr.1 & Magazina nr.2	Magazina Ndrim & Sinjalistike	Magazina Rikupero,Oficina,Karburanti	
311	Debi	291,591,483	112,751,528	159,460,001	563,803,012
	Kredi	309,715,953	94,844,239	163,920,087	568,480,279
603	Debi	309,715,953	94,844,239	144,192,207	548,752,398
	Kredi	291,707,481	112,751,528	139,732,120	544,191,129
213/1	Debi	44,599,171	129,183,600		173,782,771
	Kredi	15,849,480	112,239,847		128,089,327
213	Debi	15,849,480	112,239,847		128,089,327
	Kredi	-	-		-
101	Debi	-	-		-
	Kredi	79,549,237	130,671,600		210,220,837
327	Debi	873,666			873,666
	Kredi	-			-
214	Debi	7,536,240			7,536,240
	Kredi	-			-
215	Debi	26,540,160			26,540,160
	Kredi	-			-
218	Debi		1,488,000		1,488,000
	Kredi		-		-
450	Debi			19,727,880	19,727,880
	Kredi			19,727,880	19,727,880
Totali	Debi	696,822,151	450,507,215	323,380,088	1,470,593,455
	Kredi	696,822,151	450,507,215	323,380,088	1,470,709,453

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”. Titullari i ka nxjerrë Urdhrat për ngritjen e

komisioneve të inventarizimit për inventarizimin fizik dhe vlerësimin e aktiveve që klasifikohen të dëmtuara.⁸

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Periudha ushtrimore			
		Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
	Llogari të arkëtueshme	56,311,951	858,922,030	57,244,116	62,291,926
411	Klientë e llogari te ngjashme				
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	16,043,076	15,564,636	15,128,846	14,801,939
431	Tatime e taksa	0	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal	0			
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	0			
435	Sigurime Shoqërore	0			
436	Sigurime Shëndetësore	0			
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	0			
44	Institucione te tjera publike	0			
466	<i>Kreditorë për mjete në ruajtje</i>	<i>586,128</i>	<i>1,573,690</i>	<i>2,067,823</i>	<i>3,585,377</i>
468	Debitorë te ndryshëm	15,011,277	14,405,457	14,405,457	14,382,457
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	25,257,598	55,951,937	27,709,813	33,107,530
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0	0		
49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)	0	0		
	Të tjera aktive afatshkurtra	114,475,348	16,775,041	24,951,875	20,931,287
409	Furnitore(Debitorë),parapagime pagesa pjesore	0	0		
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0		
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0		
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0			
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	114,475,348	16,775,041	24,951,875	20,931,287
	Totali	170,787,299	875,697,071	82,195,991	83,223,213
	Diferenca	704,909,772	(-)793,501,080	1,027,222	

⁸ Trajtohet në mënyrë të detajuar në rubrikën për procesin e inventarizimit të aktiveve

- **“Llogari të arkëtueshme”** për vitin 2022 është në shumën 62,291,926 lekë dhe në vitin 2021 është 57,244,116 lekë me një diferencë prej 5,047,810 lekë. Kjo shtesë ka ardhur si rezultat i rritjes së llog. 466 “kreditorë për mjete në ruajtje” dhe llog. 4342; zvogëlim të llog. 468 “debitorë të ndryshëm” dhe llog.423,429 “Personeli, paradhënie, deficite e gjoba.

- **“Të tjera aktive afatshkurtra”** për vitin 2022 është në shumën 20,931,287 lekë dhe që përbëhet nga llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”; për vitin 2021 është në shumën 24,951,875 lekë dhe që përbëhet nga llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

Llog. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,067,823 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,585,377 lekë, gjendje e cila përfaqëson vlerën e garancisë 5% të vlerës totale të investimeve të njesisë. Analiza e kësaj llogarie është si më poshtë:

Numri i investimeve	Gjendje 31.12.2021	Shtesa 2022	Pakësime 2022	Gjendje 31.12.2022	Numri
	2,067,823	1,573,690	3,091,244	3,585,377	

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në fund të vitit 2021 është 14,405,457 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 14,382,457 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Viti 2019		Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
	Vlera në lekë	Debitorë në	Vlera në lekë	Debitorë në	Vlera në lekë	Debitorë në	Vlera në lekë	Debitorë në
Gjendja në 01.01.	14,405,457		15,011,277		15,011,277		14,405,457	
Shtesa gjatë vitit	605,820		-		-		-	
Pakesime gjatë vitit	-		-		605,820		23,000	
Gjendja në 31.12.	15,011,277		15,011,277		14,405,457		14,382,457	

Nga analiza rezulton se vlera e kësaj llogarie është e trashëguar nga viti 2016 për dëmtime në rrugë e rrjete. Për këtë shumë te pasqyra e konfirmimit është shënuar se nuk ka asnjë evidencë. Shuma e detyrimeve debitohet në llog. 468 “debitorë të ndryshëm” dhe kreditohet në llog. 4341 “të tjera operacione me shtetin (kreditor)”. Llog. 468 ka si kundërparti llog.470 "të ardhura për t’u marrë" në pasiv. **U konstatua** se nga ana e Drejtorisë së financës nuk është bërë asnjë analizë apo verifikim, si dhe nuk është marrë asnjë masë për të siguruar arkëtimin e detyrimit deri në vlerë të plotë të tij, pasi dhe periudha e lindjes së detyrimit nuk është e hershme, për të mos u bërë e mundur arkëtimi i vlerës.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 52,661,688 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën 54,038,817 lekë, me një diferencë prej 1,377,129 lekë; Shuma e kësaj llogarie përfaqëson burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor) që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës. Është pakësuar llog. 486 “shpenzime të periudhave të ardhshme” me shumën 4,020,588 lekë, kjo shumë nuk kuadron me shumën e llogarive të pagueshme në pasiv si në tabelë, me një diferencë prej 33,107,530 lekë. Kjo diferencë përfshin (në kredi): llog. 421 në shumën 23,736,968 lekë, llog. 435 në shumën 6,950,610 lekë, llog. 436 në shumën 964,569 lekë dhe llog. 431 në shumën 1,455,383 lekë.

Emërtimi i llogarive	Vlera për çdo vit ushtrimor			
	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Llogari 401-408	114,475,348	45,775,600	24,911,313	20,890,725
Detyrime personelit llog 42	20,529,141	21,888,309	22,509,149	23,736,968
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	1,081,216	1,173,887	1,235,572	1,455,383
Sigurime shoqërore llog.435	3,239,305	3,456,841	3,561,464	6,950,610
Sigurime shëndetësore llog.436	367,374	391,779	403,628	964,569
Organizma të tjerë shtetërorë	0	0	0	0
Kreditorë të ndryshëm llog.467	40,562	40,562	40,562	40,562
Totali	139,732,946	72,726,978	52,661,688	54,038,817

Kjo llogari përfaqëson llogaritë e klasës 4 të pasivit në pasqyrën financiare të “pozicionit financiar”.

Llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 24,951,875 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 20,931,287 lekë. Diferenca prej 4,020,588 lekë tregon për pakësim të llogarisë nga pagesat e kryera debitorëve në shumën 20,020,286 lekë për “mallra/shërbime” e kryera në vitin 2021 dhe 22,244,960 lekë për zërin “mallra e shërbime” të kryera në vitin 2022, fatura të pa paguara të vitit 2022 në shumën 15,999,698 lekë për “investimet”. Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Vlera e kësaj llogarie, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera “mallra dhe shërbime”, por të pa financuara në vitin ushtrimor për shkak të mungesës së fondeve. Llog.486 ka si kundërparti llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”. Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2019, pika 42 ku cilësohet: “Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, “shërbime” apo “investime” të kryera, por të pa financuara”.

Institucioni		Llog.486	Gjendja 01.01	Pakësime	Shtesa	Gjendja 31.12.
Detyrime të prapambetura 2012-2015			4,931,589	-	-	4,931,589
210-1155	DPRRNP	2019	316,472,267			109,543,759
		2020	109,543,759			11,843,452
		2021	11,843,453	5,334,000	25,354,286	20,020,286
		2022	20,020,286	22,244,960	38,199,404	15,999,698
Totali llog. 486						20,931,287

Nga auditimi rezultoi se për periudhën 2011-2015 janë trashëguar detyrime si më poshtë:

Artikulli	Datë fature	Përshkrimi	Vlera
602	11.11.2015	Blerje profile hekuri	119,520
602	07.08.2015	Pjesë këmbimi	7,500
602	31.08.2015	Disk prerës	104,398
602	31.12.2013	Sherbim interneti	141,600
602	16.12.2013	Blerje karburanti	3,934,380

602	06.03.2012	Blerje materiale elektrike	106,229
602	04.10.2012	Sigurimi i mjeteve TPL	371,100
602	10.07.2012		106,300
602	15.09.2015	v.gjyqesor	40,562
Totali			4,931,589

Nga auditimi **u konstatua** se për këto detyrime nuk është bërë asnjë analizë mbi arsyet e mbartjes nga viti në vit në vlerën e tij të plotë pa bërë pagesa qoftë edhe pjesore, me qëllim minimizimin e vlerës deri në likuidim të saj në fund të periudhës 7 vjeçare.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. Aktivët afatgjatë

Objektivat e auditimit janë që të sigurohemi se: Aktivët ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet e subjektit janë të plota dhe korrekte.

Në Formatin 1 “Pozicioni Financiar”, “Aktivët afatgjatë” paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e Ilog.231). Gjendja totale në mbyllje të secilit vit ushtrimor 2019-2022 është si në tabelën më poshtë:

Vlera neto e Aktiveve e afatgjatë	31.12.2018	31.12.2019	31.12.2020	31.12.2021	31.12.2022
	9,586,226,868	7,990,870,826	6,666,549,689	5,549,146,486	4,755,019,696
Vlera (kosto historik)	13,751,629,537	14,002,028,184	14,199,441,010	14,326,904,802	14,582,280,915

Aktivët Afatgjatë jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivët Afatgjatë Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në fund të vitit 2021 në vlerën 215,474,992 lekë dhe në fund të vitit 2022 është po në të njëjtën

Lëvizjet e llogarisë	Viti 2019		Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
	Vlera në lekë	numri	Vlera në lekë	numri	Vlera në lekë	numri	Vlera në lekë	numri
Gjendja në 01.01.	213,774,992	64	215,474,992	65	215,474,992	65	215,474,992	65
Shtesa gjatë vitit	1,700,000	0	0	0	0	0	0	0
Pakesime gjatë vitit	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjendja në 31.12.	215,474,992	65	215,474,992	65	215,474,992	65	215,474,992	65
Diferenca	1,700,000	1	0	0	0	0	0	0

Në Formatin 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjatë Jo materiale” (vlera neto), llog.202 “studime e kërkime” paraqitet si më poshtë:

Emërtimi i Aktivit Llog. 202 "Studime e kërkime/projektme"	Gjendja më 01.01.	Shtesa gjatë vitit ushtrimor	Pakësime gjatë vitit ushtrimor	Amortizim i Akumuluar	Gjendja më 31.12.
2019	213,774,992	1,700,000	-	0	215,474,992
2020	215,474,992	-	-	0	215,474,992
2021	215,474,992	-	-	0	215,474,992
2022	215,474,992	-	-	0	215,474,992

Konstatim: Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe regjistrit të aktiveve rezultojn se nuk është llogaritur amortizimi i aktiveve të kësaj llogarie kontabël (15%), në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 36 i ndryshuar.

Kjo vlerë rakordon me vlerën e regjistrit të Aktiveve për llog. 202 të viteve respektive 2019-2022.

Llog. 202 "Studime e kërkime/projektme"	Numri 01.01.2019	Numri 01.01.2020	Numri 01.01.2021	Numri 01.01.2022	Numri 31.12.2022
	64	65	65	65	65

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë, rezultojn se në fillim të vitit 2019 shuma progresive e 64 aktiveve AAJM të llog.202 "studime e kërkime/projektme" është prej 213,774,992 lekë, që përfshin periudhën nga viti 2002 deri në vitin 2012; gjatë vitit 2019 është shtuar një aktiv në shumën 1,700,000 lekë duke e çuar llog.202 në shumën totale 215,474,992 lekë vlerë e cila mbartet e pandryshuar deri në 31.12.2022.

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 "Aktivet Afatgjata Materiale" në pasqyrën Format 1, dhe format 7/a e 7/b paraqitet si më poshtë:

21	2.Aktive materiale	Afatgjata	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
			7,775,395,834		5,333,671,494	4,539,544,704
210	Toka, Troje, Terrene		125,647,289		125,647,289	125,647,289
211	Pyje, Plantacione		0			
212	Ndertesa e Konstruksione		8,451,726		7,627,683	7,007,770
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		7,092,231,863		4,794,660,011	4,122,197,053
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje		286,052,950		209,103,913	96,681,188
215	Mjete Transporti		258,530,070		192,473,645	166,985,063
216	Rezerva Shteterore		0			
217	Kafshe pune e prodhimi		0			
218	Inventar ekonomik		4,236,558		4,011,735	3,866,739
24	Aktive afatgjata te demtuara		245,378		147,218	17,159,602
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		-		-	-

Llog. 210 “Toka, troje, terrene” paraqitet sipas vlerës bruto paraqitet:

Llog.210 “Toka, Troje, Terrene”	Gjendja 01.01.	Shtesa gjatë vitit ushtrimor	Pakësime gjatë vitit ushtrimor	Amortizim i akumuluar	Gjendja 31.12.
2019	125,647,295	0	0	0	125,647,295
2020	125,647,289			0	125,647,289
2021	125,647,289			0	125,647,289
2022	125,647,289			0	125,647,289

Llog. 211 “Pyje, plantacione” paraqiten në vlera zero, pasi nuk kanë aktive të regjistruara në këtë llogari. Analiza e llog.211 si më poshtë:

llog. 211 “Pyje, Plantacione”	Gjendja 01.01.	Shtesa gjatë vitit ushtrimor	Pakësime gjatë vitit ushtrimor	Amortizim i akumuluar	Gjendja 31.12.
2019	0	0	0	0	0
2020	0	0	0	0	0
2021	0	0	0	0	0
2022	0	0	0	0	0

Llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” Analiza e llog.212 si më poshtë:

Llog.212 “Ndërtime e Konstruksione”	Gjendja 01.01.	Shtesa gjatë vitit ushtrimor	Pakësime gjatë vitit ushtrimor	Amortizimi vjetor	Gjendja 31.12.
2019	18,264,861	0	0	225,507	18,267,861
2020	18,267,861	-	-	422,586	18,267,861
2021	18,267,861			401,457	18,267,861
2022	18,267,861	-	603,978	15,935	17,663,883

Konstatim: Nga auditimi rezulton se për 6 aktive të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” mungon viti i krijimit të aktivitetit apo koha e marrjes së tyre në dorëzim për përdorim. Nuk rezultojnë vlera për mirëmbajtjen e tyre të shtuara në vlerën e vet objekteve si dhe nga ana e njësisë publike nuk është ngritur asnjë grup pune me ekspertë për të rivlerësuar këto objekte, duke mos i pasqyruar kështu në vlerën reale të tyre.

Llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqiten si më poshtë:

Llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore	Gjendja 01.01	Shtesa gjatë vitit ushtrimor	Pakësime gjatë vitit ushtrimor	Amortizimi vjetor	Gjendja 31.12.
2019	8,672,611,427	154,142,721	0	1,734,522,285	7,092,231,863
2020	12,798,358,895	150,687,890	0	1,418,446,372	12,949,046,785
2021	12,949,046,785	135,081,306	0	1,164,894,676	13,084,128,091
2022	13,084,128,091	488,181,773	0	1,160,644,731	13,572,309,864

Llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë neto paraqitet në. Analiza e gjendjes së llog. 214 me ndryshimet paraqitet si vijon:

Llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje”	Gjendja 01.01	Shtesa gjatë vitit ushtrimor	Pakësime gjatë vitit ushtrimor	Amortizimi vjetor	Gjendja 31.12.
2019	514,571,445	19,342,800	66,639,336	50,231,121	467,274,909
2020	467,274,909	17,494,136	2,763,072	49,883,245	482,005,973
2021	482,005,973	110,172,167	121,949,294	31,279,690	470,228,846
2022	470,228,846	-	276,611,246	164,188,521	193,617,600

Konstatim: nga auditimi i pasqyrave financiare 7/a dhe 7/b dhe regjistrin të aseteve për vitin 2019, rezultoi se janë 82 lloje aktive të shtuara me 2830 copë në vitin 2019, në vlerën totale prej 81,694,295 lekë. Ndërkohë që në pasqyrat financiare 7/a e 7/b shtesa e tyre vjetore është pasqyruar në shumën 19,342,800 lekë .

Në tabelë më poshtë pasqyrohen 6 aktivitet e klasifikuara gabim në regjistrin e aseteve të vitit 2019, të cilat nga auditimi rezultuan të sistemuara në regjistrin e aseteve të vitit 2020.

Emërtimi i aktivit	Viti i krijimit	Çmimi	Sasia	Vlera kontabël	Amortizimi i akumuluar 2019	Vlera e mbetur 2019
Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i sinjalistikës së qytetit (faza III)	31.10.2005	29,905,679	1	29,905,679	13,636,990	16,268,689
Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i sinjalistikës së qytetit (faza II)	24.08.2004	57,194,831	1	57,194,831	26,080,843	31,113,988
Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i sinjalistikës së qytetit (faza I)	27.08.2003	39,655,324	1	39,655,324	18,082,828	21,572,496
Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i sinjalistikës së qytetit (faza IV)	16.10.2007	33,854,749	1	33,854,749	15,437,766	18,416,983
Për realizimin e projektit të sinjalistikës vertikale	23.08.2004	19,776,728	1	19,776,728	9,018,188	10,758,540
Për realizimin e projektit të sinjalistikës vertikale faza I	17.12.2007	5,695,085	1	5,695,085	2,596,959	3,098,126
6			6	186,082,396	84,853,574	101,228,822

Në regjistrin e aktiveve [2022], këto aktive rezultojnë të sistemuara në llog.213.

Llog. 215 “Mjete transporti” Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë DPRRNP Tiranë Ndërsa në formatin 7/a lëvizjet e llogarisë janë si më poshtë:

Llog. 215 “mjete transporti”	Gjendja 01.01	Shtesa gjatë vitit ushtrimor		Pakësime gjatë vitit ushtrimor		Amortizimi vjetor	Gjendja 31.12.
		Në numër	Në vlerë	Në numër	Në vlerë		
2019	219,997,958	10	141,852,465	-	-	59,655,284	361,850,423
2020	361,850,423	6	29,688,000	-	-	51,706,014	391,538,423
2021	235,512,056	1	3,264,000	-	-	47,302,411	394,802,423
2022	394,802,423	4	26,540,160	19	37,625,447	14,403,295	383,717,136

Bashkia DPRRNP Tiranë ka në pronësi të saj dhe në gjendje aktive mjete transporti shtimi i numrit të cilëve për çdo vit pasqyrohet si në tabelën e mëposhtme:

Viti	Numri i mjeteve të reja	Vlera totale	Numri total i mjeteve	Vlera Totale
2019	8	73,727,600	102	361,850,423.40
2020	6	29,688,000	109	
2021	1	3,264,000	110	394,802,423
2022	4	26,540,160	83	383,717,136

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve [2019] **rezulton** se për 23 mjete transporti mungon viti i krijimit të aktivitetit, [2022] janë 8 mjete që u mungon viti i krijimit të aktivitetit duke rezultuar me llogaritje jo të saktë të amortizimit dhe pamundësinë e vlerësimit real të vlerës së mbetur të dobishme në fund të çdo viti ushtrimor.

Nga analiza e llog. 215 rezultojnë vlera bruto e saj ka ndryshuar me vlerë në rritje në shumën 27,615,600 lekë.

Llog. kontabël 218 “Inventar ekonomik” Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga DPRRNP Tiranë. Sipas pasqyrave financiare të DPRRNP Tiranë, gjendja e llogarisë 218 paraqitet si më poshtë:

Llog. 218 “invent ar ekonomi k”	Gjendja 01.01	Shtesa gjatë vitit ushtrimor		Pakësime gjatë vitit ushtrimor		Amor tizimi vjetor	Gjendja 31.12.
		Në numër	Në vlerë	Në numër	Në vlerë		
2019	4,301,213	-	-	-	-	584,550	2,338,198
2020	2,338,198						
2021							
2022							

Nga analiza e llog. 218 “inventar ekonomik” **rezulton se**, kategoria “pajisje kompjuterike” nuk është ndarë si kategori më vete (llog.218/1) duke mos pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj, për të saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit. Kështu nga verifikimi i

analizës së llogarisë dhe rregjistrimit të inventareve rezultoi se llogaritja e amortizimit për pajisjet kompjuterike për vitet 2019 dhe 2020 nuk është llogaritur me normën e amortizimit prej 25% të vlerës së mbetur, por me normën 20% në moszbatim të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 36. Ndërsa rezultoi se për vitet në vijim 2021 e 2022, janë llogaritur konform Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2019 i ndryshuar.

Llog. 218/1 “pajisje kompjuterike”	Gjendja 01.01	Shtesa gjatë vitit ushtrimor		Pakësime gjatë vitit ushtrimor		Amortizimi vjetor	Gjendja 31.12.
		Në numër	Në vlerë	Në numër	Në vlerë		
2019	4,301,213	-	-	-	-	584,550	2,338,198
2020	2,338,198						
2021							13,921,055
2022	13,921,055		1,488,000		3,452,374	1,819,378	11,956,681

Vlera neto e AAM në fund të vitit 2021 është 1,627,034,153 lekë dhe në fund të vitit 2022 është 1,622,960,884 lekë, ku diferenca prej (-)4,073,269 lekë, përfaqëson vlerën e amortizimeve dhe kostove historike [kosto historike- amortizim i akumuluar].

Levizjet Llog. 218 “Inventar ekonomik” për vitin 2022, vlera në lekë	
Celie me 01.01.2022	163.901,410
Blerje me pagese (D)	71,951.683
Dalje (K)	19.298.241
Gjendja me 31.12.2022	189.724.123

Nga auditimi rezultoi se ndryshimet në numër të aktiveve afatgjata për çdo vit ushtrimor pasqyrohet si në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi i llogarive	Numri 01.01.2019	Numri 01.01.2020	Numri 01.01.2021	Numri 01.01.2022	Numri 31.12.2022	Totali
Llog. 202 “Studime e kërkime/projektme”	64	65	65	65	65	
Llog. 210 “Toka, troje, terrene”	3	3	3	3	3	
Llog. 211 “Pyje, kullota, platancione	0	0	0	0	0	
Llog.212 “Ndërtime e konstruksione”	12	12	13	13	8	
Llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”	169	176	181	187	5053	
Llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”	116	198	4651	4014	356	
Llog. 215 “mjete transporti”	92	100	104	108	83	
Llog. 218 “inventar ekonomik”	66	66	905	930	993	
Llog. 24 “Aktive të qendr. trup.dëmtuara”	-	-	-	-	99	
Llog.28 “Caktime”	-	-	-	-	-	

Nga auditimi rezultoi se lëvizjet në llog. 213 dhe llog.214 janë në vlera të konsiderueshme, pasi ishin klasifikuar gabimisht, dhe janë risistemuar konform nomenklaturës së llogarive kontabël për grupin e klasës 2 / AAGJ.

Llog. 24 “Aktive të qëndr. trup. të dëmtuara”

Llog. 24 “Aktive të qendr. trup.dëmtuara”	Gjendja 01.01	Shtesa gjatë vitit ushtrimor		Pakësime gjatë vitit ushtrimor		Amortizimi progresiv	Gjendja 31.12.
		Në numër	Në vlerë	Në numër	Në vlerë		
2019	4,434,245	-	-	-	4,188,867	61,355	245,378
2020	245,378		4,434,245	-	-	4,250,222	4,434,245
2021	4,434,245	-	-	-	-	4,287,027	4,434,245
2022	4,434,245	98	57,459,225	-	-	44,773,868	61,893,470

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të pasqyruar në tabelë, rezulton se ka një lëvizje të vlerës nga llog.212, llog. 214, llog.215, llog. 218 në llog. 24 “aktive të qëndrueshme të trupëzuara”, për 3 vitet e para i janë nënshtruar procesit të riparimit, ndërsa për vitin 2022 procedurës për nxjerrje jashtë përdorimit.⁹ Për vitin 2022 llog.24 përbëhet nga nëntë dhjetë e nëntë (99) aktive të cilësuar të dëmtuara, nga të cilat: njëzetë e tetë (28) aktive i përkasin llog.218 në vlerë kontabël 61,893,470 lekë dhe vlerë të mbetur 514,926, prej të cilave tetë (8) *aktive e kanë vlerën e mbetur zero (0)*; tridhjetë e një (31) aktive i përkasin llog.215 në vlerë kontabël 37,719,663 lekë dhe vlerë të mbetur 11,898,064 lekë, prej të cilave tre (3) *aktive e kanë vlerën e mbetur zero (0)*; njëzetë e tetë (28) aktive i përkasin llog.214 në vlerë kontabël 15,683,210 lekë dhe vlerë të mbetur 4,368,213 lekë; pesë (5) aktive i përkasim llog.212 në vlerën kontabël 603,978 lekë dhe vlerë të mbetur 238,592 lekë; ka dhe një grup aktivesh të dëmtuara përdorur nga administrata në vlerën kontabël totale 4,434,245 lekë dhe vlera e mbetur 139,807 lekë. Nga auditimi i regjistrave të aktiveve **rezultoi** se për këtë grup aktivesh, nuk janë dhënë specifikime mbi llogarinë kontabël së cilës i përkasin dhe rrjedhimisht dhe llogaritja e amortizimit nuk është bërë sipas normës përkatëse të amortizimit.

Llog. 28 “Caktim” në mbyllje të viteve 2021 dhe 2022 njësia publike nuk ka caktuar AAGJ në përdorim për të tjerë, pra kjo llogari nuk ka vlerë;

Nga auditimi **u konstatua** se DPRRNP Tiranë ka marrë në përdorim një objekt në pronësi të ish Bordit të Kullimit.¹⁰ tani Drejtoria e ujitjes dhe Kullimit. Mungesa e hartimit të akt marrëveshjes apo kontratës së përdorimit mes dy institucione, ka rezultuar me mosevidentimin e vlerës së këtij aktivi në llog.107 “aktive të caktuara në përdorim”, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, ku shprehimisht citohet:

* Për përcaktimin e AAGJM në përdorim të të tjerë, funksionimi i vlerës historike dhe amortizimit (vlerë neto) për njësinë që merr në përdorim është si më poshtë: debitohet llog.21 (analiza shtatëshifrore përkatëse) dhe kreditohet llog.107 “aktive të caktuara për përdorim”;

* për amortizimin vjetor të AAGJM, debitohet llog.1013 “pakësimi i AAGJ” dhe kreditohen llogaritë përkatëse të grupit 21 të AAGJM;

⁹ Trajtuar në nënpikën për procedurën e Inventarizimit

¹⁰ Trajtuar në nënpikën për procedurën e Inventarizimit

Pra llog.107 “aktive të caktuara në përdorim” merr në kredi vlerën neto të aktivitetit që institucione merr në përdorim nga të tretët me kundërpartitë debitorin e llogarive përkatëse të grupit 21 të AAGJM. Teprica e saj tregon që aktivitetet nuk janë të vetat.

Llog. 209 & 219 “Amortizimi i AAM & AAJM”: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të DPRRNP Tiranë në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën 8,777,758,316 lekë; Në mbyllje të vitit 2022 paraqiten në vlerën 9,827,261,219 lekë, ku rezulton se kjo vlerë është shtuar për 1,215,510,802 lekë dhe pakësuar për shumën 166,007,899 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit, pasqyrave dhe evidencave të miratuara, **u konstatua** se nga ana e sektorit të financës për vitet 2021 dhe 2022 nuk është hartur një evidencë e veçantë vetëm për llog. 209 dhe 219 “Amortizimi i AAJM & AAM”, për të mbajtur nën kontroll vlerën e mbetur të aktiveve të njësisë publike;

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të regjistruar në kontabilitet, **u konstatua** se një pjesë e këtyre aktiveve pasi i është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite, vlera e tyre është e papërfillshme (më e vogël se “100” lekë ose “0” lekë). Këto aktive vazhdojnë të jenë në përdorim dhe gjendje pune. Nga ana e titullarit në cilësinë e NA dhe koordinatit të Riskut dhe NZ të institucionit, nuk është marrë asnjë masë për të ngritur grupin e punës me ekspertë të fushave, për këta artikuj, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre. Ndryshimet në jetën e pritshme të dobishme dhe të vlerës së tyre të kontabilizohen duke ndryshuar periudhën e amortizimit apo metodën, sipas rastit, dhe të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël.

Pasqyra statistikore nr. 7/b “Aktivet afatgjata me vlerë neto”

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga DPRRNP Tiranë për vitet 2019 dhe 2020, janë si më poshtë:

duhet llogaritur/është llogaritur

*ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje	5%	5%
*inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi)	20%	20%
*për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi)	25%	20%
*për mjetet e transportit	20%	20%
*për aktivitetet afatgjata jomateriale (metoda lineare)	15%	0%

Nga auditimi **rezultoi** se sektori i financës për vitin 2019 dhe 2020 nuk ka zbatuar normën e përcaktuar të amortizimit në përlllogaritjet e bëra mbi bazë grupimi të aktiveve. Ky fakt është reflektuar në vlerën e amortizimit si dhe në vlerën e mbetur të aktiveve në pasqyrat financiare të hartuara në përfundim të çdo viti ushtrimor; për vitet në vijim 2021 e 2022 nga auditimi rezultoi se është llogaritur korrekt amortizimi i aktiveve sipas normave përkatëse të amortizimit;

Gjithashtu **u konstatua** se për llog.202 nuk është llogaritur normë amortizimi.

Llog. 230 dhe 231 "Investime" për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e flukseve monetare për vitin 2021, paraqiten në shumën

171,262,379 lekë dhe për vitin 2022 në shumën 272,899,681 lekë, me një diferencë (shtim) prej 101,637,302 lekë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën po të njëjtat vlera.

- Janë 21 Investime të kryera gjat vitit 2022.

Për investimet referuar Udhëzimit të MFE nr. 8 dt.09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, veprimet kontabël ndjekin këto hapa: me çeljen e fondeve - debitohet llog. 520 dhe kreditohet llog. 476; me konstatimin e shpenzimit - debitohet llog. 231 dhe kreditohet llog. 404; në momentin e pagesave- debitohet llog. 404 dhe kreditohet llog. 520; në fund te vitit ushtrimor për fondet e përdorura për investimet në proces debitohet llog. 476 dhe kreditohen llog. 720 dhe llog. 4342 për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues; me perfundimin e investimit te konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimin total të vlerës së kontratës bëhet kapitalizimi i aktivitet në debi të llog. 21 (përcaktohet artikulli kontabël) dhe kredi të llog. 231; me kapitalizimin e aktivitet - debitohet llog. 476 dhe kreditohet llog. 105; kreditohet llog. 1011 dhe debitohet llog.105. Pra të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre dhe detyrimet të evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e ndodhjes si shpenzim pavarësisht nga data e pagesës.

Në mënyrë analitike aktivitet afatgjata materiale në proces për periudhën janar – dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Vlera e kontratës	Nr. faturës	Vlera e faturës	Vlera e paguar	Vlera e mbetur për 2023
Përmirësimi i ndricimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi I korsive të bicikletave në sheshin “Nënë Tereza” deri tek hyrja e liqenit Artificial.(Plani 2022)	37,641,883	2525/2022 dt. 30.11.2022	37,640,835	20,900,000	15,640,835
Mbikqyrja e ndricimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi I korsive të bicikletave në sheshin “Nënë Tereza” deri tek hyrja e liqenit Artificial.(Plani 2022)	558,569	68/2022 dt.23.11.2022	558,569	244,960	313,609
Kolaudimi i punimeve për objektin "Përmirësimi i ndricimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi I korsive të bicikletave në sheshin “Nënë Tereza” deri tek hyrja e liqenit Artificial.	45,254	104/2022 dt. 23.11.2022	45,254	-	45,254

Emërtimi	Vlera e kontratës	Nr. faturës	Vlera e faturës	Vlera e paguar	Vlera e mbetur për 2023
3	38,245,706		38,244,658	21,144,960	15,999,698

Burimi: DPRRNP Bashkia Tiranë

PASIVET (DETYRIMET) Pasivet Afatshkurtra

Llog. e klasës 4, në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme dhe paraqesin detyrimet deri më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë	Emërtimi	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Diferenca/ Ndryshimi IV-III
		I	II	III	IV	
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	114,475,348	45,775,600	24,911,313	20,890,725	(-)4,020,588
42	Detyrime ndaj personelit	20,529,141	21,888,309	22,509,149	23,736,968	
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,081,216	1,173,887	1,235,572	1,455,383	
435	Sigurime shoqërore	3,239,305	3,456,841	3,561,464	6,950,610	
436	Sigurime shëndetësore	367,374	391,779	403,628	964,569	
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	586,128	1,573,690	2,067,823	3,585,377	1,517,554
467	Kreditorë të ndryshëm	40,562	40,562	40,562	40,562	
4341	Të tjera operacione me shtetin (detyrime)	31,054,353	29,970,093	29,534,303	29,184,396	(-)349,907
Gjendja në fund të periudhës						
	Të tjera pasive afatshkurtra	0		0	0	
C	FONDI NETO/FONDET (A-B)	8,222,319,842	6,909,122,875	5,797,629,245	4,999,698,854	(-)797,930,391
D	FONDI I KONSOLIDUAR	8,222,319,842	6,909,122,875	5,797,629,245	4,999,698,854	(-)797,930,391
101	Fonde bazë	8,320,278,387	6,897,998,705	5,791,719,672	5,000,557,355	(-)791,162,317
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	97,958,545	11,124,170	5,909,573	-3,803,601	(-)9,713,174
E	TOTALI I PASIVIT (B+C)	8,393,693,269	7,013,393,636	5,086,507,444	5,881,893,059	795,385,615

Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2021 është 24.911.313 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është 20.890.725 lekë me një diferencë (-)4,020,588 lekë; ndërsa gjendja e llog. 401-408 paraqet faturat e palikuiduara ndaj të tretëve nga DPRRNP Tiranë deri më 31.12.2022 që nuk kanë plotësuar afatin 60 ditor. Nga analiza e gjendjes së kësaj llogarie rezultoi se fatura të palikuiduara në llog 401 para kësaj periudhe janë në vlerën 4,891,027 lekë, të llogarise 404 në vlerën 15,999,698 lekë.

Llog. 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura nga DPRRNP Tiranë, paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në shumën 22,509,149 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 23,736,968 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 1.227.819 lekë. Vlera e llog.42 përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor 2022 për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës. Nga analiza e llogarisë dhe nga ditari i bankës 2023, rezultoi se shuma e kësaj llogarie përbëhet nga:

{ 23,689,968 lekë paga të punonjësve dhjetor 2022
 plus 23,000 lekë të llog.4341 për gjoba lënë nga KLSH dhe audit i Brendshëm
 plus 24,000 lekë të llog. 467 për pension ushqimor mbajtur nga paga e dy punonjësve.

Llog. 431, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, paraqitet në vitin 2021 në vlerën 1,235,572 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,455,383 lekë me një diferencë (shtim) prej 219,811 lekë; vlera e llog. 431 përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor 2020 dhe e paguar në Janar të vitit pasardhës. Vlera rakordon me vlerën sipas listëpagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimi mbi pagën dhe ditarit të bankës 2023.

Llog. 435, “Sigurime shoqërore” dhe llog. 436 “Sigurime shëndetësore” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,561,464 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,950,610 lekë për sig. Shoq; në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 403,628 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është pasqyruar 964,569 lekë për sig. Shënd. Gjendja e këtyre llogarive përfaqëson vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2022 që paguhën në muajin janar të vitit pasardhës. Vlera e sigurimeve përbën 15% të pagës bruto paguar nga punëdhënësi; sig shëndetësore ndahen 1.7% punëdhënësi dhe 1.7% punëmarrësi. Nga ditari i pagesave rezultoi se vlera e përbashkët e këtyre 2 llogarive është 7,915,179 lekë dhe që përbën 16.7% nga punëdhënësi të pages bruto [1.7% sig.shend + 15% sig.shoq] nders 11.2 % (9.5 % + 1.7%). Rezulton se llogaritë janë plotësuar në vlera të sakta dhe se ka informacion analitik për çdo llogari.

Nr.	Pagat Dhjetor 2022	Paga	Sig.Sho	Tatimi mbi page
1	Punonjesit e DPRRNP Tiranë në total	23,736,968	7,915,179	1,455,383

Llog. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,067,823 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,585,377 lekë, gjendje e cila përfaqëson vlerën e garancisë 5% të vlerës totale të investimeve si garanci defektesh për objektet e investimeve të cilave nuk u ka mbaruar afati i garancisë së punimeve të parashikuara në kontratën e sipërmarrjes, por edhe si garanci për të cilat firma nuk ka dorëzuar dokumentacionin për të përfituar likuidimin.

Llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”, përfshin faturat e palikuiduara si detyrime ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera, por të papaguara për mungesë fondesh. Gjendja në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 40,562 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në po këtë vlerë. Kjo vlerë përfaqëson një detyrim për vendimin gjyqësor të datës 15.09.2015 të palikuiduar. Kjo llogari është kundërparti e llog. 486 “shpenzime për periudhat e ardhshme”

Lëvizjet e llogarisë 467	
Gjendja në 01.01.2022	40,562
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2022	0
Gjendja në 31.12.2022	40,562

Vlera e kësaj llogarie duhet të përfaqësojë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve, si shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore, për detyrime të prapambetura për shërbime (edhe ato postare), për detyrime të prapambetura për mirëmbajtje, për investime, për detyrime të prapambetura të tjera. Nga analiza e pasqyrave dhe ditarit të bankës 2023, rezulton se llog.467 përbëhet nga:

{ Pensioni ushqimor në vlerën 24,000 lekë,
 energji elektrike muaji dhjetor 29,410,365 lekë,
 tatim i fitimit në burim (qiramarrje) 132,000 lekë,
29,566,365 lekë
 detyrim i mbetur nga vendimi gjyqësor 40,562 lekë.

Llog. 467 = 29,606,927 lekë

Nga auditimi **u konstatua** se vlera e llog.467 “kreditorë të ndryshëm” është nënvlerësuar për shumën 29,566,365 lekë.

Llog. 4341 “Operacione me shtetin” (detyrime) në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën 29,534,303 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 29,184,396 lekë. Kjo llogari përmbledh gjithë detyrimet e DPRRNP Tiranë ndaj shtetit apo të tretëve.

Në pasiv të bilancit grupi "Të tjera aktive afatshkurtara" paraqitet në vlerën zero. Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet vlerë në **llog. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë”** (me kundërparti llog. 468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Pra llog. 470 është nënvlerësuar për shumën 14,382,457 lekë.

Llog. 85 “Rezultati i ushtrimit”, paraqitet me tepriçë kreditore në vlerën (-)3,803,601 lekë në mbyllje të vitit 2022 dhe në vlerën 5,909,573 lekë në mbyllje të vitit 2021 me një diferencë (pakësim) në vlerën -9,713,174 lekë; dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Vlera e saj është e barabartë me diferencën e të ardhurave me shpenzimet. Është në vlerë negative, sepse gjatë vitit 2022 janë konsumuar më shumë materiale konkretisht në vlerën prej 568,480,279 leke, e cila rezulton më e madhe sesa furnizimi i kryer gjatë vitit për blerje materiale në vlerën prej 564,676,678 lekë. Për konsumimin e këtyre materialeve është përdorur gjëndja e magazinës në fillim të vitit 01.01.2022 konkretisht në vlerën 248,482,759 leke.

Nr. Llog	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
b	c	1				2
A	TE ARDHURAT	1,322,096,081	1,156,495,499	1,114,337,210	1,147,716,943	897,072,920
70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	0	0	0	0	0
700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	0	0	0	0	0
7000	Tatim mbi te ardhurat personale					
7001	Tatim mbi Fitimin					
7002	Tatim mbi Biznesin e vogel					
7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat					

702	2.Tatimi mbi Pasurine	0	0	0	0	0
7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme					
7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme					
7029	Te tjera tatime mbi Pasurine					
703	3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	0	0	0	0	0
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar(TVSH)					
7031	Akciza					
7032	Takse mbi shërbimet specifike					
7033	Takse mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie					
7035	Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie					
704	4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare	0	0	0	0	0
7040	Takse doganore per mallrat e importit					
7041	Takse doganore per mallrat e eksportit					
7042	Tarife shërbimi doganor e kaliposte					
7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare					
705	5.Takse e rruges				0	0
708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombëtare				0	0
709	7.Gjoha e Kamat vonesa					
75	II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE	0	0	0	0	0
750	NGA TE PUNESUARIT					
751	NGA PUNEDHENESI					
752	NGA TE VETPUNESUARIT					
753	NGA FERMERET					
754	NGA SIGURIMET VULLNETARE					
755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE					
756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE					
71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	326,907	678,016	581,323	0	0
710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	0	0	0	0	0
7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare					
7101	Nga Ndermarrjet publike financiare					
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia					
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	326,907	678,016	581,323	0	0
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore					
7111	Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh					
7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale					
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve					
7114	Te ardhura nga biletat					
7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime	326,907	678,016	581,323		
7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje					
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore					
76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	0	0	0	0	0
760	Nga interesat e huadhenies se brendshme					
761	Nga interesat e huadhenies se Huaj					
765	Nga interesat e depozitave					
766	Nga kembimet valutore					
72	V.GRANTE KORENTE	1,321,769,174	1,155,817,483	1,113,755,887	1,147,716,943	897,072,920
720	1.Grant korent i Brendshëm	1,321,769,174	1,155,817,483	1,113,755,887	1,147,716,943	897,072,920
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)				0	0
7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	397,351,277	62,399,420	39,199,890	1,003,324,389	551,198,874
7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH					
7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)					

7204	Pjesmarrie e institucioneve ne tatime nacionale					
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit	870,379,080	1,045,647,402	1,001,829,019		
7206	Financim I pritshem nga buxheti	54,038,817	47,770,661	72,726,978	144,392,554	345,874,046
7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)					
7209	Te tjera grante korente te brendshme					
721	2.Grant korent I Huaj	0	0	0	0	0
	Nga Qeveri te Huaja					
	Nga Organizata Nderkombetare					
	VI.TE ARDHURA TE TJERA	0	0	0	0	0
781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi					
782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra					
783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata					
784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme					
787	Terheqje nga seksioni I investimeve					
73	VII. NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE					

Pasqyra Format 2 “Performanca financiare” dhe analiza e llogarive te të “Ardhurat” dhe “Shpenzimet”

Kjo pasqyrë ka rubrikën A – Të Ardhurat dhe Rubrikën B- Shpenzimet.

Nga pasqyrat rezultojnë se rubrika e të “Ardhurave” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,243,591,444 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,571,310,165 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 327,718,721 lekë që tregon për rritje nga buxheti i Bashkisë për DPRRNP. Analiza e llogarive të të Ardhurave paraqitet si më poshtë vijon:

- **Llog. 70** “të ardhura nga taksa e tatime” paraqitet në bilanc të vitit 2022 në vlerën 0 lekë, e cila kuadron me akt rakordimin me thesarin;

- **Llog. 71** “të ardhurat jotatimore” paraqitet në bilanc të viti 2022 në vlerën 326,907 lekë; në vitin 2021 është në shumën 678,016 lekë.

Llog. 711 “tarifë administrative dhe të ardhura sekondare” në vlerën 326,907 lekë, që përbëhet nga: nënlllog. 7115 "gjoba, kamatvonesa dhe zhdëmtime" në vlerën po këtë vlerë

- **Llog. 72** “Grante korrente”/ **llog. 720** “Grant korrent i brendshëm” paraqitet në vitin 2022 në vlerën 1,321,769,174 lekë dhe përbëhet nga: nënlllog. 7201 "Nga buxheti për NJQP" në vlerën 397,351,277 lekë, nënlllog. 7205 “Financim shtese për të ardhurat e krijuara brenda sistemit” në shumën 870,379,080 lekë, nënlllog. 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" në vlerën 54,038,817 lekë.

Llog. 7206 “financim i pritshëm nga buxheti” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 54,038,817 lekë, e cila **nuk kuadron** me gjendjen e llog. 4342 “operacione me shtetin (të drejta)” e cila është në shumën 33,107,530 lekë, me një diferencë prej 20,931,287 lekë vlerë e cila është e barabartë me shumën e “të tjera aktive afatshkurtra”, të llog. 486 “shpenzime në periudha të ardhshme”. Pra llog. 4342 “operacione me shtetin (të drejta)” është nënvlerësuar për shumë 20,931,287 lekë.

Rubrika B -SHPENZIMET

Nr. llog		Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
B	SHPENZIMET	1,325,899,682	1,150,585,926	1,103,213,040	1,245,675,488	724,505,977
600	LPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJESVE	311,622,461	292,576,584	271,694,936	257,367,681	260,724,708
600 1	Paga, personel i përhershëm	311,622,461	282,059,985	271,694,936	257,367,681	260,724,708
600 2	Paga personel i Përkohshëm					
600 3	Shperblime		10,516,599			
600 9	Shpenzime te tjera per personelin					
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	52,031,286	47,094,482	45,329,943	42,940,257	41,436,061
601 0	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	46,733,974	37,506,018	40,713,170	38,565,063	37,212,535
601 1	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	5,297,312	9,588,464	4,616,773	4,375,194	4,223,526
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	931,633,260	814,867,092	795,797,576	846,843,507	594,472,696
602	Mallra dhe sherbime te tjera	931,633,260	931,633,260			
602 0	Materiale zyre e te pergjitheshme	1,256,376	1,946,340			
602 1	Materiale dhe sherbime speciale	4,404,840	6,828,332			
602 2	Sherbime nga te trete	307,238,789	284,579,751			
602 3	Shpenzime transporti	137,984,053	110,339,833			
602 4	Shpenzime udhetimi					
602 5	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	468,532,787	408,559,956			
602 6	Shpenzime per qeramarrje	10,240,400	456,480			
602 7	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	3,300				
602 8	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua					
602 9	Shpenzime te tjera operative	1,972,715	2,156,400			
603	IV.SUBVECIONE	0	0	0	0	0
603 0	Subvecione per diference cmimi					
603 1	Subvecione per te nxitur punesimin					
603 2	Subvecione per te mbuluar humbjet					
603 3	Subvecione per siper marrjet individuale					
603 9	Subvecione te tjera				0	0
	V.TRANSFERIME KORENTE	10,482,469	1,279,325	933,432	565,498	439,455
604	I.Transferime korente te brendshme	0	1,279,325	933,432	565,498	439,455
604 0	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise					
604 1	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme					
604 2	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetesore		1,279,325	933,432	565,498	439,455

604	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse					
4						
605	2.Transferime korente me jashte	0	0	0	0	0
605	Transferime Per Organizatat Nderkombetare					
1						
605	Transferime Per Qeverite e Huaja					
2						
605	Transferime Per institucionet jo fitimprurse te huaja					
3						
605	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit					
9						
606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	10,482,469	0	0	0	0
606	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH					
0						
606	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	10,482,469	0			
1						
	VL.SHPENZIME FINANCIARE	0	0	0	0	0
65	1.ShpENZIME Financiare te brendshme					
650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte					
651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme					
652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise					
656	Shpenz.nga kambimet valutore					
66	2.ShpENZIME Financiare te jashtme	0	0	0	0	0
660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja					
661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb					
662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme					
	VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	0	0	0	0	0
681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit					
682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte përdorimit e te shitura					
683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit					
686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare					
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	3,803,601	-5,909,573	-11,124,170	97,958,545	-172,566,943
	IX. TOTALI OPERACIONEVE/ SHPENZIME TE TJERA	16,326,605	678,016	581,323	0	0
828	Tituj te ardhurash te anuluar (-)					
829	Urdh.shp.anulluar ose parashkruar (+)					
841	Transferimi i ndryshim te gjendjes se inventarit te produkteve (+)					
831	Caktim te ardh.funks.per investime (-)	15,999,698				
842	Derdhje te ardhura ne buxhet (-)					
0						
842	Derdhje buxhet te ardhurave pa perdorura (-)					
1						
842	Transferim te ardhurave brenda sistemit (-)	326,907	678,016	581,323		
2						
842	Transferime per ndryshim gjendje te inventarit (llog 63) (-)					
3						
842	Transferim per debitore te konstatuar e te ngjashme (-)					
4						
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES (Rezultati I Veprimtarise se vitit Ushtrimor)	-3,803,601	5,909,573	11,124,170	-97,958,545	172,566,943

- **Llog. 600** “paga dhe përfitime e punonjësve” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 311,622,461 lekë, dhe rakordon me akt rakordimin me thesarin; vlera e kësaj llogarie përbëhet nga “paga personeli i përhershëm”, “shpërblime”.

Konstatim: Në pasqyrat e viteve 2019, 2020 dhe 2021 (viti 2022 nuk ka patur punonjës provizorë), nuk është plotësuar nënlog. 6002 “Paga personel i Përkohshëm”, por shuma e

pagave të 50 punonjësve të përkohshëm është pasqyruar sëbashku në nënlog. 6001 “Paga personel i përhershëm”.

- **Llog. 601** “kontribute të sigurimeve” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 52,031,286 lekë, ku rezulton e pasqyruar në dy llogari te veçanta (sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore) pasqyruar në llog. 6010 “kontribut i sigurimeve shoqërore” në vlerën 46,733,974 lekë dhe llog. 6011” kontribut i sigurimeve shëndetsore” në vlerën 5,297,312 lekë;

- **Llog. 602** “blerje mallra e shërbime” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 931,633,260 lekë dhe përbëhet nga vlerat e llogarive si më poshtë:

Llog. 6020 “materiale zyre të përgjithshme” në vlerën 1,256,376 lekë;

Llog. 6021 “materiale dhe shërbime speciale” në vlerën 4,404,840 lekë;

Llog. 6022 “shërbime nga të tretë” në vlerën 307,236,789 lekë;

Llog. 6023 “shpenzime transporti” në vlerën 137,984,053 lekë;

Llog. 6024 “shpenzime udhëtimi” në vlerën 0 lekë;

Llog. 6025 “shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në vlerën 488,553,073 lekë;

Llog. 6026 “shpenzime për qiramarrje” në vlerën 10,240,400 lekë;

Llog. 6027 “Shpenzime per detyrime për kompensile legale” në vlerën 3,300 lekë;

Llog. 6029 “shpenzime të tjera operative” në vlerën 1,972,715 lekë.

Nga analiza e **llog.602/ nëllog. 6026 “shpenzime qiraje”** me prishjen e pesë objekteve¹¹, nga DPRRNP Tiranë për nevojat e saj është lidhur një kontratë qiraje me nr. rep. 3112/nr. kol. 1971 datë 01.06.2022, ndërmjet DPRRNP Tiranë dhe bashkëpronarëve Z. T.P dhe Znj. M.P . Nga auditimi rezulton se kontrata në fjalë ka mangësi në përmbajtje, pasi nga ana e noterit E. H. me licencë profesionale nr. 511, nuk ka të përcaktuar bazën ligjore të cilës i është referuar për hartimin e kontratës dhe bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur për llogaritjen e vlerës së qirasë. Për këtë **konstatim** nuk është zbatuar neni 659, neni 660 dhe neni 662 të Kodit Civil. Përcaktimi i bazës ligjore referuese përveçse garanton të drejtat dhe detyrimet e palëve, rrit edhe përgjegjshmërinë për mbrojtjen e sendit objekt kontrate nga dëmtimi, humbja apo tjetërsimi.

- **“Transferime korrente”/ llog. 606** “ transferime për buxhetet familjare e individë” në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 10,482,469 lekë; ku përbëhet nga nënlog. 6061 ”Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor”.

- **Llog. 63** “ndryshimi i gjendjes së inventarit” në vlerën 3,803,601 lekë, e cila është e barabartë me diferencën e klasës 3 të formatit 1 të bilancit;

- **Llog. 85** “teprica ose deficit i periudhës (rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor)” në vlerën

(-) 3,803,601 lekë, vlerë e cila rakordon me diferencën mes të ardhurave dhe shpenzimeve.

- **Formati 5** “shënime shpjeguese” është plotësuar;

- **Formati 8** “numri i punonjësve dhe fondi i pagave” është plotësuar saktë, duke dhënë një pasqyrim të plotë të shpërndarjes së fondit të pagave sipas kërkesave të formatit.

¹¹ Trajtuar në nëpikën për procedure e Inventarizimit

Ku tek Formati 8 i bilancit Fondi i pagave gjithsej është i barabarte me llog 6001 “Paga personeli” te Formati 2 i Bilancit;

Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore te Formati 8 i Bilancit është i barabartë me pagesat e kryera për këtë llogari që janë të pasqyruara në evidencën e realizimit të shpenzimeve me thesarin si dhe është pasqyruar në ditarin e bankës (llog 435+llog 436).

Tatimi mbi të ardhurat te Formati 8 i Bilancit është i barabartë me pagesat e kryera për këtë llogari që janë të pasqyruara në evidencën e realizimit të shpenzimeve me thesarin si dhe është pasqyruar në ditarin e bankës (llog. 431).

Për konstatimet më sipër nuk janë zbatuar drejt Udhëzimi i MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022, kreu I, II dhe III; Aneksi I.

Me shkresën nr. 1775/3 prot., datë 03.06.2024 nga Subjekti DPRRNP Bashkia Tiranë dhe me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024, janë shprehur observacionet mbi gjetjet dhe konstatimet e përcjella nga grupi i auditimit në Akt Konstatimin nr. 5 datë 21.03.2024 dhe në PRA, lidhur me [gjetje dhe rekomandime (4)], si më poshtë vijon:

Pretendimet e Subjektit:

- Për gjetjen 4, pika 4, është konstatuar se nuk është llogaritur amortizimi i llogarisë “Studime e projekte” është e vërtetë se nuk është bërë dhe gabimi ka ardhur nga trashëgimia në vite, në momentin e konstatuar nga ana e Financës u bënë këto veprime: “ të gjitha ato projekte që u lidhën me objektet për të cilat kanë qënë u shtuan në vlerën e objektit përkatës, pra u bë kalimi nga llogaria 202 te llogaria 213, duke llogaritur edhe amortizimin nga data e përfundimit të objektit e deri me 31.12.2022, për vitin 2023 amortizimi është llogaritur me vlerën totale të objektit, për ato projekte që nuk u lidhën me objektet për të cilat ishin hartuar vazhdojnë te jenë në llogarinë 202 dhe për këto është llogaritur amortizimi deri me 31.12.2023, duke u reflektuar në Pasqyrat e Bilancit të vitit 2023.

- Për gjetjen nr 4, pika nr 5, ju sqarojmë se: mbajtja e llogarisë 218 në bllok dhe jo e ndarë në 218/1 paisje zyre dhe 218/2 paisje kompiuterike është bërë pasi kështu janë kërkuar në formularët e aseteve dhe në pasqyrën financiare, konkretisht në Aneksin statistikor 7/b nuk kërkohet e ndarë. Ne analizat i kemi të mbajtura për cdo llogari dhe për cdo artikull, thjesht me një kërkesë nga ana juaj dhe financa do ua kishte vënë në dispozicion.

- Për gjetjen nr 4 pika 6, për llog 24 ju sqarojmë se: përbërja e kësaj llogarie e paraqitur në Bilancin e vitit 2022 është si në tabelën e mëposhtme:

Nga llogaria 218 kanë kaluar në llogarinë 24 shuma e aktiveve 33 cope me vlerë 3.212374 lekë bruta, amortizim deri me 31.12.2022 me vlerë 2.748.428 lekë dhe vlerë të mbetur 463.946 lekë , shuma qe shenohet ne faqen 76 të projekt-raportit se llogarisë 218 i përkasin 61.893.470 lekë është shuma totale e llog. 24 dhe jo e llogarisë 218.

- Për gjetjen nr.4 , pika 7, ju sqarojmë se: DPRRNP ka marrë një objekt nga Ministria e Bujqësisë (Bordi I kullimit Durrës) për një afat 6 mujor, për të cilin është hartuar një procesverbal i nënshkruar nga 2 palët, nuk është regjistruar në kontabilitet pasi nuk ka një kontratë përdorimi apo një praktikë shkresore e përcjellur nga Bashkia Tiranë për këtë veprim, theksojmë se në kontabilitet janë shtuar ato asete të cilat kanë ardhur me shkresa të plota nga Bashkia Tiranë.

- Për gjetjen 4, pika 8, ku thuhet se u konstatua se nga sektori i Finances për vitet 2021,2022 nuk është mbajtur një evidencë e vecantë vetëm për llog. 209 e 219 “Amortizimi i AAJM dhe AAM” Për këtë ju sqarojmë se nga ana e sektorit të financës për çdo vit është bërë llogaritja e amortizimit vjetor

për çdo artikull sipas llogarive përkatëse me perjashtim të llogarisë 202 siç e shpjeguar më sipër, mbi ato llogaritje janë bërë shtesat në pasqyrat e bilancit. Artikujt me vlere zero do mbahen në bilanc deri sa të dalin jashtë përdorimi me procedura të rregullta sipas udhëzimit nr 30 date 27.12.2011.

Bashkëngjitur keni pasqyrat e Aseteve per vitet 2020,2021,dhe 2022.

- Për gjetjen 4, pika 9, ku thuhet se u konstatua se në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria 230 e 231 nuk kanë të pasqyruar vlerat respektive të investimeve për vitin 2022 dhe vitet e mëparshme. Për këtë ju sqarojmë se: llogarie 230 e 231 nuk dalin në pasqyrën e pozicionit financiar pasi nga kontabilizimi i veprimeve të vitit ushtrimor ato transferohen në llogaritë përkatëse të asetëve, mënyrën e kontabilizimit e keni trajtuar gjërësisht në faqen 78 të projekt

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me pretendimet tuaja mbi gjetjet dhe konstatimet e përcjella për pasaktësinë e vlerave të disa llogarive kontabël, sqarojmë si më poshtë vijon:

- Mbi mosllogaritjen e amortizimit të llog.202, referuar dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 36 i ndryshuar, llogaritja duhet të fillojë nga viti 2018 e në vijim dhe vlera totale duhet pasqyruar në pasqyrat e bilancit të vitit të mbyllur ushtrimor 2023 (meqë reflektimi juaj ka qenë i menjëhershëm). Të verifikohet vlera dhe të saktësohet në rast të mosllogaritjes së sakt të saj në llog.202 të pasqyrave financiare në vijim. Për sa u shprehëm observacioni juaj për llogaritjen e vlerës së amortizimit të llog. 202 dhe pasqyrimin të saj në pasqyrat e bilancit të vitit 2023 **merret pjesërisht në konsideratë;**

- Lidhur me pretendimin tuaj mbi llog. 218, pajisjet kompjuterike duhet të klasifikohen veçmas në llog. 218/1, ju sjellim në vëmendjen tuaj se konstatimi ynë ka të bëjë me faktin e mospasqyrimin në pasqyrat 7/a e 7/b dhe në regjistrin e aktiveve me Urdhër të brendshëm të tuitullarit të veçantë për aktivet e kësaj kategorie. Nga verifikimi i dokumentacionit (pasqyrave financiare, evidencave të amortizimit dhe regjistrit të aktiveve), observacioni juaj për llog.218 dhe llog 218/1 **merret në konsideratë nga grupi i auditimit;**

- Lidhur me pretendimin tuaj mbi analizën e llog 24, ju sjellim në vëmendjen tuaj se konstatimi ynë i referohet mungesës së analizës së bllokut të aktiveve në shumën totale të vlerës kontabël 4,434,245 lekë dhe vlerës së mbetur 139,807 lekë. Nga ana juaj duhet të zërthehet ipas llo kontabël qëpërfaqëson me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur, pasi referuar Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 i ndryshuar neni 36, llog. kontabël kanë normë të ndryshme amortizimi. Pra obesrvacioni juaj për analizën e llog. 24 **nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit;**

- Lidhur me mungesën e akt marrëveshjes së lidhur ndërmjet dy komisioneve për marrjen në përdorim të objektit në pronësi të ish Bordit të kullimit, pretendimi juaj nuk ka arsytim ligjor, pasi në komisionin e ngritur si anëtar i radhës së parë është drejtori i financës së DPRRNP dhe duhej të përpilohej me patjetër akt marrëveshja. Për sa sqaruam observacioni juaj **nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit;**

- Lidhur me llog. 230 e llog 231 obseracioni juaj **merret në konsideratë nga grupi i auditimit.**

Mbi saktësinë e përgatitjes së zërave të pasqyrave financiare

I. Pasqyra Format 1 “Pasqyra e Pozicionit Financiar” - Aktivet & Pasivët; Pasqyra Format 2 “Pasqyra e Performancës Financiare”; Pasqyra Format 7/a,b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historikedhe vlera neto);

1. Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se janë paguar 3 fatura të kontratave të punëve të lidhura në vitin 2021 (2) dhe 2022 (1), për të cilat janë ngurtësuar 5% e vlerës së tyre, nga të cilat për kontratën nr. 1767/8 datë 16.08.2022 në vlerën 37,641,883 lekë vlera e llog.466 është llogaritur në shumën 1,100,000 lekë kur në fakt duhet të ishte në shumën 1,882,094 lekë.

Me një diferencë prej (-)782,094 lekë është nënvlerësuar llog. 466 si vlera e 5% e garancisë për këtë kontratë.

2. Nga analiza e llog.468 "debitorë të ndryshëm" e pasqyruar në mbyllje të vitit 2022 në shumën 14,382,457 lekë, rezultoi se vlera e kësaj llogarie është e trashëguar nga viti 2016 për dëmtime në rrugë e rrjete. Për këtë shumë te pasqyra e konfirmimit është shënuar se nuk ka asnjë evidencë. Shuma e detyrimeve debitohet në llog. 468 "debitorë të ndryshëm" dhe kreditohet në llog. 4341 "të tjera operacione me shtetin (kreditor)". Llog. 468 ka si kundërparti llog.470 "të ardhura për t'u marrë" në pasiv. U konstatua se nga ana e Drejtorisë së financës nuk është bërë asnjë analizë apo verifikim, si dhe nuk është marrë asnjë masë për të siguruar arkëtimin e detyrimit deri në vlerë të plotë të tij, pasi dhe periudha e lindjes së detyrimit nuk është e hershme, për të mos u bërë e mundur arkëtimi i vlerës.

3. Nga analiza e Llog. 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" që paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 20,931,287 lekë, përfshihet edhe shuma e mbartur ndër vite 4,931,589 lekë për mallra e shërbime të kryera nga 2011-2015 dhe të papaguara. Nga auditimi u konstatua se për këto detyrime nuk është bërë asnjë analizë mbi arsyet e mbartjes nga viti në vit në vlerën e tij të plotë pa bërë pagesa qoftë edhe pjesore, me qëllim minimizimin e vlerës deri në likuidim të saj në fund të periudhës 7 vjeçare.

4. Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe regjistrit të aktiveve rezultoi se për periudhën nën auditim 2019-2022, nuk është llogaritur amortizimi i aktiveve të llog. 202 "studime dhe kërkime" me normën përkatëse të amortizimit (15%), në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 36 i ndryshuar.

5. Nga analiza e llog. 218 "inventar ekonomik" rezultoi se, kategoria "pajisje kompjuterike" nisur nga karakteristikat specifike të aktivitetit, nuk është ndarë si kategori më vete llog. 218/1, duke pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj për të saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit. Por nga verifikimi i analizës së llogarisë dhe regjistrit të inventareve rezultoi se llogaritja e amortizimit për pajisjet kompjuterike vetëm në vitet 2021 dhe 2022 është llogaritur saktë prej 25% të vlerës së mbetur.

6. Për vitin 2022 llog.24 përbëhet nga nëntë dhjetë e nëntë (99) aktive të cilësuar të dëmtuara, nga të cilat: njëzetë e tetë (28) aktive i përkasin llog.218 në vlerë kontabël 61,893,470 lekë dhe vlerë të mbetur 514,926, prej të cilave tetë (8) aktive e kanë vlerën e mbetur zero (0); tridhjetë e një (31) aktive i përkasin llog.215 në vlerë kontabël 37,719,663 lekë dhe vlerë të mbetur 11,898,064 lekë, prej të cilave tre (3) aktive e kanë vlerën e mbetur zero (0); njëzetë e tetë (28) aktive i përkasin llog.214 në vlerë kontabël 15,683,210 lekë dhe vlerë të mbetur 4,368,213 lekë; pesë (5) aktive i përkasin llog.212 në vlerën kontabël 603,978 lekë dhe vlerë të mbetur 238,592 lekë; ka dhe një grup aktivesh të dëmtuara përdorur nga administrata në vlerën kontabël totale 4,434,245 lekë dhe vlera e mbetur 139,807 lekë. Nga auditimi i regjistrave të aktiveve u konstatua se për këtë grup aktivesh, nuk janë dhënë specifikime mbi llogarinë kontabël së cilës i përkasin dhe rrjedhimisht dhe llogaritja e amortizimit nuk është bërë sipas normës përkatëse të amortizimit.

7. Llog. 28 "Caktime" në mbyllje të viteve 2021 dhe 2022 njësia publike nuk ka caktuar AAGJ në përdorim për të tjerë, pra kjo llogari nuk ka vlerë; Nga auditimi u konstatua se DPRRNP Tiranë ka marrë në përdorim një objekt në pronësi të ish Bordit të Kullimit. Mungesa e hartimit të akt marrëveshjes apo kontratës së përdorimit mes dy institucione, ka rezultuar me mosevidentimin e vlerës së këtij aktivi në llog.107 "aktive të caktuara në përdorim", në

kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. Pra llog.107 “aktive të caktuara në përdorim” merr në kredi vlerën neto të aktivitetit që institucione merr në përdorim nga të tretët me kundërparti debitin e llogarive përkatëse të grupit 21 të AAGJM. Teprica e saj tregon që aktivitetet nuk janë të vetat.

8. Llog. 209 & 219 “Amortizimi i AAM & AAJM” sipas pasqyrave financiare të DPRRNP Tiranë në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën 8,777,758,316 lekë; Në mbyllje të vitit 2022 paraqiten në vlerën 9,827,261,219 lekë, ku rezulton se kjo vlerë është shtuar për 1,215,510,802 lekë dhe pakësuar për shumën 166,007,899 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit, pasqyrave dhe evidencave të miratuara, u konstatua se nga ana e sektorit të financës për vitet 2021 dhe 2022 nuk është hartur një evidencë e veçantë vetëm për llog. 209 dhe 219 “Amortizimi i AAJM & AAM”, me qëllim mbajtjen nën kontroll të vlerës së mbetur të aktiveve të njësisë publike;

- Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të regjistruar në kontabilitet, u konstatua se një pjesë e këtyre aktiveve pasi i është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite, vlera e tyre është e papërfillshme (më e vogël se “100” lekë ose “0” lekë). Këto aktive vazhdojnë të jenë në përdorim dhe gjendje pune. Nga ana e titullarit në cilësinë e NA dhe koordinatorit të Riskut dhe NZ të institucionit, nuk është marrë asnjë masë për të ngritur grupin e punës me ekspertë të fushave, për këta artikuj, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre. Ndryshimet në jetën e pritshme të dobishme dhe të vlerës së tyre të kontabilizohen duke ndryshuar periudhën e amortizimit apo metodën, sipas rastit, dhe të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël

9. Llog. 7206 “financim i pritshëm nga buxheti” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 54,038,817 lekë, e cila *nuk kuadron* me gjendjen e llog. 4342 “operacione me shtetin (të drejta)” e cila është në shumën 33,107,530 lekë, me një diferencë prej 20,931,287 lekë vlerë e cila është e barabartë me shumën e “të tjera aktive afatshkurtra”, të llog. 486 “shpenzime në periudha të ardhshme”. Pra llog. 4342 “operacione me shtetin (të drejta)” është nënvlerësuar për shumë 20,931,287 lekë.

10. Llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”, përfshin faturat e palikuiduara në kohë si detyrime ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera, por të papaguara për mungesë fondesh. Gjendja në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 40,562 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në po këtë vlerë. Nga auditimi u konstatua se vlera e llog.467 “kreditorë të ndryshëm” është nënvlerësuar për shumën 29,566,365 lekë.

11. Në pasiv të bilancit grupi “Të tjera aktive afatshkurtara” paraqitet në vlerën zero. Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet vlerë në llog. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llog. 468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Pra llog. 470 është nënvlerësuar për shumën 14,382,457 lekë.

12. Llog. 600 “paga dhe përfitime e punonjësve” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 311,622,461 lekë, dhe rakordon me akt rakordimin me thesarin; vlera e kësaj llogarie përbëhet nga “paga personeli i përhershëm”, “shpërblime”. U Konstatua se në pasqyrat e viteve 2019, 2020 dhe 2021 (viti 2022 nuk ka patur punonjës provizorë), nuk është plotësuar nënlllog. 6002 “Paga personel i Përkohshëm”, por shumica e pagave të 50 punonjësve të përkohshëm është pasqyruar sëbashku në nënlllog. 6001 “Paga personel i përhershëm”.

13. Nga analiza e llog.602/ nënlllog. 6026 “shpenzime qiraje” me prishjen e pesë objekteve, nga DPRRNP Tiranë për nevojat e saj është lidhur një kontratë qiraje me nr. rep. 3112/nr. kol. 1971 datë 01.06.2022, ndërmjet DPRRNP Tiranë dhe bashkëpronarëve Z. T.P dhe Znj. M.P .

Nga auditimi rezulton se kontrata në fjalë ka mangësi në përmbajtje, pasi nga ana e noterit E. H. me licencë profesionale nr. 511, nuk ka të përcaktuar bazën ligjore të cilës i është referuar për hartimin e kontratës dhe bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur për llogaritjen e vlerës së qirasë. Për këtë konstatim nuk është zbatuar neni 659, neni 660 dhe neni 662 të Kodit Civil. Përcaktimi i bazës ligjore referuese përveçse garanton të drejtat dhe detyrimet e palëve, rrit edhe përgjegjshmërinë për mbrojtjen e sendit objekt kontrate nga dëmtimi, humbja apo tjetërsimi.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022; UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël”; UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar me ligjin nr.8282, datë 21.01.1998, ligjin Nr. 9040, datë 27.03.2003 dhe ligjin Nr. 9807, datë 20.09.2007; VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”; VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar; VKM nr. 610, datë 24.07.2013 “Për miratimin e shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin”; VKM nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e Njësitë të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njësitë të vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”; Ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Udhëzimi nr. 21/2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”; Udhëzimin nr.16, datë 20.07,2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike.

Drejtimit kryesore të auditimit mbi procedurën e inventarizimit janë:

- Njohja dhe zbatimi i Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 për marrjen e masave të nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi;
- Përgjegjësia e Titullarit të Njësisë Publike në cilësinë e NA, për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi;
- Përgjegjësia e Nëpunësit zbatues NZ dhe menaxherëve të të gjitha niveleve të Njësisë Publike mbi aktivet e njësisë, përfshirë Koordinatorin e riskut;
- Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve në DPRRNP.

Në zbatim të auditimit, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Baza rregullatore mbi të cilën ushtron funksionet e saj DPRRNP: Rregullorja e brendshme e miratuar, Rregullore për Menaxhimin e Aktiveve (nëse ka), Rregullore të Sigurisë Teknike, Manuali i Proceseve të Punës (nëse ka), etj.
2. Strukturën organizative dhe organigramën e institucionit me ndryshimet për periudhën 2019-2022; dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
3. Shkresat e përcaktimit të NA dhe NZ në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
4. Shkresat për krijimin e grupit të menaxhimit strategjik [GMS]; planin vjetor dhe procesverbalet e takimeve;
5. Strategji dhe Regjistër Risku; Regjistri i Aseteve të DPRRNP.

Nga auditimi i dokumentacionit të venë në dispozicion nga DPRRNP Tiranë, në përgjigje të kërkesave të përshkruara më lart lidhur me Procedurën e inventarizimit të aktiveve, grupi i auditimit referuar Udhëzimit nr. 30 date 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”, të gjitha njësitë e sektorit publik kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Nga auditimi në DPRRNP Tiranë, u kërkuan praktikrat e procedurave të inventarizimit për periudhën 2019 - 2022.

Nga auditimi rezultoi se:

1. Referuar Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, praktika e procedurës së Inventarizimit përmban:

- Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm në cilësinë e NA për krijimin e komisioneve të verifikimit fizik dhe vlerësimit paraprak të aktiveve, të vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve;

Pjesërisht zbatuar

- Përmbledhëse Inventare të magazinave dhe zyrave, për llogaritë përkatëse;

zbatuar

- Relacioni ose Raporti përmbyllës përpiluar dhe nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të Verifikimit Fizik dhe vlerësimit paraprak të Inventareve/aktiveve;

zbatuar

- Relacioni ose Raporti përmbyllës përpiluar dhe nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të Vlerësimit të Inventareve/aktiveve;

zbatuar

- Komisionin e asgjësimit të vlerave materiale, zbatimi i procedurave të tyre monitorohen nga NZ;

Pjesërisht zbatuar

2. Praktika shkresore për ngritjen e komisioneve për vitet: 2019, 2020, 2021 dhe 2022 dhe statusi i çdo faze të procedurës së Inventarizimit të DPRRNP Tiranë, është si më poshtë vijon:

Viti	Urdhrat Brendshëm për Komisionet e Inventarit Fizik & vlerësim paraparak	Relacion	Urdhrat Brendshëm për Komisionet e Vlerësimit	Relacion	Urdhrat Brendshëm për Komisionin e Asgjesimit	Relacioni	Vlera e aktiveve vlerësuar të dëmtuara/për asgjesim(në lekë)	Statusi Procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit
2019	*UB. 3550 dt. 25.11.2019 *UB. 3551 dt. 25.11.2019 *UB. 3551/1 dt. 25.11.2019 *UB. 3551/2 dt. 25.11.2019 *UB. 3552 dt. 25.11.2019 *UB. 3552/1 dt. 25.11.2019 *UB. 3552/2 dt. 25.11.2019	*Nr. 3550/2 dt. 06.01.2020 *Nr. 3551/5 dt. 06.04.2020 *Nr. 3551/3 dt. 06.01.2020 *Nr. 3551/4 dt. 06.01.2020 *Nr. 3552/3 dt. 06.01.2020 *Nr. 3552/4 dt. 06.01.2020 *Nr. 3552/5 dt. 06.01.2020	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	28,305,143	Nuk ka
	7 shkresa		Nuk ka		Nuk ka		28,305,143	Nuk ka
2020	*UB. 3363 dt. 16.12.2020 *UB. 3364 dt. 16.12.2020 *UB. 3365 dt. 16.12.2020 *UB. 3366 dt. 16.12.2020 *UB. 3367 dt. 16.12.2020 *UB. 3368 dt. 16.12.2020 *UB. 3369 dt. 16.12.2020 *UB. 3369 dt. 16.12.2020	Nr. x dt. x.01.2021 Nuk ka Nr. x Dt. x. 01.2021 Nr. x Dt. x. 01.2021 Nr. x Dt. x. 01.2021 Nr. x Dt. x. 01.2021 Nr. x Dt. x. 01.2021 Nr. x Dt. x. 01.2021	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	2,114,840	Nuk ka
	8 shkresa		Nuk ka		Nuk ka		2,114,840	Nuk ka
2021	*UB. 3537 dt. 21.12.2021 *UB. 3538 dt. 21.12.2021 *UB. 3539 dt. 21.12.2021 *UB. 3540 dt. 21.12.2021 *UB. 3541 dt. 21.12.2021 *UB. 3542 dt. 21.12.2021 *UB. 3543 dt. 21.12.2021 *UB. 3544 dt. 21.12.2021 *UB. 3545 dt. 21.12.2021	Nr. 3537/1 dt. 13.01.2022 Nr. 3538/1 dt. 13.01.2022 Nr. 3539/1 dt. 13.01.2022 Nr. 3540/1 dt. 13.01.2022 Nr. 3541/1 dt. 05.01.2022 Nr. 3542/1 dt. 05.01.2022 Nr. 3543/1 dt. 05.01.2022 Nr. 3543/1 dt. 05.01.2022 Nr. 3545/1 dt. 05.01.2022	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	3,219,960	Nuk ka
	9 shkresa		Nuk ka		Nuk ka		3,219,960	Nuk ka
2022	*UB. 3822 dt. 28.12.2022 *UB. 3823 dt. 28.12.2022 *UB. 3824 dt. 28.12.2022 *UB 3825 dt. 28.12.2022 *UB 3827	Nr. 3822/1 dt. 10.01.2023 Nr. 3823/1 dt. 13.01.2023 Nr. 3824/1 dt. 11.01.2023 Nr. 3825/1 dt. 17.01.2023 Nr. 3827/1	*UB. 933 dt. 29.03.2022	Memo 1896 dt. 28.6.2022			603,928 pa procedurë Vlera bruto 39,731,143 Vlera e mbetur neto 3,934,611	Nuk ka Nuk ka

dt. 28.12.2022 *UB 3828	dt. 24.01.2023 Nr.3828/1						
dt. 28.12.2022 *UB 3829	dt. 20.01.2023 Nr. 3829/1						
dt. 28.12.2022 *UB 3830	dt. 20.01.2023 Nr.3830/1						
dt. 28.12.2022	dt. 20.01.2023						
8 shkresa		Nuk ka		Nuk ka		40,335,071	Nuk ka

Punoi: Grupi i auditimit

Konstatime:

1. Nga auditimi i dokumenteve dhe informacioni i pasqyruar në tabelat e mësipërme, rezultojnë në 2 raste (sipas tabelës 2): me UB nr. 3826 dt. 28.12.2022 është caktuar B.S kr. komisioni të inventarizimit të [magazinës nr.1] për dy vite radhazi 2021 dhe 2022; me UB nr. 3550 dt. 25.11.2019, UB nr.3364 dt. 16.12.2020 dhe UB nr.3537 dt. 21.12.2021 është krijuar komisioni i inventarizimit të [Pajisjet/Inventari ekonomik në zyrë/korridor/magazinë 1] i cili ka në përbërjen e tij të njëjtën anëtarë për 3 vite radhazi, duke mos plotësuar kriteret e Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 84 ku citohet se ...”inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me rradhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision”.

2. DPRRNP Tiranë nuk ka hartuar dhe miratuar Strategji dhe Rregullore “Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve (inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve) në moszbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 6,7,8,9 dhe 17,18,19; Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së GMS, caktimit të Kordinatorit të MFK dhe Kordinatorit të Riskut, në moszbatim të nenit 27, nenit 9, nenit 10 të Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontriollin” i ndryshuar, Udhëzimin nr.16, datë 20.07,2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, Udhëzimit nr. 21/2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”; pasi është ndër detyrat prioritare e GMS të hartojë dhe miratojë Strategji dhe Rregullore për menaxhimin e aktiveve të Njësisë publike.

- Strategjitë dhe Rregullorja për menaxhimin e aktiveve duhet të përmbajnë paketën e masave për:

a. Mbrojtjen fizike kundër vjedhjes, vandalizmit, dëmtimeve natyrore, nëpërmjet instalimit të kasafortave, drynave të sigurisë/alarmit/patrullat, sistemit të pompave për parandalimin e zjarrit, kontrollet e inventareve dhe siguracionet, etj;

b. Aksesin e kontrolluar dhe ruajtjen e informacionit mbi aktivet, të dhënat e personelit, të dhënat financiare, sistemet e kompjuterizuara të informacionit, etj;

c. Depozitimi në llogarië e sistemit të thesarit i vlerave monetare të arkëtuara nga të gjitha nivelet e njësisë së qeverisjes së përgjithshme, menjëherë pas pranimit të tyre.

d. Përcaktimin e sistemeve dhe procedurave për zëvendësimin apo shtimin e aktiveve afatgjata. Planifikimi në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të tyre të jetës është një tjetër mënyrë për parandalimin e mosfunksionimit e papritur të ndonjë aktivi. Jetëgjatësia standarde që jepet në regjistrin e aktiveve afatgjata nëpërmjet normave të amortizimit, është një tregues se kur një aktiv duhet të zëvendësohet. Është e rëndësishme që jetëgjatësia standarde të mos ndiqet verbazi, pasi aktivi mund të vazhdojë të jetë në gjendje pune dhe njëkohësisht i nevojshëm ose i dobishëm për plotësimin e objektivave të njësisë.

Dobishmëria e çdo aktivi duhet vlerësuar nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, i cili ngrihet dhe funksionon sipas kriterëve të këtij udhëzimi.

e. Riparim i menjëhershëm i dëmeve. Duhet të kryhen inspektime të rregullta dhe të ekzistojë një sistem për regjistrimin e dëmeve dhe për garantimin se veprimet e duhura po merren me shpejtesi.

ë. Shërbime të rregullta mirëmbajtjeje për minimizimin e avarive të mundshme. Për tu siguruar për eficientë të aktiveve është e nevojshme të ekzistojnë sistemet përkatëse të kontrollit.

f. Mirëmbajtja e planifikuar. Aktivitet afatgjatë materiale duhen mbikëqyrur rregullisht në drejtim të jetëgjatësisë së pjesëve përbërëse të tyre (p.sh çatisë, sistemit të ngrohjes, etj). Në një program mirëmbajtjeje të planifikuar ky informacion përdoret për t'i orientuar shpenzimet drejt punës parandaluese sesa drejt riparimit të avarive. Çdo njësi publike duhet të hartojë planin e mirëmbajtjes së aktiveve me qëllim planifikimin e fondeve të nevojshme si dhe sigurimin e eficientë në përdorimin e aktiveve.

g. Trajnimi i punonjësve për përdorimin dhe mbrojtjen e aktiveve.

h. Përshtatshmëria për përdorim e aktiveve, nëse është e mundur, për minimizimin e riskut që vjen nga mospërputhja e aktivitet me objektivin në rast të ndryshimit të kushteve të punës.

i. Planet e emergjencës për vlerësimin e gjithë pasojave potenciale të riskut nga faktorë të jashtëm si fatkeqësi natyrore, epidemi e të tjera të ngjashme, nëpërmjet katër fazave të mëposhtme:

- Rishikimi i rreziqeve dhe vlerësimi i ndikimeve potenciale mbi veprimtarinë duke regjistruar dhe analizuar humbjet për të identifikuar prirjet dhe problemet e reja
- Zhvillimi, përditësimi, auditimi dhe testimi i planit. Përfshihen nga detyrimet sipas këtij paragrafi, njësitë publike të parashikuara në nenin 3, pika 2 dhe 3 të Ligjit 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
- Menaxhimi i krizave—zbatimi i planit gjatë dhe pas një incidenti
- Rikthimi në operacionet normale.

3. Për vitet 2019, 2020, 2021, komisionet e inventarit fizik dhe të vlerësimit paraprak kanë përpiluar relacionin me listën e aktiveve të dëmtuara për procedura të mëtejshme (tabela 1) – në vlerat respektive: 28,305,143 lekë, 2,114,840 lekë, 3,219,960 lekë. **U konstatua** se nga ana e NA dhe NZ nuk është marrë asnjë masë për ngritjen e komisioneve të vlerësimit përfundimtar të tyre, me qëllim nxjerrjen e aktiveve të dëmtuara për jashtë përdorimit/asgjesisimit. Kjo në moszbatim të Udhëzimit nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kreu IV paragrafi 3 pika 96;

4. NZ ka ndjekur përmbylljen e procesit të inventarizimit për fazën e parë “verifikimit fizik dhe vlerësimit paraprak” për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, duke hartuar përmbledhësen e inventareve sipas zyrave/magazinave dhe personave që i kanë në ngarkim, si dhe regjistrin e aktiveve afatgjatë për llog. 202, llog. 210, llog. 212, llog. 213, llog. 214, llog. 215, llog. 218;

- Nga auditimi **u konstatua** se në regjistrin e aseteve ka objekte inventari që nuk kanë vitin e krijimit si aktiv në Njësinë publike.

- Gjithashtu se asetet e DPRRNP Tiranë nuk janë të pajisura me certifikatë pronësie, mos rivlerësimin e tyre dhe si rrjedhojë mospasqyrim të sakt të vlerave të tyre në llogaritë përkatëse 210 dhe 212.

5. Mbi vlerësimin e mjeteve të transportit dhe pajisje e makineri, nga NA me Urdhrin nr. 933 datë 29.03.2022 është ngritur komisioni i vlerësimit prej shtatë (7) anëtarësh si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Drejtori/Sektori	Pozicioni në strukturë	Formimi profesional	Data e emërimit
1	S.M	Financë	Drejtor drejtorie	Financë	17.11.2020
2	O.S	-//-	Specialiste	Financë-kontabilitet	27.05.2013
3	M.K	Transportit	Përgjegjëse sektori	Ekonomik	25.10.2018
4	S.Q	Teknik	Specialist	Ing. mekanike	14.07.2014
5	M.B	Teknik/oficinë	Përgjegjës	Mekanik i mesëm	01.07.2021
6	F.K	Teknik/oficinë	Teknik/mekanik	Xhenerik i mesëm	24.04.2020
7	B.GJ	s.Pllakave	Specialist	Ing. mekanike	03.08.2016

Burimi: DPRRNP Bashkia Tiranë

Nga auditimi i praktikës dokumentare **rezultoi** se:

- **Mungon** Urdhri i titullarit (nr.933 datë 29.03.2022)
- Komisioni është ngritur konform akteve ligjore;
- **Ka mangësi** apo pasaktësi në formulimin e aktit të titullarit lidhur me afatin e përfundimit të procedurës (dt. 15.01.2022 është para fillimit të vet procedurës) dhe bazës ligjore të cilës i referohet (VKM nr. 510/2015)
- Është hartuar relacioni përmbyllës me tabelën e mjeteve të dëmtuara për jashtë përdorimit, si dhe proces verbalet për çdo mjet të dëmtuar shoqëruar me fotot përkatëse;
- Me nr. 1896 prot., datë 28.06.2022 është hartuar dhe dërguar “Memo” drejtuar Kryetarit të bashkisë dhe menaxherëve të strukturave përgjegjëse: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Për këto mjete u kërkua informacion i detajuar dhe nga auditimi rezultoi si më poshtë: janë bërë procedurat e çregjistrimit të përhershëm pranë DRSHTRR Tiranë, me qëllim shmangien e detyrimeve vjetore: taksa e qarkullimit, gjoba e kolaudimit si dhe siguracioni vjetor;

Nr	Emertimi	Targa	Viti Prodhi m	Viti Shfrytezi m	Sasi	Çmimi i Blerjes	Vlera Fillestare Blerjes	Vlera E Amortizimit 31.12.2021	Vlera E Mbetur 31.12.2021	Viti i Statusit të mjetit
1	Motokarro	TR 070 B	1999	2000	1	490,000	490,000	476,142	13,858	-
2	Motokarro	TR 068 B	1999	2000	1	490,000	490,000	476,142	13,858	Ç.përhershëm / 2012
3	Kamion Volvo	TR 4314 G	1981	2006	1	2,170,000	2,170,000	2,020,409	149,591	Ç.P / 2017
4	Autoveture Audi	TR 4415 G	1990	2004	1	599,000	599,000	568,318	30,682	Ç.p / 2012
5	Autoveture Golf	TR 7650 A	1985	2002	1	350,000	350,000	336,679	13,321	Ç.P / 2012
6	Benz Kamion	TR 0714 K	1986	2009	1	1,189,500	1,189,500	1,061,476	128,024	Ç.p / 2020
7	Autobot Zifti	TR 1755 E	1998	1999	1	7,300,000	7,300,000	7,122,041	177,959	-
8	Autobot Uji	Pa targë	1986	1995	1	3,319,843	3,319,843	3,275,160	44,683	-
9	Benz Kamion	TR 5956 H	1999	2000	1	499,500	499,500	485,374	14,126	Ç.P / 2012
10	Motokarro	TR 066 B	1999	2000	1	490,000	490,000	476,142	13,858	Ç.P / 2012
11	Motokarro	TR 067 B	1999	2000	1	490,000	490,000	476,142	13,858	-
12	Gaz Kulle Ndricimi		1993	1998	1	4,450,000	4,450,000	4,356,488	93,512	NA
13	Motorcikle	3B08	2008	2008	1	90,000	90,000	81,650	8,350	-
14	Motorcikle	TR 3B07	2008	2008	1	115,800	115,800	105,057	10,743	-
15	Freze Asfalti		1997	2005	1	6,890,000	6,890,000	4,379,410	2,510,590	NA
16	Bitumatriçe	Pa targë	1988	1994	1	998,000	998,000	813,883	184,117	-
17	Benz Kamion	TR 5372 R	1992	2008	1	2,171,700	2,171,700	1,970,220	201,480	Ç.P / 2019
18	Benz Veture	AA 470 BI	1987	2009	1	930,000	930,000	829,906	100,094	Ç.P / 2019
19	Benz Kamion	TR 0716 K	1996	2009	1	1,189,500	1,189,500	1,061,476	128,024	Ç.P / 2019
20	RUL Asfalti 5 Ton/ Brevedato	Pa targë	1970	1998	1	1,938,300	1,938,300	1,897,569	40,731	-

21	RUL Asfalti HAMM	Pa targë	1985	1993	1	3,480,000	3,480,000	3,445,197	34,803	-
22	Triçikël	Pa targë	2008	2008	1	90,000	90,000	81,650	8,350	-
Totali i mjeteve të transportit për nxjerrje jashtë përdorimit					19		27,393,143	26,246,751	1,146,392	
TOTALI					22		39,731,143	35,796,532	3,934,611	

Burimi: DPRRNP/Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi i gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacioni i pasqyruar në tabelën e mjeteve të vlerësuara jashtë funksioni për nxjerrje jashtë përdorimit/skrup, rezultoi se nga komisioni janë vlerësuar nëntëmbëdhjetë mjete transporti jashtë funksionimit, nga të cilat **konstatohet** se: dhjetë (10) mjete janë çregjistruar përgjithmonë nga sistemi i mjeteve në DRSHTRR Tiranë deri në vitin 2019, pra para periudhës së ngritjes së këtij komisioni, duke shmangur kështu pagesën e panevojshme të taksave, kolaudimit dhe siguracionit për periudhën vijuese; pesë (5) mjete janë pa targa, që ka sjellë *shmangien* nga pagesa të detyrimeve ndaj shtetit dhe riskun e humbjes së tyre si aktiv; për nëntë (10) mjete (përfshirë edhe pesë (5) mjetet pa targa) nuk është vijuar me procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit duke bërë verifikimin dhe çregjistrimin në DRSHTRR Tiranë. Këto problematika nuk janë pasqyruar në asnjë regjistër aktivësh dhe procedurash dhe nuk i janë nënshtruar procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit, duke i lënë prezent në regjistrin e aktiveve.

- Edhe pse i është dërguar relacion gjithëpërfshirës Strukturave përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, për këto mjete nga ana e Titullarit të njësisë dhe Nëpunësit zbatues nuk janë marrë masat për ndjekjen e hapave vijuese të procedurës së inventarizimit, me ngritjen e komisionit për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjesimit dhe dokumentimin e saj. Të gjitha sa më lart në moszbatim të Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 8 “përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit” pika 8/ç; neni 9 “përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”; neni 10 “përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të riskut; neni 11 “përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë” pika 4; neni 12 “përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit zbatues” pikat ë- f ; Udhëzimit nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kapitulli I pika 2; 5,6,7,8,9/a,b,c 10; kapitulli IV pika 73, pika 81, pika 96, pika 99, pika 100, pika 101, pika 102, pika 103-106; pika 107-120.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi korrespondencën e DPRRNP Tiranë me Bashkinë Tiranë, rezultoi se me shkresën nr. 24328/1 prot., datë 02.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë i është kthyer përgjigje "memos" së DPRRNP nëpërmjet së cilë ka kërkuar konfirmim mbi përmbylljen e procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjesim të mjeteve të vlerësuara jashtë funksioni dhe të amortizuara teknikisht; Referuar përmbajtjes së saj, rezultoi se janë radhitur tre arsyt të cilat në kushtet e asaj periudhe kundërshtojnë përmbylljen e procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit, duke iu referuar dhe VKB nr. 135 datë 15.11.2018 "Për miratimin e procedurës së vlerësimit, nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjesimit të teknikës së transportit në inventarin e Bashkisë Tiranë".

Nga kryetari i Bashkisë Tiranë një vit më vonë, në zbatim të kësaj VKB, u nxorr Urdhri nr. 39418 datë 13.10.2019 "Për ngritjen e komisioneve të vlerësimit dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të teknikës së transportit".

Komisioni Qëndror për Bashkinë			
Nr.	Emër Mbiemër	Emërtimi i Strukturës	Statusi në komision
1	J.H	DPMF	Kryetar

2	F.S	DSHMB	Anëtar
3	Y.F	DSHMB	Anëtar
4	O.K	DJ	Anëtar
5	N.C	DF	Anëtar
	B.K	DSHMB	Anëtar- Ing.mekanik
7	I.P	DPPNR.3Q	Anëtar- Ing.mekanik
Komisioni Qëndror për Njësitë Administrative			
1	B.N	NJA 1	Pa përcaktim
2	B.P	-//-	-//-
3	K.B	-//-	-//-

Burimi: DPRRNP Tiranë

U konstatua se: arsyet e radhitura për mospërbushjen e kërkesës së DPRRNP Tiranë, nuk janë bindëse, pasi sipas argumentimit në shkresë, rezulton se kriteret e VKB nr. 135/2018 prevalojnë mbi ato të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”;

- Komisioni Qendror nuk ka monitoruar punën e komisioneve të nivelit të dytë para, gjatë dhe në mbyllje të procedurës së vlerësimit, me qëllim kryerjen sa më me efektivitet të procedurës së vlerësimit të teknikës së transportit nga komisionet e njëjësive vartëse sipas kuadrit ligjor dhe akteve rregullatore të Bashkisë Tiranë, duke mos zbatuar detyrimin e përcaktuar në pikën A/b të Urdhrit nr. 39418 datë 13.10.2019.

DPRRNP Tiranë në cilësinë e subjektit që përdor, mirëmban dhe pasqyron çdo shpenzim në bilancin e saj për mjetet e transportit dhe jo vetëm, ndonëse në vitin 2022 nëpërmjet “memos” ka kërkuar pranë Bashkisë Tiranë mundësinë e çregjistrimit të përhershëm të mjeteve të amortizuara me vlerë kontabël 39,731,143 lekë dhe vlerë të mbetur 3,934,611 lekë, duhet të përbushte apo të argumentonte zyrtarisht pamundësinë e përbushjes së pretendimeve dhe të rikërkonte në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Bashkisë Tiranë, konfirmimin për të përmbyllur procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit të mjeteve të amortizuara teknikiisht, me qëllim largimin e tyre nga ambientet e DPRRNP, çuarjen e tyre për skrap dhe bërjen të mundur të shkarkimit të tyre nga kontabiliteti.

6. Mbi inventarizimin e objekteve “Ndërtesa” (12 objekte-godina & kabina elektrike - llog. 212) në pronësi të DPRRNP Tiranë, me UB nr. 3823 dt. 28.12.2022, si çdo vit është ngritur komisioni prej 3 anëtarësh si mëposhtë:

Nr	Emër Mbiemër	Drejtori/Sektori	Pozicioni në strukturë	Formimi profesional	Data e emërimit
1	K.I	Juridik&Prokurimet	specialist	ekonomik	01.01.2021
2	E.P	Monitorimi/d.juridike	specialiste	arkitekthe	10.03.2020
3	A.I	Transportit	specialiste	shkenca shoqërore	19.03.2019

Burimi: DPRRNP Tiranë

Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, **rezultoi** se:

- Është realizuar inventari fizik nga komisioni i inventarizimit fizik për aktivet “ndërtesa /godina”;

- Nga titullari i njësisë nuk është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve “ndërtesa/godina” në mungesë të komunikimit dhe bashkëveprimit edhe me Nëpunësin Zbatues të njësisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit

Publik” Rubrika “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi” pikat 95-106;

- Nga titullari i njësisë nuk është ngritur komisioni për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit për arsye tjetërsimi në këtë rast të pesë (5) objekteve në mungesë të komunikimit dhe bashkëveprimit edhe me Nëpunësin Zbatues të njësisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Rubrika “Dhënia në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve” pika 107-120;

✓ Titullarët e njësisë publike DPRRNP Tiranë gjatë periudhës nën auditim janë si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Drejtor i Përgjithshëm	Periudha e ushtrimit të detyrës	Data e emërimit	Data e largimit
1	E.K	-//-	2016-2020	U. nr. 6304 dt.25.02.2016	U. nr. 365518 dt. 15.10.2020
2	H.RR	-//-	2020-2023	U. nr. 35523 dt. 15.10.2020	U. nr. 28861 dt. 04.09.2023

✓ Në tabelën më poshtë pasqyrohen nëpunësit zbatues [NZ] dhe menaxherët përgjegjës që ndjekin procedurën e inventarizimit të aktiveve në DPRRNP Tiranë:

Viti	Emërtimi i plotë i drejtorisë që përfshin strukturën e financës	Drejtori	Emërimi ne detyrë/largimi	Përgjegjësi i sektorit të financës	Emërimi ne detyrë/largimi
2019	Drejtorja e Administratës dhe Financës	L.C	UE-nr. 829 prot., datë 03.03.2016	E.M	UE-nr. 2078 prot., datë 13.07.2018
			UL-nr. 2673/1 prot., 23.09.2019 dalje në pension		-
2020	Drejtorja e Financës	E.M	UE-nr. 2734 prot., datë 23.09.2019	Valdete Vehbi	UE- nr. 915 prot., datë 07.10.2019
			UL-nr. 2897/1 prot., datë 16.11.2020		-
2021	Drejtorja e Financës dhe Menaxhimit të Shërbimeve 01.10.2021 Drejtorja e Financës, Transportit dhe Burimeve Njerëzore	S.M	UE-nr. 3075 prot., datë 16.11.2020	O.S	-
2022	01.02.2022 Drejtorja e Financës, Burimeve njerëzore dhe Shërbimeve				UE-nr. 925 prot., datë 01.04.2022

Përshkrim i situatës dhe aktet ligjore/nënligjore të periudhës 2019-2022 që kanë shoqëruar nxjerrjen nga regjistri i aktiveve të njësisë publike DPRRNP Tiranë, të objekteve në pronësi apo menaxhim të saj, është si më poshtë vijon: Me shkresën nr. 10166/1 prot. datë 26.03.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Punëve Publike/ Bashkia Tiranë (T.T) me objekt “Kërkesë për bashkëpunim”, është vënë në dijeni ndër të tjera edhe DPRRNP (bashkë me Drejtorja Ujësjetllës e Kanalizime dhe Drejtorja e Përgjithshme e Pastrimit e Gjellbërimit), për të liruuar ambientet që kanë në administrim/menaxhim. Kjo kërkesë ka këtë rrjedhë dokumentacioni ligjor dhe këtë dokumentacion bashkëngjitur:

1. Akti Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të tërmetit 2019”;¹²
2. VKM nr. 887 datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore” i ndryshuar;
3. VKM nr. 78 datë 31.01.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësitë administrative 4 dhe 8, zona “5 maji”, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese”;
4. VKM nr. 186 datë 26.02.2020 “Për caktimin e njërive zbatuese për rindërtimin e shtëpive individuale”;
5. Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr. 5779/3 datë 19.03.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e miratimit të planeve të detyruara vendore (PDyV)” sipas së cilës miratohet PDyV për kontratën e shërbimit nr. 7981/20 prot. 06.03.2020 Loti I “Hartimi i Planeve të detyruara Vendore për shpalljen e zonës së re për zhvillim në NJA 4 & NJA 8 zona “5 maji” Bashkia Tiranë.
6. Shkresa nr. 10166 datë 04.03.2021 nga Shoqëria “N”shpk mbikqyrës i punimeve për objektin; Hartimi i projektit të zbatimit të punimeve për godinën 21 në zonën zhvillimore “5 maji” në bazë të kontratës nr. 35619/11 datë 26.10.2020 (kontrata nuk i është bashkëngjitur shkresës, mungon), është konstatuar se në sheshin e ndërtimit ku do të realizohet projekti i objektit godina 21 një pjesë e gjurmës bie mbi rrugën ekzistuese “Selaudin Bektashi”...../..... kërkohet të lirohen objektet nga baza materiale që përmbajnë pasi pengojnë punimet.
Kërkesa e subjektit “I”shpk si BOE, Loti IX “studim projektim” në referim të kontratës nr. 135619/14 datë 04.02.2021 me Bashkinë Tiranë (kontrata nuk i është bashkëngjitur), ku i kërkohet Shoqërisë “N.” në cilësinë e mbikqyrësit t’i drejtojë Bashkisë Tiranë lirim të objekteve.
Kopje e projektit të miratuar nuk i është bashkëngjitur shkresës së Bashkisë Tiranë.
7. Vendimi nr. 533 datë 22.09.2021 i Zv.Kryeministrit dhe Ministrit për Rindërtim “Për shpronësimin për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit për zhvillimin e zonës së re, në përputhje me planin e detyruar vendor, përmes kompensimit me shkëmbim, për të gjitha pasuritë që preken nga realizimi i projektit “për zonën e re për zhvillim në njësitë administrative 4 dhe 8, zona ‘5 maji’, Bashkia Tiranë”, në të cilën pasqyrohen hapat e procedurës që do ndiqen nga strukturat përgjegjëse. Bashkëlidhur Vendimit edhe lista e objekteve të përfshira në zonën zhvillimore me specifikimet e nevojshme.
8. Kërkesa për bashkëpunim e Bashkisë Tiranë, nuk ka bashkëngjitur kopje të kontratës nr. 36958/4 datë 02.11.2020;

Përsa më lart grupi i auditimit kërkoi komunikimin shkresor zyrtar mes DPRRNP Tiranë dhe Bashkisë Tiranë si organi epror i tij.

¹² Aktet ligjore të listuara në paragrafët me ngjyrë janë kuadri ligjor ku i është referuar shkresa e Bashkisë Tiranë për bashkëpunim, por që nuk i janë bashkëngjitur fizikisht shkresës.

- Nga ana e subjektit, grupit të auditimit iu vu në dispozicion dokumentacioni i disponueshëm nga ana e tyre i sipërlistuar, i cili rezultoi i pjesshëm. Gjithashtu nga komunikimi verbal me subjektin, **rezultoi** se për lirimin e këtyre pesë objekteve për tjetërsim, ka qenë komunikim dhe dakortësi e zhvilluar verbalisht, pa dokumentuar asnjë takim apo diskutim rreth tyre si nga Titullari i njësisë, ashtu edhe nga Drejtoria juridike dhe prokurimeve të DPRRNP Tiranë. Korrespondenca zyrtare e DPRRNP dhe Bashkisë Tiranë:

Nr.	Nga Bashkia Tiranë	Nga DPRRNP Tiranë	Objekti
1	Nr. 10166/1 prot., datë 26.03.2021 (bashkëngjitur kërkesa e mbikqyrësit të punimeve dhe BOE)	mbërritur	Kërkesë e Bashkisë Tiranë për bashkëpunim: lirim ambientesh për zbatim projekti
	nisur	Nr. 889 prot., datë 29.03.2021	
2	Nr. 38936 prot., datë 07.10.2021		Kërkesë e Bashkisë Tiranë për bashkëpunim: lirim ambientesh -parkingu
		Nr. 2725 prot., datë 08.10.2021	
3	Nr. 38936/2 prot., datë 29.10.2021	-	
4		Nr. 3097 prot., datë 10.11.2021	Kërkesë e DPRRNP për ambiente shërbimi (1)
	Nr. 38935/3 prot., datë 11.11.2021		
5	Nr. 38936/4 prot., datë 16.11.2021	-	
6	Nr. 38935/5 prot., datë 25.11.2021		Kthim përgjigje nga Bashkia Tiranë, pamundësi nga ana e saj për vënie në dispozicion ambiente shërbimi për DPRRNP; Referuar shkresës nr. 2477/1 prot., datë 31.05.2021e MM të cituar në shkresën e Bashkisë Tiranë, nuk ka asnjë listë bashkëngjitur.
		Nr. 3097/4 prot., datë 01.12.2021 (mungon shkresa nr. 2477/1 prot., datë 31.05.2021e Ministrisë së Mbrojtjes për Bashkinë Tiranë)	
7		Nr. 140 prot., datë 18.01.2022	Kërkesë e DPRRNP për ambiente zyra dhe shërbimi (2)
	Nr. 2766 prot. datë 19.01.2022		
////	////	Nr. 140/1 mungon	////
8	-	Nr. 140/2 prot., datë 31.01.2022	Kërkesë e DPRRNP për ambiente zyra dhe shërbimi (3)
9	Nr. 2766/1 prot., datë 31.01.2022		Vënie në dijeni për trajtimin e kërkesës së DPRRNP Tiranë
		Nr. 140/3 prot., datë 01.02.2022	
////	////	Nr. 140/4 mungon	////
10	Nr. 2766/2 prot., datë 15.02.2022 (shkresa nr. 5645 prot., datë		Bashkia Tiranë vë në dijeni DPRRNP Tiranë për

	07.02.2022 për Ministrinë e Bujqësisë)		kërkesën drejtuar MBZHR për ambiente zyre e shërbimesh
		Nr. 140/5 prot., datë 16.02.2022	
	Nr. 832/2 prot. datë 17.02.2022 e MBZHR për Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Durrës	-	
	Nr. 832/3 prot. datë 18.02.2022 e MBZHR për Bashkinë Tiranë	-	
	Nr. 80/1 prot., datë 17.02.2022 e DUK Durrës-Ngritja e komisionit për procedurën e dhënies në përdorim të zyrave	Nr. 531 prot. datë 18.02.2022 e DPRRNP Tiranë- Ngritja e komisionit për marrjen në dorëzim për përdorim të përkohshëm të zyrave të DUK Durrës	Plotësohet kërkesa për ambiente zyrash për DPRRNP Tiranë
	Nr. 167/2 prot., datë 12.05.2022 – Proçesverbali i mbajur nga komisioni i DUK Durrës dhe DPRRNP Tiranë		
11		Nr. 494 prot., datë 17.02.2022	Kërkesë e DPRRNP për nxjerrje jashtë përdorimi të 5 objekteve
	Nr. 7520 prot., datë 21.02.2022		
12	Nr. 7520/1 prot., datë 17.03.2022		Kthim përgjigje nga Bashkia Tiranë për kërkesën
		Nr. 859 prot., datë 23.03.2022	
13		Nr. 1198 prot., datë 22.04.2022	Kërkesë e DPRRNP për dokumente shoqëruese: VKM nr. 73/31.01.2020; VKB nr. 5779/12 datë 03.04.2020; VKM nr. 533/2021
	Shkresa “kthim përgjigje” e Bashkisë Tiranë mungon, por janë vetëm aktet nënligjore të kërkuara nga DPRRNP		

Burimi: DPRRNP Tiranë/Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit si dhe informacionit të pasqyruar në tabelën e mësipërme, **u konstatua se:**

- DPRRNP Tiranë nuk ka kërkuar t’i vihet në dispozicion gjithë praktika dokumentare e listuar në shkresën nr. 10166/1 prot., datë 26.03.2021 të Bashkisë Tiranë me objekt ”kërkesë për bashkëpunim”;

- gjithashtu kërkesat e DPRRNP Tiranë për Drejtorinë e Përgjithshme Juridike, të Aseteve dhe Liçensimit/Bashkia Tiranë (1, 3) dhe Drejtorinë Investimeve të Punëve Publike/Bashkia Tiranë (2) konsistojnë për gjetje të ambienteve ku të ushtrorë aktivitetin e vet kjo njësi publike dhe sigurimin e fondeve për çmontimin dhe transferimin e bazës materiale;

Nga Bashkia Tiranë nuk i është ofruar zgjidhje kërkesës së DPRRNP Tiranë për mungesë objektsh dhe terrenesh të përshtatshme, *duke konfirmuar kështu* se vendimmarrja për prishjen e objekteve ku ushtronte veprimtarinë e vet DPRRNP Tiranë, ka qenë e shpejtë dhe e pastudiuar për pasojat që do i shkaktonte njësisë publike.

• **Bashkia Tiranë e gjendur përballë nevojës urgjente** për të plotësuar kërkesën e DPRRNP për ushtrimin normal të aktivitetit të saj, i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë

së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për ambiente. MBZHR i është përgjigjur pozitivisht, duke i vënë në dispozicion për përdorim objektin me nr. pasurie 4/184, zona kadastrale nr. 8240 Tiranë, me emërtimin Bordi i Kullimit Tiranë (ish Bordi i kullimit- sot Sektori i Tiranës i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Durrës).

Komisionet respektive janë si në tabelën më poshtë:

DUK Durrës		DPRRNP Tiranë	
Procesverbali nr. 167/2 prot., datë 12.05.2022			
Anëtarët e komisionit – UB nr. 80/1 datë 17.02.2022		Anëtarët e komisionit – UB nr. 531 datë 18.02.2022	
S.K	P/Sektori i Financës	S.M	Dr/DFBNJSH
I.A	Juriste	M.N	Juriste
A.T	P/Sektori Hidrovor-Makineri	H.G	Dispeçer

Burimi: DPRRNP Tiranë

Praktika e dhënie-marrjes në përdorim të objektit “zyra” përmban këtë dokumentacion:

Praktika dokumentare	Statusi
Kontrata e Përdorimit apo Marrëveshja	Nuk është lidhur
Urdhri nr.56 datë 17.02.2022 e ministrit të BZHR	Nuk është
Shkresa nr. 832/2 datë 17.02.2022 e Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR për DUK Durrës	√
Shkresa nr. 832/3 datë 18.02.2022 e Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR për Bashkinë Tiranë	√
UB i komisionit të DUK Durrës nr. 80/1 datë 17.02.2022	√
UB i komisionit të DPRRNP Tiranë nr. 531 datë 18.02.2022	√
Çertifikata e pronësisë, kartela dhe plan rievimi i objektit	Nuk janë
Procesverbali i materialeve gjendje fizike në objekt/mjete të amortizuara nga ana funksionale dhe fizike	√

Nga auditimi **u konstatua** se praktika dokumentare nuk është e plotë në formë e në përmbajtje, pasi edhe pse në komisionet respektive janë anëtarë edhe juristë, për marrjen në dorëzim të objektit “zyra” nga ana e DPRRNP Tiranë, dy komisionet duhet të kishin lidhur një kontratë përdorimi, ku ndër të tjera përcaktohet edhe afati i përdorimit të objektit me të gjithë dokumentacionin e listuar bashkëngjitur saj. Ky mosveprim është në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë i përditësuar, Pjesa V “Kontratat”.

• Objektet e DPRRNP Tiranë, të përfshira në planin e Bashkisë Tiranë, janë si në tabelën mëposhtë:

Objektete e përfshira në PdyV 2022					
Nr	Emërtimi	Viti i ndërtimit	Vlera	Amortizim i akumuluar	Vlera e mbetur
1	Magazina	1970	86,254	Nuk ka	Nuk ka

2	Dhoma e oksigjenit -ofiçina	1970	5,729		
3	Fabrika e repartit te pllakave	1970	309,612		
4	Zyra e prodhimit	1970	118,500		
5	Gabina elektrike	1994	83,833		
Totali			603,928		

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për këtë procedure, pasqyruar edhe në tabelën respektive të mësipërme, **u konstatua se:**

1. Komisioni i inventarit fizik të ndërtesa/godinave ka bërë edhe nxjerrjen jashtë regjistrin të aktiveve objektet e përfshira në [PdyV], pa qenë i autorizuar të realizojë atë procedurë;

2. Nga ana e Titullarit nuk ka dalë Urdhri i Brendshëm për vlerësimin dhe për nxjerrjen jashtë përdorimit të objekteve (llog. 212);

3. Nëpunësi zbatues nuk ka ndjekur dhe dokumentuar hapat e procedurës sipas radhës së tyre për çdo objekt, pjesë e saj;

4. Komisioni i verifikimit fizik i cili është vetautorizuar për të nxjerrë nga regjistri i aktiveve pesë (5) objektet e përshkruara mësipër, nuk ka verifikuar paraprakisht objektet në listën e publikuar bashkëngjitur Vendimit nr. 533 datë 22.09.2021; si dhe nuk ka kërkuar praktikën e plotë dokumentare për procedurat e ndjekura nga Bashkia Tiranë, mbi të cilën do të mbështetej komisioni i ngritur në DPRRNP Tiranë për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit të objekteve për arsye tjetërsimi, në zonën e “5 Majit”; për sa konstatuar më lart, këto mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 8,9,10,11,12; Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;

5. Komisioni ka nxjerrë jashtë regjistrin të aktiveve pesë objektet e evidentuara edhe në tabelën e mësipërme, në vlerën totale të tyre prej 603,928 lekë. Kjo vlerë nuk është vlera reale e këtyre objekteve, pasi këto objekte duhet të nënshtroheshin më parë procedurës së vlerësimit të tyre nga ekspertë të fushës.

- Nga auditimi i regjistrin të aktiveve të regjistruara në kontabilitet, u konstatua se një pjesë e këtyre aktiveve pasi i është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite, vlera e tyre është e papërfillshme më e vogël se 100 lekë ose “0” lekë. Këto aktive vazhdojnë të jenë në përdorim dhe gjendje pune. Nga Titullari i njësisë dhe Nëpunësi zbatues nuk është marrë asnjë masë për të ngritur grupin e punës me ekspertë të fushave, për këta artikuj, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre. Ndryshimet në jetën e pritshme të dobishme dhe të vlerës së tyre, të kontabilizohen duke ndryshuar periudhën e amortizimit apo metodën, sipas rastit, dhe të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël.

Konkluzion:

1. Mbi dy procedurat e ndjekura nga DPRRNP Tiranë dhe Bashkia Tiranë me Strukturat përgjegjëse të saj Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Juridike, të Aseteve dhe Liçensimit dhe Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike, për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit/ tjetërsim apo asgjesim sipas rastit të aktiveve të DPRRNP Tiranë, rezulton se nga Bashkia Tiranë nuk është ndjekur e njëjta rrugë komunikimi dhe nuk është zbatuar i njëjti standard, konkretisht: për nxjerrjen jashtë regjistrin të objekteve (llog.212) ka orientuar DPRRNP Tiranë duke iu referuar Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; ndërsa për procedurën e nxjerrjes jashtë

përdorimit/asgjesim të mjeteve të vlerësuara si jashtë funksionit dhe të amortizuara teknikisht, i është referuar pikësëpari VKB nr. 135 datë 15.11.2018 "Për miratimin e procedurës së vlerësimit, nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjesimit të teknikës së transportit në inventarin e Bashkisë Tiranë".

2. DPRRNP Tiranë nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë dhe Rregullore "Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve (inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve);

3. Nga ana e Titullarit të DPRRNP në cilësinë e NA dhe Koordinatorit të Riskut dhe Nëpunësit Zbatues, nuk janë ndjekur rigorozisht të gjithë hapat e procedurës së inventarizimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi;

4. Praktika dokumentare e vlerësimit të mjeteve të transportit dhe makinerive rezultoi me mangësi apo pasaktësi sipas konstatimit të sipër përshkruar;

5. Me përfundimin e procedurës nga Komisioni i vlerësimit të mjeteve të transportit dhe makinerive të dëmtuara për riparim apo nxjerrje jashtë përdorimit/tjetërsim, nga Titullari i njësisë dhe NZ nuk është vijuar me ngritjen e komisionit, zhvillimin e procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit/tjetërsimit të mjeteve jashtë funksionit dhe dokumentimit të tij;

6. Shkresa e Bashkisë Tiranë nuk ka bashkëngjitur praktikën dokumentare të akteve ligjore/nënligjore të hartuara dhe miratuara për nxjerrjen nga regjistri i inventareve për tjetërsim të pesë (5) objekteve që janë në administrim të DPRRNP Tiranë;

- Gjithashtu nga Titullari dhe nga Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve të DPRRNP Tiranë, nuk ka patur asnjë reagim apo komunikim zyrtar lidhur me shkresën e Bashkisë Tiranë. Pra është konsideruar i drejtë ligjërisht çdo akt i miratuar prej saj për procedurën.

7. Komisioni verifikimit fizik dhe vlerësimit paraprak të objekte/godinave i ngritur me Urdhrin e titullarit të njësisë, ka realizuar pa autorizim të titullarit edhe nxjerrjen jashtë regjistrimit të aktiveve të DPRRNP Tiranë të pesë (5) objekteve, duke mos ndjekur asnjë kriter procedural të përcaktuar në kuadrin ligjor të saj;

8. Nxjerrja nga regjistri i aktiveve të DPRRNP Tiranë është realizuar jashtë kërkesave ligjore/nënligjore që kërkon procedura.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me:

1. Ligjin nr. 10296/2011 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 8,9,10,11,12 dhe 27;

2. Manualin mbi Menaxhimin Financiar dhe kontrollin;

3. Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";

4. Udhëzimin nr. 16, dt. 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike";

5. Udhëzimin nr. 21/2016 "Për menaxherët e të gjitha niveleve";

6. Rregullore e Brendshme e DPRRNP Tiranë.

Personat përgjegjës:

1. E.K Drejtor i Përgjithshëm për periudhën 25.02.2016-15.10.2020

2. H.RR Drejtor i Përgjithshëm për periudhën 15.10.2020-04.09.2023

3. E.M Drejtor i Financës për periudhën 23.09.2019-16.11.2020

4. S.M Drejtor i Financës për periudhën 16.11.2020 e në vijim

5. M.M Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve për periudhën deri në 05.09.2023

Komisioni i verifikimit të aktiveve (të llog 212) që ka realizuar dhe nxjerrjen nga regjistri i aktiveve të objekteve:

6. K.I

7. E.P

8. A.I

Me shkresën nr. 1775/3 prot., datë 03.06.2024 nga Subjekti DPRRNP Bashkia Tiranë dhe me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024, janë shprehur observacionet mbi konstatimet dhe gjetjet për procedurën e inventarizimit të përcjella në Akt konstatimin nr. 3 datë 21.03.2024 dhe PRA, subjekti ka observacionet si më poshtë vijon:

Pretendimi i Subjektit:

- Për gjetjen 5, pika 4, në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimi të automjeteve të dëmtuara ju sqarojmë se: Drejtoria jonë bazuar në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrit të Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar dhe vendimit nr.135, datë 15.11.2018, të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e procedurës së vlerësimit, nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimit të teknikës së transportit në inventarin e Bashkisë Tiranë" filloi procedura për nxjerrjen jashtë përdorimit të mjeteve të transportit me Urdhër të Brëndshëm Nr.933, datë 29.03.2022 "Për ngitjen e komisionit të vlerësimit të mjeteve të transportit dhe makineri e pajisje". Pas mbarimit të procedurës dërguam për miratim në Bashkinë Tiranë Memon me nr. 1896 prot, datë 28.06.2022. Me shkresën me nr.24329/1, datë 02.09.2022 "kthim përgjigje" nga Kryetari i Bashkisë ku bëjnë me dije se: Bashkia Tiranë ka kthyer përgjigjen e memos me shkresën Nr 24328/1 datë 2.9.2022 duke mos miratuar kërkesën e DPRRNP duke shtuar si kërkesa te reja si: 1.Praninë në komision të një inxhinjeri elektrik, veprim i cili nuk është në kërkesat e VKB nr 135/2018, pasojë e këtij ndryshimi është fillimi i procedurës nga e para. 2-kilometrat e përshkruara nuk janë te të gjithë mjetet mbi 100.000 km, të bëhet vlerësimi i kostos në lekë te rubrika "efektiviteti ekonomik i riparimit". Në lidhje me këtë pikë ju sqarojmë se: Në Vendimin nr.135 të Këshillit Bashkiak në pikën c procedura e vlerësimit jepen 9 kritere që duhet të plotësojë një mjet për të dalë jashtë përdorimit. Këto kritere janë përjashtuese me njëra tjetrën, pra një mjet duhet të plotësojë një nga këto pika për të nisur procedurën dhe jo 9 kriteret. Mjetet për të cilat nuk kam vendosur km dhe efektivitetin ekonomik të riparimit janë shumë të konsumuara sepse janë shumë të vjetra dhe kanë vite që nuk punojnë dhe fakti që ka shumë vite që nuk është bërë procedurë për nxjerrje jashtë përdorimit ato janë jashtë funksionit totalisht. Për këto arsye këto mjete plotësojnë 2 nga 9 kriteret e vendosura në pikën c/2, kriteri 2 dhe kriteri 3 pikërisht citohen:

-Kur riparimi i teknikës së transportit është i pamundur si pasojë e konsumit dhe nuk mund të përshtatet për përdorim tjetër.

-Kur teknika e transportit dëmtohet në shkallë të tillë, që është e pamundur të kthehet në gjendje pune nëpërmjet riparimit.

3. Është kërkuar që nëpunësi me përgjegjësi material, shoferi të firmosë procesverbalin e daljes jashtë përdorimi. Kjo kërkesë nuk mund të realizohet pasi mjetet kanë shumë vite që rrijnë stok në ambientet e magazinave të Institucionit, shoferat që i kanë përdorur kanë lëvizur ose edhe mund të kenë ndërruar jetë, kërkesë që nuk mund të realizohet nga ana e komisionit.

Në VKB nr 135/2018 janë 9 kritere që përcaktojnë paaftësinë e mjetit për punë, një mjet që plotëson njërin nga këto kritere duhet të vlerësohet për të dalë jashtë përdorimi, asnjë mjet nuk mund të plotësojë këto 9 kritere.

Ka automjete që nuk e kanë vitin e krijimit si aktiv në Njësinë Publike- Është e vërtetë pasi nuk janë dokumentat e mjeteve të ardhura në njësinë publike, personat që kanë qënë aty me vite thonë se shumë dokumenta janë shkatërruar gjatë viteve të tranzicionit, ka mjete që janë para viteve 90 e nuk kanë dokumenta për asnjë të dhënë që kërkohet por janë si mjete të dëmtuara në ambientet e magazinave të Drejtorisë.

Për këto arsye komisioni e ka ndaluar punën pasi u pa e pa realizuar duke mos patur vullnetin e organeve drejtuese të Bashkisë. Mendojmë se më efektive do të ishte që këto asete të vlerësohen nga një komision i Bashkisë Tiranë.

- Për gjetjen 5 pika 5, ju sqarojmë se, Përsa u përket objekteve ndërtimore të prishura nga zbatimi i planit rregullues i Bashkisë Tiranë në zonen 5 Maji ju sqarojmë se nga Bashkia Tiranë ka ardhur shkresa nr 10166/1 datë 26.03.2021 “Kërkesë për bashkëpunim” dhe asnjë shkresë tjetër shoqëruese, as kontratë e lidhur me subjektin zbatues, por është kërkuar lirimi i menjëhershëm i ambienteve që ti hapet rruga firmës zbatuese të projektit, për këto veprime ka qenë e interesuar zyra e investimeve pranë Bashkisë Tiranë. Nga ana e DPRRNP me shkresën nr. 494 datë 17/02/2022 i është kërkuar Bashkisë Tiranë për nxjerrjen jashtë përdorimi të këtyre objekteve si rezultat i prishjes së tyre për zbatimin e këtij projekti, Nga ana e Bashkisë është kthyer përgjigje negative duke kërkuar që të zbatohen procedurat e udhëzimit nr.30 datë 27/12/2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Theksojmë se këto objekte nuk plotësonin kriteret sipas udhëzimit 30 datë 27/12/2011 pasi nuk ishin të dëmtuara, të shembura etj nga amortizimi në vite por u prishen për ti hapë rrugë zbatimit të një projekti.

-Të ndodhur para një fakti që objektet ishin prishur dhe nga Bashkia nuk u miratua nxjerrja jashtë përdorimi, nga ana e financës u lëvizën në kontabilitet nga llogaria 212 dhe u kaluan në llogarinë 24, llogari kjo që përmbledh asetet e konstatuara të dëmtuara që nuk janë të përshtatshme për tu përdorur për nevojat e aktivitetit të subjektit. Në këtë llogari janë të gjitha aktivet e konstatuara të dëmtuara ku mbahen deri në momentin e kompletimit të procedurave të daljes jashtë përdorimi

- Për gjetjen 5 pika 6, Të gjitha aktivet pavarsisht sa është vlera neto e mbetur e tyre pas llogaritjes së amortizimit qëndrojnë në kontabilitet deri sa të përfundojnë procedurat e vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

- Lidhur me procedurën e vlerësimit të aktiveve të llog. 214 dhe llog. 215, ju sjellim në vëmendjen tuaj se gjithçka ju përshkruar është pasqyruar në trajtimin e bërë nga ana jonë. Konfirmoni se konstatimi ynë qëndron dhe se duheshin ndjekur hapat e listuar nga grupi i auditimit në aktin e konstatimit nr. 3 datë 21.03.2024 dhe në PRA. Rekomandimi ynë konsiston në faktin e ridërgimit të “Memos” kryetarit të bashkisë Tiranë por me reflektimet përkatëse, me qëllim konfirmimin nga organi epror me hapat vijuese të inventarizimit-nxjerrjen jashtë përdorimit për skrap. Observacioni juaj ***nuk merret në konsideratë*** nga grupi i auditimit;

- Mbi veprimet e ndjekura nga komisioni i verifikimit fizik të aktiveve të llog.212 dhe konkretisht për nxjerrjen jashtë regjistrit të aktiveve të pesë objekteve, observacioni juaj nuk justifikon mosveprimet e titullarit të njësisë, drejtorisë ligjore dhe drejtorisë së financës dhe veprimin në kundërshtim me kuadrin ligjor të menaxhimit të aktiveve të komisionit të inventarizimit. Observacioni juaj ***nuk merret në konsideratë*** nga Grupi i auditimit.

Mbi procedurën vjetore të inventarizimit të aktiveve dhe parregullsitë në zbatimin e kuadrit ligjor, u konstatua se:

1. Nga auditimi i dokumenteve dhe informacioni i pasqyruar në tabelat përmbledhëse të Inventarizimit, rezulton se në 2 raste (sipas tabelës 2): me UB nr. 3826 dt. 28.12.2022 është caktuar B.S kr. komisioni të inventarizimit të [magazinës nr.1] për dy vite radhazi 2021 dhe 2022; me UB nr. 3550 dt. 25.11.2019, UB nr.3364 dt. 16.12.2020 dhe UB nr.3537 dt. 21.12.2021 është krijuar komisioni i inventarizimit të [Pajisjet/Inventari ekonomik në zyra/korridor/magazinë 1] që ka në përbërjen e tij të njëjtën anëtarë për tre vite radhazi, në moszbatim të Udhëzimit 30/2011 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 84;

2. DPRRNP Tiranë nuk ka hartuar dhe miratuar Strategji dhe Rregullore “Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve (inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve) në moszbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 6,7,8,9 dhe 17,18,19; Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së GMS, caktimit të Kordinatorit të MFK dhe Kordinatorit të Riskut, në moszbatim të nenit 27, nenit 9, nenit 10 të Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontriollin” i ndryshuar, Udhëzimin nr.16, datë 20.07,2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, Udhëzimit nr. 21/2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”; pasi është ndër detyrat prioritare e GMS të hartojë dhe miratojë Strategji dhe Rregullore për menaxhimin e aktiveve të Njesisë publike.

3. Për vitet 2019, 2020, 2021, komisionet e inventarit fizik dhe të vlerësimit paraprak, kanë përpiluar relacionin me listën e aktiveve të dëmtuara për procedura të mëtejshme (tabela 1) – në vlerat respektive: 28,305,143 lekë, 2,114,840 lekë, 3,219,960 lekë. Nga ana e NA dhe NZ nuk është marrë asnjë masë për vijimin e procedurave me ngritjen e komisioneve të vlerësimit përfundimtar të tyre, me qëllim nxjerrjen e aktiveve të dëmtuara për jashtë përdorimit/asgjesimit. Kjo në moszbatim të Udhëzimit nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kreu IV paragrafi 3 pika 96;

4. Praktika dokumentare e vlerësimit të mjeteve të transportit dhe mjete e pajisje, rezultoi me këto mangësi: Urdhri i titullarit (nr.933 datë 29.03.2022, pasaktësi në formulimin e aktit të titullarit lidhur me afatin e përfundimit të procedurës (dt. 15.01.2022 pra para fillimit të vet procedurës) dhe bazës ligjore të cilës i referohet (VKM nr. 510/2015);

- Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën e mjeteve të vlerësuara jashtë funksioni për nxjerrje jashtë përdorimit/skrup, rezulton se nga komisioni janë vlerësuar njëzetë mjete transporti jashtë funksionimit, nga të cilat konstatohet se: dhjetë (10) mjete janë çregjistruar përgjithmonë nga sistemi i mjeteve në DRSHTRR Tiranë para periudhës së ngritjes së këtij komisioni, duke shmangur kështu pagesën e panevojshme të taksave, kolaudimit dhe siguracionit për periudhën vijuese, por që kanë qenë prezente në regjistrin e aktiveve të njësisë, në kontabilitetin e saj në llog.215; pesë (5) mjete janë pa targa, që ka sjellë *shmangien* nga pagesa të detyrimeve ndaj shtetit dhe riskun e humbjes së tyre si aktiv; për dhjetë (10) mjete (përfshirë edhe pesë (5) mjetet pa targa), nuk është vijuar me procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit duke bërë verifikimin dhe çregjistrimin në DRSHTRR Tiranë. Këto problematika nuk janë pasqyruar në asnjë regjistër aktivesh apo procedurash dhe nuk i janë nënshtruar procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit, duke i lënë prezent në regjistrin e aktiveve.

- Edhe pse i është dërguar relacion gjithëpërfshirës Strukturave përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, për këto mjete nga ana e Titullarit të njësisë dhe Nëpunësit zbatues nuk janë marrë masat për ndjekjen e hapave vijuese të procedurës së inventarizimit, me ngritjen e komisionit për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjesimit dhe dokumentimin e saj. Të gjitha sa më lart në moszbatim të Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 8 “përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit” pika 8/ç; neni 9 “përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”; neni 10 “përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të riskut; neni 11 “përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë” pika 4; neni 12 “përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit zbatues” pikat ë- f ; Udhëzimit nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kapitulli I pika 2; 5,6,7,8,9/a,b,c 10;

kapitulli IV pika 73, pika 81, pika 96, pika 99, pika 100, pika 101, pika 102, pika 103-106; pika 107-120; VKB nr. 135/2018.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi korrenspondencën e DPRRNP Tiranë me Bashkinë Tiranë, rezultoi se me shkresën nr. 24328/1 prot., datë 02.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë i është kthyer përgjigje "memos" së DPRRNP nëpërmjet së cilë ka kërkuar konfirmim mbi përmbylljen e procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjesim të mjeteve të vlerësuara jashtë funksioni dhe të amortizuara teknikisht. U konstatua se arsyet e radhitura për mospërmbylljen e kërkesës së DPRRNP Tiranë, nuk janë bindëse, pasi sipas argumentimit në shkresë, rezultoi se kriteret e VKB nr. 135/2018 prevalojnë mbi ato të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"; si dhe komisioni qendror nuk ka monitoruar punën e komisioneve të nivelit të dytë para, gjatë dhe në mbyllje të procedurës së vlerësimit, me qëllim kryerjen sa më me efektivitet të procedurës së vlerësimit të teknikës së transportit nga komisionet e njëjësive vartëse sipas kuadrit ligjor dhe akteve rregullatore të Bashkisë Tiranë, duke mos zbatuar detyrimin e përcaktuar në pikën A/b të Urdhrit nr. 39418 datë 13.10.2019.

5. Mbi inventarizimin e objekteve "Ndërtesa" (12 objekte-godina & kabina elektrike - llog. 212) në pronësi të DPRRNP Tiranë, me UB nr. 3823 dt. 28.12.2022, si çdo vit është ngritur komisioni prej 3 anëtarësh, nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultoi se:

- Komisioni i inventarit fizik të ndërtesa/godinave ka bërë edhe nxjerrjen jashtë regjistrit të aktiveve objektet e përfshira në [PdyV], pa qenë i autorizuar të realizojë atë procedurë;

- Nga ana e Titullarit nuk ka dalë Urdhri i Brendshëm për vlerësimin dhe për nxjerrjen jashtë përdorimit të objekteve (llog. 212);

- Nëpunësi zbatues nuk ka ndjekur dhe dokumentuar hapat e procedurës sipas radhës së tyre për çdo objekt, pjesë e saj;

- Komisioni i verifikimit fizik i cili është vetautorizuar për të nxjerrë nga regjistri i aktiveve pesë (5) objektet e përshtuara mësipër, nuk ka verifikuar paraprakisht objektet në listën e publikuar bashkëngjitur Vendimit nr. 533 datë 22.09.2021; si dhe nuk ka kërkuar praktikën e plotë dokumentare për procedurat e ndjekura nga Bashkia Tiranë, mbi të cilën do të mbështetej komisioni i ngritur në DPRRNP për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit të objekteve për arsye tjetërsimi, në zonën e "5 Majit", për sa konstatuar më lart këto mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 8,9,10,11,12; Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";

- Komisioni ka nxjerrë jashtë regjistrit të aktiveve pesë objektet e evidentuara edhe në tabelën përkatëse, në vlerën totale të tyre prej 603,928 lekë. Kjo vlerë nuk është vlera reale e këtyre objekteve, pasi këto objekte duhet ti nënshtroheshin më parë procedurës së vlerësimit të tyre nga ekspertë të fushës;

- Nga titullari i njësisë nuk është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve "ndërtesa/godina" në mungesë të komunikimit dhe bashkëveprimit edhe me Nëpunësin Zbatues të njësisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" Rubrika "Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi" pikat 95-106;

- Nga titullari i njësisë nuk është ngritur komisioni për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit për arsye tjetërsimi në këtë rast të pesë objekteve në mungesë të komunikimit dhe

bashkëveprimit edhe me Nëpunësin Zbatues të njësisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Rubrika “Dhënia në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve” pika 107-120;

- DPRRNP Tiranë nuk ka kërkuar t’i vihet në dispozicion gjithë praktika dokumentare e listuar në shkresën nr. 10166/1 prot., datë 26.03.2021 të Bashkisë Tiranë me objekt ”kërkesë për bashkëpunim”, por kërkesat e DPRRNP Tiranë për Drejtorinë e Përgjithshme Juridike, të Aseteve dhe Liçensimit/Bashkia Tiranë dhe Drejtorinë Investimeve të Punëve Publike/Bashkia Tiranë, konsistojnë për gjetje të ambienteve ku të ushtrojë aktivitetin e vet kjo njësi publike dhe sigurimin e fondeve për çmontimin dhe transferimin e bazës materiale;

- Nga subjekti grupit të auditimit iu vu në dispozicion dokumentacioni i disponueshëm i cili rezultoi i pjesshëm. Nga komunikimi verbal me subjektin, rezultoi se për lirim të këtyre pesë objekteve për tjetërsim, ka qenë komunikim dhe dakortësi e zhvilluar verbalisht, pa dokumentuar asnjë takim apo diskutim rreth tyre si nga Titullari i njësisë, ashtu edhe nga Drejtoria juridike dhe prokurimeve të DPRRNP Tiranë.

6. Bashkia Tiranë e gjendur përballë nevojës urgjente për të plotësuar kërkesën e DPRRNP për ushtrimin normal të aktivitetit të saj, i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për ambiente. MBZHR i është përgjigjur pozitivisht, duke i vënë në dispozicion për përdorim objektin me nr. pasurie 4/184, zona kadastrale nr. 8240 Tiranë, me emërtimin Bordi i Kullimit Tiranë (ish Bordi i kullimit- sot Sektori i Tiranë i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Durrës). Nga auditimi u konstatua se praktika dokumentare nuk është e plotë në formë e në përmbajtje, pasi edhe pse në komisionet respektive ka anëtarë edhe juristë, për marrjen në dorëzim të objektit “zyra” nga ana e DPRRNP Tiranë, dy komisionet duhet të kishin lidhur një kontratë përdorimi, ku ndër të tjera përcaktohet edhe afati i përdorimit të objektit me të gjithë dokumentacionin e listuar bashkëngjitur saj. Ky mosveprim është në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë i përditësuar, Pjesa V “Kontratat”;

Veprime në kundërshtim me ligjin nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016; Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”; Udhëzimi nr. 21/2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”; Udhëzimin nr.16, datë 20.07,2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë; Rregullore e Brendshme e DPRRNP Tiranë.

III. Auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2022 në DPRRNP Tiranë

1. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik [DPRRNP], është njësi në varësi të Bashkisë Tiranë. Struktura Organizative dhe buxheti për zhvillimin e aktivitetit të saj miratohen nga Bashkia (kryetari dhe këshilli bashkiak), në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Për një ushtrim efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave institucionale dhe në arritjen e objektivave të bashkisë Tiranë në realizimin e shërbimeve në

forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative, DPRRNP ka kompozuar struktura organizative për të arritur këto objektiva.

Viti	Nr. i Drejtorive	Nr. i Sektorëve	Nr. i stafit Plan / Fakt	
2019	4	16	448	445
2020	4	18	468	466
2021	4	18	475	475
	6	18		
	7	18		
2022	7	18	495	480
		19	505	503
		21	525	522

Burimi: DPRRNP Tiranë

Struktura e DPRRNP Tiranë si njësi në varësi të Bashkisë Tiranë, emërimet e personelit përbërës të saj, janë kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm bazuar në Ligjin nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” neni 19; ndërsa Këshilli Bashkiak ushtron kompetencat e tij bazuar në nenin 54/ç,dh të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” në miratimin e nivelit të pagave dhe buxhetit ku konfirmohet edhe numri i përgjithshëm i punonjësve në strukturë. Personeli në Strukturat organizative të DPRRNP Tiranë për periudhën 2019-2022, ka një shpërndarje si në tabelë:

Nr	Emërtesa për pozicion në Strukturë	Nr. Personeli 2019 (1 strukturë)		Nr. Personeli 2020 (1 strukturë)	Nr. Personeli 2021 (3 struktura)	Nr. Personeli deri më 31.12.2022 (3 struktura)		
1	Drejtori I Përgjithshëm	1	1	1	1	1	1	1
	Zv/Drejtor I Përgjithshëm					1		
2	Drejtor Drejtorie	4	4	4	7	7	7	7
3	Përgjegjës Sektori	15	16	18	18	18	19	21
4	Specialist I	19	19	28	31	35	39	41
5	Specialist II	13	15	13	31	30	29	29
6	Specialist III	17	16	16				
7	Asistente e Drejtorit të Përgjithshëm	1	1					
8	Manovrator makineri te renda						6	8
9	Shofer mjete teknologjik	11	15	35	40	40	35	35
10	Punonjës /Protokoll /Arkivë	2	2	2				
11	Shofer mjete mbi 2.5 t	14		16	16	16	17	17
12	Teknik i mesem ndriçimi + bordi kullimit	56	56	58	57	62	62	62
13	Punëtor gadishmërie (ndriçimi & sinjalistike)	38	38	38	38	38	40	44
14	Operator i sallës së monitorimit		2					
15	Dispeçer, Teknik zbatues, Oficinë, Manovrator/furre, franto, prodhim asfalti	26	32	22	23	26	25	24
16	Punëtor prodhimi asfalti dhe frantoje	12	12	12	4	4	4	4

Nr	Emërtesa për pozicion në Strukturë	Nr. Personeli 2019 (1 strukturë)		Nr. Personeli 2020 (1 strukturë)	Nr. Personeli 2021 (3 struktura)	Nr. Personeli deri më 31.12.2022 (3 struktura)		
17	Shofer mjete nën 2.5 t	10	14	10	10	10	10	10
18	Magaznier	4	4	4	5	5	5	5
19	Punëtor	190	190	190	195	202	204	214
20	Pastruese	1	1	1	1	1	1	1
Totali		434	448	468	475	495	505	525

Burimi: DPRRNP Tiranë

Për vitin 2019, në mbështetje të VKB nr. 159, datë 21.12.2018 “Për miratimin e programit afatmesëm 2019-2021 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2019”, konfirmuar nga institucioni i Prefektit me shkresë nr. 5419/1prot, datë 28.12.2018, me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 3097/2, datë 21.01.2019, është miratuar “Struktura organike e Drejtorisë së Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë.

Për vitin 2020, në mbështetje të VKB nr 157, datë 26.12.2019 “Për miratimin e programit afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë, Tiranë , për vitin 2020”, me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 4984, datë 31.01.2020, është miratuar “Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve dhe Ndriçimit Publik, ndryshuar emërtimi i institucionit me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 159, datë 26.12.2019 “Për miratimin e stemave të Drejtorive të Përgjithshme të Punëtorëve të Qytetit dhe Qendrës Ekonomike të Zhvillimit të Fëmijëve, institucione në varësi të Bashkisë Tiranë”, është miratuar me Urdhër nr. 4984, datë 31.01.2020 Struktura dhe organika e DPRRNP.

- Viti 2021 ka pësuar 3 ndryshime strukturore, pa ndryshim në numër 475 punonjës .

Për vitin 2021, në mbështetje të VKB nr 172, datë 21.12.2020 “Për miratimin e programit afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë, Tiranë për vitin 2021”, me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 1084/1, datë 11.01.2021, është miratuar struktura organike e Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve dhe Ndriçimit Publik, me 475 punonjës .

Për vitin 2021 në mbështetje të VKB nr. 172, datë 21.12.2020 “Për miratimin e programit afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë, Tiranë për vitin 2021 (të ndryshuar)”, me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 23612/1, datë 18.06.2021, është miratuar struktura organike e Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve dhe Ndriçimit Publik, me 475 punonjës me ndryshim strukturor, shtimin e 1 (një) drejtorie, Drejtoria e Sinjalistikës Rugore.

Për vitin 2021 në mbështetje të VKB nr. 172, datë 21.12.2020 “Për miratimin e programit afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2021 (të ndryshuar)”, me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 37547/1, datë 01.10.2021, është miratuar struktura organike e Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve dhe Ndriçimit Publik, me 475 punonjës me ndryshim strukturor, shtimin e 1 (një) drejtorie, Drejtoria e Mirëmbajtjes së Trotuarëve dhe KUSH.

- Viti 2022 ka pësuar 3 ndryshime strukturore , me shtesë në numër punonjësish, gjithsej bëhen 495.

Për vitin 2022, në mbështetje të VKB nr 166, datë 24.12.2021 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2022”, me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 3879/1, datë 31.01.2022, është miratuar struktura organike e Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve dhe Ndriçimit Publik, **me 495 punonjës** .

Për vitin 2022, në mbështetje të VKB nr 166, datë 24.12.2021 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2022” (i ndryshuar), me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 16282/1, datë 29.04.2022, është miratuar struktura organike e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, me **505 punonjës**.

Si paraqitet fondi i buxhetit të miratuar për të mbuluar shpenzimet për pagat e punonjësve sipas strukturave të çdo viti ushtrimor:

Viti ushtrimor	Program i	kap	Llogaria	Plan	Fakt
Viti 2019	04530	5	600	287,258,291	257,367,681
	04530	5	601	45,739,827	42,940,254
			6009999	332,998,118	300,307,935
Viti 2020	04520	5	600	299,050,568	271,694,936
	04520	5	601	47,710,000	45,329,943
			6009999	346,760,568	317,024,879
Viti 2021	04520	5	600	303,383,575	292,576,584
	04520	5	601	48,429,500	47,094,482
			6009999	351,813,075	339,671,066
Viti 2022	04520	5	600	315,981,017	306,997,426
	04520	5	601	51,968,954	51,258,604
			6009999	367,949,971	358,256,030

Burimi: DPRRNP/D Financës

- Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për: • Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune; • Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës; • Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta; • Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. • Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuara për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve; • Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

- Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët, duhet të jenë të përshkruara në Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës. Ato janë pjesë e rëndësishme e politikave dhe praktikave që lidhen me burimet njerëzore. Si të tilla *Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit*. Për këto arsye kriteret duhet të jenë pjesë në Rregulloren e Brendshme të Njesisë, neni “përshkrimet e punës” si dhe e dosjes së personelit. DBNJ/[SBNJ] nga ana e tij pasi harton planin vjetor të punësimit, ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, praktikë e cila në përfundim bëhet pjesë e dosjes së personelit; Kjo procedurë realizohet në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi, “Kodit të punës”, VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar. Gjithashtu [SBNJ] në bashkëpunim me secilën njësi të strukturës, hartojnë Formularët e Përshkrimit të Pozicionit të Punës të çdo pozicioni në strukturë. Me hartimin e tyre nga ana e

Titullarit të DPRRNP Tiranë duhet t'i përcillen për miratim Drejtorisë së burimeve njerëzore në Bashkinë Tiranë.

Ky formular duhet të jetë pjesë përbërëse e dosjes bashkëngjitur kontratës së punës dhe manualit të procedurave të njësisë publike.

Konstatim: Ndryshimet në strukturat e rikompozuara nuk janë shoqëruar me përshkrimet e punës të miratuara për çdo njësi drejtori apo sektor dhe për çdo pozicion të ri, si dhe nuk janë reflektuar në Rregulloren e institucionit;

Konstatim: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nevojat për punësim trajtohen verbalisht në analizat dhe takimet e punës që zhvillohen;

- gjithashtu mes titullarit të institucionit dhe Strukturave përgjegjëse në organin epror Bashkia Tiranë mbizotëron komunikimi verbal mbi strukturën dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve. Nuk ka asnjë dokument zyrtar paraprak mbi sygjerime apo dhënie mendimesh mbi njësitë përbërëse, organizimin dhe numrin e punonjësve të secilës njësi.

▪ Strukturat e institucionit janë hartuar/miratuar sipas kërkesave të Ligjit nr.139/2015 neni 64/j, ku specifikohen elementët që duhet të përmbajë Struktura organizative e NJVQV: pozicioni, kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion, numrin e personelit për çdo pozicion, në përputhje kjo me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu nga tabela rezulton se ka rikompozime të njësisë të strukturës, lëvizje të numrit të personelit dhe qarkullim të tyre brenda njësisë. Si rezultat i ristrukturimeve të Drejtorive apo sektorëve që janë shoqëruar edhe me pozicione të reja, ka patur efekte të cilat si vendeve vakante që janë në DPRRNP Tiranë, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

31.12.	Numri i Punonjësve		Diferenca
	Plan	Fakt	
2019	448	445	3
2020	468	466	2
2021	475	475	0
2022	525	522	3

Burimi: DPRRNP Tiranë

Konstatim: Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se numri i vendeve vakante sipas strukturave të çdo viti, ka qenë si në tabelë. Plani vjetor i punësimeve është hartuar nga përgjegjësjë e sektorit të burimeve njerëzore, por për përdorim të brendshëm. Rezultoi se nuk është ndarë numri i nevojave për zëvendësim të stafit për arsye të “daljes në pension” nga numri i nevojave për staf të ri duke iu referuar strukturës organizative të miratuar apo në pritje për miratim;

Konstatim: Njoftimet për vendet vakante publikohen në stendat e institucionit dhe në ëeb-in e Bashkisë Tiranë, si organ epror i saj. Rezulton se DPRRNP Tiranë nuk ka faqen e vet zyrtare ku të përfshijë programin e transparencës, dhe për rrjedhojë të bëhet dhe publikimi i vendeve vakante në të.

▪ Nga auditimi i lëvizjeve dhe i ndryshimeve në strukturat organizative të DPRRNP Tiranë, pasqyruar në tabelën e mësipërme, vihet re se në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 numri i vendeve vakante është i papërfillshëm, pasi në gjykimin tonë meqë procedurat e punësimit me Kod Pune janë më fleksibël dhe kërkesa për punë në treg është e lartë, bëhet i mundur plotësimi brenda një afati kohor të shkurtër i tyre.

- Vendet vakante janë krijuar si rezultat i ristrukturimeve dhe i largimeve të punonjësve për arsye të ndryshme. Një pasqyrim më i detajuar i numrit me arsyen e largimeve, jepet në tabelën e mëposhtme:

Arsyet e largimit	2019	2020	2021	2022	TOTALI
Pension	-	-	-	2	2
Dorëheqje	6	10	15	25	56
Me procedurë disiplinore	-	-	1	-	1
Përfundim kontrate	-	-	-	2	2
KMCAP	-	-	-	2	2
Transferim	-	-	-	-	-
Ndarje nga jeta	-	-	-	2	2
Braktisje				3	3
TOTALI	6	10	16	36	68

Burimi: DPRRNP Tiranë

- Nga verifikimi i disa dosjeve të personelit punësuar gjatë periudhës audituese 2019-2022 rezultoi se dokumentacioni i tyre përgjithësisht ishte i plotë konform VKM nr. 117/2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” i ndryshuar me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, por **rezultoi** se ndryshimet e pozicioneve brenda njësisë, apo nga një njësi në tjetrën nuk është shoqëruar me sistemin e dokumentacionit të përditësuar në fashikuj pra me krijimin e një praktike të re dokumentare, ndonëse i përkasin të njëjtës dosje personeli, në moszbatim të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

▪ Drejtoria e Administratës dhe Financës [DAF] e ndryshuar, si struktura përgjegjëse për personelin, njofton për çdo rast Drejtorin e Përgjithshëm mbi vendet vakante në strukturën organizative të njësisë publike, i cili nga ana e vet në fillim të çdo viti nxjerr Urdhrat për ngritjen e Komisionit që ndjek procedurën e punësimit: njoftimi, konkurrimi, shqyrtimit të dokumentacionit të aplikuesit, etj, dhe ka afat një vjeçar, konkretisht: Për vitin 2019 është Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 04 datë 03.01.2019 i ndryshuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 2748 datë 24.09.2019; Për vitin 2020 është Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 37 datë 08.01.2020 i ndryshuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 37/1 datë 17.11.2020; për vitin 2021 është Urdhri nr. 03 datë 05.01.2021; për vitin 2022 me Urdhrin nr. 03 datë 05.01.2022.

Nr.	Përbërja e komisionit viti 2019	Përbërja e komisionit viti 2020	Përbërja e komisionit viti 2021	Përbërja e komisionit viti 2022
		UB nr. 04 dt. 03.01.2019 UB. Nr. 2748 dt. 24.09.2019	UB. nr. 37 dt. 08.01.2020 UB. nr. 37/1 dt. 17.11.2020	UB. nr. 03 dt. 05.01.2021
1	L.C kr. E.M	E.M kr. S.M	S.M kr.	S.M kr.
2	R.L	R.L	R.L	R.L
3	M.M	M.M	M.M	M.M

Burimi: DPRRNP Tiranë

- Kërkesat e DPRRNP Tiranë për rishikimin e pozicioneve të punës në strukturë janë dërguar zyrtarisht në përputhje me strukturën dhe buxhetin vjetor të miratuar. Ato përmbajnë: argumentimet për çdo pozicion, klasifikimin e vendeve të punës, numri i punonjësve për çdo njësi, klasifikimin e pagës, organigramën dhe pasqyrën e pagave dhe sigurimeve shoqërore.

- Niveli i pagave të Bashkisë Tiranë dhe njërive vartëse të saj miratohet me VKB, dhe te Lidhjet bashkëngjitur tyre përcaktohen: Kategoria/klasa, Grupi, shtesa për vjetërsi, shtesa për vështirësi dhe shtesa për pozicion.

Viti	VKB e miratimit të nivelit të pagave për çdo pozicion
2019	Nr. 34 prot., datë 05.04.2017
2020	Nr. 157 prot., datë 26.12.2019
2021	
2022	Nr. 40 prot., datë 28.04.2022 ≠ Nr. 83 prot., datë 30.09.2022

Punoi: Grupi i auditimit

2. Strukturat Organizative paraqesin informacion të qartë mbi klasifikimin, kategorinë dhe grupin të cilit i përket çdo pozicion. Në tabelë pasqyrohen kategoritë dhe grupi i pagave, referuar lidhjeve bashkëngjitur strukturave të miratuara me VKB dhe kategorisë dhe nivelit të pagave:

Njësitë e punës	Grupi	Shtesa për vështirësi
Drejtor i Përgjithshëm	II a	
Zv/Drejtori i përgjithshëm	II b	
Drejtor Drejtorie	II b	
Përgjegjës Sektori	III a	
Specialist I	III b	
Specialist II	IV a	
Specialist III	IV b	
Pastrues	Klasa I	
Magaznier	Klasa V	
Punëtor prodh. Asfalti dhe frantoje	Klasa V	5%
Punëtor	Klasa III	5%
Dispeçer	Klasa VI	5%
Teknik zbatues		5%
Oficinë		5%
Manovrator furre		5%
Prodhim asfalti		
Punëtor gadishmërie (ndriçim /sinjalistikë)	Klasa VI	5%
Teknik i mesëm (ndriçim /bordi i kullimit)		5%
Manovrator mjete të rënda	Klasa XIV	5%
Përgjegjës grupi	Klasa XI	
Shofer mjete teknologjik	Klasa IX	5%
Shofer mjete deri në 2.5 t	Klasa IV	
Shofer mjete mbi 2.5 t	Klasa VIII	
Nr. Kategori	23	10

Burimi: DPRRNP/Punoi: Grupi i auditimit

Nga verifikimi i listëpagesave rezultoi se ka përputhje të llogaritjes së pagave me lidhjet bashkëngjitur VKB respektive.

▪ Nga auditimi mbi hartimin dhe miratimin e strukturës organizative dhe organigramës në strukturën e DPRRNP Tiranë rezultoi se nuk ka pozicione të caktuara me status të “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) kategori të ndryshme: persona me aftësi të kufizuar, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptiane etj.) si personel administrativ apo të atyre me klasa. Por në DPRRNP Tiranë ka të punësuar me këtë status, por rezultoi se ka qenë e rastësishme dhe jo e planifikuar në strukturë. Megjithatë ka gjetur zbatim Ligji nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligji nr. 15/2019 dt. 13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”. Pra rezultoi se nga DPRRNP Tiranë, janë respektuar aktet ligjore e nënligjore për dhënie përparësie rekrutimit të personave të grupit të veçantë.

Konstatim: DPRRNP Tiranë ndonëse ka punësuar persona me status nga “grupi i veçantë” nuk ka përcaktuar në strukturë pozicione me status “Grup i veçantë”, në moszbatim kjo të Ligjit nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjit nr. 15/2019 dt. 13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”, VKM nr. 535/2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet” etj.

▪ Gjatë periudhës audituese 2019-2022, ka patur të punësuar me kontratë provizore (3 mujore) si më poshtë:

Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme				
maj-korrik 2019	qershor-gusht 2020	maj-korrik 2021	2022	Spektori
50	50	15	0	Administrimi i ujërave

Konstatim: Në planin vjetor të punësimeve nuk janë parashikuar nevojat për punonjës provizorë; kjo rezultoi nga mungesa e kërkesave të analizuar/studiuara të njësisë që ka nevojë për staf provizor me argumentet përkatëse drejtuar strukturës përgjegjëse së burimeve njerëzore në Bashkinë Tiranë.

▪ Nga praktika e listëpagesave (borderove), përzgjedhëm disa muaj të çdo viti. Deri tani rezultoi se praktika është e plotë me kohëshënuesin e çdo sektori a drejtorie, raportet mjekësore, procesverbalet e përpiluara mbi orarin e ushtrimit të aktivitetit ditor, orët e natës dhe orët e ditëve të shtuna. Gjithë dokumentacioni shkresor është nënshkruar nga personat përgjegjës: menaxheri i njësisë përkatëse (drejtori apo përgjegjës sektori sipas rastit) dhe përgjegjësi i burimeve njerëzore.

- Listëpagesat mujore janë nënshkruar nga specialiste e financës për pagat dhe drejtor i drejtorisë së financës; Listëpagesat dhe urdhër shpenzimet përkatëse dorëzohen në 4 banka të nivelit të dytë, konform procedurave të dokumentuara ligjore.

- Për pagesat e orëve të turnit të II e III, i është bashkëngjitur Urdhri i brendshëm i titullarit mbështetur në procesverbalet e hartuara nga drejtorët dhe përgjegjësit e njësive dhe miratuar nga vet titullari;

- Lëvizjet Brenda organikës janë realizuar në zbatim të Urdhrave të titullarit, konform standardeve të formateve zyrtare të miratuara;

- Nga auditimi rezultoi se në strukturën e DPRRNP Tiranë, referuar fushës së aktivitetit të saj, ka pozicione që kanë shkallë vështirësie dhe punonjësit e këtyre pozicioneve përballen me këto vështirësi në përditshmërinë e tyre në përmbushje të detyrës gjatë orarit zyrtar. DPRRNP Tiranë i ka kushtuar vëmendjen e duhur kësaj kategorie, për ta trajtuar konform kuadrit ligjor në fuqi.
- DPRRNP Tiranë nuk ka punonjës të punësuar me kohë të pjesshme;
- Në librin e kontabilizimit të pagave, nuk rezultojnë punonjës të paguar jashtë strukturës së miratuar.
- Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit mbi sigurimet shoqërore të punonjësve në DPRRNP Tiranë, janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8434 datë 28.11.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligjit nr. 9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore në RSH”;
- Sipas listëpagesave të përzgjedhura, është zbatuar struktura sipas vendimeve të miratuara;
- Nuk rezultoi punonjës të pezulluar përkohësisht nga puna për pjesëmarrje në fushatat elektorale për zgjedhjet vendore 2019 dhe zgjedhjet parlamentare 2021.

Viti ushtrimor	Numri i punonjësve			Fondi pagave gjithsej	Shpërblim suplementare	Ndihma Shoq. te menjehershme	Kontributi sig. shoq. dhe shëndetësor	Shpërblim te tjera	Tatimi mbi të ardhurat
	Pranuar te rinj	Larguar	Gjendje fund te vitit ushtrimor						
	1	2	3						
2019	0	0	498	257,367,681	0	0	71,739,962	0	12,629,854
2020	518	0	518	271,694,936	0	0	75,731,724	0	13,484,796
2021	81	74	475	282,059,985	0	1,279,325	78,678,764	10,516,599	15,922,910
2022	505	0	525	257,737,612	0	9,590,000	85,635,688	892,469	14,905,700

Konstatim: DPRRNP Tiranë lidhur me trajtimin e punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u ka përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, rezulton në moszbatim të VKM nr. 68/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfiturar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”.

Konkluzion:

Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.) për DPRRNP Tiranë rezulton se:

- DPRRNP Tiranë nuk disponon faqe zyrtare interneti, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore për informimin dhe transparencën;
- Nuk janë përcaktuar në strukturën organizative pozicione me status të “grupit të veçantë”;
- Nuk janë zbatuar aktet ligjore/nënligjore lidhur me trajtimin me pagë të punonjësve, shpërblime/ dieta ushqimore punonjësve me Kod Pune, duke parashikuar fond në PBA-të dhe buxhetin vjetor të DPRRNP Tiranë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore:

- 1) Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, si dhe nenet 9, 10, 11 të ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
- 2) Udhëzimi i vitit 2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”
- 3) Udhëzimin nr. 16, datë 20.07,2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”

Personat përgjegjës

1. E.K Drejtor i Përgjithshëm për periudhën deri në datën 15.10.2020;
2. H.RR Drejtor i Përgjithshëm për periudhën 15.10.2020-04.09.2023
3. L.C Drejtor i Administratës dhe Financës për periudhën deri në 23.09.2019
4. E.M Drejtor i Administratës dhe Financës për periudhën 23.09.2019-16.11.2020
5. S.M Drejtor i Administratës dhe Financës për periudhën 16.11.2020 e në vijim

Pretendime të Subjektit: Me shkresën nr. 1775/3 prot., datë 03.06.2024 nga Subjekti DPRRNP Bashkia Tiranë dhe me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024, janë shprehur observacionet mbi gjetjet dhe konstatimet e përcjella nga grupi i auditimit në Akt Konstatimin nr. 4 datë 21.03.2024 dhe në PRA si më poshtë vijon:

Rekomandimi 6.1: - Do merren masa për krijimin e faqes zyrtare në internet të vetë DPRRNP, Tiranë dhe programit të transparencës.

- Janë marrë masat për hartimin e Formularit të përshkrimit të pozicionit të punës, duke ngritur Urdhërin e Brëndshëm nr 1890 prot., datë 10.05.2024 si dhe Formularin Tip hartuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse për përshkrimin e punës të çdo pozicioni në strukturën organike. Ky material u përcoll pranë Drejtorisë Juridike dhe të Prokurimeve me shkresë nr. 1890/1 prot., datë 13.05.2024. Procesi i punës për zbatimin e rekomandimit do të vijojë me përgatitjen e draftit përfundimtar, ku me urdhër të brëndshëm të Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve do të kalojë për zbatim në të gjitha drejtoritë e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

- Plani vjetor i punësimit ka vazhduar të hartohet me shkresë të brendshme nga sektori i Burimeve Njerëzore, miratuar në Planin Mujor të Punës me nr. 530/1 prot, datë 05.02.2024.

- Në vijim, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), do të hartojmë planifikuar në PBA 2025-27, Planin Vjetor të Punësimeve të ndarë sipas numrit të nevojave për zëvendësim të stafit për arsye të daljeve në pension, nga numri i nevojave për staf të ri, duke ju referuar strukturës organike në pritje për miratim.

Përsa i përket kërkesës për caktimin në strukturën organizative, të pozicioneve për kategorinë “grup i veçantë”, në shkresën nr 1666/5 prot., datë 29.04.2024, në zbatim të urdhërit të Brendshëm nr 1666/1 prot., datë 25.04.2024 për “Krijimin e komisionit për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-27”, është kërkuar në zërin “paga dhe sigurime shoqërore” parashikim për punësimin e personave me aftësi të kufizuara (PAK), grup i cili do të jetë pjesë e targetit ekzistues.

- Përsa i përket trajtimit të punonjësve të cilët gjatë orarit zyrtar të punës nuk u janë përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, do të merren masa në vijimësi, që në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të zbatohet VKM nr 68/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”. Dokumentat e sipërcituara do të përcillen për miratim në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në Bashkinë, Tiranë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me observacionet e [gjetje dhe rekomandimit (6)], vlerësojmë faktin që janë pranuar nga ju dhe janë marrë masat për zbatimin e tyre. Ndonëse janë përpiluar aktet

përkatëse, përderisa nuk janë përcjellë ende në organin epror Bashkia Tiranë për njohje, konfirmim të ligjshmërisë dhe fillim të zbatimit të tyre, observacioni juaj merret pjesërisht në konsideratë.

1. Nga DPRRNP Tiranë ndryshimet në strukturat e rikompozuar, nuk janë shoqëruar me përshkrimet e punës të miratuara për çdo njësi të saj drejtori apo sektor dhe për çdo pozicion të ri, si dhe nuk janë reflektuar në Rregulloren e brendshme të institucionit.

2. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nevojat për punësim trajtohen verbalisht në analizat dhe takimet e punës që zhvillohen.

- Gjithashtu mes titullarit të institucionit dhe Strukturave përgjegjëse në organin epror Bashkia Tiranë mbizotëron komunikimi verbal mbi strukturën dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve. Nuk ka asnjë dokument zyrtar paraprak mbi sugjerime apo dhënie mendimesh mbi njësitë përbërëse, organizimin dhe numrin e punonjësve të secilës njësi.

3. Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacioni i pasqyruar në tabelën e vendeve vakante, rezulton se numri i tyre sipas strukturave të çdo viti ka qenë relativisht i ulët. Plani vjetor i punësimeve është hartuar nga përgjegjësja e sektorit të burimeve njerëzore, por për përdorim të brendshëm. Rezultoi se nuk është ndarë numri i nevojave për zëvendësim të stafit për arsye të “daljes në pension” nga numri i nevojave për staf të ri duke iu referuar strukturës organizative të miratuar apo në pritje për miratim.

4. Njoftimet për vendet vakante publikohen në stendat e institucionit dhe në ëeb-in e Bashkisë Tiranë, si organ epror i saj. Rezulton se DPRRNP Tiranë nuk ka faqen e vet zyrtare ku të përfshijë programin e transparencës në kundërshtim me Ligjin nr. 119/2014 "ër të drejtën për informim" neni 1 pika 2,3; neni 2 pika 1/a; neni 4 pika 1,2; neni 7; dhe për rrjedhojë të bëhet dhe publikimi i vendeve vakante në të sipas nenit 7.

5. DPRRNP Tiranë ndonëse ka punësuar persona me status nga “grupi i veçantë” nuk ka përcaktuar në strukturë pozicione nga kjo kategori, në moszbatim kjo të Ligjit nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjit nr. 15/2019 dt. 13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”, VKM-ja nr. 535/2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet” etj.

6. Në planin vjetor të punësimeve nuk janë parashikuar nevojat për punonjës provizorë; kjo rezulton nga mungesa e kërkesave të analizuarra e të studiuara të njësisë që ka nevojë për staf provizor me argumentimet përkatëse, drejtuar strukturës përgjegjëse së burimeve njerëzore të Bashkisë Tiranë.

7. DPRRNP Tiranë lidhur me trajtimin e punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u ka përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, rezulton në moszbatim të VKM nr. 68/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar; VKM nr. 117/2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” i ndryshuar; Ligjin nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të

Kufizuara”; Ligjin nr. 15/2019 dt. 13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”; VKM-ja nr. 535/2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”; VKM nr. 165, datë 2.3.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendor” pika 17; VKM nr. 707/2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore” i ndryshuar; Ligjit 7705/1995 “Për sigurimet shoqërore”, VKM nr. Nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”; VKM nr. 68/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën për informim".

2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe dokumentacionin elektronik të marrë nga sistemi SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishtme janë trajtuar, si vijon:

Procedurat e periudhës 01.01.2019-31.12.2019:

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë kryer gjithsej 46 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit **523,504,956.00** lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur **477,719,024.00** lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **45,785,932** lekë pa TVSh. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën më poshtë:

Procedura 01.01.2019-31.12.2019	Nr.	Vlera e Fondit Limit	Vlera e Kontraktuar	Diferenca me Fondin Limit
Gjithsej	46	523,504,956	477,719,024	45,785,932
Kërkesë për propozim	0	-	-	-
E hapur	18	481,610,837	438,350,981	43,259,856
E hapur e thjeshtuar	12	35,728,536	33,857,000	1,871,536
Me vlerë të ulët	16	6,165,583	5,511,044	654,539
Sipas objekteve	46			
Objekte në fushën e investimeve	2	29,964,366	24,932,584	5,031,782
Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	44	493,540,590	452,786,440	40,754,150

U audituan gjithsej 9 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit **361,586,075** lekë dhe vlerë të kontratave **318,251,419** lekë e fondit limit total. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej 28 OE/BOE, nga të cilat janë s’kualifikuar 12 OE/BOE. Me 1 BOE kanë qenë 1 BOE

procedurë, . Procedurat e zgjedhura për auditim janë paraqitur në tabelën më poshtë. Vlerat e paraqitura janë pa TVSh.

Nr.	Objekti	Lloji i procedurës	OE fitues	Fondi limit	Vlera e kontratës
1	Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të ndricimit publik”.	E hapur	OE ”H” SHPK	33,255,455	27,121,285
2	Blerje karburanti Loti I gasoil Loti i II Benzinë	E hapur (Marrëveshje kuadër)	B.OE.”A” sha. “O” SHPK	51,931,500 <i>Loti i I diezel</i> 47,,606,400 <i>Loti II : benzine</i> 4,325,100	47.606.400 Marzhi Fitimit 17.2 % 4,325,100
3	Blerje BITUMI	E hapur (Marrëveshje kuadër)	R ER Sha	38,333,333	38.333.333lekë Marzhi i fitimit 35%
4	Blerje Inerte	E Hapur	SH Shpk	44,027,500	36,136,600
5	Zgara dhe Puseta	E Hapur	“M” Sh.pk	24,579,300	24,341,900
6	Ndertimi i urës në rrugën Kocaj- Veski, Baldushk	E Hapur	“K” Sh.p.k.	18,249.229	14,598,584.2
7	Rikonstruksoni i urës së fshatit Vilëz Zall Bastar	E Hapur	BOE-OE “A” Sh.p.k. dhe “K“ Sh.p.k.	11,715.137	10,333,964
8	Mirëmbajtja e Sheshit Skëndërbej	E Hapur Marrëveshje Kuadër	BOE “F” sh.p.k, “T”, “S ” sh.p.k,	133,329,038	Me ofertë vlerën e shumatoreve për njësi 913,939.95 lekë dhe me ofertë vlerë ekonomike 120,278,173
			Totali	361,586,075	318,251,419

1. Procedura e Prokurimit me objekt: “Blerje materiale per mirembajtjen e rrjetit te ndricimit publik”.

Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur” REF.-12772-03-07-2019”- Urdhri nr.560/1 prot., datë 07.03.2019	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr.560/1, datë 20.02.2019 1.A.K 2.O.GJ 3.S.Q	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr.560/3 prot., datë 07.03.2019. 1.M.M 2. E.K 3.A.K	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.560/4 prot., datë 07.03.2019. 1.L.C 2.P.S 3.M.N
4. Fondi Limit (pa tvsh) 33,255,455 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: OE ”H” Sh.p.k. me vlere 27,121,285 lekë pa Tvsh		6. Diferenca me fondin limit 6.174170 lekë pa tvsh

7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 01.04.2019 ora 11.00.....	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkise.	9. Operatorët Ekonomike Pjesemarres 3 OE Skualifikuar 2OE Kualifikuar 1OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 10 ditë		
	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 560/15 prot., datë 23.04.2019	12.Përgjigje Ankesës

1. Hartimi i fondit limit

Me Urdher nr.560/1, datë 20.02.2019 është krijuar komisioni për hartimit e specifikimeve teknike dhe fondit limit me anëtar A.K ,O.GJ ,S.Q , “Procedurë e hapur me” REF.-12772-03-07-2019”.

Me urdhër nr. 560/3 Prot., datë 07.03.2019 është krijuar Njësia e Prokurimit me anëtarë komisioni M.M , E.K , A.K.

Me Urdhrin nr.560/4 Prot., datë 07.03.201 është vendosur krijimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me anetarë, L.C Kryetare, P.S Anëtar, M.N Anëtar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor që gjendet në dosjen e prokurimit me “Procedurë e hapur me ” REF.-12772-03-07-2019” “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të ndricimit” rezulton se fondi limit në vlerën 33,255,455 leke pa tvsh bazuar në procesverbalin nr.560/2 datë 20.02.2019 janë përcaktuar sasi të e nevojshme dhe specifikimet teknike për blerjen e materialeve për mirëmbajtjen e rrjetit te ndricimit.

Data e levrimit do të jete 10 dite.

Fondi Limit, bazuar në vlerësimin e komisionit për hartimit e specifikimeve teknike është llogaritur në vlerën 33,255,455 lekë pa tvsh

2. Hartimi i kriterëve

Me shkresën hyrëse në Drejtorinë e Përgjithshme Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit me nr. 560/6 dste 13.03.2019, është paraqitur ankesa nga OE “A” sh.p.k, në lidhje me kriteret e vecanta të kualifikimit si dhe specifikimet teknike.

Me urdher nr. 560/6 date 13.03.2019 të Titullarit të Autotritetit Kontraktor është ngritur komisioni për shqyrtimin e ankesës i përbërë nga 1.L.C 2.P.S 3. M.N .

Me urdhërin nr. 560/7 datë 13.03.2019 të Titullarit të Autotritetit Kontraktor është vendosur pezullimi i procedurës së prokurimit “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të ndricimit publik”.

Me shkresën nr.560/9 date 15.03.2019 është vendosur pranimi i ankesës se OE ”A” sh.p.k dhe ndryshimi pjesërisht në lidhje me kriteret e vecanta të kualifikimit si dhe specifikimet Teknike, dokumentet e tenderit.

3. Vlerësimi i Ofertave

Data e hapjes së tenderit është 01.04.2019 ora 11.00 dhe kanë marrë pjesë Operatorët Ekonomikë si vijon:

1 OE “R”s h.p.k. NUIS K...A me vlerë 27,000,000 lekë pa TVSH.

2 OE “H” sh.p.k.me NUIS L...H me vlerë 27,121,285 lekë pa TVSH.

3 OE “I” sh.p.k.me NUIS K...H me vlerë 29,828,675 lekë pa TVSH.

4. OE ”K” sh.p.k. Me NUIS L...I me vlere 30,000.000 leke pa TVSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave rezulton si vijon Janë skualifikuar OE si më poshtë:

- OE "R" sh.p.k. NUIS K...A me vlerë 27,000,000.lekë pa TVSH.
- OE "I" sh.p.k.me NUIS K...H me vlerë 29,828,675 lekë pa TVSH.
- OE "K" sh.p.k. Me NUIS L...I me vlere 30,000,000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi, rezultoi se skualifikimet e këtyre OE, janë bërë me të drejtë, pasi nuk i plotësojnë kriteret e vendosura në DT.

Operatori Fitues:

OE "H" sh.p.k.me NUIS L...H me vlerë 27,121,285 leke pa Tvsh.

Nga shqyrtimi dokumentacionit të OE fituese OE "H" sh.p.k.me NUIS L...H me vlerë 27, 21,285 leke pa TVSH rezulton se është conform kriterëve të vendosur në DT.

Zbatimi i Kontrates

Nga verifikimi i faturave hyrje-dalje për materialet e mirëmbajtjes së rrjetit të ndricimit, rezulton se faturat e daljes nga magazina janë pa numër serie origjinal por të shënuar me shkrim dore.

Fletëdaljet e muajit Dhjetor 2019 janë pa numër origjinal serie. Nga data 01.12.2019 - 30.12.2019 janë bërë 22 fatura dalje, të cilat fillojnë me nr.317 (të shkruar) date 01.12.2019 dhe mbaron me faturën nr.345 datë 30.12.2019. Gjatë kontrollit të zërit llampa sinjalistike rezultojnë dalje nga magazina e materialeve elektrike për mirëmbajtjen e rrjetit të ndricimit publik në sasinë 236 copë me vlerë 393.6 lekë secila për periudhën 01.12.2019 deri në 31.12.2019.

Nga verifikimi i situacioneve të zbatimit nga specialistët e zbatimit në terren, ku bashkangjitur janë edhe faturat e dorëzimit, rezultojnë 236 llamba sinjalistike.

Ka përputhje të faturave të daljes dhe atyre të situacioneve në lidhje me zërin llampa sinjalistike për muajin dhjetor 2019.

U verifikuan faturat e daljeve për materialin Drozel mesai 60 copë vlerë 2647'2 lekë copë për muajin korrik 2019 rezultuan në përputhje 60 copë në terren . Ka përputhje të daljeve të sasisë në dalje me ato të situacioneve për materialin Drozel për muajin korrik 2019.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr.25 dhe në Rekomandimin nr. 13.1 të Projekt Raportit (faqe 240) sqarojmë se magazina është pajisur me blloqe fletë hyrje dhe fletë dalje sipas të gjitha të dhënave formale, siç është ndër të tjera edhe numri serial origjinal.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit **znj.M.M, z. E.K , z.A.K.**

1.Në lidhje me observacionin e mësipërm procedura e audituar i përket vitit 2019 dhe konstatimi i mësipërm për mungesën e numrit serial të faturave qëndron.Në vitet në vazhdim të audituara 2020-2022 nuk paraqitet e njëjta problematike dhe si i tille **nuk merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Procedura e Prokurimit me objekt: “Blerje Karburanti”

Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur” REF.-09896-02-21-2019”- Loti i I :REF-09899-02-21-2019. Loti II: REF:-09901-02-21-2019 Urdhri nr.448/3 prot., datë 21.02.2019	1. Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr.448/2 datë 08.02.2018. 1. M.K 2. B.S 3. H.B	2. Njësia e Prokurimit Urdhri nr.448/3 prot, Datë 21.02.2019 1. M.M 2. E.K 3. M.K	3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.448/4prot datë 21.02.2019. 1. L.C Kryetare 2. F.A Anëtar 3. M.N Anëtar
4. Fondi Limit (pa tvsh) 51,931,500)Lekë pa TVSH <i>Loti i I Blerje diezel (gazoi;)me fondin limit 47,606,400 Leke pa TVSh</i> <i>Loti II : Blerje benzine pa plumb me fond limit 4,325,100 Lekë pa TVSH</i>	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: B.OE.”A” sha. “O” SHPK. me NUIS L...H, J...I Loti i I: diesel (G) me fond limit 47,606,400 Leke pa TVSH, Marzhi Fitimit 17.2 (%)		6. Diferenca me fondin limit lekë pa TVSH
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 18.03.2019 ora 10:00.....	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë.	9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 2-OE: BOE b) S’KUALIFIKUAR 1.OE BOE c) Kualifikuar 1-OE-BOE	
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: Nga nënshkrimi i kontratës deri më datë 31.12.2019 sipas nevojave te Autoritetit Kontraktor.			
10. Ankimime	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 448/11 prot., datë 08/04/2019	12.Përgjigje Ankesës nga	

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Për parashikimin e zërit blerje karburanti viti 2019 jemi bazuar si më poshtë:

1-Jemi referuar konsumit të karburantit nga viti 2018:

-Për vitin 2018 konsumi i karburantit G ishte 272,060 litra ndërsa benzina ishte 24,694 litra. Nga këto një sasi prej 8,000 litra G i përket konsumit të karburantit të Administratës.

2- Kemi parashikuar konsumin e karburantit edhe për mjetet e reja që do të blihen me anë të prokurimit gjatë vitit 2019.

Për vitin 2019 janë parashikuar të blihen 10 mjete të reja si më poshtë:

a-Fadrom Hidromek me fletëhyrje nr. 3, datë 03.05.2019, 2 copë për të cilat konsumi është përlllogaritur sipas mjeteve të ngjashme me to. Mjeti me targë TR 1446 R, i cili ka konsum 9 l/orë pune, gjatë vitit 2018 ka kryer 923 orë punë, konsumi vjetor 8307 Litra.

Për këto dy mjete të cilat do blihen gjatë viti 2019 përlllogaritja e konsumin mesatar është 15,000 litra ne total.

b-Eskavator Terex me goma, me fletëhyrje nr 4 date 10.05.2019. Për konsumin e këtij mjeti jemi referuar mjetit afërsisht të ngjashëm me të, si mjeti me targë TR 0454 G i cili ka një konsum 18 Lit/orë pune dhe gjatë vitit 2018 ka kryer 278 orë pune. Konsumi mesatar në vit është 5,000 Litra.

c-Kamion 4-Aks Astra, fletehyrje nr 7 date 17.07.2019. Për konsumin e këtij mjeti jemi referuar mjetit të ngjashëm me të por me kapacitet më të vogël 3-Aks me targë AA 982 JF e cila ka një konsum prej 50 L/100km dhe gjatë viti 2018 ka kryer 9920 km dhe një konsum vjetor 4960L. Duke qënë se mjeti 4-Aks është i një tonazhi më të lartë, kemi parashikuar një konsum mesatar prej 6500 Lit në vit.

d-Mini eskavator me zinxhir, fletëhyrje nr 1 date 17.04.2019. Për konsumin e këtij mjeti jemi referuar mjetit të ngjashëm me të TR 0255I minifadrom, i cili ka konsum prej 5 Lit/orë pune dhe gjatë vitit 2018 ka kryer 1093 orë pune. Duke iu referuar këtij mjeti kemi parashikuar konsum mesatar rreth 5,000 Lit në vit.

e-Freze asfalti, fletehyrje nr 6 date 07.06.2019. Për konsumin e këtij mjeti jemi referuar një konsumi mesatar prej 20 Lit/orë pune, bazuar në specifikimet e mjetit që është kërkuar nga ana jonë. Konsumi mesatar në vit 5,000 Lit.

f-Kamion, fletëhyrje nr 2 datë 23.04.2019. Për konsumin e këtij mjeti jemi referuar mjetit të ngjashëm me targë TR 2018 I me një konsum prej 38 L/100km dhe konsum vjetor 3,960 Lit. Konsumi mesatar i përlllogaritur për mjetin Kamion është 4,000 Lit

g-Kamionçina copë 2, fletëhyrje nr 2 date 23.04.2019. Për konsumin e këtyre mjeteve jemi referuar mjetit të ngjashëm me targë AA 855 UZ me një konsum 18 L/100 km dhe një konsum vjetor 1740 Lit për gjatë viti 2018. Konsumi mesatar vjetor për dy mjetet e reja është përlllogaritur 3,500 Lit.

h-Autokullë, fletëhyrje nr 5 date 29.05.2019. Për konsumin e këtij mjeti jemi referuar mjetit të ngjashëm me targë AA 855 UZ me një konsum 18L/100km dhe një konsum vjetor 1740 Lit për gjatë viti 2018. Konsumi mesatar vjetor për këtë mjet është përlllogaritur 2,500 Lit duke marrë parasysht faktin se mjeti tip autokullë punon edhe me orë pune.

Shënim: Është përlllogaritur një tepricë prej 15,520 Litra naftë për fillim e vitit 2020. Për lëndën benzinë gjatë viti 2018 konsumi ka qene 24,694 Lit dhe parashikimi jonë ka qënë një sasi prej 30,000L, duke përlllogaritur edhe tepricën prej 5,306 Litra për fillim e vitit 2020.

2.Bazuar në Akt Konstatimin nr.26 dhe në Rekomandimin nr. 9.1 të Projekt Raportit (faqe 239) sqarojmë se Komisioni i ngritur me Urdhër të Titullarit me Nr. 448/1 Prot., datë 08.02.2019 për hartimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe grafikut të lëvrimit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karburanti” i është referuar nenit 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , i ndryshuar , ku parashikohet shprehimisht se.

“1. Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.

2. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

c) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.”

Konkretisht në përlllogaritjen e fondit limit Komisioni i është referuar alternativës së çmimit të tregut duke bërë testim tregu. Janë marrë tre oferta për G 10 ppm ULSD dhe tre për benzinë nga tre operatorë ekonomikë të ndryshëm (“B”, “O” dhe “A”) që kanë objekt të veprimtarisë së tyre tregëtimin e karburanteve. Çmimi për njësi i ofertuar nga operatorët ekonomikë është i shoqëruar me një analizë të mirëfilltë sipas strukturës së llogaritjes së çmimit të karburantit ku përfshihen çmimi sipas bursës referuar buletinit të publikuar nga APP-ja, akciza, taksat, marzhi i fitimit si dhe kursi i këmbimit. Analiza e çmimit bashkë me dokumentat shoqërues siç është tabela e bursës në buletin e APP-së dhe kursi i këmbimit të dollarit amerikan janë pjesë përbërëse e çdo oferte të dhënë. Bashkëlidhur do të gjeni procesverbalin e llogaritjes së fondit limit, ofertat dhe analizat e çmimeve.

Për sa më lart, Komisioni gjykon se ka vepruar në përputhje të plotë me pikën 2, gërma a) të nenit 59 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga komisioni i llogaritjes së fondit limit **znj.M.K, z.B.S z.H.G.**

1. Në lidhje me dokumentimin e përlllogaritjes së fondit limit Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i është referuar kontratës së mëparshme të vitit 2018. Veprimet e mësipërme janë në përputhje me VKM Nr.914, datë 29.12.2014. Observacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor paraqet argumenta shtesë dhe si i tillë **merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Në lidhje me përlllogaritjen e çmimit të karburantit sipas observacionit të mësipërm Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i është referuar VKM Nr.914, datë 29.12.2014. **Observacioni i mësipërm merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

3. Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje Bitumi

Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur” REF.-09719-02-20-2019”- Urdhri nr.478/1 prot., datë 12.02.2019	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr.478/1, datë 12.02.2019 1. B.S 2. J.J 3. L.O	2 Njësia e Prokurimit 1. M.M 2. E.K 3.B.S	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.472/4 prot., datë 20/02/2019. 1. .L.Ç Kryetare 2. .F.A Anetar 3. .M.N Anetare
4. Fondi Limit (pa tvsh) 38,333,333 (Leke pa TVSH	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: OE “R ” Sh.a. Nipt L ... V Marzhi i fitimit 35%		6. Diferenca me fondin limit
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 18.03.2019 ora 11.00.....	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë.		9. Operatorët Ekonomike Pjesëmarrës në tender, 2-OE-BOE S’kualifikuar S/ka, Kualifikuar 2-BOE-OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: deri ne 31.12.2019 sipas nevojave te Autoritetit Kontraktor.			
10. Ankimime	11. Data e lidhjes të kontratës:		12. Përgjigje Ankesës nga

AK-s'ka APP-s'ka KPP-s'ka	Nr. 478/9 prot., datë 03.04.2019	APP, AK apo KKP: AK
---------------------------------	----------------------------------	---------------------

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me procesin e zbatimit të kontratës.

Nuk është i mbështetur në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 27, pika 3 “Kontratat e mallrave”.

1. Hartimi i fondit limit

Me urdhër nr.478/1, datë 12.02.2019 është krijuar komisioni për hartimit e specifikimeve teknike dhe fondit limit me anëtar, B.S ,J.J ,L.O .

“Procedure e Hapur me REF.-09719-02-20-2019”- “Blerje Bitumi

Me urdhër nr.448/2 datë 12.02.2019 është krijuar Njësia e Prokurimit me anëtarë komisioni, M.M., E.K., B.S.

Me urdhër nr.472/4 prot., datë 20/02/2019 është vendosur krijimi i Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me anëtarë, L.Ç Kryetare, F.A Anëtar, M.N Anëtar.

Fondi Limit për blerje bitumi është percaktuar bazuar në vlerësimin e komisionit për hartimit e specifikimeve teknike është llogaritur në vlerën 38,333,333 lekë pa Tvsh.

2. Hartimi i kriterëve

Kriteret për procedurën e mësipërme janë në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Vlerësimi i Ofertave

Data e hapjes së tenderit është 18.03.2019 ora 11.00,dhe kanë marrë pjese në tender

Operatorët Ekonomike pjesëmarrës si vijon ,

1.OE ”T” Sh.a. me nipt L...J me ofertë ekonomike 37%

2.OE “R ”Sh.a.

Nipt L ... V ofertë ekonomike 35% .

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave rezulton si vijon:

Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në tender si vijon,

1.OE ”T” Sh.a. me nipt L...J me ofertë ekonomike 37%.

2.OE “R” Sh.a. Nipt L ...3 V ofertë ekonomike 35%.

b) S’kualifikuar S/ka

ç) Kualifikuar:

1. OE ”T” Sh.a. me nipt L...J me ofertë ekonomike 37

2.OE “R” Sh.a. Nipt L ... V ofertë ekonomike 35% .

Marzhi i fitimit 35%, rezulton si oferta me marzhin më të ulët të fitimit.

Konkluzioni: Nga auditimi, rezulton se vlerësimi nga KVO i ofertës fituese është i drejtë, pasi plotësohen kriteret e kërkuara në DT.

Zbatimi i Kontrates

Nga verifikimi i fletëdaljeve mujore për asfalto-betonin për muajin Shkurt 2019, rezultoi se sasia e asfalto betonit të prodhuar është 997 tonë dhe nga verifikimi i fletëdaljeve të çdo dite rezultoi në total një shumë prej 1002 tonë. Kjo mospërputhje është si rezultat i korigjimeve në fletedaljet (pasi numri i korigjuar nuk përcaktohet sakte). Nga kontrolli i fletë hyrjeve rezultoi në total prej 993 tone nga 997 tone dalje në total në muajin shkurt 2019.

Mallrat e blera kanë kaluar nga furnitori duke u bërë hyrje në magazinë pa pasur një hallkë kontrolli mbi sasinë, llojin dhe cilësinë e kërkuar sipas kërkesave së procedurës e prokuruar.

Kriteret: Moszbatimi I UMF 30 datë 27.11.20212 ku qartësisht citohet se: *“Titullari i njesise miraton urdherin per ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqëruar. Komisioni të përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision të bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi material”.*

Veprimet që kryejnë strukturat e Nepunësit Zbatues:

52. *Strukturat e Nepunësit Zbatues para marrjes në dorëzim të dokumentave nga personat me përgjegjësi materiale, kryejnë kontrollin paraprak të tyre. Ky kontroll përfshin kontrollin e rregullshmërisë së jashtme, kontrollin nga pikpamja e zbatimit të ligjshmërisë dhe kontrollin e saktësisë së veprimeve aritmetike.*

53. *Kontrollohet numri rendor i dokumentit, si për flete hyrje dhe flete dalje, të cilat duhet të ndjekin rendin kronologjik dhe të mos kenë kapërcim numri, të ketë adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli. Kur konstatohet kapërcim i numrit rendor apo data jo kronologjike, nënpunësi zbatues mban procesverbal me personat me përgjegjësi materiale, dokumenton dhe sinjalizon cdo parregullsi.*

54. *Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë nëse flete hyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletë hyrje origjinale, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj.*

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr. 27 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se:

1. Njësia e Prokurimit e ka vendosur këtë kriter në përputhje të plotë me nenin 46 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 27 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke vlerësuar natyrën dhe vlerën e konsiderueshme të kontratës që do të prokurohet.

Së pari, kur është zhvilluar kjo procedurë prokurimi fabrika për prodhimin e asfaltit dhe depozita për bitumin në funksion të kësaj fabrike ndodheshin në fund të rrugës “5 maji”, instaluar aty që rreth viteve 1960 (Sot ky vend nuk ekziston pasi janë ndërtuar pallate). Vendi ku futej boti dhe shkarkonte bitumin

në depozitë ka qenë i tillë që nuk lejonte mundësinë e aksesimit nga një autobot me kapacitet më të madh se 20.000 litra pasi shkarkimi bëhej me nivel që do të thotë shkarkohej me vetërrjedhje duke u pozicionuar autoboti në një vend më të ngritur. Si rrjedhim, duke u nisur nga eksperiencia shumëvjeçare furnizimi me autobot më të madh ka dështuar. Në këto kushte, për të mos çuar në dështimin e furnizimit, humbjen e kohës dhe gjithashtu uljen e kostove të panevojshme për operatorin ekonomik është vendosur një kapacitet maksimal i lejuar prej 20.000 litrash.

Së treti, autobotet me kapacitet deri në 20.000 litra klasifikohen tek autobotet më të përhapura dhe me përdorim më të gjerë në fushën e furnizimit me bitum për vetë madhësinë e tyre duke ofruar komoditet dhe lehtësi në qarkullim brenda qytetit të Tiranës.

Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

Për sa më lart gjykojmë se ky kriter është plotësisht i argumentuar dhe nuk është përjashtues.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga njësia e prokurimit **znj.M.M, z.E.K, z.A.A.**

1. Në lidhje me kriterin e vendosur për kërkesën për autobot me kapacitet 20,000 litra referuar observacionit të Autoritetit Kontraktor kjo kërkesë është e argumentuar dhe si i tillë **merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

4. Procedura e Prokurimit me objekt: “Blerje Inerte”

Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur” REF.—37347-09-26-2019”- Urdhri nr.2760 prot., datë 25.09.2029	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit	2 Njësia e Prokurimit 1. M.M 2.E.K 3.I.B	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr 2760/1 prot., datë 25.09.2019. 1. .F.A Kryetar 2. .V.K Anetar 3. .M.N Anetar
4. Fondi Limit (pa tvsh) 44,027,500 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: “SH” Shpk me NUIS K...N me oferte 36,136,600 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 7,890,900 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 21.10.2019 ora 10.00.....	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Tiranë.		9. Operatorët Ekonomike Pjesëmarrës në tender, 8-BOE-OE S’kualifikuar 5-BOE-OE Kualifikuar 3-BOE-OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: Nga nënshkrimi i kontrates deri në datë 31.12.2019 sipas nevojave të kërkesave të Autoritetit Kombëtar.			
10.Ankimime AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka;	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 2760/9 prot., datë 10.12.2019		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me hartimit të specifikimeve teknike, përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe zbatimin e kontratës.

Nuk është ngritur Komisioni i Përcaktimit të Fondit Limit

Për procedurën e mësipërme nuk është argumentuar fondi limit. Hartimi i fondit limit është bërë në kundërshtim me nenin 59 të VKM 914 datë 29.12.2014.

Hartimi i kriteve nga NjP me VKM nr.914 date 29.12.2014 nenin 61“Çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me përmasat e kontratës si dhe të shmangë cdo kriter të vecantë apo kërkesë diskriminuese.

Nuk është zbatuar ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 85, pika 2. Referuar kesaj dispozite dita e diele është ditë pushimi.

Në kundërshtim me kriteret e vendosura dhe në DST nuk janë të verifikuar, inspektuar dhe testuar mallrat e marra ne dorëzim në zbatim VKM nr.914 date 29.12.2014 nenin 77 dhe të nenit 16 në zbatim të kontratës nr.2760/6 date 26.04.2019.

Hartimi i kriterëve

1. Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

a) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk mund t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre.

Vlerësimi i ofertave

Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në tender si vijon ,

1. Operatori ekonomik “A” shpk me NUIS K...A, me oferte **0** (zero).
2. Operatori ekonomik “A” shpk me NUIS K...D, me ofertë **27.618.000** (njëzetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik “B” shpk me NUIS K...N, me ofertë **41.727.700** (dyzetë e një milion e shtatëqind e njëzetë e shtatë mijë e shtatëqindë) lekë pa tvsh.
4. Operatori ekonomik “E” shpk me NUIS K...H, me ofertë **30.999.984** (tridhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.
5. Bashkimi i operatorëve ekonomik “K” shpk me NUIS K...C dhe “A” shpk me NUIS L...T, me ofertë **41.866.250** (dyzetë e një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqindë e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.
6. Operatori ekonomik “L” sha me NUIS K...Ë, e me ofertë **43.025.500** (dyzetë e tre milion e njëzetë e pesë mijë e pesëqindë) lekë pa tvsh.

7. Operatori ekonomik "S" shpk me NUIS K...J, me ofertë **37.638.800** (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqindë e tridhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë pa tvsh.
 8. Operatori ekonomik "SH" shpk me NUIS K...N, me ofertë **36.136.600** (tridhjetë e gjashtë milion e njëqindë e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh.
- Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 8 OE-BOE.

Janë s'kualifikuar 5 OE/BOE dhe konkretisht:

1. Operatori ekonomik "A", pasi nuk përmbush asnjë pikë të kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e këtyre pikave.
2. Operatori ekonomik "A" shpk, pasi
 - Nuk përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit pasi nuk ka paraqitur deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme (Shtojca 8).
 - Nuk përmbush pikën 1/b, ç, d, dh, e, të kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;
 - ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
 - Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
 - dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;
 - Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.
 - Nuk përmbush pikën 2.2.1 dhe 2.2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar ku është parashikuar se "Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - 1. Kopje të certifikuara të pasqyrave financiare të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2016,2017,2018), të konfirmuara nga Dega e Tatim Taksave si dhe të shoqëruara me Raportin e Auditimit Ligjor, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.
 - Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2016, 2017, 2018) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit, perkatesisht: 17.611.000 (shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH." pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e këtyre pikave.
 - Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se "Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerën prej jo më pak se 40% e fondit limit të vënë në dispozicion përkatësisht: 17.611.000 (shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
 - Këto furnizime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - o Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate dhe faturat me tvsh.
 - OSE

○ Kur furnizim i ngjashëm është realizuar me subjekte private “Operatori ekonomik do ta vertetojë këtë shërbim duke paraqitur fatura tatimore shitje, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara” pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

- Nuk përmbush pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se "Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për realizimin e kontratës, për të cilin duhet të paraqesi kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezën e punës, si dhe të figurojë në listëpagesën e shoqërisë si mëposhtë: 1 (një) inxhinier ndërtimi" pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

- Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se "Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) shoferë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë" pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

- Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se "Operatori ekonomik duhet të paraqesi fletë analizë/raport testimi për mallrat objekt prokurimi, të lëshuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hapjes së ofertave, të lëshuar nga një laborator i çertifikuar nga organet kompetente të Shtetit Shqiptar" pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

- Nuk përmbush pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se "Operatori ekonomik duhet të ketë impiant prodhimi dhe përpunimi të inerteve në pronësi/me qera ose Kontratë Furnizimi për mallrat objekt prokurimi, të lidhur para noterit, me afat deri në përfundimin e kontratës. Për impiantin duhet të paraqitet Leje Mjedisore tipi B (Kodi III.1.B) në përputhje me objektin e prokurimit, të vlefshme deri në realizimin e kontratës" pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

- Nuk përmbush pikën 2.3.9 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se "Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018. (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën e sipërcituar)" pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

- Nuk përmbush pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se "Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori ku merr përsipër në çdo kohë furnizimin e Autoritetit Kontraktor në të gjithë ditët e javës, në vendin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor" pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

- Nuk përmbush pikën 2.3.11 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se "Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Mjetet Sasia	Gjendja
Kamion me kapacitet mbajtës minimumi 14 t	5 copë Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtës 1.5 - 2 t	2 copë Pronësi ose me qera
Kamion me vinq	1 copë Pronësi ose me qera

○ Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).

○ Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

○ Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

○ Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese)" pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

1. Operatori ekonomik “**B**” shpk me NUIS K...N.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se "*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) shoferë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë"*, pasi OE ka paraqitur leje drejtimi për mjete të rënda vetëm për dy shoferë (S.Hdhe M.H) ndërsa 3 të tjerët kanë leje drejtimi vetëm për eskavator, manovrator dhe buldozer.

2. Nuk përmbush pikën 2.3.11 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se "*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.*

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion me kapacitet mbajtës minimumi 14 t	5 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtës 1.5 - 2 t	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç	1 copë	Pronësi ose me qera

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese)." pasi nuk ka paraqitur 2 kamionë me kapacitet mbajtës 1.5 t - 2 t.*

2.Operatori ekonomik "E" shpk me NUIS K...H.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Nuk përmbush pikën 1/e të kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku është parashikuar se *"Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri."*, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

2.Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se *"Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerën prej jo më pak se 40% e fondit limit të vënë në dispozicion përkatësisht: 17.611.000 (shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.*

Këto furnizime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a.*Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate dhe faturat me tvsh.*

OSE

b.*Kur furnizim i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur fatura tatimore shitje, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara." pasi vlera e furnizimeve të ngjashme të paraqitura nga OE është më vogël se 40% e fondit limit të vënë në dispozicion dhe përkatësisht më e vogël se 17.611.000 (shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.*

3.Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se *"Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) shoferë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë."*, pasi OE ka paraqitur leje drejtimi për mjete të rënda vetëm për dy shoferë (A.L dhe E.O) ndërsa 4 të tjerët kanë leje drejtimi vetëm për eskavator.

4.Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se *"Operatori ekonomik duhet të paraqesi fletë analizë/raport testimi për mallrat objekt prokurimi, të lëshuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hapjes së ofertave, të lëshuar nga një laborator i certifikuar nga organet kompetente të Shtetit Shqiptar"* pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

5.Nuk përmbush pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori ku merr përsipër në çdo kohë*

furnizimin e Autoritetit Kontraktor në të gjithë ditët e javës, në vendin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor" pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

6. Nuk përmbush pikën 2.3.11 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se "Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion me kapacitet mbajtës minimumi 14 t	5 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtës 1.5 - 2 t	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç	1 copë	Pronësi ose me qera

a. _____ P

ër mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).

b. _____
Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c. _____
Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

e. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese)." pasi ka paraqitur 4 kamion me kapacitet mbajtës minimumi 14 t nga 5 të kërkuar dhe nuk ka paraqitur 2 kamionë me kapacitet mbajtës 1.5 t - 2 t.

3. Operatori ekonomik "L" sha me NUIS K...Ë.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se "Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) shoferë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë", pasi OE ka paraqitur leje drejtimi për mjete të rënda vetëm për tre shoferë (F.S., A.V. dhe N.N.) ndërsa 2 të tjerët kanë leje drejtimi vetëm për buldozerist dhe automakinist.

Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se "Operatori ekonomik duhet të paraqesi fletë analizë/raport testimi për mallrat objekt prokurimi, të lëshuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hapjes së ofertave, të lëshuar nga një laborator i çertifikuar nga organet kompetente të Shtetit Shqiptar."

Nga auditimi rezultoi se OE/BOE e skualifikuar, nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT dhe janë skualifikuar me të drejtë.

Është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "SH" me vlerë 36,136,600 lekë pa tvsh, i cili nga auditimi rezultoi të ketë plotësuar kriteret e përcaktuara në DT.

Zbatimi i Kontratës.

Për marrjen në dorëzim të mallrave në zbatim të kontratës Nr. 2760/8 prot. datë 26.11.2019 me objekt "Blerje Inerte" është ngritur komisioni i përbërë nga

1. J.J.
2. H.G.
3. E.B.
4. S.L.

2. Nga shqyrtimi dokumentacionit rezulton se në procesin e dorëzimit inerteve në magazinë nuk bëhej kontrolli teknik i inerteve, konform detyrimit ligjor të kontratës nr. 560/15 datë 23.04.2019 të lidhur midis Autoritetit Kontraktues dhe OE "SH" Shpk, *neni 16 te saj si vijon: Verifikimi dhe Pranimi i Mallrave.*

16.1 *Përpara pranimit, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të verifikojë, inspektojë dhe testojë Mallrat. Këto veprime duhet të kryhen menjëherë pas dorëzimit të Mallrave. Kontraktuesi ka të drejtë të marrë pjesë në këtë proces dhe të shqyrtojë raportet përkatëse të prërgatitura nga Autoriteti Kontraktor ose agjentët e tij.*

16.2 *Autoriteti Kontraktor pranon ose refuzon Mallrat menjëherë pas dorëzimit duke njoftuar me shkrim Kontraktuesin në lidhje me vendimin e tij për të pranuar ose refuzuar.*

2-Për sasinë e inerteve të dorëzuara Autoriteti Kontraktor nuk disponon matës mekanik/elektronike për tu siguruar për sasinë e materialeve të dorëzuara.

Nga shqyrtimi dokumentacionit rezulton se në procesin e dorëzimit inerteve në magazinë nuk bëhej kontrolli teknik i inerteve për të bërë diferencimin pasi furnizohet me dy lloj granili me cmime të ndryshme, bazuar kjo në detyrimin ligjor ndaj kontratës nr.560/15 datë 23.04.2019 të lidhur midis Autoritetit Kontraktues dhe OE "SH" Shpk lidhur midis palëve neni 16 te saj si vijon;

Në kundërshtim me kriteret e vendosura dhe në DST nuk janë të verifikuar, inspektuar dhe testuar mallrat e marra në dorëzim bazuar dhe në zbatim të VKM nr.914 date 29.12.2014 nenin 77 dhe të nenit 16 të kontratës nr.2760/6 date 26.04.2019.

Kontrata me nr.2760/6 date 26.04.2019 me objekt "Blerje inerte" e lidhur midis Drejtorise Përgjithshme Nr.2 e Punetoreve të Qytetit dhe Shoqërisë perfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.K dhe "SH" shpk me NUIS K ... N përfaqësuar nga z.D.O nuk është nënshkruar cdo faqe të kontratës vetëm në faqen e fundit nga palët e kësaj kontrate.

Në kundërshtim me kriteret e vendosura dhe në DST nuk janë të verifikuar, inspektuar dhe testuar mallrat e marra në dorëzim në zbatim të nenin 16 te kontratës.

Mallrat e blera kanë kaluar nga furnitori duke u bërë hyrje në magazinë pa pasur një hallkë kontrolli mbi sasinë, llojin dhe cilësinë e kërkuar sipas kërkesave së procedurës e prokuruar.

Kriteret: Moszbatimi I UMF 30 datë 27.11.20212 ku qartësisht citohet se: *"Titullari i njesise miraton urdherin per ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqëruar. Komisioni të*

përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision të bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi material”.

- Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr. 28 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se:

1.Procedura e prokurimit me REF-37347-09-26-2019 e audituar nga ana juaj është procedure e rishpallur. Procedura e mëparshme me numër njoftimi CN/01098/09242019 është procedurë e anuluar. Procedura e anuluar ka filluar me kërkesën për nisje procedure nga Sektori i Transportit me Nr. 2354 Prot., datë 13.08.2019, vijon me urdhërin për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike , llogaritjen e fondit limit dhe grafikut të lëvrimit me Nr. 2354/1 Prot., datë 13.08.2019 si dhe me procesverbalin e hartuar nga ky komision me Nr. 2354/2 Prot., datë 16.09.2019 (Bashkëlidhur do të gjeni dokumentacionin e sipërcituar). Kjo është arsyeja që procedura e re ka filluar me urdhrin e prokurimit.

Në këto kushte, nuk kemi të bëjmë me mungesë të urdhërit për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe grafikut të lëvrimit apo të procesverbalit të hartuar nga ky komision.

2.Kriteri i vendosur për tonazhin e kamionëve me kapacitet mbajtës minimumi 14 ton është kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kërkesë është në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit si dhe me përmasat e kontratës, pasi Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish - komunave, pra zonat rurale. Është parashikuar që dorëzimi i mallit, përveç se në magazinë e AK-së, të bëhet edhe direkt në kantieret e punimeve brenda territorit të Bashkisë Tiranë sipas kërkesës dhe nevojës së AK-së. Këto mjete janë parashikuar për transport në kantiere si në zonat rurale, brenda qytetit apo edhe në magazinë. Për arsye teknike dhe organizative minimumi i tonazhit të kërkuar është tonazhi më i përshtatshëm për të plotësuar nevojat e AK-së në sasi të konsiderueshme si p.sh çakull për rrugë rurale, gurë kave për mbrojtje lumore etj në zonat rurale apo edhe furnizim në magazinë, duke ulur jo vetëm kostot e operatorit ekonomik por edhe për të shmangur vonesa në kryerjen e furnizimit në dëm të AK-së.

3.Në vendosjen e kriterit të disponueshmërisë së OE në çdo ditë të javës, janë marrë parasysht eksperiencat e AK-së me situatat e emergjencës (DPN2 si drejtori shërbimesh është drejtorja kryesore e Bashkisë që reagon në mënyrë të menjëhershme për çdo situatë emergjence natyrore për shkak të mjeteve që disponon dhe numrit e stafit të kualifikuar), ku kërkohet një përgjigje e shpejtë që duhet treguar ndaj këtyre situatave që mund të çojnë në nevojën për inerte në të gjitha ditët e javës, qofshin ditë pushimi javore apo ditë festash zyrtare.

Disa situata të tilla renditen si mëposhtë vijon:

- Shembje kolektori dhe zgarave në rrugë
- Dalja e Lanës nga shtrati ka sjellë nevojën për ngritjen e pengesave me gurë për mbrojtjen e shtëpive si psh në rastin e shtëpive në pjesën poshtë “Pallatit me shigjeta”.
- Çarja e rrugëve rurale
- Dëmtimi i mbrojtjes lumore nga vërshimet e shumta

- Problematika me digat e rezervuarëve dhe portat e shkarkimit etj.

4. Në kriterin e vendosur për mundësinë e marrjes me qera të mjeteve që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, ku në kontratën noteriale duhet të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, Njësia e Prokurimit sqaron se nuk ka qenë qëllimi për specifikimin e objektit të prokurimit ose të tenderit në kontratë. Nëse do të ishte ky qëllimi do të ishte parashikuar të specifikohet objekti i tenderit apo i procedurës së prokurimit.

Megjithatë duke e parë në këndvështrimin e auditit, njësia arsyeton se duke u nisur nga rëndësia e veçantë që ka për AK-në dhe vlera e konsiderueshme e fondit limit nuk do ishte e tepruar parashikimi i objektit të tenderit të kontratës. Kjo kërkesë është e justifikuar pasi AK kërkon siguri dhe garanci se mjetet nuk do të jenë të angazhuara në kontrata apo punëmarrje të tjera dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti duke mos sjellë vonesa në kryerjen e punës dhe si pasojë mosrealizimin e objektivave të AK-së.

Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

Për sa më lart gjykojmë se ky kriter është plotësisht i argumentuar dhe nuk është përjashtues.

5. Lidhur me zbatimin e kontratës, komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim të mallit përbëhet nga specialistë të fushës (profil inxhinierik) me përvojë shumëvjeçare. Çdo lëvrimit malli përpara se të merrej në dorëzim dhe të bëhet hyrje në magazinë, verifikohet në lidhje me sasinë, llojin dhe cilësinë e tij në prezencë të OE dhe më pas ky komision ka mbajtur procesverbalin e marrjes në dorëzim sipas parashikimeve ligjore. Duke qenë se njësia matëse për inertet e kërkuara në DST është me m3, edhe verifikimi e matja e tyre është bërë sipas metro kubëve të transportuara me kamionë nga OE duke iu referuar pikërisht madhësisë së kamionit me kazanë të standartizuar për sa i përket volumeve të tyre. Në këto kushte nuk ka lindur nevoja për disponimin e ndonjë matësi mekanik/elektronik për këtë qëllim. Ndërsa për sa i përket diferencimit të granilit nga 1 në 2, komisioni e ka bërë verifikimin lehtësisht pasi madhësia (granulometria) e kokrrës dallohet menjëherë me sy të lirë nga specialistët e fushës me eksperiencë shumëvjeçare, pjesë e komisionit të marrjes në dorëzim.

6. Për sa i përket kontratës së furnizimit me inerte me Nr.2760/6 prot, date 26.11.2019 po Ju bashkëlidhim një kopje të kësaj kontrate të mbajtur nga Zyra e Protokollit, të firmosur dhe vulosur në çdo faqe nga të dyja palët, titullari i AK-së dhe administratori i OE fitues.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrëqimit Publik nga njësia e prokurimit **znj.M.M, z.E.K, z.I.B** dhe komisioni i marrjes në dorëzim **z.J.J, z.H.G, z.S.L, z.E.B.**

1. Autoriteti Kontraktor sipas observacionit të mësipërm ka paraqitur dokumentacionin justifikues në lidhje me urdhrin për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe grafikut të levrimit dhe dhe si i tillë **merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktor për 5 kamion me kapacitet mbajtës minimumi 14 ton, referuar dhe sasisë të inerteve të cilat do të dorëzohen nga operatori fitues në magazinës e Autoriteti Kontraktor dhe në kantiere është kriter i argumentuar dhe si i tillë **merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

3. Kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktor për furnizimin e Autoritetit Kontraktor në të gjithë ditët e javës, është kriter i argumentuar dhe si i tillë **merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

4. Në lidhje me pikën 2.3.9. sipas DST-ve ,dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Për mjetet

e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t'u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikimin e tyre. Pika e mësipërme është trajtuar në Akt Konstatimin Nr.28, datë 21.03.2024 dhe nga subjekti i audituar nuk janë sjellë argumenta shtesë për argumentimin e kësaj kërkesë në DST dhe si i tillë **nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit**

5.Lidhur me zbatimin e kontratës për marrjen e mallrave në dorëzim,grupi i auditimit citon se për mallrat që merren në dorëzim në magazinën e institucionit duhet të disponohet 1 peshore elektronike në mënyrë që mjeti të peshohet me ngarkesë dhe pa ngarkesë për të kuptuar sasinë e mallrave të dorëzuar.Sasia e mallrave nuk mund të matet më sy nga specialistët e fushës si i tillë **nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

6. Është paraqitur kontrata e furnizimit me inerte me Nr.2760/6 prot, date 26.11.2019, efirmosur dhe vulosur në çdo faqe nga të dyja palët, titullari i AK-së dhe administratori i OE fitues

5. Procedura e Prokurimit me objekt: “Zgara Puseta”

Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedure e hapur ” REF.- REF-18759-04-18-2019 Urdhri nr.272/1/1 prot., datë 05/03/2019	Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr.272/1/1 prot., datë 05/03/2019 1.H.XH 2.I.M 3.J.P	Njësia e Prokurimit Me urdhër nr.722/3 datë 18.04.2019 1.M.M 2. E.K 3.H.XH	Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.722/4 prot., datë 18.04.2019. 1..L.C Kryetare 2. .F.A Anëtar 3..M.N Anëtare
4. Fondi Limit (pa tvsh) 24,579,300 Leke	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: OE “M” Sh.p.k.me vlerë 24,341,900 lekë		6. Diferenca me fondin limit 23,740 leke.
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 13/05/2019, Ora 10:00	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë		Pjesëmarrës në tender 3-OE-BOE b) S'kualifikuar 2- BOE-OE. c) Kualifikuar 1.BOE-OE.
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës			
10.Ankimime	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 478/9 prot., datë 03.04.2019		12.Përgjigje Ankesës nga

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosur kriterë të paargumentuara e të pambështetura në LPP, konkretisht:

Kriteri i vendosur për detyrimin operatorit ekonomik për një kamion vinç 10 Tone nuk është i mbështetur në specifikimet teknike dhe grafiku i punimeve nuk janë të argumentuara nga komisioni për përgatitjen e tij

Nuk është i mbështetur në VKM nr.914 date 29.12.2014 ne 61 i saj “Cdo kriter vecante duhet të jetë në përputhje me përmasat e kontratës si dhe të shmangë cdo kriter te vecantë apo kërkesë që lidhet me skualifikimin e operatorëve ekonomik dhe përbën diskriminim.

1. Hartimi i fondit limit

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur komisioni paraprak me urdhrin nr. 722/1, datë 05.03.2019 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit”, i përbërë nga:

1. H.XH.
2. I.M.
3. J.P.

Sipas procesverbalit nr.722/1 të datës 14/04/2019, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e studimit të tregut, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, ka studiuar ofertat e tregut nga 3 OE të ndryshëm Shoqëria “M” sh.p.k., “A” sh.p.k. , “M” sh.p.k. duke përllogaritur si fond limit vlerën mesatare të këtyre të fundit e cila rezulton të jetë 24,579,300 lekë pa tvsh.

Përllogaritja e fondit limit është konform akteve ligjore dhe nënligjore.

2.Hartimi i kritereve

Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision me datë 14.04.2019 “Për krijimin e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike”, i përbërë prej, H.XH, I.M, J.P. Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 722/2 datë 14.04.2019 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Me urdher nr.722/3 date 18.04.2019 është krijuar njësia e prokurimit e përberë nga M.M, E.K, H.XH.

Nga kontrolli në lidhje me argumentimin dhe hartimin e kritereve rezultoi si vijon; Kriteri i vendosur për detyrimin operatorit ekonomik për një kamion vinc 10 Tone nuk është i argumentuar teknikisht.

3.Vlerësimi i Ofertave

Me urdhër nr.722/4 datë 18.04.2019 është krijuar Komisioni i Vlerësimit Ofertave i përbërë nga, L.C Kryetare, F.A Anëtar, M.N Anëtare.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit me REF-18790-04-18-2019, “Zgara Puseta”, në data 13/05/2019, Ora 11:00.

Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, si më poshtë:

1. Shoqëria “A” shpk me NUIS L...Q dhe me vlerë 24.543.500 (njëzetë e katër milion e pesëqind e dyzetë e tre mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.
2. Shoqëria “M” shpk me NUIS L...N dhe me vlerë 24.341.900 (njëzetë e katër milion e treqind e dyzetë e një mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH.
3. Shoqëria “V” shpk me NUIS L...I dhe me vlerë 0 lekë.

KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	“M” Sh.p.k.		Kualifikuar

2	“A” Sh.p.k.	S’kualifikuar
3	“V” Sh.p.k.	S’kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës nr.722/6 më datë 27.05.2019 në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.

Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 3 OE-BOE operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 2-OE, janë kualifikuar 1-OE.

Konkluzioni: Nga auditimi, u konstatua se OE fituese “M” Sh.p.k.i plotëson kriteret e DT.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr. 29 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se:

1.Kriteri i vendosur për tonazhin e kamionit me vinç me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton është kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kërkesë është në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit si dhe me përmasat e kontratës. Kemi të bëjmë me zgara gize që kanë peshë të konsiderueshme dhe një kamion me peshëmbajtje të tillë klasifikohet tek kamionët mesatar që gjenden rëndom në qarkullim dhe pikërisht furnizimi me të do të ulte jo vetëm kostot e operatorit ekonomik por do të shmangte edhe vonesat në kryerjen e furnizimit për të dyja palët.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga njësia e prokurimit **znj.M.M, z.E.K, z.H.XH.**

1.Pretendimi i subjektit në lidhje me kriterin e vendosur nga Autoriteti Kontraktor për 1 kamion me vinç me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton, nuk është i argumentuar teknikisht dhe **si i tillë nuk merret në konsideratë dhe do të qëndrojë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

6. “Ndërtimi i urës ne rrugën Kocaj- Veski , Baldushk”

Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedure e hapur” REF-24163-05-28-2019 Loti I;REF- 24166-05-28-2019 Loti II;REF-24169-05-28-2019 Urdhri nr.1545/1 prot.,datë 27/05/2019	Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Realizuar “I” Sh.p.k. Realizuaer nga projektuesi Ing.A.SH. Miratuar nga Këshilli Teknik vendim nr.5/9 datë 13.03.2019.	Njësia e Prokurimit Me urdher nr.1545/1 date 18.04.2019 1.M.M 2. V.K 3. R.S	Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.1545/2 prot., datë 27.05.2019. 1.L.C Kryetare 2..S.GJ Anëtar 3..M.N Anëtare
4. Fondi Limit (pa tvsh) 30,933.482 Leke pa Tvsh. Loti I ;18,249.229 leke pa tvsh. Loti II ;11,715.137 leke pa tvsh.	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: BOE “V ”Sh.p.k & “RR” Sh.p.k.me vlerë 16,095,665.8 leke pa tvsh.		4. Diferenca me fondin limit

7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 28.06.2019, Ora 10;00	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë	Pjesëmarrës në tender Loti I 4-OE-BOE b) S'kualifikuar 3 BOE-OE c) Kualifikuar 1 BOE-OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: Loti I ;6 (gjashtë) muaj kalendarike nga nënshkrimi i kontratës Loti II ; 2(dy)muaj kalendarike nga nënshkrimi i kontrates		
10.Ankimime	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 1545/11 prot., datë 06.08.2019	12.Përgjigje Ankesës nga

Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me hartimin e kriterëve të procedurave të prokurimit.

1. Hartimi i fondit limit

Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit ka rezultuar:

Kjo procedurë “E Hapur, “Ndërtimi mirëmbajtje urash”, me vlerë lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 e Punëtoreve të Qytetit Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale .

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Me shkresën nr.1545 datë 16.05 2019 të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 e Punëtoreve të Qytetit Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale bazuar në shkresën nr. 1522 prot.datë 16.05,2019 te Drejtorisë së Përgjithshme te Punëve Publike ka bërë kërkesë për nisjen e procedurave për projektin “Ndertimi i urës në rrugën Kocaj-Veski , Baldushk.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga shoqëria projektuese “I “ sh.p.k.dhe miratuar Keshilli Teknik nëpërmjet Vendimit me nr.7/6 datë 03.04.2019 bashkalidhur projekti, preventivat, raporti teknik, specifikimet teknike, grafiku i punimeve realizuar nga projektuesi Ing. A.SH me nr. License K-0829/1 dhe miratuar nga Këshilli Teknik nëpërmjet vendmit me nr.5/9 datë 13.03.2019.. Grupi i punës ka përcaktuar fondin limit në vlerën 18,249,229 lekë pa Tvsh.

2.Hartimi i kriterëve

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton se janë argumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 27.05.2019, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjrisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit

Me shkresën nr.1545/1 date 27.05.2019 te Drejtorise Pergjithshme te Punetoreve te Qytetit per proceduren e prokurimit, Loti I ‘Ndertimi i ures rruges Kocaj-Veske , Baldushk”eshte miratuar njesia e prokurimit e perberë nga:

1. M.M.

2. V.K.
3. R.S.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

1. Një punësim mesatar i të paktën 50 (pesëdhjetë) personave, për periudhën Dhjetor 2018 - Maj 2019.
2. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007. (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS).
3. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë PASS 99-2012. (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën PASS).
4. Kriteri i vendosur për operatorin ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku (i vlefshëm), diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë, 1 (një) mjek i përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm bazuar në ndryshimet e fundit ligjore nuk është e legjitimuar.

Në lidhje me numrin e punonjësve, kriteri I vendosur nuk është në përputhje me pikën 8 germa (b) të nenit 26 dhe 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar . *Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhën kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës, OE të disponojë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha më të hershme.*

Nga verifikimi i kritereve të specifikimeve teknike rezulton se nevoja për një punësim mesatar i të paktën 50 (pesëdhjetë) personave, për periudhën Dhjetor 2018 - Maj 2019 është jo i bazuar në preventivin dhe grafikun e punimeve

Kriteret bazuar në pikat 14 dhe 15 si vijon;

14. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007. (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS).

15. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë PASS 99-2012. (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën PASS , *nuk duhet pasi duhet të paraqiten nga nje OE kur BOE është fitues.*

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim mirëmbajtje urash”, me fond limit 29,964,366 ,lekë pa tvsh i ndarë në 2 lote:

Loti 1 “Ndërtimi i urës në rrugën Kocaj-Veski, Baldushk”, me REF-24166-05-28-2019, me fond limit 18.249.229 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e dyzetë e nëntë mijë e dyqind e njëzetë e nëntë) lekë pa tvsh.

Loti 2 “Rikonstruksoni i urës së fshatit Vilëz Zall Bastar”, me REF-24169-05-28-2019, me fond limit 11.715.137 (njëmbëdhjetë milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, ndryshon nga data 28.06.2019, ora 10:00, përcaktuar në dokumentet e tenderit, në datë 04.07.2019, ora 10:00 dhe hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al.

Nga verifikimi i formularëve të deklaratimit të njësisë së prokurimeve rezulton se emrat e anëtareve të njësisë së prokurimit me vendimin nr 1545/1 date 27.05.2019 rezulton se emrat në vendimin e caktimit të anëtareve të komisionit janë jo të njëjtë me ato të vetëdeklarimeve.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST rezulton:

Kapaciteti teknik, nuk është në përputhje me nenin 20 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteri për një Autovinc 20 tone nuk mbështetur nga argumentimi i punimeve në specifikimet teknike në pikat 5,6 -5,9 dhe nga grafiku i punimeve të argumentuara nga komisioni për përgatitjen e tij.

Autovinç mbi 20 ton 1 copë Pronësi ose me qera

Rimorkiator me kapacitet 20 ton 1 copë Pronësi ose me qera

Kriteri i vendosur për operatorin ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku (i vlefshëm), diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë, 1 (një) mjek i përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm bazuar në ndryshimet e fundit ligjore nuk është e legjitimuar.

- Kriteri i vendosur për detyrimin operatorit ekonomik për të punësuar 1 (një) punonjës teknik ndërtimi, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme; diplomë përkatëse, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik me kategori IV (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit është i pambështetur teknikisht.

- Kriteri për pajisjtë e mëposhtme është i paargumentuar dhe i pabazuar në preventivin e objektit.

- Kaska mbrojtëse minimumi 50 (pesëdhjetë) copë;

-Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 (pesë) copë;

-Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 (pesë) copë;

-Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë;

-Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 (dhjetë) copë.

3. Vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur, Ndërtim mirëmbajtje urash”. Loti I “Ndërtimi i urës në rrugën Kocaj- Veski Baldushk” me fond limit me vlerë 18,249,229 leke. Nisur nga procesverbali i hapjes së ofertave dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertën ekonomike si më poshtë:

Nr.	BOE-OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa TVSH)
1	“K” Shpk	14,598,584.2

2	“SH” Sh.p.k.	15,962,384
3	“V” Sh.p.k & “RR“ Sh.p.k.	16,095,665.8
4	“S” Sh.p.k	16,421,012 lekë

Burimi i të dhënave: SPE dhe DPRrNP

Me procesverbalin e datës 04.07.2019 (dita e hapjes së ofertës), ka skualifikuar 3-OE ka bërë edhe dorëzimin e mostrave të kërkuara në DT.

Në dosje administrohet procesverbali për shqyrtimin e ofertave pa nr. prot, datë 04.07.2019, sipas të cilit, KVO ka vendosur skualifikimin e OE “K” Shpk pjesëmarrës, pasi nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim bazuar në pikat 2.3.7 të kapacitetit teknik të kualifikimit të punonjësve dhe pikën 2.3.16 kapacitetin teknik të mjeteve dhe pajisjeve teknike.

KVO ka vendosur skualifikimin OE-“SH” ShPK pasi nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim bazuar në pikat 2.3.7 të kapacitetit teknik të kualifikimit të punonjësve dhe pikën 2.3.16 kapacitetin teknik të mjeteve dhe pajisjeve teknike

KVO ka vendosur skualifikimin e OE “S” Sh.p.k pasi nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikimin, bazuar ne pikat 2.3.7 të kapacitetit teknik të kualifikimit të punonjësve dhe pikën 2.3.16 kapacitetin teknik të mjeteve dhe pajisjeve teknike.

Nga verifikimi në SPE, rezulton se skualifikimi i BOE të mësipërme është i drejtë pasi nuk plotësojnë kriteret e DT.

KVO ka vendosur kualifikimin e “V” Sh.p.k.dhe “RR” Sh.p.k. pasi ka plotësuar kërkesat për kualifikim dhe pas llogaritjes së ofertës nuk ka gabime aritmetike.

Konkluzioni; Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se OE i shpallur fitues “V” Sh.p.k. dhe “RR“ Sh.p.k, i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT..

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 1545/6, datë 26.07.2019, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.K.

Pas njoftimit të fituesit, me shkresën nr. 1545/19 prot., datë 04.10.2019 është lidhur kontrata me shkresën nr. 1545/10, datë 06.08.2019 me vlerë 19,314.786.96 lekë me TVSh.

Me urdhër nr.1545/14 date 06.08.2019 “të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 te Punëtorëve të Qytetit është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.K urdhri “Për ngritjen e grupit të marrjes në dorëzim të punimeve” me objekt “Ndërtim mirëmbajtje urash” Loti I ;”Ndërtim i urës në rrugën Kocaj-Veski Baldushk” Loti II ;”Rikonstruksioni i urës së fshatit Vilez,Zall Bastar” me përbërje si me poshtë:

V.K, H.G dhe R.S.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr. 30 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se:

1. Certifikatë OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018

Çdo kompani ka detyrimin të mbrojtë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit. ISO 45001 është standardi ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe

sigurisë në punë. Kërkesat e standardit ISO 45001 përfshijnë: vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve. Certifikimi ISO 45001 mund të merret nga çdo kompani, pavarësisht aktivitetit të saj si dhe risqeve të shëndetit dhe sigurisë. Ky certifikim konfirmon angazhimin e shoqërisë për të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur punonjësit e saj dhe të çdo personi tjetër në ambientet e saj.

Për sa u sqarua më lart, çdo operator ekonomik pjesëmarrës në tenderat e punëve duhet të jete i pajisur me këto ISO pavarësisht ndarjes së punëve në % në BOE apo numrit të punetoreve. Ky kriter nuk konsiderohet i përbushur nëse ISO paraqitet vetëm nga njëri prej tyre. Sido që të ndahet % midis OE, secili prej tyre do të kryejë një aktivitet të caktuar që kërkon pjesëmarrjen e punonjësve dhe secili prej tyre duhet të faktoj se plotëson standartin i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë. Theksojmë se kjo është një ndër Isot më bazike që disponohet pothuajse nga pjesa më e madhe e OE.

-PAS 99:2012 Sistemi i Menaxhimit të Integruar

Shoqëritë zbatojnë sisteme menaxhimi që ndjekin kërkesat e disa standardeve (si për shembull ISO 9001, ISO 14001, ISO 45001, etj). Kjo lehtësohet nga aplikimi i një sistemi të integruar të menaxhimit, i cili vjen me një numër përfitimesh në krahasim me zbatimin individual të secilit standard. Disa nga këto përfitime përfshijnë: zvogëlimin e vëllimit të dokumentacionit, administrim më të lehtë ose kostot e ulta të certifikimit. PAS 99 është një dokument që mund të përdoret për të mbështetur integrimin e një sistemi menaxhimi. Ai siguron një strukturë për zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi të integruar të menaxhimit. Certifikimi i PAS 99 konfirmon faktin që shoqëria ka një qasje të saktë ndaj zhvillimit dhe zbatimit të sistemit të saj të menaxhimit të integruar.

Per sa u sqarua më lart, çdo operator ekonomik pjesëmarrës në tender duhet të jete i pajisur me këto ISO pavarësisht ndarjes së punëve në % në BOE dhe ky kriter nuk konsiderohet i përbushur nëse ISO paraqitet vetëm nga njëri prej tyre. Sido që të ndahet % midis OE, secili prej tyre do të kryejë një aktivitet të caktuar, aktivitet i cili duhet të plotësojë kërkesat e një sistemi të integruar të menaxhimit të shoqërisë.

2.Në lidhje me emrat e dy prej anetareve të njesisë së prokurimit në formularët e konfliktit të interesit sqarohet se kemi të bëjmë me një lapsus.

3. Autovinç me kapacitet 20 ton.

Qëllimi kryesor për përdorimin e autovinçit është montimi i trarëve b/a të mbistrukturës së urës.

Bazuar në seksionin tërthor të traut 0.9x0.9 ml dhe të gjatësisë së tij 12.5 ml, pesha e traut betonarme që do të montohet është 8.75 ton.

Në llogaritje duhet të merret parasysh dhe koeficienti dinamik që ndikon në ngarkesë si pasojë e levizjes dhe frenimit të ngarkesës në planin horizontal dhe vertikal (gjatë ngritje-uljes dhe rrotullimit të krahut të vinçit), i cili paracaktohet në vlerat 1.20 – 1.25. Në këto kushte, ngarkesa e llogaritit e traut merret 10.94 ton.

Duke vlerësuar kushtet e terrenit, në të cilin pozicionimi i vinçit për montimin e trarëve nuk mund të kryhet në shtratin e lumit, por mund të realizohet vetëm me pozicionimin në brigjet e lumit, në skajet e urës.

Si pasojë e këtij pozicionimi dhe gjatësinë e elementit b/a, kemi rritjen e rrezes së ngarkesës (largësia e qendrës së rëndesës së traut nga aksi i vinçit) dhe rritjen hapjes së krahut të vinçit, dy karakteristika këto që zvogëlojnë SËL (Safety Work Load) të vinçit të zgjedhur. Për këtë arsye, për ngarkesën e dhënë (rreth 11 ton), për rrezën e ngarkesës (rreth 3-3.5 ml) dhe gjatësinë e krahut të vinçit (rreth 7 ml), bazuar në grafiket dhe diagramat e ngarkesës së disa vinçave me peshëngritje të ndryshme, u zgjedh vinçi me peshëngritje 20 ton.

-Rimorkiator me kapacitet 20 ton.

Është parashikuar që, prodhimi i trarëve b/a të mbistrukturës së urës, të prodhohen në kantiere prodhimi, duke siguruar kështu kontrollin e nevojshëm dhe cilësinë e kërkuar të këtyre elementeve.

Për transportin e elementeve nga kantieri i prodhimit në sheshin e ndërtimit është i domosdoshëm rimorkiatori, i cili, bazuar në peshën e minimalisht 2 trarëve për çdo transport, duhet që mjete të ketë peshëmbajtjen për rreth 20 Ton.

4. Mjeku është kërkuar bazuar në VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” ndryshuar me VKM nr.742, datë 6.11.2003 ku është parashikuar se “2/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.”

5. Bazuar në parashikimin e nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor vendos kërkesa që garantojnë atë se operatorët ekonomikë do të zbatojnë me sukses kontratën. Një ndër kriteret e veçanta në kontratat e punëve është zotërimi i personelit të nevojshëm për të zbatuar kontratën. Njësia e Prokurimit e ka gjykuar të arsyeshme dhe në përpjestim të drejtë kërkesën për teknik ndërtimi si kriter i lidhur ngushtë me natyrën, vlerën e kontratës (fondi limit 30.933.482 lekë pa tvsh, pra mbi kufirin e ulët monetar, procedurë e hapur) dhe rëndësinë e saj (punime në vepra inxhinierike me rëndësi të veçantë siç janë urat dhe mbrojtja lumore).

Gjithashtu duke patur në konsideratë natyrën e kontratës (punë), nevoja e teknikut të ndërtimit si pjesë e personelit të OE është gjykuar thelbësore për shkak të detyrave dhe përgjegjësi që ai ka gjatë zbatimit të punimeve si mëposhtë vijon:

- Roli i teknikut të ndërtimit, pasi njihet me projektin deri në detaje, është të ndjek nga afër ecurinë e vazhdueshme të punës në objekt gjatë të gjitha fazave në bashkëpunim me inxhinierin e kantierit.

- të lexojë dhe kontrollojë zbatimin e projektit në përputhje me kërkesat, specifikimet teknike dhe kushtet teknike të zbatimit (KTZ).

- të informojë inxhinierin e kantierit për ecurinë e punës, për problematikat e ditës, difektet që mund të evidentojë si dhe jep mendim për përmirësime;

Pra, për sa më lart del qartë se roli i teknikut të ndërtimit dhe inxhinierit të ndërtimit janë në koherencë me njëri – tjetrin dhe ndarja e detyrave të tyre garanton AK për zbatimin e suksesshëm të kontratës.

Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

6. Kaskat mbrojtëse bëjnë pjesë tek pajisjet personale të sigurisë të detyrueshme për tu përdorur në kantier në përputhje me Ligjin nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë në Kantier”, i ndryshuar. Numri i kaskave është kërkuar në përpjestim me numrin e punonjësve.

-Kaska mbrojtëse 50 cope. Kaskat mbrojtëse janë pjesë e kit-it personal të domosdoshëm, rrjedhojë e kërkesave të sigurisë në punë të punonjësve, sipas Kodit të Punës pasi kemi të bëjmë me punime në lartësi dhe prezencë të makinerive të ndryshme. Për këtë arsye ato duhet të jenë të gatëshme për të gjithë punonjësit që do të jenë pjesë e kantierit të ndërtimit, si edhe të kantierit të prodhimit të parafrabikateve.

-Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 (pesë) copë. Duke qënë se kantieri është i hapur dhe në pamundësi për tu mbyllur me rrethim, duke qënë se ndodhet në rrugë kalimet e popullatës, është e domosdoshme që gjatë natës kantieri duhet të jetë i ndriçuar për të eliminuar dëmtimet e mundëshme të personave që mund të kalojnë përmes tij.

Edhe pajisjet e tjera si fikeset e zjarrit, komplet i ndihmes se shpejte dhe tabelat paralajmeruese bëjnë pjesë tek ato pajisje të detyrueshme në kantier për sigurinë e detyrueshme sipas legjislacionit të përmendur më lart.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga njësia e prokurimit **znj.M.M, z.E.K , z.H.XH.**

1. Kërkesa për certifikatën ISO PAS 99:2012 Sistemi i Menaxhimit të Integruar nuk është e lidhur ngushtë me procedurën e prokurimit dhe si e tillë nuk është e nevojshme të kërkohej në kritere të veçanta për konkurrimin e operatorëve ekonomik. Ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.

-Kërkesa për Certifikatë ISO 45001-2018 “Sigurimi në punë”. Kjo kërkesë nuk është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit. Në Republikën e Shqipërisë janë krijuar institucione të posaçme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë për punonjësit. Është detyrë e këtyre institucioneve për të garantuar sigurinë. **Observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Në lidhje me emrat e anëtarëve të njësive së prokurimit në formularët e konfliktit të interesit është pranuar që është lapsur dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.

3.Kërkesa e Autoritetit Kontraktor për autovinç me kapacitet 20 ton është argumentuar sipas observacionit të mësipërm dhe si e tillë është e nevojshme për zbatimin e kontratës dhe do të merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

4. Kërkesa për mjek nuk është e lidhur ngushtë me procedurën e prokurimit dhe si e tillë nuk është e nevojshme të kërkohej në kriteret e veçanta për konkurrimin e operatorëve ekonomikë. Ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.

5. Në procedurën e mësipërme “Ndërtimi i urës në rrugën Kocaj-Veski, Baldushk” Në këtë procedurë në DST është kërkuar inxhinier ndërtimi dhe kohëzgjatje e punimeve do të jetë 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës.Referuar zërave të preventivit të punimeve dhe volumit të tyre nuk është e nevojshme të kërkohej edhe inxhinier ndërtimi edhe teknik ndërtimi dhe sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

6. Kërkesa e Autoritetit Kontraktor për kaska mbrojtëse 50 copë dhe prozhektorë ndriçimi është në përputhje me objektin e prokurimit dhe si i tillë do të merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

7. “Rikonstruksoni i urës së fshatit Vilëz Zall Bastar”

Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur” REF-24163-05-28-2019 Loti II;REF-24169-05-28-2019, Urdhri nr.1545/1 prot.,datë 27/05/2019	Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Realizuar “I” Sh.p.k. Realizuaer nga projektuesi Ing.A.SH. Miratuar nga Këshilli Teknik vendim nr.5/9 datë 13.03.2019	Njësia e Prokurimit Me urdhër nr.1545/1 datë 18.04.2019 1.M.M 2.V.K 3.R.S	Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.1545/2 prot., datë 27.05.2019. 1.L.C Kryetare 2.S.GJ Anëtar 3..M.N Anëtare
4. Fondi Limit 11,715,137 leke pa tvsh	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: BOE-OE “A” Sh.p.k.dhe “K“ Sh.p.k, 10,333,964 lekë pa tvsh.		4. Diferenca me fondin limit 1,381,173 leke.
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 28.06.2019, Ora 10;00	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë		Pjesëmarrës në tender 5-OE-BOE b) S’kualifikuar 4- BOE-OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës:			

Loti I ;6 (gjashtë) muaj kalendarike nga nënshkrimi i kontratës Loti II ; 2(dy)muaj kalendarike nga nënshkrimi i kontratës		c) Kualifikuar 1. BOE-OE
10.Ankimime	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 1545/11 prot., datë 06.08.2019	12.Përgjigje Ankesës nga

1. Hartimi i fondit limit

Procedura e prokurimit është “E Hapur, Ndërtim mirëmbajtje urash”, me vlerë 11,715,137 lekë pa TVSH, do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Me shkresën nr.1545 datë 16.05 2019 Drejtoria e Kullimit dhe Rrugëve Rurale bazuar në shkresën nr. 1522 prot.datë 16.05.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, ka bërë kërkesë për nisjen e procedurave për projektin “Rikonstrukcion i Urës së fshatit Villes, Zall Bastar”.

Për kryerjen e këtij investimi është përlogaritur fondi limit dhe është bërë hartimi i specifikimeve teknike.

Argumentimi i fondit limit, specifikimet teknike dhe preventivit, janë hartuar nga shoqëria projektuese “I” sh.p.k.dhe miratuar Këshilli Teknik nëpërmjet Vendimit me nr.7/6 datë 03.04.2019 bashkalidhur projekti, preventivat, raporti teknik, specifikimet teknike, grafiku i punimeve realizuar nga projektuesi Ing. A.SH me nr. License K-0829/1 dhe miratuar nga Këshilli Teknik nëpërmjet vendimit me nr.5/9 datë 13.03.2019. Grupi i punës ka llogaritur mesataren aritmetike të tre ofertave dhe ka përcaktuar fondin limit në vlerën 11,715,137 lekë pa Tvsh.

2.Hartimi i Kritereve

Me shkresën nr.1545/1 datë 27.05.2019 të Drejtorisë Përgjithshme të Punëtorëve të Qytetit për procedurën e prokurimit, Loti I “Ndërtimi i urës së rrugës Kocaj-Veske, Baldushk” është miratuar njësia e prokurimit e përbërë nga:

- 1) M.M.
- 2) V.K.
- 3) R.S.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike janë përcaktuar nga Njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 05.03.2020, dhe pas shtojcës së modifikimeve datë 25.03.2020 (hedhur në system), janë si më poshtë

Shtojca 12

Loti 1: Loti 2: “Rikonstruksoni i urës së fshatit Vilëz Zall Bastar”

Për modifikimin e dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit

Me REF-24163-05-28-2019, “Ndërtim mirëmbajtje urash” e ndarë në 2 lote:

Loti 1: “Ndërtimi i urës në rrugën Kocaj-Veski, Baldushk”

Loti 2: “Rikonstruksoni i urës së fshatit Vilëz Zall Bastar”

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim mirëmbajtje urash”, me fond limit 29,964,366 (njëzetë e nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh i ndarë në 2 lote:

Loti 1 “Ndërtimi i urës në rrugën Kocaj-Veski, Baldushk”, me REF-24166-05-28-2019, me fond limit 18,249,229 lekë pa tvsh

Loti 2 “Rikonstruksoni i urës së fshatit Vilëz Zall Bastar”, me REF-24169-05-28-2019, me fond limit 11,715,137 lekë pa tvsh, ndryshon nga data 28.06.2019, ora 10:00, përcaktuar në dokumentet e tenderit, në datë 04.07.2019, ora 10:00 dhe hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit eëë.app.gov.al.

Me urdher nr.1545/2 daë 27.05.2019 të Autoritetit Kontraktor Drejtorisë së Përgjithshme nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit është bërë përllogaritja e fondit limit si dhe materialet e nevojshme për fillimin e procedurës së prokurimit (Projekti, preventivat, raporti teknik, specifikimet teknike grafiku i punimeve) Lot 1 “Ndërtimi i urës së rrugës Kocaj-Veski, Baldushk” dhe Loti II”Rikonstrukcioni i urës së fshatit Viles, Zall Bastar”.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit janë argumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 27.05.2019, veprim *Kapaciteti teknik, nuk është në përputhje me nenin 20 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

Kriteri për një Autovinç 20 ton nuk argumentohet në bazë të preventivit të punimeve.

Autovinç mbi 20 ton 1 copë Pronësi ose me qera

Rimorkiator me kapacitet 20 ton 1 copë Pronësi ose me qera

Kriteri i vendosur për operatorin ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku (i vlefshëm), diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë, 1 (një) mjek i përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm bazuar në ndryshimet e fundit ligjore nuk është e legjitimuar.

Kriteri i vendosur për detyrimin e operatorit ekonomik për të punësuar 1 (një) punonjës teknik ndertimi, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme; diplomë përkatëse, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik me kategori IV (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit tone nuk mbështetet nga argumentimi i punimeve, specifikimet teknike dhe nga grafiku i punimeve të argumentuara nga komisioni për përgatitjen e tij

Nuk është në përputhje me pikën 8 germa (b) të nenit 26, 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhën kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës, OE të disponojë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha më të hershme.

Kriteri për pajisjen kaska mbrojtëse është jo i argumentuar dhe bazuar në specifikimet teknike Kaska mbrojtëse minimumi 50 (pesëdhjetë) copë;

- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 (pesë) copë;
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 (pesë) copë;
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë;

- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 (dhjetë) copë.

3. Vlerësimin e Ofertave”

Loti 2 “Rikonstruksoni i urës së fshatit Vilëz Zall Bastar”, me REF-24169-05-28-2019, me fond limit 11,715,137 lekë pa tvsh, ndryshon nga data 28.06.2019, ora 10:00, përcaktuar në dokumentet e tenderit, në datë 04.07.2019, ora 10:00 dhe hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit eëë.app.gov.al.

Me procesverbalin e datës 04.07.2019 (dita e hapjes së ofertës), ka skualifikuar 4-BOE, është bërë edhe dorëzimin e mostrave të kërkuara në DT.

Në dosje administrohet procesverbali për shqyrtimin e ofertave pa nr. prot, datë 04.07.2019, sipas të cilit, KVO ka vendosur skualifikimin e OE “SH” Shpk pjesëmarrës me oferte 9,137,140 lekë pa tvsh, pasi nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim bazuar në pikat 2.3.5 të kapacitetit teknik të kualifikimit të punonjësve dhe pikën 2.3.11 kapacitetin teknik të mjeteve dhe pajisjeve teknike.

Nga verifikimi I dokumentave në SPE rezulton se klasifikimi i mëposhtëm është bazuar në DST

KVO ka vendosur skualifikimin OE- “K” Sh.p.k.me oferte 9,958.349 lekë pa tvsh pasi nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim bazuar në pikat 2.3.7 të kapacitetit teknik të kualifikimit të punonjësve dhe pikën 2.3.16 kapacitetin teknik të mjeteve dhe pajisjeve teknike KVO ka vendosur skualifikimin e OE “Sh” Sh.p.k, me ofertë 9,971.121 lekë pa tvsh pasi nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim bazuar në pikat 2.3.7 të kapacitetit teknik të kualifikimit të punonjësve dhe pikën 2.3.16, për kapacitetin teknik të mjeteve dhe pajisjeve teknike.

KVO ka vendosur skualifikimin e OE “S ” Sh.p.k.me ofertë 10,894.310 lekë pa tvsh pasi nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim bazuar në pikat 2.3.7 të kapacitetit teknik

Nga auditimi rezultoi se skualifikimi i BOE të mësipërme është i drejtë pasi nuk plotësojnë kriteret e DST.

KVO ka vendosur kualifikimin e BOE-OE “A” Sh.p.k. dhe “K”Sh.p.k. me ofertë 10,133,964 lekë pa tvsh pasi plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim dhe pas verifikimit të ofertës ekonomike, nuk ka gabime aritmetike.

Konkluzioni: Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se OE i shpallur fitues i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 1545/6, datë 26.07.2019, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.K.

Pas njoftimit të fituesit, me shkresën nr. 1545/19 Prot., datë 04.10.2019 është lidhur kontrata me shkresën nr. 1545/11, datë 06.08.2019 me vlerë 12,160,756.8 lekë me TVSh.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr. 31 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se:

1. Në lidhje me emrat e dy prej anetareve të njesise e prokurimit në formularet e konfliktit të interesit sqarohet se kemi të bëjmë me një lapsus.

2. Mjeku është kërkuar bazuar në VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” ndryshuar me VKM nr.742, datë 6.11.2003 ku është parashikuar se “2/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.”

3. Bazuar në parashikimin e nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor vendos kërkesa që garantojnë atë se operatorët ekonomikë do të zbatohen me sukses kontratën. Një ndër kriteret e veçanta në kontratat e punëve është zotërimi i personelit të nevojshëm për të zbatuar kontratën. Njësia e Prokurimit e ka gjykuar të arsyeshme dhe në përpjestim të drejtë kërkesën për teknik ndërtimi si kriter i lidhur ngushtë me natyrën, vlerën e kontratës (fondi limit 30.933.482 lekë pa tvsh, pra mbi kufirin e ulët monetar, procedurë e hapur) dhe rëndësinë e saj (punime në vepra inxhinierike me rëndësi të veçantë siç janë urat dhe mbrojtja lumore).

Gjithashtu duke patur në konsideratë natyrën e kontratës (punë), nevoja e teknikut të ndërtimit si pjesë e personelit të OE është gjykuar thelbësore për shkak të detyrave dhe përgjegjësi që ai ka gjatë zbatimit të punimeve si mëposhtë vijon:

- Roli i teknikut të ndërtimit, pasi njihet me projektin deri në detaje, është të ndjek nga afër ecurinë e vazhdueshme të punës në objekt gjatë të gjitha fazave në bashkëpunim me inxhinierin e kantierit.
- Të lexojë dhe kontrollojë zbatimin e projektit në përputhje me kërkesat, specifikimet teknike dhe kushtet teknike të zbatimit (KTZ).
- Të informojë inxhinierin e kantierit për ecurinë e punës, për problematikat e ditës, difektet që mund të evidentojë si dhe jep mendim për përmirësime;

Pra, për sa më lart del qartë se roli i teknikut të ndërtimit dhe inxhinierit të ndërtimit janë në koherencë me njëri – tjetrin dhe ndarja e detyrave të tyre garanton AK për zbatimin e suksesshëm të kontratës. Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

4. Kaskat mbrojtëse bëjnë pjesë tek pajisjet personale të sigurisë të detyrueshme për tu përdorur në kantier në përputhje me Ligjin nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë në Kantier”, i ndryshuar. Numri i kaskave është kërkuar në përpjestim me numrin e punonjësve.

-Kaska mbrojtëse. Kaskat mbrojtëse janë pjesë e kit-it personal të domosdoshëm, rrjedhojë e kërkesave të sigurisë në punë të punonjësve, sipas Kodit të Punës pasi kemi të bëjmë me punime në lartësi dhe prezencë të makinerive të ndryshme. Për këtë arsye ato duhet të jenë të gatëshme për të gjithë punonjësit që do të jenë pjesë e kantierit të ndërtimit, si edhe të kantierit të prodhimit të parafrabikateve.

-Prozhektorë ndriçimi natën. Duke qënë se kantieri është i hapur dhe në pamundësi për tu mbyllur me rrethim, duke qënë se ndodhet në rrugë kalimtare e popullatës, është e domosdoshme që gjatë natës kantieri duhet të jetë i ndriçuar për të eliminuar dëmtimet e mundshme të personave që mund të kalojnë përmes tij.

Edhe pajisjet e tjera si fikeset e zjarrit, komplet i ndihmes së shpejte dhe tabelat paralajmëruese bëjnë pjesë tek ato pajisje të detyrueshme në kantier për sigurinë e detyrueshme sipas legjislatcionit të përmendur më lart.

5. Vlerësimi i numrit të punonjësve bazohet në zbrëthimin analitik të orëve të punës së nevojshme për realizimin e punimeve, kondicionuar kjo dhe nga specifikat e kryerjes së operacionave dhe zërave të ndryshëm të punimeve.

Specifikisht, ndërtimi i urës në fshatin Vilës, Zall Bastar presupozon kryerjen e punimeve kryesore në shtratin e lumit Terkuzë dhe të punimeve të tjera në mbistrukturë dhe në veprat mbrojtëse. Kështu, për realizimin e punimeve të gabionit që kryhen në shtratin e lumit, kërkohet një përqëndrim i lartë i fuqisë punëtore, për përfundimin e tyre në afate sa më të shkurtëra. Kjo, pasi dihet që, në raste shirash, prurjet e lumit janë shumë të mëdha dhe të rrëmbyera, gjë e cila ka sjellë dhe dëmtimin e urës ekzistuese dhe nevojën e kryerjes së investimit të ri. Pë të minimizuar rrezikun e dëmtimit të punimeve gjatë periudhës së ndërtimit, u vlerësua që, punimet në shtratin e lumit (ndërtimi i mureve me gabion) të kryhen në një periudhë maksimumi 1 mujore, dhe punimet e tjera në periudhën e mbetur nga afati 2 mujor.

Si rezultat i këtij afati dhe zbërthimit analitik të zërave të punës për ditët e punës së nevojshme për realizimin e tyre (mbi bazën e VKM Nr 629 datë 15.07.2015) grafikun e punimeve, në bazë të të cilit numri i kërkuar i punonjësve është 40 persona.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrçimit Publik nga njësia e prokurimit **znj.M.M, z.V.K , z.R.S.**

1.Në lidhje me emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit në formularët e konfliktit të interesit është pranuar që është lapsur dhe si i tillë **nuk merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Kërkesa për mjek nuk është e lidhur ngushtë me procedurën e prokurimit dhe si e tillë nuk është e nevojshme të kërkohet në kriteret e veçanta për konkurrimin e operatorëve ekonomikë. Ky pretendim **nuk merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

3. Në procedurën e mësipërme “Rikonstruksoni i urës së fshatit Vilëz Zall Bastar” Në këtë procedurë në DST është kërkuar inxhinier ndërtimi dhe kohëzgjatje e punimeve do të jetë 2 muaj nga data e lidhjes së kontratës.Referuar zërave të preventivit të punimeve dhe volumit të tyre nuk është e nevojshme të kërkohet edhe inxhinier ndërtimi edhe teknik ndërtimi dhe sa më sipër observacioni **nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

4. Kërkesa e Autoritetit Kontraktor për kaska mbrojtëse dhe prozhektorë ndriçimi është në përputhje me objektin e prokurimit dhe si i tillë do të **merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

5. Në lidhje me numrin e punonjësve, edhe në observacion nuk argumentohet me zërat e punës, grafikun dhe analizat e çmimeve në fuqi dhe sa më sipër observacioni **nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

8. Mirëmbajtja e Sheshit Skenderbej

Procedura e Prokurimit Procedure e hapur, Marrëveshje kuadër me një BOE ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara. Urdhër me nr.3448 /1 prot. date 18.11.2019 REF-44983-11-26-2019 Menaxhimin dhe mirëmbajtja e sheshit Skënderbej	Specialistet e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit. Dërguar zyrtarisht nga Bashkia Tirane me shkresën nr.3448/2 datë 21/11/2019 Nr.2825 prot datë 01.10.2019 të DPNr.2PQ Studimi studio”I” shpk,”H” shpk. V.K.T.Nr.1, datë 20.02.2019 Bashkia Tiranë.	Njesia e Prokurimit Me urdhër nr.3448/4 prot datë 26.11.2019 1.M.M 2.A.K 3.B.GJ 4.I.B 5.A.K 6.A.B	Komisioni Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr.3448/5 datë 26.11.2019 1F.A 2.P.S 3.M.N
--	--	--	--

Fondi Limit 133,329,038 leke pa tvsh,	Oferta Fituese , vlera fituese BOE fitues Operatorëve Ekonomik “F” sh.p.k, “T”, “S” sh.p.k	
Data e hapjes së tenderit Data e zhvillimit 20/12//2019 ora 10.00	Burimi i Financimit Buxheti i Bashkisë	Pjesemarrës në tender
Kohëzgjatja e kontratës 36 muaj nga nënshkrimi i kontratës,		

Hartimi i fondit limit

Sektori i Ndrçimit Publik, dhe Prodhim Mirëmbatje me shkresat nr.3448 prot dhe 3448/1 prot, DT 18.01.2019 i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 e Punonjësve të Qytetit për miratimin e kërkesës për nisje procedure “Menaxhimi dhe mirëmbatje e sheshit “Skënderbej” me fond limit 133,329,038 lekë pa tvsh.

Me kërkesë të Drejtorisë së Pergjithshme Nr.2 e Punonjësve të Qytetit nr.3448/2 datë 21.11.2019 është bërë kërkesë për punonjës të specializuar për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sheshit ”Skënderbej”.

Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe dokumenteve standarde, i përberë nga zj. M.M, z.A.K, z.B.GJ, z.I.B, z.A.K dhe z.A.B ka mbajtur procesverbalin pa nr. Prot, datë 26.11.2019 ku ka hartuar dokumentet standarde të tenderit me procesverbalin Nr.1 duke bërë pjesë të dosjes së prokurimit.

Hartimi i kriterëve

Me urdhër prokurimi të Drejtorisë së Pergjithshme Nr.2 e Punonjësve të Qytetit Tiranë me nr. 3448/4 prot, datë 26.11.2019, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga zj. M.M, z.A.K, z.B.GJ, z.I.B, z.A.K dhe z.A.B në Drejtorisë së Pergjithshme Nr.2 e Punonjësve të Qytetit.

Me urdhër nr.3448/5 datë 26.11.2019 të Drejtorisë së Pergjithshme Nr.2 e Punonjësve të Qytetit është ngritur Komisioni i Vlerësimit të ofertave i përbërë nga z.F.K, z.P.S dhe M.N për procedurën e prokurimit me objekt “Menaxhimi dhe mirëmbatje e sheshit “Skënderbej” me fond limit 133,329,038 lekë pa tvsh.

-Në datë 22.06.2022 është administruar procesverbali për hartimin e dokumenteve të tenderit. Kriteret e veçanta të kualifikimit, në lidhje me licencat profesionale, janë hartuar në kundërshtim me VKM nr.42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Nga auditimi konstatohet se nga NjP janë vendosuar kriteret e paargumentuara e të pambështetura, konkretisht:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

- a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi për kategoritë e mëposhtme:

- N.P. 3- A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile, industriale, veshje fasadash
- N.P. 7- A Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje
- N.P. 12-A Punime të inxhinierisë së mjedisit
- N.S 2- A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
- N.S-16-A Ndertimi i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij

Bazuar ne VKM nr.42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurate dhenies se licencave profesionale te zbatimit klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”

Parashikimi i pikës N.P. 3- A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile, industriale, veshje fasadas është kriter i vendosur jo në përputhje me VKM nr.42 datë 16.01.2008 si vijon; *N.P. 3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash. Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.*

Kriteri i vendosur në pikën N.S-16-A Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij, nuk është argumentuar me preventivin e punimeve dhe grafikun e punimeve dhe është kriter rëndues për pjesëmarrësit e tjerë në prokurim.

7. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 6 (gjashtë) muajt e fundit, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme (për të gjithë periudhën e kontratës) dhe diplomën përkatëse si mëposhtë:
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi, profili trajtim i ujrave (Të jetë i pajisur me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)
 - 1 (një) Inxhinier Mekanik
 - 1 (një) Inxhinier Kimist (Të jetë i pajisur me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)
 - 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
 - 2 (dy) Agronom (Të paktën një agronom të jetë i pajisur me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)

Kriteri vendosjes se 1(nje) inxhinier mjedisi nuk është i justifikuar bazuar në VKM Nr.42 datë 16.01.2019 kategoria NP-12.Kriteri i vendosjes së 1(nje) inxhinier ndërtimi dhe 2 (dy)agronomeve nuk është i *mbeshtetur ne VKM nr.914 date 29.12.2014 neni 61* “Cdo kriter vecante duhet te jete ne perputhje me permasat e kontrates si dhe te shmangë cdo kriter te vecantë apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomik që përbën diskriminim ndaj furnizuesve bazuar në nenin 20 të LPP” Vendosja e 1(nje) agronomi do te justifikonte preventivin dhe grafikun e punimeve për mirëmbajtjen e zonës së gjelbërt.

8. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës si mëposhtë:

- 2 (dy) mirëmbajtës elektrik
- 2 (dy) mirëmbajtës hidraulik
- 2 (dy) bojaxhi
- 2 (dy) mirëmbajtës pompash
- 2 (dy) punonjës mekanik
- 2 (dy) punonjës saldator
- 2 (dy) punonjës karpentier
- 1 (një) pllakashtrues c) Normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

Vendosja e kriterit për 2 (dy) punonjës saldator dhe 2 (dy) punonjës karpentier nuk është i mbështetur në VKM nr.914 datë 29.12.2014, neni 61 “Cdo kriter vecantë duhet të jetë në përputhje me permasa të kontratës si dhe të shmangë cdo kriter të vecante apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatoeveve ekonomik ëe përbën diskriminim ndaj furnizuesve bazuar në nenin 20 të LPP” në preventivin dhe gafikun e punimeve

SA më sipër mbanë përgjegjësi NjP e përbërë nga zj. M.M, z. A.K, z.B.GJ, z.I.B, z.A.K dhe z.A.B.

Vlerësimi i Ofertave

Me urdhër nr.3448/5 date 26.11.2019 të Drejtorisë së Pergjithsme Nr.2 e Punonjësve të Qytetit është ngritur Komisioni i Vlerësimit të ofertave i përbërë nga z.F.K, z.P.S dhe M.N për procedurën e prokurimit me objekt “Menaxhimi dhe mirëmbajtje e sheshit “Skënderbej” me fond limit 133,329,038 lekë pa tvsh.

Në datë 26.12.2019 nga KVO-ja është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Menaxhimi dhe mirëmbajtje e sheshit “Skënderbej” me fond limit 133,329,038 lekë pa tvsh operatorët të cilët paraqitën oferta si më poshtë.

1-“F” shpk, dhe “S” shpk me ofertë me vlerën e shumatoreve për njësi të ofruar prej 913,939.95 lekë dhe me oferte vlerë ekonomike 120,278,173 lekë pa tvsh.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë BOE “F” shpk dhe “S” shpk, për të cilët, referuar procesverbalit të datës 10.08.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr Operatori ekonomi Oferta lekë pa TVSh Kualifikuar

1. BOE: “F” shpk, dhe “S” shpk me ofertë me vlerën e shumatoreve për njësi të ofruar prej 913,939.95 lekë dhe me ofertë vlerë ekonomike 120,278,173 lekë pa tvsh.

Nga KVO është mbajtur procesverbali i vlerësimit me date 30.12.2019 me objekt “Menaxhimi dhe mirëmbajtje e sheshit “Skënderbej” me fond limit 133,329,038 lekë pa tvsh BOE: “F” shpk, dhe “S” shpk vendosi të njoftojë BOE: “F” shpk, dhe “S” shpk për kualifikimin bazuar në dokumentacionin dhe ofertën e paraqitur.

Bazuar ne Raportin Përmbledhës me nr.3448/7 datë 07.01.2019, vendosi të njoftojë BOE pjesëmarrës nëpërmjet SPE në lidhje me vlerësimin dhe klasifikimin të kualifikuar të BOE: "F" shpk dhe "S" shpk.

Me shkresën nr.3448/8 date 08.11.2020 është dërguar formulari i njoftimit të operatorëve ekonomik të suksesshëm në marrëveshjen kuadër e firmosur nga Kryetari AK z.E.K.

Më datë 13.01.2020 është mbajtur procesverbali i dorëzimit të dokumentacionit pranë KVO nga BOE: "F" shpk dhe "S" shpk i shpallur fitues.

Me datë 14.01.2020 me nr. 3448 Prot., është nënshkruar marrëveshja kuadër për shërbime ndërmjet AK Drejtoria së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndrimit Publik z.E.K dhe kontraktuesve "F" Shpk me administrator z.SH.F dhe "S" shpk me administrator B.A.

Me urdhërin nr.3448/13 datë16.01.2020 është ngritur komisioni për dhënien e kontratave në bazë të marrëveshjes kuadër nr.3448/10 date 14.01.2020 të përbërë nga:

z. I.B, z.B.GJ, z.S.Q dhe z. I.F.

Nga kontrolli i dokumentacionit të BOE: "F" shpk dhe "S" shpk bazuar në kontratën (Për bashkim të Përkohshëm) të shoqërive rezulton se perfaqesuesit e shoqërive kanë rënë dakort për raportin pjesëmarrës në këtë kontratë bashkëpunimi të jetë 95% "F" Shpk dhe 5% "S".

Konkluzion: Dokumentacioni i BOE: "F" shpk dhe "S" shpk fituese është konform DST.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr. 31 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se:

1.Argumentimi i pikave të licencës

Pika N.P.3: Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash është vendosur, referuar preventivit të punimeve dhe relacionin teknik ku parashikohen punime mirëmbajtje të të gjitha sipërfaqeve të shtruara me pllakë guri ose materiali tjetër, duke përfshirë sheshin kryesor, sheshet përpara monumenteve të kulturës si Pallati i Kulturës, Muzeu Kombëtar etj., bashkë me shkallarët e tyre si dhe xokolaturat e objekteve të cilat janë të shtruara me pllakë.

Pika N.S.-16: Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij. Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja, ristrukturimi i impianteve të ujit të pijshëm të ujërave që duhen pastruar, përfshirë edhe grumbullimin e biogazit dhe të prodhimit të energjisë elektrike e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet. Kjo pikë është vendosur referuar preventivit të punimeve dhe relacionit teknik, ku parashikohet mirëmbajtja e depos së ujit, përfshirë pastrimin dhe klorifikimin e saj.

Pika N.P.12: Punime të inxhinierisë mjedisore konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Kjo pikë është vendosur referuar preventivit të punimeve dhe relacionit teknik ku parashikohen punime komplekse mirëmbajtje të gjelbërimit pasi kemi të bëjmë me sipërfaqe të gjelbëruar prej rreth 13.800 m2, ku përfshihet bimësi me një ndërtim shtresor dhe përbërje të shumëllojshme. Janë më shumë se 150 specie të pemëve, shkurreve, luleve, hardhi, zhardhok një/ dy vjetore dhe një shtresim vertikal është aplikuar ku pemët përbëjnë shtresën kryesore që strehon nënshtresat që përbëhen nga shkurre dhe bimë të ulta shumëvjeçare. Përdorimi i llojeve gjetherënëse dhe gjelbërim gjithëvjetor në pemë, shkurre dhe shtresa bimësh të ulta shumëvjeçare siguron një pamje të gjelbër gjatë gjithë vitit që përbën një ekosistem të mirëfilltë.

2. Argumentimi i stafit teknik

Inxhinieri i Mjedisit është kërkuar si ekspert, në përputhje dhe me pikën e liçences N.P.12, i cili do të monitorojë të gjithë veprimtarinë mjedisore, bazuar në zërat e punimeve të preventivit dhe relacionin teknik. Duke pasur në konsideratë vendndodhjen e sheshit, ku ka një fluks të madh popullate kërkohet ti jepet vëmendje dhe rëndësi e veçantë monitorimit të shërbimeve, që gjenerojnë mbetje dhe raportimeve për marrjen e masave nga eksperti .

Inxhinieri i ndertimit është kërkuar në përputhje me kërkesat për mirembajtje të sheshit, i cili në pjesën më të madhe është i shtruar me pllake dhe asfalt dhe asistenca e inxhinierit është e nevojshme për mirembajtjen e tij sipas pikës së liçencës N.P.3

Punimet e Gjelbërimit duhet të asistohen nga eksperte të fushës perkatese si Agronom, të cilët duhet të jenë të specializuar, pasi natyra e bimeve sic edhe është përkrahur në Raportin e Studimit pika 4.1.3 “Punëtorët duhet të jenë të specializuar në kategori të ndryshme të bimëve dhe mirëmbajtjes, me së paku dy punëtorë për kategori: bimë të ulta shumëvjeçare, shkurre dhe pemë, bimë tropikale dhe hardhi”. Në kushtet kur kemi të bëjmë me një sipërfaqe të gjelbëruar prej rreth 13.800 m², ku përfshihet bimësi me një ndërtim shtresor dhe përbërje të shumëllojshme me rreth 150 specie bimësh, asistenca prej 2 agronomeve është e justifikuar plotësisht.

3. Kërkesa për 2 saldatore dhe 2 karpentier është vendosur në mbështetje të nenit 44, pika 1 dhe Neni 46, pika 1, gërma ”b” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe në mbështetje të nenit 28, pika 5, gërma “c” të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Profili i punonjësve është vendosur duke marrë në konsideratë zërat e punimeve sipas preventivit dhe relacionit teknik, vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën, rëndësinë si dhe kohëzgjatjen e saj. Kjo kërkesë i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

Konkretisht punonjësit e mësipërm do të kryejnë punimet për zërat e preventivit si mëposhtë:

Kapitulli K: “Mirembajtja e Mobilimit Urban”:

- Zëri i punimeve “Lyerje e karrigeve të levizshme + riparime të imta”. Riparimet e imta bazuar në raportin e studimit të kryer konsistojnë në riparime saldimi, etj , si rrjedhim Autoriteti Kontraktor ka kërkuar punonjës të kualifikuar në profilin Saldator.

- Zërat e punimeve “Meremetim i bllokuesve të trafikut, Meremetim i stolave të betonit” , bazuar në raportin e studimit të kryer dhe metodologjisë së kryerjes së riparimit konsistojnë në përdorim të karpentierisë dhe të produkteve të betonit. Si rrjedhim, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar punonjës të kualifikuar në profilin “Karpentier”.

Gjithashtu po ti referohemi sasive të mëposhtme, shkëputur nga preventivi i procedurës së prokurimit (220 karrige, 350 stola etj) dhe grafikut të zbatimit të shërbimit, ku këto zera janë parashikuar të kryhen brenda një dite, gjykojmë se numri prej 2 saldatorësh dhe 2 karpentierësh është plotësisht i justifikuar.

Lyerje e karrigeve të levizshme + riparime të imta	cope	220
Lyerje e kangjellave	m ²	200
Meremetim I stolave të betonit	cope	350
Meremetim I bllokuesve të trafikut	cope	100
Meremetim dhe lyerje e koshave metalik të mbaturinave	cope	50

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga njësia e prokurimit **znj.M.M, z.B.GJ , z.I.B.**

1. Në lidhje me kriterin për pikat e licencës profesionale, janë bërë kërkesat e cituara jo në përputhje me natyrën e objektit që prokurohet. Sa më sipër observacioni **nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**
2. Nisur nga pika 1, ku punimet e mjedisit nuk përputhen me natyrën e punimeve, edhe inxhinieri mjedisit nuk duhet të ishte kërkuar. Sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**
3. Në lidhje me kërkesën për karpentierët dhe saldatorët, bazuar në punimet e preventivit, nuk përputhet me natyrën e objektit që prokurohet. Sa më sipër observacioni **nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

Procedurat e periudhës 01.01.2020-31.12.2020:

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë kryer gjithsej 58 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 599,982,953 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur 561,552,776 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 38,430,177 lekë pa TVSh ose 6.4 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën më poshtë:

Procedura 01.01.2020-31.12.2020	Nr.	Vlera e Fondit Limit	Vlera e Kontraktuar	Diferenca me Fondin Limit
Gjithsej	58	599,982,953	561,552,776	38,430,177
Kërkesë për propozim	24	89,763,757	81,649,828	8,113,929
E hapur	20	504,867,363	475,406,603	29,460,760
E hapur e thjeshtuar				
Me vlerë të ulët	14	5,351,833	4,496,345	855,488
Sipas objekteve	58			
Objekte në fushën e investimeve	0			
Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	58	599,982,953	561,552,776	38,430,177

U audituan gjithsej 6 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit 250,677,752 lekë dhe vlerë të kontratave 245,599,732 lekë ose 97.9 % e fondit limit total (tre procedura janë me marzh fitimi dhe një procedurë është me dy lote). Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej 13 OE/BOE, nga të cilat janë s'kualifikuar 1 OE. Me 1 OE kanë qenë 3 procedura. Procedurat e zgjedhura për auditim janë paraqitur në tabelën më poshtë. Vlerat e paraqitura janë pa TVSh.

Nr.	Objekti	Lloji i procedurës	OE fitues	Fondi limit	Vlera e kontratës
1	Blerje Bitumi	E Hapur	R Sha	67,925,000	Marzh fitimi 43%
2	Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik	E Hapur	I shpk	41,625,220	39,198,200
3	Blerje karburanti Loti I Gasoil Blerje karburanti Loti II Benzinë	E hapur	I. BOE "K" ShPK & "R" ShPK II. OE "G" ShPK	54,895,534 2,816,600	Marzh fitimi 9 % Marzhi I fitimit 23%
4	Blerje lëndë djegëse për përdorim teknik, civil dhe industrial	E Hapur	T shpk	35,220,898	Marzh fitimi 45%
5	Materiale për sinjalistikë (Shtylla LED)	E Hapur	"S" ShPK	22,141,000	20,835,000
6	Blerje pllaka dhe bordura	E Hapur	K.T shpk	26,053,500	24,708,500
Totali				250,677,752	245,599,732

1. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje bitumi”, DPRrNP

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje bitumi”, DPRrNP, Nr. REF-54583, datë 03-18-2020.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 762/3, datë 12.03.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 762/1, datë 11.03.2020	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 762/4, datë 12.03.2020
2. Lloji i Procedurës – “E hapur, mallra”	1. B.S 2. Q.X 3. I.B 1. Urdhër Prokurimi Nr. 762/3, datë 12.03.2020 Njësia e Prokurimit 1. M.M, Personi përgjegjës, jurist 2. E.K, Jurist 3. B.S Inxhinier (specialist i fushës)	1. F.A, Kryetar 2. J.J 3. M.N
5. Fondi Limit (pa TVSh) 67,925,000 lekë,	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “R ” ShPK me marzh fitimi 33%, sipas kontratës nr. 762/9 prot, dt. 30.04.2020 me afat deri në darën 31.12.2020.	7. Diferenca me fondin limit
8. Data e hapjes së tenderit Datë 14.04.2020	9. Burimi Financimit Transfertë nga Buxheti i Bashkisë Tiranë 2020	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) S’kualifikuar 0 BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur, mallra”, me vlerë 67,925,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (DPRrNP). Nga verifikimi i DT konstatohet se është përzgjedhur në mënyrë të pajustificuar si sipas pikës 3.1 “*Kriteret e përzgjedhjes*”, ...iii) *marzhi më i ulët i fitimit, të shprehur në përqindje.*

Vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Ky kriter është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 31 “Kriteret për vlerësimin e ofertës”, pika 3, sipas të cilës “*Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, G, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:*

a) *çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;*

b) *elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi ;*

c) *marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje”.*

Sa sipër, bitumi nuk hyn tek lista e mallrave që kanë të përcaktuar këtë kriter vlerësimi. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit me përbërje M.M , E.K dhe B.S .

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet kërkesa me nr. 762, datë 11.03.2020 e Drejtorisë së Prodhimit dhe Mirëmbajtjes, për realizimin e kësaj procedure prokurimi.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit dhe hartimi i specifikimeve teknike, janë hartuar nga grupi i punës të ngritur për këtë qëllim me Urdhrin nr. 762/1, datë 11.03.2020 të titullarit të AK z. E.K, me përbërje B.S, Q.X dhe I.B.

Është mbajtur procesverbali me nr. 762/2 prot., datë 12.03.2020, sipas të cilit është përcaktuar sasia e pritshme e bitumit, bazuar në një Aktmarrëveshje të bërë me shoqërinë “R” ShPK me nr. 2821/12, datë 11.12.2019, sipas të cilës, çmimi i bitumit për kg është 78.998 lekë pa TVSh. Sipas kësaj çmimi, sasia e pritshme e bitumit është 859831 kg.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit dhe specifikime teknike janë përcaktuar nga Njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 12.03.2020.

Me procesverbalin pa numër protokolli, datë 07.04.2020 është bërë modifikimi datës së hapjes së tenderit nga 13.04.2020 në 14.04.2020.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit janë argumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 12.03.2020, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

Është kërkuar që OE ofertues të paraqesin Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të vitit 2019 të Bashkisë Tiranë. Ky kriter është diskriminues, pasi përjashton operatorët ekonomikë që nuk operojnë në Bashkinë Tiranë. Për sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit me përbërje M.M, E.K, Jurist dhe B.S inxhinier.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur, mallra”. Nisur nga procesverbali i hapjes së ofertave dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 3 OE, nga të cilët janë kualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Marzhi I fitimit
1	“R” SHPK	33%
2	“A” SHPK	85%
3	“T” SHPK	49.5

Burimi i të dhënave: Bashkia DPRrNP

Punoi: KLSH

Në dosje administrohet procesverbali për shqyrtimin e ofertave pa nr. prot, datë 16.04.2020.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 762/6, datë 24.04.2020, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.K.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se OE i shpallur fitues “R” SHPK, nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT, pasi nga verifikimi në SEP, rezulton që të ketë sjellë vërtetimin për pagesën e taksave vendore në Fier dhe jo në Tiranë, siç kërkohet në DT.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “*Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*”

Pas njoftimit të fituesit, me shkresën nr. 762/7 prot., datë 24.04.2020 është lidhur kontrata me shkresën nr. 762/9, datë 30.04.2020 me vlerë 81,510,000 lekë me TVSh.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO nuk duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me këë OE. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 81,510,000 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjisllacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së F.A, J.J dhe M.N.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr.6 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se:

1. Në nenin 10 të ligjit Nr.8450, date 24.2.1999 “PER PERPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTAES, TE GAZIT DHE NENPRODUKTEVE TE TYRE”, i ndryshuar është parashikuar si mëposhtë vijon:

Neni 10

Ne kuptim te ketij ligji, nafta, gazi natyror dhe nenproduktet e tyre klasifikohen ne kategori, si vijon:

Kategoria O

A. Nafta bruto

B. Gazi natyror

Kategoria I

A. Gazi i lengshem

Kategoria II

A. Benzine automjetesh

B. Benzine mjetesh te fluturimit ajror

C. Nenprodukte te tjera, te lengshme si: benzol, toluol, ksilol, solven, ehite spirit.

Kategoria III

A. G (Diezel)

B. Vajguri ndriçues

C. Lende djegese per mjetet e fluturimit ajror reaktive (kerozene)

Kategoria IV

A. Vajrat

B. Solare

Kategoria V

A. Bitum (asfalt)

B. Mazut

Duke u mbështetur në klasifikimin e mësipërm bitumi është konsideruar si nënprodukt i naftës, i cili bën pjesë në kategorinë V.

2. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për taksat vendore sqarojmë se ky kriter nuk është përjashtues dhe nuk ka patur për qëllim diskriminimin e operatorëve ekonomik apo përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në tender. Duke qenë se Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është drejtori në varësi të Bashkisë Tiranë është kërkuar që operatorët që ushtrojnë aktivitetin në territorin e kësaj bashkie të paraqesin taksat vendore si një nga detyrimet më minimale në rast se marrin pjesë në tendera dhe të përfitojnë nga fondet publike vendore. Pra, një operator që konkuron në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga DPRRNP minimalisht duhet të ketë paguar taksat vendore. Në rast se OE nuk e ushtron aktivitetin e tij në territorin e Bashkisë së Tiranës, nuk paraqet taksat vendore të Bashkisë Tiranë dhe rrjedhimisht nuk përbën shkak për skualifikim mosparaqitja e tyre.

Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

Vlen për tu përmendur fakti se edhe nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ky kriter është kuptuar si një kriter jo përjashtues, gjë e cila duket në qëndrimin që ka mbajtur ky komision duke mos e skualifikuar njërin prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës, i cili nuk ka paraqitur taksat e Bashkisë Tiranë pasi e ushtron aktivitetin e tij në një bashki tjetër dhe ka paraqitur taksat respektive.

3. Konkretisht për kapacitetin e kërkuar të autobotit (minimalisht 20.000 litra) sqarojmë se: Së pari, kur është zhvilluar kjo procedurë prokurimi fabrika për prodhimin e asfaltit dhe depozita për bitumin në funksion të kësaj fabrike ndodheshin në fund të rrugës "5 maji", instaluar aty që rreth viteve 1960 (Sot ky vend nuk ekziston pasi janë ndërtuar pallate). Vendi ku futej boti dhe shkarkonte bitumin në depozitë ka qenë i tillë që nuk lejonte mundësinë e aksesimit nga një autobot me kapacitet më të madh se 20.000 litra pasi shkarkimi bëhej me nivel që do të thotë shkarkohej me vetërrjedhje duke u pozicionuar autoboti në një vend më të ngritur. Si rrjedhim, duke u nisur nga eksperiencia shumëvjeçare furnizimi me autobot më të madh ka dështuar. Në këto kushte, për të mos çuar në dështimin e furnizimit, humbjen e kohës dhe gjithashtu uljen e kostove të panevojshme për operatorin ekonomik është vendosur një kapacitet maksimal i lejuar prej 20.000 litrash.

Së dyti, kapaciteti i depozitës që u përmend më lart nuk i kalon 20.000 litra dhe rrjedhimisht është në proporcion të drejtë me kërkesën e kapacitetit maksimal të kërkuar për autobotin.

Së treti, autobotet me kapacitet deri në 20.000 litra klasifikohen tek autobotet më të përhapura dhe me përdorim më të gjerë në fushën e furnizimit me bitum për vetë madhësinë e tyre duke ofruar komoditet dhe lehtësi në qarkullim brenda qytetit të Tiranës.

Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

Për sa më lart gjykojmë se ky kriter është plotësisht i argumentuar dhe nuk është përjashtues.

4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vepruar drejtë me kualifikimin e OE "R" sh.a, duke u nisur nga parimi i mosdiskriminimit dhe mospërjashtimit të asnjë operatori ekonomik pjesëmarrës, i cili nuk ushtron veprimtarinë e tij në territorin e Bashkisë Tiranë. Gjithashtu KVO-ja është udhëhequr

nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike, parimi i rritjes së efijencës dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit, pasi ky operator ka ofruar ofertën më të ulët duke u renditur i pari .

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z. E.K, z. B.S dhe antarët e KVO-së z.F.A, z.H.G, z.T.P.

1. Në lidhje me përfshirjen e bitumit si mall që duhet prokuruar me marzh fitimi, pretendimi juaj nuk është i argumentuar teknikisht, pasi legjislacioni i prokurimit është i shprehur saktë për mallrat që prokurohen në këtë mënyrë dhe si i tillë ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

2. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për taksat vendore në qytetin e Tiranës, pretendimi juaj nuk është i argumentuar teknikisht dhe si i tillë ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

3. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për botin më të vogël se 20 ton, pretendimi juaj është i argumentuar teknikisht dhe si i tillë merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.

4. Në lidhje me kualifikimin e OE fitues pa plotësuar kriterin e vendosur në DT në lidhje me taksat lokale, sqarojmë se KVO, në zbatim të nenit 53, pika 3 të LPP-së Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe Neni 58 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar, duhet të kishte bërë skualifikimin e këtij OE.

Ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

2. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik”, DPRrNP

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik”, DPRrNP, Nr. REF-53082, datë 03-05-2020.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 620/3, datë 05.03.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 762/1, datë 11.03.2020	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 620/4, datë 05.03.2020
2. Lloji i Procedurës – “E hapur, mallra”	1. O.GJ 2. A.ALL 3. S.Q 1. Urdhër Prokurimi Nr. 620/3, datë 05.03.2020 Njësia e Prokurimit 1. M.M, Personi përgjegjës, jurist 2. E.K, Jurist 3. A.ALL, Inxhinier (specialist i fushës)	1. P.S, Kryetar 2. A.K 3. M.N
5. Fondi Limit (pa TVSh) 41,625,220 lekë,	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “I” ShPK me ofertë ekonomike 39,198,200 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 762/9 prot, dt. 30.04.2020 me afat 20 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit 2,427,020 lekë, ose 5.8%
8. Data e hapjes së tenderit Datë 14.04.2020	9. Burimi Financimit Transfertë nga Buxheti i Bashkisë Tiranë 2020	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) S’kualifikuar 0 BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE

11. Ankimime; në AK me shkresën 620/8 prot, datë 21.04.2020	12. Përgjigje Ankesës me shkresën nr. 620/12, daë 23.04.2020	13. Përgjigje Ankesës
---	--	-----------------------

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur, mallra”, me vlerë 41,625,220 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik (DPRrNP).

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet kërkesa me nr. 620, datë 02.03.2020 e Drejtorisë së Ndrëçimit, për realizimin e kësaj procedure prokurimi.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga grupi i punës të ngritur për këtë qëllim me Urdhrin nr. 620/1, datë 02.03.2020 të titullarit të AK z. E.K, me përbërje O.GJ, A.LL dhe S.Q. Sipas proceverbalit me nr. 620/2 prot, datë 04.03.2020 të këtij grupi pune, janë përcaktuar sasi të mallrave që do të kërkohen, si dhe specifikimet teknike të tyre dhe është bërë testimi i tregut. Në dosjen e prokurimit administrohen ofertat e dhëna nga subjektet “A” ShPK, “E” ShPK dhe “I” ShPK me vlerat respektive 41,634,290 lekë pa TVSh, 43,045,100 lekë pa TVSh dhe 40,274,270 lekë pa TVSh. Grupi i punës ka bërë mesataren aritmetike të tre ofertave dhe ka përcaktuar fondin limit në vlerën 41,651,220 lekë pa TVSh.

Nga verifikimi në sistemin e QKB, rezultoi se subjekti “E” ShPK nuk e ka objekt të veprimtarisë shitjen e materialeve elektrike.

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike janë përcaktuar nga Njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 05.03.2020, dhe pas shtojcës së modifikimeve datë 25.03.2020 (hedhur në sistem).

Me procesverbalin pa numër protokolli, është bërë modifikimi i datës së hapjes së tenderit nga 06.04.2020 në 14.04.2020.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit janë argumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 12.03.2020, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se është kërkuar që OE ofertues të paraqesin Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të vitit 2019 të Bashkisë Tiranë. Ky kriter është diskriminues, pasi përjashton operatorët ekonomikë që nuk operojnë në Bashkinë Tiranë.

Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit me përbërje M.M, E.K, Jurist dhe A.LL, inxhinier.

Me shkresën nr. 620/6 prot, datë 06.04.2020 është bërë pezullimi i procedurës për shkak të njoftimit të APP-së për periudhën e pandemisë dhe pas komunikimit me APP-në, me shkresën nr. 620/7, datë 07.04.2020 është bërë heqja e pezullimit të procedurës.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur, mallra”. Nisur nga procesverbali i hapjes së ofertave dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe ka marrë në pjesë në procedurë OE, me ofertën ekonomike si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike
1	“I” SHPK	39,198,200

Burimi i të dhënave: Bashkia DPRrNP

Punoi: KLSH

Me procesverbalin e datës 14.04.2020 (dita e hapjes së ofertës), ky OE ka bërë edhe dorëzimin e mostrave të kërkuara në DT.

Në dosje administrohet procesverbali për shqyrtimin e ofertave pa nr. prot, datë 14.04.2020, sipas të cilit, KVO ka vendosur skualifikimin e OE pjesëmarrës i vetëm në këtë tender, pasi nuk plotëson kriterin e vërtetimit të OSHEE dhe atë të mjetit të kërkuar në DT. Për dokumentin e lëshuar nga OSHEE, mungon pagesa e deyrimit të muajit Shkurt, ndërsa për mjetin e paraqitur mungon dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit dhe siguracioni është 6 ditë jashtë afatit të skadencës.

Me shkresën e protokolluar në DPRrNP me nr 620/8 prot, datë 21.04.2020, OE “I” ShPK është ankuar pranë AK, duke justifikuar marrjen e vërtetimit nga OSHEE në muajin Mars, kur ishte edhe data e parë e hapjes së tenderit dhe skadencën e siguracionit, për shkak të masave të rrepta të detyrueshme në situatën e përhapjes së pandemisë.

Pas pezullimit të procedurës me shkresën nr. 620/9, datë 21.04.2020, me shkresën nr. 620/10, datë 21.04.2020 është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) me përbërje Y.R, A.RR dhe E.SH.

Me shkresën me nr. 620/11, datë 23.01.2020, KSHA ka marrë në shqyrtim ankesën e OE “I” ShPK dhe e ka pranuar këtë ankesë, duke i quajtur devijime të vogla devijimet e konstatuara nga KVO, në mbështetje të nenit 53, pika 4, të e Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, “Shqyrtimi i ofertave”.

Me shkresën nr. 620/12, datë 23.04.2020 është bërë njoftimi i ankuesit për vendimin e marrë nga KSHA.

Me shkresën 620/13, datë 23.04.2020 të TAK, është hequr pezullimi i procedurës.

Në datën 23.04.2020 është mbajtur një procesverbal rivlerësimi nga KVO, i cili bazuar në vendimin e KSHA-së, ka vendosur kualifikimin e OE “I” ShPK.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 620/14, datë 04.05.2020, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.K.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se OE i shpallur fitues i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT.

Pas njoftimit të fituesit, me shkresën nr. 620/15 prot., datë 04.05.2020 është lidhur kontrata me shkresën nr. 620/17, datë 11.05.2020 me vlerë 47,037,840 lekë me TVSh.

Nga auditimi në SPE të dokumentacionit të OE "I" ShPK, i shpallur fitues pas rivlerësimit nga KSHA, rezulton se mangësitë e këtij OE janë ato të cituara nga KVO. Vendimi i KSHA, duke marrë në konsideratë edhe kushtet e pandemisë, është i drejtë.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr.7 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se:

1.Operatori ekonomik "E" sh.p.k ushtron një veprimtari të gjerë në fushën e ndërtimit të impianteve dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj. Në këtë veprimtari përfshihet jo vetëm zbatimi i punimeve por edhe furnizimi me mallra që shërbejnë për realizimin e projektit. Pra, duke e gjykuar në këtë këndvështrim shitja e mallrave elektrikë është një pjesë përbërëse dhe e pandarë e veprimtarisë së sipërcituar të OE.

2.Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për taksat vendore sqarojmë se ky kriter nuk është përjashtues dhe nuk ka patur për qëllim diskriminimin e operatorëve ekonomik apo përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në tender. Duke qenë se Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është drejtori në varësi të Bashkisë Tiranë është kërkuar që operatorët që ushtrojnë aktivitetin në territorin e kësaj bashkie të paraqesin taksat vendore si një nga detyrimet më minimale në rast se marrin pjesë në tendera dhe të përfitojnë nga fondet publike vendore. Pra, një operator që konkuron në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga DPRRNP minimalisht duhet të ketë paguar taksat vendore. Në rast se OE nuk e ushtron aktivitetin e tij në territorin e Bashkisë së Tiranës, nuk paraqet taksat vendore të Bashkisë Tiranë dhe rrjedhimisht nuk përbën shkak për skualifikim mosparaqitja e tyre.

Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

Vlen për tu përmendur fakti se edhe nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ky kriter është kuptuar si një kriter jo përjashtues, gjë e cila duket në qëndrimin që ka mbajtur ky komision duke mos e skualifikuar njërin prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës, i cili nuk ka paraqitur taksat e Bashkisë Tiranë pasi e ushtron aktivitetin e tij në një bashki tjetër dhe ka paraqitur taksat respektive..

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z. E.K, z. A.LL.

1. Në lidhje me subjektin "E" ShPK, i cili nuk e ka objekt të veprimtarisë shitjen e materialeve elektrike, nga ana e grupit të auditimit, është bërë verifikimi në web-in e QKB-së. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për taksat vendore në qytetin e Tiranës, pretendimi juaj nuk është i argumentuar teknikisht, pasi ky kriter pengon pjesëmarrjen e OE që nuk operojnë në Tiranë, por mund të sjellin materialet e prokuruarat me transportin e tyre, në vendin e përcaktuar në DT. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

3. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje karburanti”, DPRrNP

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburanti”, DPRrNP, Nr. REF-53091, datë 03-05-2020.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 615/3, datë 03.03.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 615/1, datë 28.02.2020	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 615/4, datë 03.03.2020
2. Lloji i Procedurës – “E hapur, mallra”	1. B.S 2. H.G 3. A.I 1. Urdhër Prokurimi Nr. 615/3, datë 03.03.2020 Njësia e Prokurimit 1. M.M , Personi përgjegjës, jurist 2. E.K , Jurist 3. B.SInxhinier (specialist i fushës)	1. F.A , Kryetar 2. M.K 3. M.N
5. Fondi Limit (pa TVSh) 54,895,534 lekë, (Loti I G 52,078,934 lekë pa TVSH, Loti II Benzinë pa plumb 2,816,600 lekë pa TVSh)	6. Oferta fituese (pa TVSh) Loti I (G) BOE “K” ShPK & “R” ShPK me marzh fitimi 9%, sipas kontratës nr. 615/13, datë 30.04.2020 me afat deri në darën 31.12.2020. Loti II (Benzinë pa plumb) OE “G” ShPK me marzh fitimi 23 %, sipas kontratës nr. 615/11, datë 21.04.2020 me afat deri në darën 31.12.2020.	7. Diferenca me fondin limit
8. Data e hapjes së tenderit Datë 30.03.2020	9. Burimi Financimit Transfertë nga Buxheti i Bashkisë Tiranë 2020	10. Operatorët Ekonomike Loti I a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S’kualifikuar 0 BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE Loti II a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) S’kualifikuar 0 BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur, mallra”, me vlerë 54,895,534 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (DPRrNP).

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet kërkesa me nr. 615, datë 28.02.2020 e Sektorit të Transportit, për realizimin e kësaj procedure prokurimi.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit dhe hartimi i specifikimeve teknike, janë hartuar nga grupi i punës të ngritur për këtë qëllim me Urdhrin nr. 615/1, datë 28.02.2020 të titullarit të AK z. E.K, me përbërje B.SH.G dhe A.I.

Është mbajtur procesverbali me nr. 615/2 prot., datë 02.03.2020, sipas të cilit është përcaktuar sasia e G it prej 369800 litra gjithsej, nisur nga konsumi i vitit 2019 në sasinë 304,908 litra, + 32040 litra (6 mjete të reja x 445 litra/muaj x 12 muaj) + 32852 litra konsumi i fabrikës (164 ditë/vit x 5 orë x 40.06 litra/orë. Në procesverbal citohet gjithashtu që është marrë në konsideratë edhe mbulimi i nevojave për karburant në fillimvitin 2021, deri në prokurimin e fondeve për këtë zë.

Sasia e benzinës pa plumb është llogaritur nga konsumi i vitit 2019 në sasinë 20000 litra (2275 litra/muaj x 8.8 muaj).

Janë marrë oferta nga tre shoqëri që operojnë në fushën e karburanteve dhe konkretisht “D ” ShPK, “E” Sha dhe “A” ShPK, për “G” dhe për benzinë pa plumb dhe është bërë mesatarja aritmetike e tre ofertave, për të nxjerrë çmimet për njësi të dy karburanteve 140.83 lekë/litër pa TVSh.

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit dhe specifikime teknike janë përcaktuar nga Njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 03.03.2020.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 03.03.2020, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës *“Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se është kërkuar që për certifikatat e cilësisë, *“... në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO”.* Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi në nenin 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, *“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 3 citohet “...Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.* Sa sipër, certifikatat ISO, si kërkesë teknike, mund të plotësohet nga i gjithë BOE. Gjithashtu është kërkuar që OE ofertues të paraqesin Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të vitit 2019 të Bashkisë Tiranë. Ky kriter është diskriminues, pasi përjashton operatorët ekonomikë që nuk operojnë në Bashkinë Tiranë

Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit me përbërje M.M, E.K dhe B.S .

Mbi vlerësimin e ofertave

Loti I (G)

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur, mallra”. Nisur nga procesverbali i hapjes së ofertave datë 30.03.2020 dhe verifikimi në SPE, për Lotin e parë (G), kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 2 OE/BOE, nga të cilët janë kualifikuar të dy OE/BOE.

Nr.	OE pjesëmarrës	Marzhi I fitimit
1	“K” ShPK & “R” SHPK	9%
2	“G” SHPK	22%

Burimi i të dhënave: DPRrNP

Punoi: KLSH

Në dosje administrohet procesverbali për vlerësimin e ofertave pa nr. prot, datë 31.03.2020. Nga auditimi në SPE i dokumentacionit të paraqitur nga BOE “K” ShPK & “R” SHPK, rezultoi se OE “R” SHPK nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të vitit 2019 në Bashkinë e Tiranës, siç kërkohet në pikën 2.2.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit. Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “*Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*”.

Loti II (Benzinë pa plumb)

Në lotin e dytë (benzinë pa plumb), nga verifikimi i procesverbalite të hapjes së ofertave datë 30.03.2020 dhe verifikimit në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë pjesë në procedurë 1 OE, i kualifikuar nga KVO, me ofertë marzh fitimi 24%.

Nr.	OE pjesëmarrës	Marzhi I fitimit
1	“G” SHPK	24%

Burimi i të dhënave: DPRrNP

Punoi: KLSH

Nga auditimi në SPE i dokumentacionit të paraqitur nga OE “G” SHPK, rezultoi se dokumentacioni është konform kriterëve të përcaktuara në DT dhe kualifikimi i këtij OE është i drejtë.

Nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 615/6, datë 09.04.2020, për të dy lotet, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.K.

Pas njoftimit të fituesit, respektivisht me shkresën nr. 615/7 prot., datë 09.04.2020 për Lotin I dhe me shkresën nr. 615/8 prot., datë 09.04.2020 për Lotin II, janë lidhur kontratat me shkresën nr. 615/13, datë 30.04.2020 me vlerë 62,494,721 lekë me TVSh për Lotin I me BOE “K” ShPK & “R” SHPK dhe me shkresën nr. 615/11, datë 21.04.2020 me vlerë 3,379,920 lekë me TVSh për Lotin II me OE “G” SHPK.

Me skualifikimin e BOE “K” ShPK & “R” SHPK në lotin I, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO nuk duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me këtë OE. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 62,494,721 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues

në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së F.A, M.K dhe M.N.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr.8 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se:

- Për parashikimin e zërit blerje karburanti viti 2020 jemi bazuar si më poshtë:

1-Jemi referuar konsumit të karburantit nga viti 2019:

- Për vitin 2019 konsumi i karburantit është 304.908 Litra, ku nga këto një sasi prej 8,010 Litra i përket konsumit të Administratës dhe benzinë 27,290 Lit.

2- Kemi parashikuar konsumin e karburantit edhe për mjetet e reja që do të blihen me anë të prokurimit gjatë vitit 2020

a- Trajler, fletëhyrje nr. 5, date 15.08.2020. Për konsumin e këtij mjeti jemi referuar mjetit afërsisht të ngjashëm me të nga fuqia motorrike si mjeti me targë AA 709 YI, i cili ka një konsum 55 Lit për 100/km dhe një konsum 2,860 Lit për periudhën 6 mujore nga momenti i blerjes. Konsumi mesatar në vite është 5,000 Lit.

b- Rrul, fletëhyrje nr 1 date 22.07.2020. Për konsumin e këtij mjeti jemi referuar mjetit të ngjashëm me të HAM 12 e cila ka konsum prej 5Lit/orë pune dhe një konsum vjetor prej 4,825 Lit naftë gjatë viti 2019. Duke iu referuar këtij mjeti dhe duke marrë parasysh faktin se na nevojitet një rul më i madh kemi parashikuar konsum mesatar rreth 7,540 Lit në vit.

c- Rul, fletëhyrje nr . 1, date 22.07.2020 për konsumin e këtij mjeti jemi referuar mjetit të ngjashëm me të HAM 12 e cila ka konsum prej 5L/orë pune dhe një konsum vjetor prej 4,825L naftë gjatë vitit 2019. Duke iu referuar këtij mjeti dhe duke marrë parasysh faktin se na nevojitet një Rrul më i vogël kemi parashikuar konsum mesatar rreth 4,000 Lit në vit.

d- Autokullë, fletëhyrje nr 6 date 10.09.2020. Për konsumin e këtij mjeti jemi referuar mjetit afërsisht të ngjashëm me të nga fuqia motorrike si mjeti me targë AA 334 VX e cila ka një konsum vjetor 9990 Lit, duke marrë një konsum mesatar kemi parashikuar 7,540 Lit.

e- Kamion 4-AKS, fletëhyrje nr 3 date 21.08.2020. Për konsumin e këtij mjeti jemi referuar mjetit të ngjashëm me të por me kapacitet më të vogël 3-Aks me targë AA 982 JF e cila ka një konsum vjetor gjatë vitit 2019 prej 4,380Lit. Duke qënë se mjeti 4-Aks është i një tonazhi më të lartë, kemi parashikuar një konsum mesatar prej 5,500 Lit në vit.

f- Kamionçinë,fletëhyrje nr 4, datë 21.08.2020 për konsumin e këtij mjeti i jemi referuar mjetit të ngjashëm me targë AA 855 UZ me një konsum 18Lit/100km dhe një konsum vjetor 4,380 Lit për gjatë viti 2019. Konsumi mesatar vjetor është përllogaritur 4,000 Lit.

Bashkëngjitur gjeni evidencën vjetore të konsumit të karburantit për vitin 2019 për cdo mjet edhe normativat e harxhimit të karburantit për cdo mjet edhe sipas drejtorive.Bashkëngjitur gjeni edhe fotokopjet e fletë-hyrjeve të mjeteve të cituara më lart të blera gjatë vitit 2020.

- Komisioni i ngritur me Urdhër të Titullarit me Nr. 615/2 Prot., datë 02.03.2020 për hartimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe grafikut të lëvrimit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karburanti” i është referuar nenit 59 “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës” të VKM-

së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , i ndryshuar , ku parashikohet shprehimisht se :

“1. Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.

2. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

c) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.”

Konkretisht në përlllogaritjen e fondit limit Komisioni i është referuar alternativës së çmimit të tregut duke bërë testim tregu. Janë marrë tre oferta për G 10 ppm ULSD dhe tre për benzinë nga tre operatorë ekonomikë të ndryshëm (“E”, “D” dhe “A”) që kanë objekt të veprimtarisë së tyre tregëtimin e karburanteve. Çmimi për njësi i ofertuar nga operatorët ekonomikë është përlllogaritur nga vetë operatorët ekonomikë. Bashkëlidhur do të gjeni procesverbalin e llogaritjes së fondit limit dhe ofertat. Për sa më lart, Komisioni gjykon se ka vepruar në përputhje të plotë me pikën 2, gërma a) të nenit 59 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar duke zgjedhur një nga mënyrat që ka parashikuar ligji.

2. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për taksat vendore sqarojmë se ky kriter nuk është përjashtues dhe nuk ka patur për qëllim diskriminimin e operatorëve ekonomik apo përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në tender. Duke qenë se Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik është drejtori në varësi të Bashkisë Tiranë është kërkuar që operatorët që ushtrojnë aktivitetin në territorin e kësaj bashkie të paraqesin taksat vendore si një nga detyrimet më minimale në rast se marrin pjesë në tendera dhe të përfitojnë nga fondet publike vendore. Pra, një operator që konkuron në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga DPRRNP minimalisht duhet të ketë paguar taksat vendore. Në rast se OE nuk e ushtron aktivitetin e tij në territorin e Bashkisë së Tiranës, nuk paraqet taksat vendore të Bashkisë Tiranë dhe rrjedhimisht nuk përbën shkak për skualifikim mosparaqitja e tyre.

Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

Vlen për tu përmendur fakti se edhe nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ky kriter është kuptuar si një kriter jo përjashtues, gjë e cila duket në qëndrimin që ka mbajtur ky komision duke mos e skualifikuar njërin prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës, i cili nuk ka paraqitur taksat e Bashkisë Tiranë pasi e ushtron aktivitetin e tij në një bashki tjetër dhe ka paraqitur taksat respektive.

3. Çertifikatë ISO 9001-2015

Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit

efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

Për sa u sqarua më lart, çdo operator ekonomik pjesëmarrës në tenderat duhet të jete i pajisur me këto ISO pavarësisht ndarjes së furnizimit në % në BOE . Ky kriter nuk konsiderohet i përmbushur nëse ISO paraqitet vetëm nga njëri prej tyre. Sido që të ndahet % midis OE, secili prej tyre do të kryejë një aktivitet (furnizim) të caktuar dhe secili prej tyre duhet të faktoj se plotëson standartin, i cili përcakton kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë. Theksojmë se kjo është një ndër ISOT më bazike që disponohet pothuajse nga pjesa më e madhe e OE.

Çertifikatë ISO 14001-2015

Kjo çertifikatë ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Është pranuar në mbarë botën se burimet e botës sonë, që po pakësohen nga dita në ditë, nuk janë të pafundme dhe se ndikimet mjedisore të produkteve dhe aktiviteteve nuk janë lokale dhe rajonale por globale. Ky ndërgjegjësim ka sjellë nevojën për të kontrolluar ndikimet mjedisore. Të qenit i pranishëm në tregun lokal dhe atë global, tani po matet me respekt dhe respekt që u jepet njerëzve. Përveç përmbushjes së pritshmërive dhe nevojave të konsumatorëve të sotëm në nivelin më të lartë, kërkohet që të vlerësohet dhe respektohet mjedisi dhe bota në të cilën jetojmë.

Këto zhvillime kanë zbuluar faktin se ekziston një nevojë për sisteme menaxheriale që do t'u mundësojnë bizneseve të mbajnë nën kontroll ndërveprimet e tyre me mjedisin dhe të përmirësojnë vazhdimisht aktivitetet dhe arritjet e tyre mjedisore. ISO 14001 është një standard i sistemit, i cili bazohet në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore. Ajo është në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni përkatës dhe ligjet në lidhje me faktorët e mjedisit. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit quhet Sistemi i menaxhimit që çdo kompani zhvillon për reduktimin sistematik dhe eliminimin e mundshëm të dëmeve që ato mund të shkaktojnë në mjedis. Pra si rezultat i këtij gjykimi menaxhimi i mjedisit që ka lidhje me çertifikatën ISO 14001:2015 është standart me të cilin duhet të operojë çdo kompani pavarësisht fushës së saj të aktivitetit apo madhësisë së saj. Ky standart tregon se kompania gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj operon në përputhje me parimet e mbrojtjes së ekosistemit dhe minimizimin e efekteve negative në mjedis.

Për sa u sqarua më lart, çdo operator ekonomik pjesëmarrës në tenderat duhet të jete i pajisur me këto ISO pavarësisht ndarjes së furnizimit në % në BOE. Ky kriter nuk konsiderohet i përmbushur nëse ISO paraqitet vetëm nga njëri prej tyre. Sido që të ndahet % midis OE, secili prej tyre do të kryejë një aktivitet (furnizim) të caktuar dhe secili prej tyre duhet të faktoj se plotëson standartin i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të mjedisit. Theksojmë se kjo është një ndër ISOT më bazike që disponohet pothuajse nga pjesa më e madhe e OE.

4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se ka vepruar drejtë me kualifikimin e OE "R" sh.a, duke u nisur nga parimi i mosdiskriminimit dhe mospërrjashtimit të asnjë operatori ekonomik pjesëmarrës, i cili nuk ushtron veprimtarinë e tij në territorin e Bashkisë Tiranë. Gjithashtu KVO-ja është udhëhequr edhe nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike, parimi i rritjes së efikasitetit dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit pasi BOE "K" sh.p.k dhe "R" sh.a kanë ofruar ofertën më të ulët duke u renditur të parët me marzh fitimi 9%.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z. E.K, z. B.S dhe antarët e KVO-së z.F.A, z.J.J, z.M.N.

1. Në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit, grupi i auditimit, pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumentacionit shoqërues të tij, e merr në konsideratë në hartimin e **Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për taksat vendore në qytetin e Tiranës, pretendimi juaj nuk është i argumentuar teknikisht dhe **si i tillë ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

3. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për pajisjen me certifikatat ISO për të gjithë antarët e bashkimit vtë operatorëve, pretendimi juaj është i paargumentuar teknikisht dhe **si i tillë ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

4. Në lidhje me kualifikimin e OE fitues pa plotësuar kriterin e vendosur në DT në lidhje me taksat lokale, sqarojmë se KVO, në zbatim të nenit 53, pika 3 të LPP-së Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe Neni 58 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar, duhet të kishte bërë skualifikimin e këtij OE.
Ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

4. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje lëndë djegëse për përdorim teknik, civil dhe industrial”, DPRrNP

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse për përdorim teknik, civil dhe industrial”, DPRrNP, Nr. REF-53091, datë 03-05-2020.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 779/3, datë 12.03.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 779/1, datë 12.03.2020	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 779/4, datë 12.03.2020
2. Lloji i Procedurës – “E hapur, mallra”	1. B.S 2. Q.X 3. I.B 1. Urdhër Prokurimi Nr. 779/3, datë 12.03.2020 Njësia e Prokurimit 1. M.M , Personi përgjegjës, jurist 2. E.K , Jurist 3. B.S Inxhinier (specialist i fushës)	1. F.A, Kryetar 2. J.J 3. M.N
5. Fondi Limit (pa TVSh) 35,220,898 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “T” ShPK me marzh fitimi 45% sipas kontratës nr. 779/9, datë 07.05.2020 me afat deri në darën 31.12.2020.	7. Diferenca me fondin limit
8. Data e hapjes së tenderit Datë 221.04.2020	9. Burimi Financimit Transfertë nga Buxheti i Bashkisë Tiranë 2020	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S’kualifikuar 0 BOE c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur, mallra”, me vlerë 35,220,898 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (DPRrNP), transfertë nga Buxheti i Bashkisë Tiranë 2020.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet kërkesa me nr. 779, datë 12.03.2020 e Drejtorisë së Prodhimit dhe Mirëmbajtjes, për realizimin e kësaj procedure prokurimi.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit dhe hartimi i specifikimeve teknike, janë hartuar nga grupi i punës të ngritur për këtë qëllim me Urdhrin nr. 779/1, datë 12.03.2020 të titullarit të AK z. E.K, me përbërje B.S, Q.X dhe I.B.

Është mbajtur procesverballi me nr. 779/2 prot., datë 12.03.2020, sipas të cilit është përcaktuar sasia e solarit prej 329655 litra gjithsej, nisur nga Akmarrëveshja me nr. 2144/12 Prot, datë 10.12.2019, ku është përcaktuar çmimi 106.8416 lekë/kg pa TVSH nga shoqëria “T” Sha.

Gjithashtu, përlogaritja e fondit limit (i cili realisht ka ardhur që në kërkesën e bërë nga Drejtoria e Prodhimit dhe Asfaltimit dhe jo nga grupi i punës së ngritur për këtë qëllim), nuk është bërë pas një kërkesë të detajuar të Drejtorisë së Prodhimit dhe Asfaltimit në lidhje me nevojat vjetore për solar (sipas nevojave për asfalte dhe normave të harxhimit të solarit/ton asfalt), si dhe duke marrë në konsideratë edhe stokun e magazinuar në ambientet e operatorit kontraktor të vitit parardhës. Sa sipër, përlogaritja e fondit limit nuk është bërë e argumentuar teknikisht.

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit dhe specifikime teknike janë përcaktuar nga Njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverballit pa nr. prot, datë 12.03.2020.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet procesverballit datë 12.03.2020, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës *“Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

-Është kërkuar që OE ofertues të paraqesin Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të vitit 2019 të Bashkisë Tiranë. Ky kriter është diskriminues, pasi përjashton operatorët ekonomikë që nuk operojnë në Bashkinë Tiranë.

- Është kërkuar që për certifikatat e cilësisë, *“... në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO”.* Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi në nenin 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, *“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 3 citohet “...Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.* Sa sipër, certifikatat ISO, si kërkesë teknike, mund të plotësohet nga i gjithë BOE.

Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit me përbërje M.M, E.K dhe B.S.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur, mallra”. Nisur nga procesverbali i hapjes së ofertave dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 2 OE, me ofertat si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Marzhi I fitimit
1	“R” SHPK	52%
2	“T” SHPK	45%

Burimi i të dhënave: DPRrNP

Punoi: KLSH

Në dosje administrohet procesverbali për hapjen e ofertave pa nr. prot, datë 21.04.2020 dhe procesverbali për shqyrtimin e ofertave pa nr. prot, datë 22.04.2020. Sipas këtij procesverbali, KVO ka kualifikuar të dy OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 779/6, datë 30.04.2020, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.K.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se OE i shpallur fitues “T” SHPK, nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT, pasi nga verifikimi në SEP, rezulton se mungon kontrata e nënshkruar dhe vërtetimi për realizim të suksesshëm të kontratës me Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, siç kërkohet në DT.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.”.

Pas njoftimit të fituesit, me shkresën nr. 779/7 prot., datë 30.04.2020 është lidhur kontrata me shkresën nr. 779/9, datë 07.05.2020 me vlerë 42,265,078 lekë me TVSh dhe marzh fitimi 45%. Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO nuk duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me këtë OE. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 42,265,078 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së F.A, J.J dhe M.N.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr.9 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se:

1. Në lidhje me kapacitetin e kërkuar të autobotit (minimalisht 20.000 litra) sqarojmë se:

Së pari, kur është zhvilluar kjo procedurë prokurimi fabrika për prodhimin e asfaltit dhe depozita për lëndën djegëse në funksion të kësaj fabrike ndodheshin në fund të rrugës ”5 maji”, instaluar aty që rreth viteve 1960 (Sot ky vend nuk ekziston pasi janë ndërtuar pallate). Vendi ku futej boti dhe shkarkonte lëndën djegëse në depozitë ka qenë i tillë që nuk lejonte mundësinë e aksesimit nga një autobot me kapacitet më të madh se 20.000 litra pasi shkarkimi bëhej me nivel që do të thotë shkarkohej me

vetërrjedhje duke u pozicionuar autoboti në një vend më të ngritur. Si rrjedhim, duke u nisur nga eksperiencia shumëvjeçare furnizimi me autobot më të madh ka dështuar. Në këto kushte, për të mos çuar në dështimin e furnizimit, humbjen e kohës dhe gjithashtu uljen e kostove të panevojshme për operatorin ekonomik është vendosur një kapacitet maksimal i lejuar prej 20.000 litrash.

Së dyti, kapaciteti i depozitës që u përmend më lart nuk i kalon 20.000 litra dhe rrjedhimisht është në proporcion të drejtë me kërkesën e kapacitetit maksimal të kërkuar për autobotin.

Së treti, autobotet me kapacitet deri në 20.000 litra klasifikohen tek autobotet më të përhapura dhe me përdorim më të gjerë në fushën e furnizimit me lëndë djegëse për vetë madhësinë e tyre duke ofruar komoditet dhe lehtësi në qarkullim brenda qytetit të Tiranës.

Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

Për sa më lart gjykojmë se ky kriter është plotësisht i argumentuar dhe nuk është përjashtues.

2. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për taksat vendore sqarojmë se ky kriter nuk është përjashtues dhe nuk ka patur për qëllim diskriminimin e operatorëve ekonomik apo përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në tender. Duke qenë se Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndrçimit Publik është drejtori në varësi të Bashkisë Tiranë është kërkuar që operatorët që ushtrojnë aktivitetin në territorin e kësaj bashkie të paraqesin taksat vendore si një nga detyrimet më minimale në rast se marrin pjesë në tendera dhe të përfitojnë nga fondet publike vendore. Pra, një operator që konkuron në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga DPRRNP minimalisht duhet të ketë paguar taksat vendore. Në rast se OE nuk e ushtron aktivitetin e tij në territorin e Bashkisë së Tiranës, nuk paraqet taksat vendore të Bashkisë Tiranë dhe rrjedhimisht nuk përbën shkak për skualifikim mosparaqitja e tyre.

Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

Vlen për tu përmendur fakti se edhe nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ky kriter është kuptuar si një kriter jo përjashtues, gjë e cila duket në qëndrimin që ka mbajtur ky komision duke mos e skualifikuar njërin prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës, i cili nuk ka paraqitur taksat e Bashkisë Tiranë pasi e ushtron aktivitetin e tij në një bashki tjetër dhe ka paraqitur taksat respektive.

3. Çertifikatë ISO 9001-2015

Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

Për sa u sqarua më lart, çdo operator ekonomik pjesëmarrës në tenderat duhet të jete i pajisur me kete ISO pavaresisht ndarjes se furnizimit ne % ne BOE . Ky kriter nuk konsiderohet i permbushur nese ISO paraqitet vetem nga njëri prej tyre. Sido qe te ndahet % midis OE, secili prej tyre do të kryejë një aktivitet (furnizim) të caktuar dhe secili prej tyre duhet të faktoj se ploteson standartin i cili përcakton kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë. Theksojmë se kjo është një ndër ISOT më bazike që disponohet pothuajse nga pjesa më e madhe e OE.

Çertifikatë ISO 14001-2015

Kjo çertifikatë ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Është pranuar në mbarë botën se burimet e botës sonë, që po pakësohen nga dita në ditë, nuk janë të pafundme dhe se ndikimet mjedisore të produkteve dhe aktiviteteve nuk janë lokale dhe rajonale por globale. Ky ndërgjegjësim ka sjellë nevojën për të kontrolluar ndikimet mjedisore. Të qenit i pranishëm në tregun lokal dhe atë global, tani po matet me respekt dhe respekt që u jepet njerëzve. Përveç përmbushjes së pritshmërive dhe nevojave të konsumatorëve të sotëm në nivelin më të lartë, kërkohet që të vlerësohet dhe respektohet mjedisi dhe bota në të cilën jetojmë.

Këto zhvillime kanë zbuluar faktin se ekziston një nevojë për sisteme menaxheriale që do t'u mundësojnë bizneseve të mbajnë nën kontroll ndërveprimet e tyre me mjedisin dhe të përmirësojnë vazhdimisht aktivitetet dhe arritjet e tyre mjedisore. ISO 14001 është një standard i sistemit, i cili bazohet në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore. Ajo është në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni përkatës dhe ligjet në lidhje me faktorët e mjedisit. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit quhet Sistemi i menaxhimit që çdo kompani zhvillon për reduktimin sistematik dhe eliminimin e mundshëm të dëmeve që ato mund të shkaktojnë në mjedis. Pra si rezultat i këtij gjykimi menaxhimi i mjedisit që ka lidhje me çertifikatën ISO 14001:2015 është standart me të cilin duhet të operojë çdo kompani pavarësisht fushës së saj të aktivitetit apo madhësisë së saj. Ky standart tregon se kompania gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj operon në përputhje me parimet e mbrojtjes së ekosistemit dhe minimizimin e efekteve negative në mjedis.

Për sa u sqarua më lart, çdo operator ekonomik pjesëmarrës në tenderat duhet të jete i pajisur me kete ISO pavaresisht ndarjes se furnizimit ne % ne BOE . Ky kriter nuk konsiderohet i permbushur nese ISO paraqitet vetem nga njëri prej tyre. Sido qe te ndahet % midis OE, secili prej tyre do të kryejë një aktivitet (furnizim) të caktuar dhe secili prej tyre duhet të faktoj se ploteson standartin i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të mjedisit. Theksojmë se kjo eshte një ndër ISOT më bazike që disponohet pothuajse nga pjesa më e madhe e OE.

4. Në lidhje me kualifikimin e OE "T" sh.a Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sqaron si mëposhtë vijon:

Një nga kriteret teknike të kërkuara në DST është që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të provojnë se kanë kryer furnizime të ngjashme gjatë 3 viteve të fundit në një vlerë jo më pak se 40 % të fondit limit duke paraqitur kontrate, vertetim realizimi me sukses dhe faturat tatimore në rast se kemi të bejme me furnizime të realizuara me institucione shtetërore ose vetem faturat tatimore per furnizime te realizuara me subjekte private.

Qëllimi i këtij kriteri është që Autoriteti Kontraktor të krijojë bindjen se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë përvojën e duhur dhe i ofrojnë siguri dhe besueshmëri atij se do ta realizojnë me sukses kontratën.

Operatori ekonomik "T" sh.p.k ka furnizuar me sukses autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtoreve të Qytetit që nga viti 2017 dhe ka nënshkruar kontratat e mëposhtme:

Kontratë furnizimi me objekt "Blerje solar" me nr. 6/17 Prot., datë 19.06.2017 me vlerë 31.983.880 lekë pa tvsh.

Kontratë furnizimi me objekt "Blerje solar" me nr. 3406/9 Prot., datë 27.12.2018 me vlerë 20.631.188 lekë pa tvsh.

Kontratë furnizimi me objekt "Blerje solar" me nr. 2144/9 Prot., datë 26.08.2019 me vlerë 31.350.000 lekë me tvsh. (Bashkëlidhur kontratat).

KVO gjatë procesit të vlerësimit ka verifikuar kontratat e sipërpërmendura, faturat korresponduese dhe vërtetimet e realizimit të lëshuara nga AK-ja për realizimin me sukses të kontratave që cituara dhe ka krijuar bindjen e plotë se ky operator mund të përmbushë me sukses kontratën me përvojën që ka.

Ndodhur para këtyre fakteve, KVO gjatë vlerësimit të procedurës është udhëhequr nga qëllimet e legjislacionit të prokurimit publik siç është rritja e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit

publik të kryera nga autoritetet kontraktore si dhe të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike (OE i renditur i pari) dhe të ulë shpenzimet procedurale;

Sjellim në vëmendje se ky qëndrim që ka mbajtur KVO në vitin 2020 është sanksionuar më vonë në nenin 26 , pika 5 të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se : “Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.”

Në përfundim, KVO gjykon se ka vepruar drejtë pasi ka krijuar bindjen e plotë se operatori “T” sh.a, i cili ka paraqitur ofertën më të ulët, ka një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referencat e përshtatshme nga kontratat e zbatuara në vitet 2017-2018-2019 me Drejtorinë e Përgjithshme Nr.2 të Punëtoreve të Qytetit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shprehjen e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z. E.K , z. B.Sdhe antarët e KVO-së z.F.A , z.J.J , z.M.N.

1. Në lidhje me kriterin e vendosur për autobotin me kapacitet deri në 20000 lit, grupi i auditimit, pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumentacionit shoqëruar të tij, e **merr në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për taksat vendore në qytetin e Tiranës, pretendimi juaj nuk është i argumentuar teknikisht dhe **si i tillë ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

3. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për pajisjen me certifikatat ISO për të gjithë antarët e bashkimit të operatorëve, pretendimi juaj është i paargumentuar teknikisht dhe **si i tillë ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

4. Në lidhje me kualifikimin e OE fitues pa plotësuar kriterin e vendosur në DT në lidhje me eksperiencën e ngjashme, sqarojmë se KVO, në zbatim të nenit 53, pika 3 të LPP-së Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe Neni 58 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar, duhet të kishte bërë skualifikimin e këtij OE, pasi nuk kishte paraqitur dokumentacionin e kërkuar. Përsa i përket pretendimit se ky OE ka furnizuar më parë DPRrNP, sqarojmë se në DT është kërkuar të paraqiten dokumente që ta vërtetojnë plotësimin e këtij kriteri dhe nga OE i shpallur fitues, nuk ishin paraqitur.

Ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

5. Procedura e prokurimit me objekt “Materiale për sinjalistikë (Shtylla LED)”, DPRrNP

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Materiale për sinjalistikë (Shtylla LED)”, DPRrNP, Nr. REF-53082, datë 03-05-2020.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 1086/3, datë 13.05.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 1086/1, datë 08.05.2020	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1086/4, datë 13.05.2020
2. Lloji i Procedurës – “E hapur, mallra”	1. A.RR 2. O.GJ 3. M.P 1. Urdhër Prokurimi Nr. 1086/3, datë 05.03.2020	1. P.S, Kryetar 2. Y.L 3. M.N

	Njësia e Prokurimit 1. M.M, Personi përgjegjës, jurist 2. E.K, Jurist 3.A.RR, Inxhinier (specialist i fushës)	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 22,141,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "S" ShPK me ofertë ekonomike 20,835,000 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 1086/9 prot, dt. 09.07.2020 me afat 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit 1,306,000 lekë, ose 5.9%
8. Data e hapjes së tenderit Datë 08.06.2020	9. Burimi Financimit Transfertë nga Buxheti i Bashkisë Tiranë 2020	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) S'kualifikuar 0 BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është "E Hapur, mallra", me vlerë 22,141,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (DPRrNP).

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet kërkesa me nr. 1086, datë 08.05.2020 e Drejtorisë së Ndriçimit Publik dhe Sinjalistikës Rrugore, për realizimin e kësaj procedure prokurimi.

Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga grupi i punës të ngritur për këtë qëllim me Urdhrin nr. 1086/1, datë 08.05.2020 të titullarit të AK z. E.K, me përbërje A.RR dhe M.P. Sipas proceverbalit me nr. 1086/2 prot, datë 12.05.2020 të këtij grupi pune, janë përcaktuar sasitë e mallrave që do të kërkohen, si dhe specifikimet teknike të tyre dhe ëshë bërë testimi i tregut. Në dosjen e prokurimit administrohen ofertat e dhëna nga subjektet "E" ShPK, "R.S. & M" ShPK dhe "F" ShPK me vlerat respektive 22,124,000 lekë pa TVSh, 22,141,000 lekë pa TVSh dhe 22,158,000 lekë pa TVSh. Grupi i punës ka bërë mesataren aritmetike të tre ofertave dhe ka përcaktuar fondin limit në vlerën 22,141,000 lekë pa TVSh.

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike janë përcaktuar nga Njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 05.03.2020, dhe pas shtojcës së modifikimeve datë 25.03.2020 (hedhur në system).

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton se janë argumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 12.05.2020, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se është kërkuar që OE ofertues të paraqesin:

- Çertifikatë **ISO 9001-2015** dhe Çertifikatë **ISO 14001-2015** (të vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO). *Kërkesa për secilin anëtar të BOE është e paargumentuar ligjërish, pasi ky kriter hyn në kriteret profesionale, të cilat duhet të plotësohen nga i gjithë BOE dhe jo nga secili anëtar i tij.*

- Kamion me vinç, me peshëmbajtje jo më pak se 10 ton. *Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi së pari është procedurë prokurimi Mall dhe jo punë dhe së dyti, asnjë nga materialet e kërkuara, nuk ka peshe më të madhe se 10 ton.*

Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit me përbërje M.M , E.K , Jurist dhe A.RR , inxhinier.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur, mallra”. Nisur nga procesverbali i hapjes së ofertave dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe ka marrë në pjesë në procedurë OE, me ofertën ekonomike si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike
1	“S” SHPK	20,835,000

Burimi i të dhënave: DPRrNP

Punoi: KLSH

Në dosje administrohet procesverbali për shqyrtimin e ofertave, sipas të cilit, KVO ka vendosur kualifikimin e OE pjesëmarrës i vetëm në këtë tender, pasi plotëson kriteret e kërkuara në DT. Nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 1086/6, datë 01.07.2020, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.K.

Pas njoftimit të fituesit, me shkresën nr. 1086/10 prot., datë 09.07.2020 është lidhur kontrata me shkresën nr. 1086/9, datë 09.07.2020 me vlerë 25,002,000 lekë me TVSh.

Nga auditimi në SPE të dokumentacionit të OE “S” ShPK, i shpallur fitues, rezulton se kualifikimi i tij nga KVO, është i drejtë.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr.10 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se:

1. Çertifikatë ISO 9001-2015

Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së.

Për sa u sqarua më lart, çdo operator ekonomik pjesëmarrës në tenderat duhet të jete i pajisur me kete ISO pavaresisht ndarjes se furnizimit ne % ne BOE. Ky kriter nuk konsiderohet i permbushur nese ISO paraqitet vetem nga njëri prej tyre. Sido qe te ndahet % midis OE, secili prej tyre do të kryejë një aktivitet (furnizim) të caktuar dhe secili prej tyre duhet të faktoj se ploteson standartin i cili përcakton kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë. Theksojmë se kjo është një ndër ISOT më bazike që disponohet pothuajse nga pjesa më e madhe e OE.

Çertifikatë ISO 14001-2015

Kjo çertifikatë ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Është pranuar në mbarë botën se burimet e botës sonë, që po pakësohen nga dita në ditë, nuk janë të pafundme dhe se ndikimet mjedisore të produkteve dhe aktiviteteve nuk janë lokale dhe rajonale por globale. Ky ndërgjegjësim ka sjellë nevojën për të kontrolluar ndikimet mjedisore. Të qenit i pranishëm në tregun lokal dhe atë global, tani po matet me respekt dhe respekt që u jepet njerëzve. Përveç përmbushjes së pritshmërive dhe nevojave të konsumatorëve të sotëm në nivelin më të lartë, kërkohet që të vlerësohet dhe respektohet mjedisi dhe bota në të cilën jetojmë.

Këto zhvillime kanë zbuluar faktin se ekziston një nevojë për sisteme menaxheriale që do t'u mundësojnë bizneseve të mbajnë nën kontroll ndërveprimet e tyre me mjedisin dhe të përmirësojnë vazhdimisht aktivitetet dhe arritjet e tyre mjedisore. ISO 14001 është një standard i sistemit, i cili bazohet në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore. Ajo është në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni përkatës dhe ligjet në lidhje me faktorët e mjedisit. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit quhet Sistemi i menaxhimit që çdo kompani zhvillon për reduktimin sistematik dhe eliminimin e mundshëm të dëmeve që ato mund të shkaktojnë në mjedis. Pra si rezultat i këtij gjykimi menaxhimi i mjedisit që ka lidhje me çertifikatën ISO 14001:2015 është standart me të cilin duhet të operojë çdo kompani pavarësisht fushës së saj të aktivitetit apo madhësisë së saj. Ky standart tregon se kompania gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj operon në përputhje me parimet e mbrojtjes së ekosistemit dhe minimizimin e efekteve negative në mjedis.

Për sa u sqarua më lart, çdo operator ekonomik pjesëmarrës në tenderat duhet të jete i pajisur me kete ISO pavaresisht ndarjes se furnizimit ne % ne BOE . Ky kriter nuk konsiderohet i permbushur nese ISO paraqitet vetem nga njëri prej tyre. Sido qe te ndahet % midis OE, secili prej tyre do të kryejë një aktivitet (furnizim) të caktuar dhe secili prej tyre duhet të faktoj se ploteson standartin i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të mjedisit. Theksojmë se kjo është një ndër ISOT më bazike që disponohet pothuajse nga pjesa më e madhe e OE.

2.Njësia e prokurimit për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të OE ka kërkuar që të paraqesë dëshmi për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën me sukses.

Duke u nisur nga rëndësia dhe natyra e kontratës Njësia kërkon të garantohet se malli objekt prokurimi do të dorezohet në magazinën e AK-së brenda afateve kohore të parashikuara në kontratë, pa dëmtime. Janë kërkuar në total 55 shtylla, nga të cilat 12 janë të mëdha, njëtrupshe, me gjatësi krahu të harkuar prej 6 m dhe 43 copë janë 4 m të larta.

Për shkak të gjatësisë së krahut të shtyllave të larta prej 6 m kërkohet një kamion minimalisht 10 ton, pasi përmasat e kazanit garantojnë transportin e një numri më të madh shtyllash në kohë më të shpejtë, pa dëmtuar shtyllat dhe modulet (-çipat) LED të cilat janë të inkorporuara në të gjithë gjatësinë e tyre,

si ne pjesen vertikale edhe ne ate horizontale. Per keto arsye, gjykojmë se kërkesa per mjet te nje tonazhi te tille eshte plotesisht e argumentuar.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z. E.K, z. A.RR.

1. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për pajisjen me certifikatat ISO për të gjithë antarët e bashkimit vtë operatorëve, pretendimi juaj është i paargumentuar teknikisht dhe **si i tillë ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**
2. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për kamionin mbi 10 t, pretendimi juaj nuk është i argumentuar teknikisht dhe **si i tillë ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

6. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje pllaka dhe bordura”, DPRrNP

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje pllaka dhe bordura”, DPRrNP, Nr. REF-64088, datë 07-03-2020.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 1606/3, datë 03.07.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 1606/1, datë 01.07.2020	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1606/4, datë 03.07.2020
2. Lloji i Procedurës – “E hapur, mallra”	1. B.T 2. M.K 3. N.D 1. Urdhër Prokurimi Nr. 1606/3, datë 03.07.2020 Njësia e Prokurimit 1. M.M , Personi përgjegjës, jurist 2. E.K , Jurist 3. B.T , Inxhinier (specialist i fushës)	1. F.A, Kryetar 2. I.B 3. M.N
5. Fondi Limit (pa TVSh) 26,053,500 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “K.T ” ShPK me vlerë 24,708,500 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 1606/16 prot, dt. 03.09.2020 me afat deri në darën 31.12.2020.	7. Diferenca me fondin limit 1,345,000 lekë, ose 5.16%
8. Data e hapjes së tenderit Datë .2020	9. Burimi Financimit Transfertë nga Buxheti i Bashkisë Tiranë 2020	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) S’kualifikuar 1 BOE c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime; ankesë OE “B” ShPK, daë 11.08.2020	12. Përgjigje ankesës shkresa nr. 1606/11 prot., datë 17.08.2020	

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur, mallra”, me vlerë 26,053,500 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (DPRrNP).

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet kërkesa me nr. 1606, datë 11.03.2020 e Drejtorisë së Prodhimit dhe Mirëmbajtjes, për nevojën për blerje të këtyre mallrave.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit dhe hartimi i specifikimeve teknike, janë hartuar nga grupi i punës të ngritur për këtë qëllim me Urdhrin nr. 1606/1, datë 01.07.2020 të titullarit të AK z. E.K, me përbërje B.T, M.K dhe N.D.

Është mbajtur procesverbali me nr. 1606/2 prot., datë 03.07.2020, sipas të cilit është përcaktuar sasia sipas llojeve të pllakave të trouarit dhe bordurave dhe specifikime teknike për këto mallra, si dhe është bërë testimi i tregut.

Në dosjen e prokurimit administrohen ofertat e dhëna nga subjektet “K.T” ShPK, “A” ShPK dhe “K” ShPK me vlerat respektive 22,537,450 lekë pa TVSh, 27,885,100 lekë pa TVSh dhe 27,677,950 lekë pa TVSh. Grupi i punës ka bërë mesataren aritmetike të tre ofertave dhe ka përcaktuar fondin limit në vlerën 26,023,500 lekë pa TVSh.

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit dhe specifikime teknike janë përcaktuar nga Njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 03.07.2020.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 03.07.2020, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës *“Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se është kërkuar që për certifikatat e cilësisë, *“... në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO”.* Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi në nenin 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, *“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 3 citohet “...Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.* Sa sipër, certifikatat ISO, si kërkesë teknike, mund të plotësohet nga i gjithë BOE.

- Është kërkuar që “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar, minimumi 1 (një) inxhinier ndërtimi, për të cilin duhet të paraqesë kontratën e punës, diplomën si dhe listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit, ku të figurojë i regjistruar. Për inxhinierin lejohet të paraqitet edhe kontratë bashkëpunimi”. Ky kriter është i panevojshëm pasi kjo procedurë është “Blerje mallra” dhe jo “Punë” dhe si e tillë, nuk ka pse të kërkohet prania e një inxhinieri ndërtimi.

- Është kërkuar disponimi i një kamioni me vinç me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton. Tonazhi i këtij kamioni është i paargumentuar teknikisht, pasi ky tonazh do të thotë që vinçi i

kamionit të ngrejë më shumë se 4 m³ pllaka betoni apo bordura betoni njëherësh, gjë që nuk është domosdoshmëri gjatë lëvrimin të mallit.

Është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të paraqesë Lejen Mjedisore (**Kodi III.1.B**) Ky kriter nuk është në natyrën e objektit që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 3 të nenit 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “...Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”. Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit me përbërje M.M, E.K, Jurist dhe B.T.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur, mallra”. Nisur nga procesverbali i hapjes së ofertave datë 29.07.2020 dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 3 OE, nga të cilët janë kualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Marzhi I fitimit
1	“B” SHPK	18,736,960
2	“H” SHPK	25,669,700
3	“K.T” SHPK	24,708,500

Burimi i të dhënave: Bashkia DPRrNP

Punoi: KLSH

Në dosje administrohet procesverbali për shqyrtimin e ofertave pa nr. prot, datë 06.08.2020.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është skualifikuar OE “B” për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi. Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.”*

- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar prej prodhuesit për mallin, objekt prokurimi “Pllakë, tip terracotë” me përmasa 30x70x2 cm.

- Në lidhje me mallrat prej mermeri/guri, operatori ekonomik ka paraqitur kontratë furnizimi me shoqërinë “G” sh.p.k. Në këtë kontratë shoqëria “G” sh.p.k nuk ka deklaruar prodhuesin ose distributorin e autorizuar prej të cilit furnizohet.

- Në lidhje me pigment/ngjyrues betoni, operatori ekonomik ka paraqitur kontratë furnizimi me shoqërinë “Z” sh.p.k. Në këtë kontratë shoqëria “Z” sh.p.k nuk ka deklaruar prodhuesin ose distributorin e autorizuar prej të cilit furnizohet.

2. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë raportet e testimit, për produktet e betonit sipas standartit SSH EN 1338, për produktet prej mermeri/guri sipas standartit SSH EN 196 dhe për pigment/ngjyrues betoni sipas standartit SH EN ISO 787, nga laboratorë të çertifikuar dhe akredituar, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike. Për standartet e përmendura pranohet dhe ekuivalenti i tyre.”*

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur raport testimi për mallrat, objekt prokurimi si mëposhtë vijon:

Nr.	Emërtimi	Dimensione (cm)
1	Pllaka trotuari, T=6 cm, pa ngjyrë (gri)	10x20
2	Pllaka trotuari, T=6 cm, me ngjyrë (e kuqe)	10x20
3	Pllaka trotuari (në formë dopio T), T=6 cm pa ngjyrë (gri)	20x15x10
4	Pllaka trotuari (në formë dopio T), T=6 cm me ngjyrë (e kuqe)	20x15x10
5	Pllaka trotuari T = 6 cm, pa ngjyrë (gri) /e kombinuar	30x30
6	Pllaka trotuari T = 6 cm, me ngjyrë (e zezë) /e kombinuar	15x30
7	Pllaka trotuari, tip TRISS T=6 cm	16x26 / 16x16 / 10x16
8	Pllaka trotuari T=6 cm, me ngjyrë (e zezë)	20x20
9	Pllaka trotuari T=6 cm, me ngjyrë (e bardhë)	10x10
10	Pllaka trotuari T=4 cm, e presuar, dekorative me kombinim ngjyrash bardh e zi	40x40
11	Pllakë, tip terracotë	30x7x2
12	Pllakë mermeri/guri, me dimensione të ndryshme T=4 cm	
13	Pllaka trotuari T=8 cm, pa ngjyrë (gri)	50x50
14	Pllaka mermeri/granit, me shënimin “Mos pështy në tokë”	50x40x4
15	Bordurë betoni kufizuese, e plotë	12x25x100
16	Bordurë betoni kufizuese, e plotë	20x30x100
17	Bordurë betoni lulishte	8x15x100
18	Kubik guri	10x10x10

Gjithashtu, nga KVO janë vlerësuar edhe dy OE e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë, të cilët janë kualifikuar me argumentin se i plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Me shkresën e protokolluar në DPRrNP me nr 1606/6 prot, datë 11.08.2020, OE “B” ShPK është ankuar pranë AK për skualifikimin e padrejtë dhe rivlerësimin e ofertës, duke pretenduar që dokumentet e hedhura nga ky OE në SPE, të cilësuar “të munguara” nga KVO, janë të plota, sipa kërkesave të DT.

Pas pezullimit të procedurës me shkresën nr. 1606/7, datë 11.08.2020, me shkresën nr. 1606/8, datë 11.08.2020 është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) me përbërje J.J , H.XH dhe E.C .

Në shkresën (procesverbalin) me nr. 1606/10 prot, datë 17.08.2020, citohet që KSHA ka marrë në shqyrtim ankesën e OE “B” ShPK dhe nuk e ka pranuar këtë ankesë, pasi ky OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi për pllakat terracotë, nuk ka paraqitur raportet e testimit për 18 mallrat e përcaktuara në DT.

Me shkresën nr. 1606/11, datë 17.08.2020 është bërë njoftimi i ankuesit për vendimin e marrë nga KSHA.

Me shkresën 1606/12, datë 28.08.2020 të TAK, është hequr pezullimi i procedurës.

-Nga auditimi në SPE të dokumentacionit të OE “B” ShPK, i cili është skualifikuar edhe pas rivlerësimit nga KSHA, rezulton se është skualifikuar me të drejtë, pasi mangësitë e këtij OE janë ato të cituara nga KVO, si dhe nuk është cituar paraqitja si eksperiencë e ngjashme e një kontrate pune dhe jo kontratë për furnizim me mallra.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 1606/13, datë 28.08.2020, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.K. Pas njoftimit të fituesit, me shkresën nr. 1606/14 prot., datë 28.08.2020 është lidhur kontrata me OE të shpallur fitues “K.T” ShPK, me shkresën nr. 1606/16, datë 03.09.2020 me vlerë 29,650,200 lekë me TVSh.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se OE i shpallur fitues “K.T” ShPK, nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT, pasi:

- Nuk është vërtetuar lidhja ndërmjet furnizuesit me bojë “B” ShPK dhe prodhuesit “L” GMBH, e kërkuar në pikën 2.3.2 të KVK.
- Analizat laboratorike të pigmenteve janë në gjuhë të huaj, në kundërshtim me pikën 4.6 të DT, ku cilësohet që gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
- Raportet e testimit të pllakave të betonit janë sipas standardit EN 1339 dhe jo EN 1338 që është kërkuar në pikën 2.3.8. Gjithashtu nuk ka dokument që të vërtetojë që këto dy standarde, janë ekuivalente.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertës së OE “H” ShPK, nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT, pasi:

- Nuk është vërtetuar lidhja ndërmjet furnizuesit me bojë “B” ShPK dhe prodhuesit “L” GMBH, e kërkuar në pikën 2.3.2 të KVK.
- Raportet e testimit të pllakave të betonit janë sipas standardit EN 1339 dhe jo EN 338 që është kërkuar në pikën 2.3.8. Gjithashtu nuk ka dokument që të vërtetojë që këto dy standarde, janë ekuivalente.
- Analizat laboratorike të pigmenteve janë në gjuhë të huaj, në kundërshtim me pikën 4.6 të DT, ku cilësohet që gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit *“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.”*

Pas njoftimit të fituesit, me shkresën nr. 1606/14 prot., datë 28.08.2020 është lidhur kontrata me shkresën nr. 1606/16, datë 03.09.2020 me vlerë 29,650,200 lekë me TVSh.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të nenit 73, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit *“Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në një procedurë prokurimi, duhet të pranohet të paktën 1 (një) ofertë e vlefshme. Në të kundërt, autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit”,* KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës. Ky

mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 29,650,200 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së F.A, I.B dhe M.N.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr.11 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se:

1. Çertifikatë ISO 9001-2015

Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

Për sa u sqarua më lart, çdo operator ekonomik pjesëmarrës në tenderat duhet të jete i pajisur me këte ISO pavarësisht ndarjes së furnizimit në % në BOE. Ky kriter nuk konsiderohet i përmbushur nëse ISO paraqitet vetëm nga njëri prej tyre. Sido që të ndahet % midis OE, secili prej tyre do të kryejë një aktivitet (furnizim) të caktuar dhe secili prej tyre duhet të faktoj se plotëson standartin i cili përcakton kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë. Thëksojmë se kjo është një ndër ISOT më bazike që disponohet pothuajse nga pjesa më e madhe e OE.

Çertifikatë ISO 14001-2015

Kjo çertifikatë ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Është pranuar në mbarë botën se burimet e botës sonë, që po pakësohen nga dita në ditë, nuk janë të pafundme dhe se ndikimet mjedisore të produkteve dhe aktiviteteve nuk janë lokale dhe rajonale por globale. Ky ndërgjegjësim ka sjellë nevojën për të kontrolluar ndikimet mjedisore. Të qenit i pranishëm në tregun lokal dhe atë global, tani po matet me respekt dhe respekt që u jepet njerëzve. Përveç përmbushjes së pritshmërive dhe nevojave të konsumatorëve të sotëm në nivelin më të lartë, kërkohet që të vlerësohet dhe respektohet mjedisi dhe bota në të cilën jetojmë.

Këto zhvillime kanë zbuluar faktin se ekziston një nevojë për sisteme menaxheriale që do t'u mundësojnë bizneseve të mbajnë nën kontroll ndërveprimet e tyre me mjedisin dhe të përmirësojnë vazhdimisht aktivitetet dhe arritjet e tyre mjedisore. ISO 14001 është një standard i sistemit, i cili bazohet në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore. Ajo është në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni përkatës dhe ligjet në lidhje me faktorët e mjedisit. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit quhet Sistemi i menaxhimit që çdo kompani zhvillon për reduktimin sistematik dhe eliminimin e mundshëm të dëmeve që ato mund të shkaktojnë në mjedis. Pra si rezultat i këtij gjykimi menaxhimi i mjedisit që ka lidhje me çertifikatën ISO 14001:2015 është standart me të cilin duhet të operojë çdo kompani pavarësisht fushës së saj të aktivitetit apo madhësisë së saj. Ky standart tregon se kompania gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj operon në përputhje me parimet e mbrojtjes së ekosistemit dhe minimizimin e efekteve negative në mjedis.

Për sa u sqarua më lart, çdo operator ekonomik pjesëmarrës në tenderat duhet të jete i pajisur me këte ISO pavarësisht ndarjes së furnizimit në % në BOE . Ky kriter nuk konsiderohet i përmbushur nëse ISO paraqitet vetëm nga njëri prej tyre. Sido që të ndahet % midis OE, secili prej tyre do të kryejë një aktivitet (furnizim) të caktuar dhe secili prej tyre duhet të faktoj se plotëson standartin i cili përcakton

kërkesat për një sistem menaxhimi të mjedisit. Theksojmë se kjo është një ndër ISOT më bazike që disponohet pothuajse nga pjesa më e madhe e OE.

2.Kërkesa për inxhinier ndërtimi është gjykuar duke marrë parasysh natyrën e kontratës, objektin dhe vlerën e saj. Duke qenë se objekti i kontratës konsiston në prokurimin e një sasive të konsiderueshme pllakash dhe bordurash, që bëjnë pjesë në grupin e materialeve të ndërtimit, minimalisht disponimi (ekspertiza) i një inxhinieri ndërtimi nga shoqëria që do të kryejë furnizimin, qoftë prodhues ose jo, do të jete garanci AK-se në realizimin me sukses të kontratës.

3.Kriteri i vendosur për tonazhin e kamionit me vinq me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton është kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kërkesë është në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit si dhe me përmasat e kontratës. Kemi të bëjmë me pllaka dhe bordura që kanë peshë të konsiderueshme dhe një kamion me peshëmbajtje të tillë klasifikohet tek kamionët mesatar që gjenden rëndom në qarkullim dhe pikërisht furnizimi me të do të ulte jo vetëm kostot e operatorit ekonomik por do të shmangte edhe vonesat në kryerjen e furnizimit për të dyja palët. Gjithashtu sqarojmë se tonazhin minimal prej 10 ton nuk e kemi lidhur me peshën që ngre vinqi gjatë shkarkimit të paletave por me kapacitetin mbajtës të kamionit.

4.Paraqitja e lejes mjedisore i sherben AK për të vlerësuar nëse prodhuesi i mallrave objekt prokurimi e ushtron aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi leja është një nga kushtet kryesore që ka lidhje drejtpërdrejt me ndikimin në mjedis të veprimtarisë së prodhimit, qoftë ofertuesi prodhues apo jo. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e legjislacionit mjedisor me qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës.

Procesi i vleresimit

1. Shoqëria "B" sh.p.k ka lëshuar Autorizim për shoqërinë "K.T" në statusin e distributorit të autorizuar të kompanisë gjermane "L" GmbH, prodhues i pigmenteve inorganike. Nga verifikimi në faqen zyrtare berdicacement.al rezulton se kjo shoqëri është distributore e kompanisë gjermane "L" GmbH, por edhe të disa kompanive të tjera prestigjioze të listuara në faqen zyrtare.

2. Në kriterin e veçantë për paraqitjen e analizave të pigmentit nuk është kërkuar përkthimi i tyre në gjuhën shqipe.

3. Standarti SSH EN 1339 është standarti i zbatueshëm për pllakat e betonit për shtrim rrugësh dhe standarti SSH EN 1338 është standarti i zbatueshëm për blloqet e betonit për shtrim rrugësh. Në të dyja rastet standarti është i rregullt pasi kemi të bëjmë me pllaka dhe blloqe betoni për shtrim rrugësh që perkon me mallrat objekt prokurimi. Pra raportet testimit janë në përputhje me standartet e zbatuara sipas informacionit në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit.

4. Laboratori S është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas verifikimit të bërë në faqen zyrtare www.dpa.gov.al dhe i është lëshuar certifikata e akreditimit me nr. LT069 në datë 12.05.2017 me vlefshmeri deri në datë 11.05.2021.

5. Për paraqitjen e kontratës së ngjashme të punës nga ana e OE "H" gjykojmë se kemi të bëjmë me furnizim dhe vendosje pllakash e bordurash, ku furnizimi zë peshën më të madhe. Ky qëndrim është mbajtur nga ana jone dhe në procedura të tjera duke mos përjashtuar operatorët ekonomikë, për të rritur konkurrencën për sa kohë që furnizimi është zë i përfshirë në kontratë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z. E.K, z. B.T dhe antarët e KVO-së z.F.A, z.I.B, z.M.N.

1. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për pajisjen me certifikatat ISO për të gjithë antarët e bashkimit vtë operatorëve, pretendimi juaj është i paargumentuar teknikisht dhe **si i tillë ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**
 2. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për inxhinierin e ndërtimit, pretendimi juaj nuk është i argumentuar teknikisht, pasi inxhinierin mund ta vendoste vetë AK ne fazën e dorëzimit të mallrave. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**
 3. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për kamionin mbi 10 t, pretendimi juaj nuk është i argumentuar teknikisht dhe **si i tillë ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**
 4. Në lidhje me kriterin e vendosur nga njësia e prokurimit për lejen mjedisore, pretendimi juaj nuk është i argumentuar teknikisht dhe **si i tillë ky pretendim nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**
 5. Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, sqarojmë se;
 - a. As në dokumentacionin shoqërues të observacionit nuk paraqitet lidhja ndërmjet furnizuesit me bojë “B” ShPK dhe prodhuesit “L” GMBH;
 - b. Gjuha e kërkuar në DT është gjuha shqipe dhe i gjithë dokumentacioni duhet të jetë në shqip;
 - c. Në DT është kërkuar plotësimi i standardit EN 338 dhe nga KVO duhet të ishte vlerësuar OE për plotësimin ose jo të këtij kriteri;
 - d. Laboratori S është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimi (është bashkëlidhur certifikata);
 - e. Eksperienca e ngjashme e kërkuar është për furnizim me mallra, por mund të vlejë edhe eksperienca në zbatim për zërin respektiv.
- Nga sa sipër, observacioni **merret pjesërisht në konsideratë dhe do të reflektohet në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit**

Procedurat e periudhës 01.01.2021-31.12.2021:

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë kryer gjithsej 65 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 688,899,017 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur 623,644,642 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 65,254,375 lekë pa TVSh ose 9.4%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën më poshtë:

Procedura 01.01.2021-31.12.2021	Nr.	Vlera e Fondit Limit	Vlera e Kontraktuar	Diferenca me Fondin Limit
Gjithsej	65	688,899,017	623,644,642	65,254,642
Kërkesë për propozim	4	10,116,250	10,078,200	38,050
E hapur	26	585,733,727	534,949,219	50,784,508
E hapur e thjeshtuar	20	87,027,763	73,738,569	13,289,194
Me vlerë të ulët	15	6,021,277	4,264,309	1,756,968
Sipas objekteve	65			
Objekte në fushën e investimeve	1	37,675,320	33,215,460	4,459,860
Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	64	651,223,697	590,429,182	60,794,515

U audituan gjithsej 9 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit 294,876,693 lekë dhe vlerë të kontratave 263,925,970 lekë ose 89.5% e fondit limit total. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej 22 OE/BOE, nga të cilat janë s’kualifikuar 10 OE/BOE. Me 1 OE kanë

qenë 2 procedura, ndërsa me 1 OE të kualifikuar kanë qenë 7 procedura. Procedurat e zgjedhura për auditim janë paraqitur në tabelën më poshtë. Vlerat e paraqitura janë pa TVSh.

Nr.	Objekti	Lloji i procedurës	OE fitues	Fondi limit	Vlera e kontratës
1	Blerje karburanti (gasoil 10ppm) Loti I	E hapur (Marrëveshje kuadër)	BOE "A", "A dhe O" shpk	34,993,250	34,993,250 Marzh fitimi 19.4%
2	Blerje karburanti Loti II gasoil < 0.1%	E hapur (Marrëveshje kuadër)	R Sha	12,375,000	12,375,000 Marzh fitimi 4.6%
3	Blerje karburanti	E hapur (Marrëveshje kuadër)	BOE "A", "A dhe O" shpk	12,747,680	12,672,000
4	Blerje Inerte	E Hapur	SH	44,565,083	39'983'000
5	Blerje Bitumi	E Hapur	R Sha	22,844,460	22,844,460 Marzh fitimi 43%
6	Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik	E Hapur	I shpk	54,896,000	44,354,800
7	Materiale për ndriçim	E Hapur	I shpk	44,104,900	34,526,000
8	Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anësor të rezervuarit Gjyslikonjë	E Hapur	I shpk	37,675,320	33'215'460
9	Blerje zgara dhe puseta	E Hapur	P shpk	30,675,000	28,962,000
Totali				294,876,693	263,925,970

Procedurat e audituara për periudhën 01.01.2021-31.12.2021

1-Procedura e prokurimit me objekt: "Loti nr.1 -Blerje karburanti (gasoil 10ppm) për "Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Loti nr.1 -Blerje karburanti (gasoil 10ppm) për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik		
1. Urdhër Prokurimi Nr.844/3 prot., datë 29.03.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Urdhër nr. 844/3, datë 29.03.2021 1. M.M –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. K.I - (Specialist) 3. B.S –(Specialist)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër Nr.844/4 prot, datë 29.03.2021 1. SH.M (Kryetar) 2. M.K (Anëtar) 3. M.N (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E Hapur", e tipit Marreveshje Kuader		
5. Fondi Limit (pa tvsh) Loti I gasoil 10ppm 34,993,250 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese: BOE "A", "A dhe O" shpk. Vlera e shprehur me marzh fitimi:19.4%. Normë e fitimit të shprehur në vlerë absolute, marreveshje kuader, me afat deri në datë 31.12.2021, nenshkruar me date 28.06.2021	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 10.05.2021	9. Burimi Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Tiranë.	10. Operatorët Ekonomike: a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE K Shpk me marzh fitimi 19.8% BOE "A", "A dhe O" shpk me marzh fitimi 19.4%
11. Ankimime në AK Dt 12.04.2021 OE "G" shpk	12. Përgjigje ankesës nga AK Nr.844/10 datë 15.04.2021	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Përgjigje nga APP datë 14.04.2021

Situata: Fondi limit: Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nr.844/1 prot, datë 23.03.2021 është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe llogaritjen e fondit limit i përbërë nga z. B.S z. H.G, z. T.P.

Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe llogaritjen e fondit limit ka mbajtur procesverbalin nr.844/2 prot, datë 26.03.2021 ku ka përcaktuar specifikimet teknike për karburantet.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit sasia e cila do te përdoret per nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nuk argumentohet dhe dokumentohet sasia e kërkuar.

Këto veprime bien në kundërshtim me nenin 59, pika 2, në VKM nr.914 datë 29.12.2014, ku citohet se “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës” dhe ngarkon me përgjegjësi komisionin e përlllogaritjes së fondit limit z. B.S, z. H.G dhe z. T.P.

Hartimi i kriterëve: Në datë 29.03.2021 është administruar procesverbali nr.1 për hartimin e dokumenteve të tenderit. DST janë firmosur nga gjithë NJP, në përputhje me Kreu V, *“Zhvillimi i procedurave”*.

Ankesa e Operatorit Ekonomik (Për kriteret e veçanta):

Në datë 12.04.2021 operatori ekonomik “G” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor për hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën e prokurimit *“Blerje Karburanti Loti I”, me fondin limit 34,993,250 lekë pa tvsh.*

Operatori ekonomik ka kundërshtuar kriterin e veçantë që operatori ekonomik duhet të disponojë 2 autobot me kapacitet deri në 1,000 litra.Me argumentin se përcaktimi i vlerës së ngarkesës fikse është kriter diskriminues dhe i paargumentuar.

Me urdhër Nr.844/7 datë 13.04.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është pezulluar procedura e prokurimit *“Blerje Karburanti Loti I”, me fondin limit 34,993,250 lekë pa tvsh.*

Me urdhër Nr.844/8 datë 13.04.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është ngritur komisioni i përbërë nga z.SH.M, znj. M.K, znj.M.N për shqyrtimin e ankesës se operatorit ekonomik “G” shpk për procedurën e prokurimit *“Blerje Karburanti Loti I”, me fondin limit 34,993,250 lekë pa tvsh.*

Kordinatori i APP në datën 14.04.2021 ka rekomanduar që të rishikohen kriteret e veçanta të mëposhtme.

1. Në pikën nr. 2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë, minimumi 7 (shtatë) në territorin e Bashkisë Tiranë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale, akt pronësie ose të jenë të pasqyruar në ekstraktin e rregjistrimit tregtar lëshuar nga QKB).Këto stacione të jenë të pajisura me Leje Mjedisore të tipit C, lëshuar nga QKL-ja, Vërtetim Teknik lëshuar nga ISHTI ose nga organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit.

Së pari, në lidhje me kriterin që OE të disponojë minimumi 7 pika karburanti në territorin e Bashkisë Tiranë, duke marrë shkas nga fakti se ky kriter mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrës apo s’kualifikimin e ofertuesve, të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e tjera dhe mund të ketë më pak pika karburanti, rekomandojmë që AK të shmangë këtë kërkesë,ose në të kundërt të mirëargumentojë ligjërisht dhe teknisht nevojën e vendosjes së numrit të pikave të karburantit,

duke mbajtur në konsideratë edhe parashikimet e nenit 20 të LPP ku përcaktohet së: *“Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter ,kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomike,që përben diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”*.

Së dyti,në lidhje me kërkesën për leje mjedisore të tipit C, sjellim në vëmendje të AK se sipas ligjit Nr.52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar ky tip leje është shfuqizuar.

Nga sa më sipër, i sugjerojmë AK të rishikojë hartimin e këtij kriteri,duke mbajtur në konsideratë parashikimet e ligjit Nr.52/2020.

2. Në pikën nr. 2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dy autobote me kapacitet deri në 1,000 litra në pronësi ose me qira.

APP sheh të nevojshme rishikimin, ose në të kundërt argumentimin mbi vendosjen e kriterit mbi disponimin e autobotëve, pasi AK ka kërkuar blerje karburanti dhe furnizim vetëm me karta elektronike dhe pistoletë publike,çka i bën të panevojshme për OE disponimin e mjeteve në fjalë.

AK duhet të mbajë në konsideratë që, në zbatim të përcaktimeve të nenit 61 të vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave me shkresën Nr.844/10 prot, datë 15.04.2021 ka kthyer përgjigje për ankesën e operatorit ekonomik.

Ankesa e operatorit ekonomik nuk është pranuar sepse Drejtoria E Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit disponon 4 mjete teknologjike të cilat do të furnizohen në kantieret e ndërtimit. Sasia e karburantit e nevojshme për furnizimin e mjeteve teknologjike nuk e kalon sasinë 1,000 litra.

Komisioni gjykon se kërkesa e Autoritetit Kontraktor për furnizim me autobus me kapacitet mbajtës deri në 1,000 litra është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

Me urdhër Nr.844/11 datë 27.04.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është hequr pezullimi për procedurën e prokurimit “*Blerje Karburanti Loti I*”, me fondin limit 34,993,250 lekë pa tvsh.

Njësia e Prokurimit ka modifikuar dokumentat standartë të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje Karburanti Loti I*”, me fondin limit 34,993,250 lekë pa tvsh.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosuar kritere të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dy autobote me kapacitet deri në 1,000 litra në pronësi ose me qira.

Kriteri i mësipërm është vendosur në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për prokurimin publik” neni 61, “Hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike” duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal.

Kërkesa e Autoriteti Kontraktor për 2 mjete autobus me kapacitet deri në 1,000 litra mund të sjellë ulje të konkurrencës sepse shumë operatorë ekonomikë mund të kenë mjete autobote por të cilët e kalojnë kapacitetin prej 1,000 litra dhe në bazë të kriteri të vendosur nuk mund të marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Për parashikimin e zërit blerje karburanti viti 2021 jemi bazuar si më poshtë:

1-Jemi referuar konsumit të karburantit nga viti 2020:

-Për vitin 2020 konsumi i karburantit është 345,150 Lit Naftë, nga këto konsumi i Administratës është 16,600 Lit dhe kaldaja e asfaltit (fabrika) 14,020 Lit. Konsumi i përllogaritur për harxhimin e mjeteve është 314,530 Lit dhe një mesatare mujore 26,210 Lit.

2- Kemi parashikuar një sasi prej 337,951 Lit për të mbuluar dhe fillimin e vitit pasardhës.

Në fillimin e vitit 2021 është akorduar një fond prej 34,993,250 Lekë pa tvsh e përkthyer kjo vlerë në Litra 249951.78 Lit, me këtë sasi nuk mbulojmë kërkesat vjetore dhe gjatë muajit Shtator në fondin shtesë prej 12,747,618 Leke pa tvsh e përkthyer kjo vlerë në Litra 88,000 Lit për të plotësuar nevojat dhe për të mbuluar nevojat e fillim vitit 2022.

2. Në lidhje me numrin e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice (loti 1 dhe 3) të percaktuara në DST sqarojme se:

Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale, e rrjetit të ndriçimit publik, e sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale, me apo pa ndriçim) si dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse në territorin e Bashkisë Tiranë. Kjo veprimtari voluminoze ushtrohet në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Ju sjellim në vëmendje se territori i Bashkisë Tiranë arrin një sipërfaqe prej 1,120.91 km². Në përbërje të saj Bashkia Tiranë ka 11 njësi administrative urbane, 13 njësi rurale dhe 3 lagje si mëposhtë vijon:

Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor disponon një flotë prej rreth 70-80 mjeteve, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga kamionçinat, kamion me akse të ndryshme, transportier rimorkio, fadroma, ekskavator me goma dhe me zinxhir, rula, autokulla, frezë asfalti, shtruese asfalti, motoçikleta etj.

Duke marrë në konsideratë territorin e gjerë ku operohet dhe dinamikën e punimeve që kryhen është i domosdoshëm aksesimi në pika të shumta karburanti duke shmangur humbjen në kohë dhe koston që do të sillte për Autoritetin Kontraktor mungesa e aksesit nga pikat e furnizimit.

-Nga verifikimi që ka bërë Njësia e Prokurimit si në terren ashtu edhe në faqen e QKB-së, rezulton se brenda territorit të Bashkisë Tiranë operojnë minimalisht 5 shoqëri tregtare që disponojnë një numër të lartë stacionesh të shitjes së karburanteve me pakicë d.m.th me pistoletë publike si mëposhtë vijon:

Shoqëria K. sh.p.k rreth 11 stacione

Shoqëria S. sh.p.k (E) rreth 10 stacione

Shoqëria D. sh.p.k (A) rreth 12 stacione

Shoqëria G. sh.p.k rreth 12 stacione

Shoqëria O. sh.p.k (B) rreth 8 stacione

- Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar parashikon instrumenta të tjerë në mënyrë që operatorët ekonomikë të bëhen pjesë e procedurave të prokurimit publik që zhvillojnë Autoritetet Kontraktore. Konkretisht në nenin 88 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar i jepet mundësia operatorëve ekonomikë që të bëhen pjesë e procedurave të prokurimit të zhvilluara nga AK edhe nëpërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë.

- Autoriteti Kontraktor i ka dhënë mundësinë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që të disponojnë stacionet e shitjes së karburanteve me pakicë jo vetëm me akt pronësie ose qeraje por edhe me kontratë bashkepunimi noteriale.

Duke marrë për bazë faktet e mësipërme, siç është territori i gjerë ku operohet (shume e rëndësishme), numri i lartë i mjeteve, numri i shoqërive që tregtojnë karburant me pakicë dhe numri i pikave që ata

disponojne brenda territorit te Bashkise Tiranë, mundesia e bashkimit te operatoreve dhe mundesia e disponimit te stacioneve edhe me kontrate bashkepunimi, AK gjykon se kërkesa per minimalisht 7 stacione është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale, e rrjetit të ndriçimit publik, e sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale, me apo pa ndriçim) si dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse në territorin e Bashkisë Tiranë.

Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor disponon një flotë prej rreth 70-80 mjetesh, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga kamionçinat, kamion me akse të ndryshme, transportier rimorkio, fadroma, ekskavator me goma dhe me zinxhir, rula, autokulla, frezë asfalti, shtruese asfalti etj.

Disa nga mjetet e Autoritetit janë mjete teknologjike të tonazhit të rëndë, të cilat stacionohen në kantiere pune që ndodhen në zona rurale të ndryshme dhe kryejnë procese pune të vazhdueshme siç është pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditëse, heqja e dherave nga rrëshkitjet etj. dhe për këtë arsye e kanë të pamundur furnizimin me karburant në stacionet e furnizimit për shkak të largësisë së tyre. Përveç largësisë nga pikat e furnizimit, lëvizja dhe transporti (eskavatorët me zinxhir transportohen vetem me rimorkiator) i këtyre mjeteve nga kantieri drejt këtyre pikave do të sillte humbje në kohë dhe kosto për Autoritetin Kontraktor.

Mjetet kryesore teknologjike që disponon Autoriteti, të cilat kanë nevojë të furnizohen me autobot janë:

-Eskavator me zinxhir (Volvo), rreth 24 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 350 litra.

-Eskavator me zinxhir (Volvo), rreth 10 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 100 litra.

-Eskavator me goma (Terex), rreth 18 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 250 litra.

-Eskavator me goma nati), rreth 12.5 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 250 litra.

Nga një përlllogaritje e përafërt rezulton që sasia e karburantit për furnizimin e mjeteve të mësipërme varion rreth 1000 litra.

Në këto kushte dhe përsa u argumentua më lart, Autoritetit Kontraktor gjykon se kjo kërkesë për furnizim me autobot me kapacitet mbajtës minimumi 1000 litra është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z. K.I, z. B.S dhe Komisioni i llogaritjes së fondit limit z.B.S z.H.G, z.T.P.

1. Në lidhje me dokumentimin e përlllogaritjes së fondit limit Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i është referuar kontratës së mëparshme të vitit 2020. Veprimet e mësipërme janë në përputhje me VKM Nr.914, datë 29.12.2014. Observacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor paraqet argumenta shtesë dhe si i tillë **merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Në lidhje me numrin e stacioneve te shitjes se karburanteve me pakice (loti 1 dhe 3) te percaktuara ne DST sqarojme se: Në lidhje me numrin e stacioneve te shitjes se karburanteve me pakice (loti 1 dhe 3) të percaktuara ne DST sqarojme se:Nga verifikimi në QKB dhe faqet ëeb të kompanive të cilat tregtojnë hidrokarburë në territorin e Bashkisë së Tiranës rezultoi se më shumë së 3 kompaninë në territorin e Bashkisë së Tiranë disponojnë më shumë së 7 pika shitje karburanti.Në këto kushtë kriteri i vendosur në DST nuk ndikon në ulje të konkurrencës dhe si i tillë **merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

3. Sipas pikës 2.3.8 në DST operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dy autobote me kapacitet deri në 1,000 litra në pronësi ose me qira mund të sjellë ulje të konkurrencës sepse shumë operatorë ekonomikë mund të kenë mjete autobote por të cilët e kalojnë kapacitetin prej 1,000 litra dhe në bazë të kriteri të vendosur nuk mund të marrin pjesë në procedurën e prokurimit.
Pika e mësipërme është trajtuar në Akt Konstatimin Nr.14 dhe nga subjekti i audituar nuk janë sjellë argumenta shtesë për argumentimin e kësaj kërkesë në DST **dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2-Procedura e prokurimit me objekt: “Loti II -Blerje karburanti (gasoil <_ 0.1%) për “Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Proedurës së Prokurimit me objekt: “Loti nr.11 -Blerje karburanti (gasoil <_ 0.1%) për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik		
1. Urdhër Prokurimi Nr.844/3 prot., datë 29.03.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Urdhër nr. 844/3, datë 29.03.2021 1. M.M –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. K.I - (Specialist) 3. B.S –(Specialist)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër Nr.844/4 prot, datë 29.03.2021 1. SH.M (Kryetar) 2. M.K (Anëtar) 3. M.N (Anëtar)
2. Lloji i Proedurës së Prokurimit: “E Hapur”, e tipit Marreveshje Kuader		
5. Fondi Limit (pa tvsh) Loti II gasoil <_ 0.1% 12,375,000 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese: OE “R–ER” sh.a. Vlera e shprehur me normë fitimi 4.6%. Normë e fitimit të shprehur në vlerë absolute, marreveshje kuader , me afat deri në datë 31.12.2021,nenshkruar me date 28.06.2021	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 10.05.2021	9.Burimi Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Tiranë.	10. Operatorët Ekonomike: a) Pjesëmarrës në tender: 3 OE -“R” sh.a me marzh fitimi 4.6% -BOE “A” sh.a dhe “B ” sh.a me marzh fitimi 19.7% - “P” sh.a me marzh fitimi 18.5%
11.Ankimime në AK Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK Jo	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Jo

Fondi limit: Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nr.844/1 prot, datë 23.03.2021 është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe llogaritjen e fondit limit i përbërë nga z. B.S, z.H.G, z. T.P.

Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe llogaritjen e fondit limit ka mbajtur procesverbalin nr.844/2 prot, datë 26.03.2021 ku ka përcaktuar specifikimet teknike për karburantet.

Hartimi i kriterëve: Në datë 29.03.2021 është administruar procesverbali nr.1 për hartimin e dokumenteve të tenderit. DST janë firmosur nga gjithë NJP, në përputhje me Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosuar kriteret e paargumentuara e të pambështetura, konkretisht:

2. Në pikën nr. 2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një autobot me kapacitet deri në 5,000 litra në pronësi ose me qira.

Kriteri i mësipërm është vendosur në kundërshtim me Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 23 pika 2 ku citohet: “*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim*

të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”.

Kërkesa e Autoriteti Kontraktor për një mjete autobot me kapacitet deri në 5,000 litra mund të sjelli ulje të konkurrencës sepse shumë operatorë ekonomike mund të kenë mjete autobote por të cilët e kalojnë kapacitetin prej 5,000 litra dhe në bazë të kriteri të vendosur nuk mund të marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 14, datë 21.03.2024

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1.Përlllogaritja e sasisë së gasoil 0.1% që perdoret për fabriken e asfaltit është përlllogaritur në procesverbalin me nr.844/2 prot., date 26.03.2021 si mëposhte vijon:

$$300 \text{ ditë/vit} \times 6 \text{ orë/ditë} \times 50 \text{ litra/ora} = 90.000 \text{ litra}$$

2.Kapaciteti i depozitave është përcaktuar në bazë të kushtit të parashikuar në ligj që lidhet me licencimin e shoqerive sipas parashikimeve të mëposhtme.

Vendim nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar

III. KUSHTET PËR PAJISJEN ME LICENCË TË TREGTIMIT ME SHUMICË TË NAFTAËS BRUTO DHE NËNPRODUKTEVE TË SAJ

3. Kapaciteti minimal i depozitave të shoqërive, që kërkojnë të pajisen me licencë, sipas llojit të licencës, është:

a) Për licencën e llojit “A”: - Për kategorinë 0/A, kapaciteti i depozitave të jetë 10 000 (dhjetë mijë) m³ - Përveç kategorisë 0/A, kapaciteti i depozitave të jetë 3 000 (tre mijë) m³ dhe, kur kjo licencë jepet për disa kategori produktesh, depozitat duhet të jenë të ndara nga njëra-tjetra, për secilën kategori produktesh, me një kapacitet të përbashkët jo më pak se 3 000 (tre mijë) m³ . Në rastin e licencimit të disa kategorive produktesh hidrokarbure, ndarja e kapaciteteve sipas produkteve hidrokarbure të jetë e pasqyruar në vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, të lëshuar nga inspektorati shtetëror përgjegjës.

Sic parashikohet më lart minimumi i kapacitetit të depozitave te nevojshme për tu licensuar duhet 3000 m³ , kerkese e cila plotesohet nga cdo operator i licencuar duke mos u bere shkak per diskriminim te operatoreve pjesemarres.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Konkretisht, shërbimi i furnizimit me bot shërben për furnizimin e nyjes (impiant) për prodhimin e asfalto betonit, i cili punon me G 0.1%. Kapaciteti është i lidhur edhe me kapacitetin e depozitave qe disponon AK dhe autobote me kapacitet deri në 5000 litra klasifikohen tek autobotet më të përhapura dhe me përdorim më të gjerë në kete fushë për vetë madhësinë e tyre duke ofruar komoditet dhe lehtësi në qarkullim duke ulur dhe kostot e OE.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z. K.I , z. B.S dhe Komisioni i llogaritjes së fondit limit z.B.S, z.H.G, z.T.P.

1. Në lidhje me argumentimin e fondit limit për sasinë e cila do të përdoret per nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, ky kriter sipas observacionit të mësipërm është argumentuar **dhe si i tillë merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

<p>2. Në lidhje me pikën nr. 2.3.7 të DST-ve, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të posedojë në pronësi ose me qira depozita me kapacitet jo më të vogël se 3,000m³. Obeservacioni i mësipërm është i mbështetur në vendim nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar dhe si i tillë merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.</p> <p>3. Në lidhje me pikën nr. 2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një autobus me kapacitet deri në 5,000 litra në pronësi ose me qira. Kërkesa e Autoriteti Kontraktor për një mjete autobus me kapacitet deri në 5,000 litra mund të sjelli ulje të konkurrencës sepse shumë operatorë ekonomike mund të kenë mjete autobote por të cilët e kalojnë kapacitetin prej 5,000 litra dhe në bazë të kriteri të vendosur nuk mund të marrin pjesë në procedurën e prokurimit. Observacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor nuk paraqet argumenta shtesë dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.</p>

3-Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje karburanti (gasoil 10ppm) për “Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburanti (gasoil 10ppm)		
1. Urdhër Prokurimi Nr.2530/3 prot., datë 22.09.2021	3. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Urdhër nr. 2530/3, datë 22.09.2021 1. M.M –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. K.I - (Specialist) 3. B.S –(Specialist)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër Nr.2530/4 prot, datë 22.09.2021 1. SH.M (Kryetar) 2. M.K (Anëtar) 3. M.N (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”, e tipit Marreveshje Kuader		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 12,747,680 lekë	6. Oferta fituese: BOE “A”, “A” dhe “O” shpk me ofertë ekonomike 12,672,000 lekë, marreveshje kuadër me datë kontrate 08.11.2021.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 75,680 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 23.09.2021	9. Burimi Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Tiranë	10. Operatorët Ekonomike: a) Pjesëmarrës në tender: 1 BOE BOE “A”, “A” dhe “O” shpk me vlerë 12,672,000 lekë
11. Ankimime në AK	12. Përgjigje ankesës nga AK	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP

Fondi limit: Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nr.2530/1 prot, datë 20.09.2021 është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe llogaritjen e fondit limit i përbërë nga z. B.S, z.H.G, z. T.P.

Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe llogaritjen e fondit limit ka mbajtur procesverbalin nr.2530/2 prot, datë 22.09.2021 ku ka përcaktuar specifikimet teknike për karburantet.

Hartimi i kriterëve:

Në datë 23.09.2021 është administruar procesverbali për hartimin e dokumenteve të tenderit. DST janë firmosur nga gjithë NJP, në përputhje me Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosuar kritere të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht:

1. Në pikën nr. 2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dy autobote me

kapacitet deri në 1,000 litra në pronësi ose me qira.

Kriteri i mësipërm është vendosur në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për prokurimin publik” neni 61, “Hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal.

Kërkesa e Autoriteti Kontraktor për 2 mjete autobot me kapacitet deri në 1,000 litra mund të sjelli ulje të konkurrencës sepse shumë operatorë ekonomike mund të kenë mjete autobote por të cilët e kalojnë kapacitetin prej 1,000 litra dhe në bazë të kriteri të vendosur nuk mund të marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Për parashikimin e zërit blerje karburanti viti 2021 jemi bazuar si më poshtë:

1-Jemi referuar konsumit të karburantit nga viti 2020:

-Për vitin 2020 konsumi i karburantit është 345,150 Lit Naftë, nga këto konsumi i Administratës është 16,600 Lit dhe kaldaja e asfaltit (fabrika) 14,020 Lit. Konsumi i përlogaritur për harxhimin e mjeteve është 314,530 Lit dhe një mesatare mujore 26,210 Lit.

2- Kemi parashikuar një sasi prej 337,951 Lit për të mbuluar dhe fillimin e vitit pasardhës.

Në fillimin e vitit 2021 është akorduar një fond prej 34,993,250 Lekë pa tvsh e përkthyer kjo vlerë në Litra 249,951.78, me këtë sasi nuk mbulojmë kërkesat vjetore dhe gjatë muajit Shtator në fondin shtesë prej 12,747,618 Leke pa tvsh e përkthyer kjo vlerë në Litra 88,000 Lit për të plotësuar nevojat dhe për të mbuluar nevojat e fillim vitit 2022.

2. Në lidhje me numrin e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice (loti 1 dhe 3) të percaktuara në DST sqarohet se:

Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale, e rrjetit të ndriçimit publik, e sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale, me apo pa ndriçim) si dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse në territorin e Bashkisë Tiranë. Kjo veprimtari voluminoze ushtrohet në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Ju sjellim në vëmendje se territori i Bashkisë Tiranë arrin një sipërfaqe prej 1,120.91 km². Në përbërje të saj Bashkia Tiranë ka 11 njësi administrative urbane, 13 njësi rurale dhe 3 lagje si mëposhtë vijon:

Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor disponon një flotë prej rreth 70-80 mjeteve, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga kamionët, kamion me akse të ndryshme, transportier rimorkio, fadroma, ekskavator me goma dhe me zinxhir, rula, autokulla, frezë asfalti, shtruese asfalti, motoçikleta etj.

Duke marrë në konsideratë territorin e gjerë ku operohet dhe dinamikën e punimeve që kryhen është i domosdoshëm aksesimi në pika të shumta karburanti duke shmangur humbjen në kohë dhe koston që do të sillte për Autoritetin Kontraktor mungesa e aksesit nga pikat e furnizimit.

-Nga verifikimi që ka bërë Njësia e Prokurimit si në terren ashtu edhe në faqen e QKB-së, rezulton se brenda territorit të Bashkisë Tiranë operojnë minimalisht 5 shoqëri tregtare që disponojnë një numër të lartë stacionesh të shitjes së karburanteve me pakicë d.m.th me pistoletë publike si mëposhtë vijon:

Shoqëria K sh.p.k	rreth 11 stacione
Shoqëria S sh.p.k (E)	rreth 10 stacione
Shoqëria D sh.p.k (A)	rreth 12 stacione
Shoqëria G sh.p.k	rreth 12 stacione
Shoqëria O sh.p.k (B)	rreth 8 stacione

- Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon instrumenta të tjerë në mënyrë që operatorët ekonomikë të bëhen pjesë e procedurave të prokurimit publik që zhvillojnë Autoritetet Kontraktore. Konkretisht në nenin 88 të VKM nr.285, datë 19.05.2021”Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar i jepet mundësia operatorëve ekonomikë që të bëhen pjesë e procedurave të prokurimit të zhvilluara nga AK edhe nëpërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë.

- Autoriteti Kontraktor i ka dhene mundesine operatoreve ekonomik pjesëmarrës qe te disponojne stacionet e shitjes së karburanteve me pakicë jo vetëm me akt pronësie ose qeraje por edhe me kontratë bashkepunimi noteriale.

Duke marrë për baze faktet e mësipërme, siç është territori i gjerë ku operohet (shume e rendesishme), numri i larte i mjeteve, numri i shoqerive qe tregetojne karburant me pakice dhe numri i pikave qe ata disponojne brenda territorit te Bashkise Tiranë, mundesia e bashkimit te operatoreve dhe mundesia e disponimit te stacioneve edhe me kontrate bashkepunimi, AK gjykon se kërkesa per minimalisht 7 stacione është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale, e rrjetit të ndriçimit publik, e sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale, me apo pa ndriçim) si dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse në territorin e Bashkisë Tiranë.

Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor disponon një flotë prej rreth 70-80 mjeteve, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga kamionçinat, kamion me akse të ndryshme, transportier rimorkio, fadroma, ekskavator me goma dhe me zinxhir, rula, autokulla, frezë asfalti, shtruese asfalti etj.

Disa nga mjetet e Autoritetit janë mjete teknologjike të tonazhit të rëndë, të cilat stacionohen në kantieri pune që ndodhen në zona rurale të ndryshme dhe kryejnë procese pune të vazhdueshme siç është pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditëse, heqja e dherave nga rrëshkitjet etj. dhe për këtë arsye e kanë të pamundur furnizimin me karburant në stacionet e furnizimit për shkak të largësisë së tyre. Përveç largësisë nga pikat e furnizimit, lëvizja dhe transporti (eskavatorët me zinxhir transportohen vetem me rimorkiator) i këtyre mjeteve nga kantieri drejt këtyre pikave do të sillte humbje në kohë dhe kosto për Autoritetin Kontraktor.

Mjetet kryesore teknologjike që disponon Autoriteti, të cilat kanë nevojë të furnizohen me autobot janë:

-Eskavator me zinxhir (Volvo), rreth 24 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 350 litra.

-Eskavator me zinxhir (Volvo), rreth 10 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 100 litra.

-Eskavator me goma (Terex), rreth 18 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 250 litra.

-Eskavator me goma nati), rreth 12.5 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 250 litra.

Nga një përlllogaritje e përafërt rezulton që sasia e karburantit për furnizimin e mjeteve të mësipërme varion rreth 1000 litra.

Në këto kushte dhe përse u argumentua më lart, Autoritetit Kontraktor gjykon se kjo kërkesë për furnizim me autobot me kapacitet mbajtës minimumi 1000 litra është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z. K.I , z. B.S dhe Komisioni i llogaritjes së fondit limit z.B.S, z.H.G, z.T.P.

1. Në lidhje me dokumentimin e përlllogaritjes së fondit limit Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i është referuar kontratës së mëparshme të vitit 2020.Veprimet e mësipërme janë në

përputhje me VKM Nr.914, datë 29.12.2014. Observacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor paraqet argumenta shtesë dhe si i tillë **merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Në lidhje me numrin e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice (loti 1 dhe 3) të percaktuara në DST sqarohet se: Nga verifikimi në QKB dhe faqet eëb të kompanive të cilat tregtojnë hidrokarburë në territorin e Bashkisë së Tiranës rezultoi se më shumë se 3 kompaninë në territorin e Bashkisë së Tiranës disponojnë më shumë se 7 pika shitje karburanti. Në këto kushte kriteri i vendosur në DST nuk ndikon në ulje të konkurrencës dhe si i tillë **merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

3. Sipas pikës 2.3.8 në DST operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dy autobote me kapacitet deri në 1,000 litra në pronësi ose me qira mund të sjellë ulje të konkurrencës sepse shumë operatorë ekonomikë mund të kenë mjete autobote por të cilët e kalojnë kapacitetin prej 1,000 litra dhe në bazë të kriteri të vendosur nuk mund të marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Pika e mësipërme është trajtuar në Akt Konstatimin Nr.14 dhe nga subjekti i audituar nuk janë sjellë argumenta shtesë për argumentimin e kësaj kërkesë në DST **dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

4-Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje Inerte” për “Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje inerte”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.614/4, datë 19.03.2021	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.614/4, datë 19.03.2021	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.614/5, datë 19.03.2021
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ‘E hapur’	1. M.M –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. J.J - (Anëtar) 3. V.K (Anëtar)	1. SH.M – (Kryetar) 2. S.GJ - (Anëtar) 3. M.N – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 44,565,083- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E “SH ” sh.p.k me ofertë 39’983’000 lekë pa tvsh lekë, me lidhje kontrate datë 28/05/2021, me afat deri më 31.12.2021.	7.Diferenca me fondin limit: 4,582,083 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 15.04.2021	9.Burimi Financimit: Transferta nga Bashkia e Tiranës - 44,565,083 lekë	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b)Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Hartimi i kriterëve: Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosuar kriterë të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht:

1.Pika 2.3.10. Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

a) *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të

përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikimin e tyre.

Vlerësimi i Ofertave:

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 614/5 datë 19.03.2021 është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje Inerte*” i cili përbëhet nga z. SH.M (kryetar), z. S.GJ dhe zj. M.N.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 OE, për të cilët, referuar procesverbalit të datës 11.05.2021, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës

Referuar raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 5 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 4 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 19.05.2021 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “SH” shpk për të cilën është lidhur kontrata datë 28.05.2021 për vlerën 39,983,000 lekë pa TVSH dhe vlera 47,979,600 lekë me TVSH, dhe me afat deri më 31.12.2021.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

OE i shpallur fitues “SH” nuk ka dorëzuar dokumentacionin e mëposhtëm sipas kërkesave të DST.

1- Mjeti me targa AA049 HX ka kapacitet mbajtës 1,050 kg nën kapacitetin e kërkuar 1.5-2 ton.

2-Fletat e analizës dhe raportet e testimit për materialin çimento nuk janë brenda afatit 30 ditor sipas kriterit në DST.

3-Fletat e analizës dhe raportet e testimit për gur kave dhe filer nuk janë sipas kriterëve në DST.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi KVO i përbërë prej z. SH.M , z. S.GJ , zj. M.N.

Konkluzion: -OE “SH” shpk **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte, KVO nuk duhej të kishte kualifikuar OE dhe nuk duhej t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij.

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, pika 3, “*Pas mbylljes së seancës publike komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit*”.

Ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 55, Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, pika 1 (a),

Oferta fituese duhet të jetë: a) “*Oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin me te ulët*”.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit (kriteret e veçanta):

1.Në kriterin e vendosur për mundësinë e marrjes me qera të mjeteve që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, ku në kontratën noteriale duhet të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, Njësia e Prokurimit sqaron se nuk ka qenë qëllimi për specifikimin e objektit të prokurimit ose të tenderit në kontratë. Nëse do të ishte ky qëllimi do të ishte parashikuar të specifikohet objekti i tenderit apo i procedurës së prokurimit.

Megjithatë duke e parë në këndvështrimin e auditit, njësia arsyeton se duke u nisur nga rëndësia e veçantë që ka furnizimi me inerte për AK-në dhe vlera e konsiderueshme e fondit limit nuk do ishte e tepruar parashikimi i objektit të tenderit të kontratë. Kjo kërkesë është e justifikuar pasi AK kërkon siguri dhe garanci se mjetet nuk do të jenë të angazhuara në kontrata apo punëmarrje të tjera dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti duke mos sjellë vonesa në kryerjen e furnizimit dhe si pasojë mosrealizimin e objektivave të AK-së.

Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

Për sa më lart gjykojmë se ky kriter është plotësisht i argumentuar dhe nuk është përjashtues.

Pretendimet e subjektit (Vlerësimi i Ofertave):

1. Në lidhje me kapacitetin e mjetit është bërë një lapsus njerëzor, pasi pa dashje tonazhi prej 1050 kg është konsideruar 1500 kg për shkak të shifrave të njëjta që kanë të dy numrat dhe që ndryshojnë vetëm nga renditja e tyre.

2. Të gjitha materialet inerte që janë kërkuar, përveç çimentos, e kanë origjinën nga thyerja e malit në gurorë. Ndryshimi qëndron në përmasat (granulometrinë) e tyre, që arrihet me fraksionimin e gurit të malit me anë të proceseve dhe impianteve teknologjike (fronto). Operatori ekonomik ka paraqitur raportet e testimit për çdo zë, përfshirë fillerin edhe gurin kave. Ndryshimi i vetëm qëndron tek terminologjia e përdorur. Për fillerin është e barsvlefshme analiza e rërës së malit 0-3 mm kurse për gurin kave analiza e çakullit të malit. Pra janë mallra të njëjtë që ndryshojnë vetëm nga emërtimi i përdorur. Për çimenton, i cili është produkt që nuk del nga gurorja, kompania prodhuese disponon çertifikatë performance dhe deklaratë karakteristikash që provojnë tipin e produktit dhe përputhshmërinë e tij me standartet e miratuara europiane ose ekuivalente, të cilat lëshohen me një afat më të gjatë se 30 ditë. Referuar nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, KVO-ja e konsideron devijim të vogël i cili nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit (kriteret e veçanta):

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z. J.J, z.V.K, dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z.SH.M, z.S.GJ, z.M.N.

1. Në lidhje me pikën 2.3.10. sipas DST-ve ,dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre. Pika e mësipërme është trajtuar në Akt Konstatimin Nr.15, datë 21.03.2024 dhe nga subjekti i audituar nuk janë sjellë argumenta shtesë për argumentimin e kësaj kërkesë në DST **dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

Qëndrimi i Grupit të auditimit (Vlerësimi i Ofertave):

1. Në lidhje me observacioni e mësipërm të paraqitur nga autoriteti kontraktor për mangësinë e tonazhit të mjetit me targa AA049 HX ka kapacitet mbajtës 1,050 kg nën kapacitetin e kërkuar 1.5-2 ton nuk janë paraqitur argumenta shtesë por është pranuar si gabim gjatë vlerësimit të dokumentave të paraqitura nga operatorët ekonomik **dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Në lidhje me observacioni e mësipërm për raportet e testimit për materialin filer dhe materialin gurë kave, Autoriteti Kontraktor ka paraqitur raportet e testimit për filerin, analizat e rërës së malit 0-3 mm e cila nuk është e barazvlefshme me materialin filler ndërsa për gurin kave është paraqitur analiza e çakullit të malit e cila nuk është e barazvlefshme me materialin gur kave.
Përsa i përket analizës për çimenton, nuk është paraqitur dokumentacion shoqëruar **dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

5-Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje Bitumi” për “Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Bitumi” për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.835/3, datë 30.03.2021	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.835/3, datë 30.03.2021	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.835/4, datë 30.03.2021
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”	1. M.M - (Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. E.K - (Anëtar) 3. B.S - (Anëtar)	1. SH.M – (Kryetar) 2. J.J - (Anëtar) 3. M.N – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 22,844,460- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E “R” sh.p.k me ofertë 43% me marzh fitimi, me lidhje kontrate datë 20/05/2021, me afat deri më 31.12.2021.	7.Diferenca me fondin limit: 0 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 23.04.2021	9.Burimi Financimit: Transferta nga buxheti i Bashkisë Tiranë 2021- 22,844,460 lekë	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Hartimi i kriterëve: Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nr.1883/1 prot, datë 07.07.2021 është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe llogaritjen e fondit limit i përbërë nga z.B.S z. K.I , z.Q.X.

Më datë 19.07.2021 është mbajtur procesverbali Nr.1 për hartimin e dokumenteve të tenderit dhe hartimin e kriterëve të veçanta.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosuar kriterë të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht

1.Pika 2.3.9. Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

a) *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit (kriteret e veçanta):

1.Në kriterin e vendosur për mundësinë e marrjes me qera të mjeteve që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, ku në kontratën noteriale duhet të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, Njësia e Prokurimit sqaron se nuk ka qenë qëllimi për specifikimin e objektit të prokurimit ose të tenderit në kontratë. Nëse do të ishte ky qëllimi do të ishte parashikuar të specifikohet objekti i tenderit apo i procedurës së prokurimit.

Megjithatë duke e parë në këndvështrimin e auditit, njësia arsyeton se Autoriteti Kontraktor ka ndër të tjera, një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj, mirëmbajtjen e shtresave asfaltike rrugore në të gjithë territorin e Bashkisë së Tiranës. Në funksion të kësaj veprimtarie AK-ja disponon një impiant për prodhimin e asfaltit, ku bitumi është një nga komponentët kryesor dhe të domosdoshëm për prodhimin e asfaltit. Drejtoria prodhon asfalt në mënyrë të vazhdueshme dhe nevoja për bitum është shumë e shpeshtë, me frekuencë mesatarisht 3-4 herë në javë, ka raste dhe çdo ditë.

Për shkak të rëndësisë se vecante që ka furnizimi me bitum, AK i lind e drejta të kerkoje qe OE te disponoje nje mjet (jo vetem ne pronesi por edhe me kontrate qiraje) në menyre qe te garantohet dhe ti ofrohet siguri AK se furnizimi nuk do te deshtoje, do te realizohet ne kohe sipas kerkeses se AK. Kerkesa e AK per specifikimin e objektit te tenderit ne kontraten e qirasë eshte e justifikuar pasi AK kerkon siguri dhe garanci se mjeti nuk do të jetë i angazhuar në kontratë apo punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti duke mos sjelle vonesa në kryerjen e furnizimit dhe si rezultat mosrealizimin e prodhimit sipas objektivave të AK-së.

Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

Për sa më lart gjykojmë se ky kriter është plotësisht i argumentuar dhe nuk është përjashtues.

2.Temperatura e kërkuar e bitumit mbi 150 °C në momentin e furnizimit është e nevojshme pasi furnizimi bëhet me ajër dhe lënda duhet të jetë sa më e lëngshme në mënyrë që të shkarkohet lehtë për tu magazinuar në depozitën e caktuar.

Qëndrimi i Grupit të auditimit (kriteret e veçanta):

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrçimit Publik nga Njësia e Prokurimit **znj.M.M, z. K.I , z. B.S.**

1. Në lidhje me pikën 2.3.9. sipas DST-ve ,dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t'u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikimin e tyre. Pika e mësipërme është trajtuar në Akt Konstatimin Nr.16, datë 21.03.2024 dhe nga subjekti i audituar nuk janë sjellë argumenta shtesë për argumentimin e kësaj kërkesë në DST **dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Në lidhje me temperaturën e bitumit, **argumenti merret në konsideratë.**

6-Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik”.

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.563/3, datë 05.03.2021	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.563/3, datë 05.03.2021	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.563/4, datë 05.03.2021
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ‘E hapur’	1. M.M –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. A.LL - (Anëtar) 3. E.SH - (Anëtar)	1. P.S – (Kryetar) 2. A.K - (Anëtar) 3. M.N – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 54,896,000- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E ‘I ’’ sh.p.k me ofertë 44,354,800 lekë pa tvsh lekë, me lidhje kontrate datë 04/05/2021, me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.	7.Diferenca me fondin limit: 10,541,200 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 31.03.2021	9.Burimi Financimit: Transferta nga Bashkia e Tiranës - 54,896,000 lekë	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Hartimi i kriterëve: 1.Pika 2.3.9. Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

a) *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit (kriteret e veçanta):

1.Në kriterin e vendosur për mundësinë e marrjes me qera të mjeteve që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, ku në kontratën noteriale duhet të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, Njësia e Prokurimit sqaron se nuk ka qenë qëllimi për specifikimin e objektit të prokurimit ose të tenderit në kontratë. Nëse do të ishte ky qëllimi do të ishte parashikuar të specifikohet objekti i tenderit apo i procedurës së prokurimit.

Megjithatë duke e parë në këndvështrimin e auditit, njësia arsyeton se Autoriteti Kontraktor ka ndër të tjera, një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj, mirëmbajtjen e shtresave asfaltike rrugore në të gjithë territorin e Bashkisë së Tiranës. Në funksion të kësaj veprimtarie AK-ja disponon një impiant për prodhimin e asfaltit, ku bitumi është një nga komponentët kryesor dhe të domosdoshëm për prodhimin e asfaltit. Drejtoria prodhon asfalt në mënyrë të vazhdueshme dhe nevoja për bitum është shumë e shpeshtë, me frekuencë mesatarisht 3-4 herë në javë, ka raste dhe çdo ditë.

Për shkak të rëndësisë së vecante që ka furnizimi me bitum, AK i lind e drejta të kerkoje që OE të disponojë një mjet (jo vetëm në pronësi por edhe me kontratë qiraje) në mënyrë që të garantohet dhe të ofrohet siguri AK se furnizimi nuk do të deshtojë, do të realizohet në kohë sipas kërkesës së AK. Kërkesa e AK për specifikimin e objektit të tenderit në kontratën e qirasë është e justifikuar pasi AK kërkon siguri dhe garanci se mjeti nuk do të jetë i angazhuar në kontratë apo punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti duke mos sjelle vonesa në kryerjen e furnizimit dhe si rezultat mosrealizimin e prodhimit sipas objektivave të AK-së.

Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

Për sa më lart gjykojmë se ky kriter është plotësisht i argumentuar dhe nuk është përjashtues.

Qëndrimi i Grupit të auditimit (kriteret e veçanta):

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik nga Njësia e Prokurimit **znj.M.M, z. K.I, z. B.S.**

1. Në lidhje me pikën 2.3.9. sipas DST-ve, dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t'u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikimin e tyre. Pika e mësipërme është trajtuar në Akt Konstatimin Nr.17, datë 21.03.2024 dhe nga subjekti i audituar nuk janë sjellë argumenta shtesë për argumentimin e kësaj kërkesë në DST **dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

7-Procedura e prokurimit me objekt: “Materiale për ndriçim”.

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Materiale për ndriçim”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.714/3, datë 19.03.2021	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.714/3, datë 19.03.2021	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.714/4, datë 19.03.2021
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”	1. M.M –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. A.LL - (Anëtar) 3. E.SH - (Anëtar)	1. P.S – (Kryetar) 2. A.K - (Anëtar) 3. M.N – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 44,104,900- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE “I” sh.p.k me ofertë 34,526,000 lekë pa tvsh lekë, me lidhje kontrate datë 10/05/2021, me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.	7.Diferenca me fondin limit: 9,578,000 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 15.04.2021	9.Burimi Financimit: Transferta nga Bashkia e Tiranës - 44,104,900 lekë	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Procedura e prokurimit “Materiale për ndriçimi” është zhvilluar në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

8-Procedura e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anësor të rezervuarit Gjyslikonjë”.

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anësor të rezervuarit Gjyslikonjë”.		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.2997/1, datë 03.11.2021	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.2997/1, datë 03.11.2021	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.2997/2, datë 03.11.2021
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ‘E hapur’	1. M.M –(Përgjegjës)Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. H.G- (Anëtar) 3. V.K (Anëtar)	1. S.GJ – (Kryetar) 2. R.S - (Anëtar) 3. M.N – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 37,675,320- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E ‘I’ sh.p.k me ofertë 33’215’460 lekë pa tvsh lekë, me lidhje kontrate datë 23/12/2021, me afat realizim kontrate 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.	7.Diferenca me fondin limit: 4,459,860 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 05.11.2021	9.Burimi Financimit: Transferta nga Bashkia e Tiranës - 37,675,320 lekë	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Hartimi i kritereve: Më datë 05.11.2021 nga anëtarët e njësisë së prokurimit znj. M.M pëson përgjegjës, z. H.G anëtar dhe z.V.K anëtar është mbajtur procesverbal për hartimin e dokumenteve të tenderit dhe hartimin e kritereve të veçanta.

Kordinatori i APP në datën 11.11.2021 ka rekomanduar që të rishikohen kriteret e veçanta të mëposhtme.

1.Në pikën 4,përshtatshmëria për të kryer veprimtari profesionale, AK ka kërkuar “Licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.

Duke marrë shkas nga punimet e përfshira në dokumentet teknike të procedurës, rezulton se zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojin e punimeve të përfshira në licencën e mëposhtme.

NP. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore-Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera dhe gurore dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në tokë buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimin të

punimeve të sistemimit bujqësor dhe rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhore të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Për sa më sipër, AK duhet të rivlerësojë nevojën për vendosje e kërkesën për disponimin e kategorisë së mësipërme duke ju përmbajtur përcaktimeve të pikës 1 të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të Vendimit Nr.285, datë 19.05.2021, që r.285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.Në pikën 2.3.2, të kapacitetit teknik AK ka kërkuar; “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë ose pajisur me licencë individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën korrik 2021-shtator 2021. Duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen referuar preventivit të punimeve vlerësojmë se AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierit gjeologjik dhe inxhinierit të mjedisit. AK duhet të mbajë në vëmendje përcaktimet e pikës 1 të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese , natyrën dhe vlerën e kontratës.

Gjithashtu në lidhje me kërkesën për 1 (një) inxhinier mekanik, AK nuk ka kërkuar kategori licence në zbatim për inxhinierin e kërkuar, rekomandojmë AK të rivlerësojë ose të argumentojë këtë kriter.

3.Në pikën 2.3.5, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar 2 (dy) manovrator dhe 2 (dy) shoferë për mjete të rënda, për të cilët të paraqitet kontrata e vlefshme e punës ,dëshmitë e drejtimit të lëshuar nga institucionet përkatëse dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën korrik 2021-shtator 2021. Rekomandojmë si të nevojshme që AK të mirë argumentojë vendosjen e kriterit në lidhje me disponimin në listëpagesa të punonjësve shoferë dhe manovrator të kërkuar, nisur nga fakti se makineritë dhe pajisjet të cilat duhet të disponojë operatori ekonomik për ekzekutimin e kontratës kërkojnë të jenë në pronësi ose me qera, rrjedhimisht në rastin kur makineritë disponohen me qera sugjerojmë rivlerësim të kriterit për disponimin e tyre në listëpagesat e shoqërisë pasi këta punonjës mund të kontraktohen.

Modifikimi i dokumentave të tenderit:

Më datë 15.11.2021 është hartuar shtojca për modifikimin e dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit me REF-10470-11-05-021 “Rehabilitim i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anësor të rezervuarit Gjyslikonjë.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosuar kritere të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht:

1. Në pikën 2.1 përshtatshmëria për të kryer veprimtari profesionale, AK ka kërkuar:

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë çertifikatë ISO 14001-2015 (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.)

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë çertifikatë ISO 45000-2018 (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.)

AK duhet të rivlerësojë osë në të kundërt të mirëargumentojë çertifikatat ISO të kërkuara për operatorët ofertues pasi këto çertifikata nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit (Procedura është për rehabilitimin e mekanizmit të komandimit të portave të ujëlshuesit shkarkuesit katastrofik anësor të rezervuarit pra nuk parashikohen veprimtari ku të nevojitet ISO 14001-2015 për menaxhimin e mjedisit apo ISO 45001-2018 për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë).

2.Në pikën 2.3.2, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme),lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën korrik 2021-shtator 2021 si më poshtë:

4(katër) punonjës mekanikë

4(katër) punonjës hekurkthyes

4(katër) punonjës karpentierë

4(katër) punonjës saldatorë

Kërkesa e mësipërme në pikën 2.3.2 në të cilën AK ka kërkuar 4 punonjës mekanikë, 4 punonjës hekurkthyes, 4 punonjës karpentierë, 4 punonjës saldatorë sipas volumit të punimeve kërkesa për 4 punonjës saldatorë dhe 4 punonjës mekanikë nuk është e argumentuar

Kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me pikën 1 të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese , natyrën dhe vlerën e kontratës

4.Në pikën 2.3.7, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e mëposhtme:

Mjetet	Njësia	Sasia	Gjendja
Kamion me kapacitet mbajtës (10-20 ton)	copë	2	Pronësi ose me qera
Kamionçinë me kapacitet mbajtës (3.5-5 ton)	copë	1	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç	copë	1	Pronësi ose me qera
Rul mbi 8 ton	copë	2	Pronësi ose me qera
Eskavator krahëgjate 21.5m	copë	1	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhirë	copë	1	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	copë	2	Pronësi ose me qera
Fadromë me goma	copë	2	Pronësi ose me qera
Autopompë betoni	copë	2	Pronësi ose me qera
Vibrator	copë	4	Pronësi ose me qera
Autobot uji	copë	1	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	copë	3	Pronësi ose me qera
Skeleri	m ²	200	Pronësi ose me qera
Elektroorgano	copë	2	Pronësi ose me qera
Motogjenerator 15 kë (minimumi)	copë	2	Pronësi ose me qera

Kërkesa e mësipërme në pikën 2.3.7, në të cilën AK ka kërkuar 2 autopompa betoni nuk është e argumentuar sepse në kërkesat e veçanta janë kërkuar 3 autobetoniere dhe referuar grafikut të punimeve dhe volumit të punimeve është e mjaftueshme vetëm 1 autopompë betoni.

Kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me pikën 1 të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit

publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese , natyrën dhe vlerën e kontratës.

Vlerësimi i Ofertave:

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 2997/2 datë 03.11.2021 është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “*Rehabilitim i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anësor të rezervuarit Gjyslikonjë*” i cili përbëhet nga z. S.GJ (kryetar), z. R.S dhe zj. M.N.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët, referuar procesverbalit të datës 13.12.2021, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës

Referuar raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 3 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 2 OE, janë kualifikuar 1 OE.

Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 23.12.2021 ka lidhur kontratën me operatorin ekonomik “I” sh.p.k për vlerën 33,215,460 lekë pa TVSH dhe vlera 39,858,552 lekë me TVSH, dhe me afat 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

OE i shpallur fitues “I” shpk nuk ka dorëzuar dokumentacionin e mëposhtëm sipas kërkesave të DST.

1-Mjeti me targa AA431EL (çertifikata e transportit është vetëm për transport të vetë jo për të tretë, mjeti është marrë me kontratë qiraje).

2-Mjeti me targa AB954AM (çertifikata e transportit është vetëm për transport të vetë jo për të tretë, mjeti është marrë me kontratë qiraje).

3- Mjeti me targa AA629NA (çertifikata e transportit është vetëm për transport të vetë jo për të tretë, mjeti është marrë me kontratë qiraje).

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi KVO i përbërë prej z. S.GJ, z. R.S , znj. M.N.

Konkluzion: OE “I” shpk **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte, KVO nuk duhej të kishte kualifikuar OE dhe nuk duhej t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij.

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80, Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika 1, “*Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme: a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura*”, neni 92 pika 3, “*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji*”.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr. 1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit :

1.Çertifikatë ISO 45001-2018

Çdo kompani ka detyrimin të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit. ISO 45001 është standardi ndërkombëtar i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë. Kërkesat e standardit ISO 45001 përfshijnë: vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve. Certifikimi ISO 45001 mund të merret nga çdo kompani, pavarësisht aktivitetit të saj si dhe risqeve të shëndetit dhe sigurisë. Ky certifikim konfirmon angazhimin e shoqërisë për të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur punonjësit e saj dhe të çdo personi tjetër në ambientet e saj.

Per sa u sqarua me lart, kjo ISO ka lidhje drejtpërdrejte me objektin e prokurimit per aq kohe sa kemi te bejme me fuqi punetore qe do te kryejne punime ne terren dhe ka te beje drejtpërdrejte me shendetin dhe sigurine ne pune.

Çertifikatë ISO 14001-2015

Kjo çertifikatë ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Është pranuar në mbarë botën se burimet e botës sonë, që po pakësohen nga dita në ditë, nuk janë të pafundme dhe se ndikimet mjedisore të produkteve dhe aktiviteteve nuk janë lokale dhe rajonale por globale. Ky ndërgjegjësim ka sjellë nevojën për të kontrolluar ndikimet mjedisore. Të qenit i pranishëm në tregun lokal dhe atë global, tani po matet me respekt dhe respekt që u jepet njerëzve. Përveç përmbushjes së pritshmërive dhe nevojave të konsumatorëve të sotëm në nivelin më të lartë, kërkohet që të vlerësohet dhe respektohet mjedisi dhe bota në të cilën jetojmë.

Këto zhvillime kanë zbuluar faktin se ekziston një nevojë për sisteme menaxheriale që do t'u mundësojnë bizneseve të mbajnë nën kontroll ndërveprimet e tyre me mjedisin dhe të përmirësojnë vazhdimisht aktivitetet dhe arritjet e tyre mjedisore. ISO 14001 është një standard i sistemit, i cili bazohet në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore. Ajo është në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni përkatës dhe ligjet në lidhje me faktorët e mjedisit. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit quhet Sistemi i menaxhimit që çdo kompani zhvillon për reduktimin sistematik dhe eliminimin e mundshëm të dëmeve që ato mund të shkaktojnë në mjedis. Pra si rezultat i këtij gjykimi menaxhimi i mjedisit që ka lidhje me çertifikatën ISO 14001:2015 është standart me të cilin duhet të operojë çdo kompani pavarësisht fushës së saj të aktivitetit apo madhësisë së saj. Ky standart tregon se kompania gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj operon në përputhje me parimet e mbrojtjes së ekosistemit dhe minimizimin e efekteve negative në mjedis.

Për sa u sqarua më lart, çdo operator ekonomik pjesëmarrës në tenderat duhet të jete i pajisur me këto ISO pavaresisht ndarjes së furnizimit në % në BOE. Ky kriter nuk konsiderohet i përmbushur nëse ISO paraqitet vetëm nga njëri prej tyre. Sido që të ndahet % midis OE, secili prej tyre do të kryejë një aktivitet (furnizim) të caktuar dhe secili prej tyre duhet të faktoj se ploteson standartin i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të mjedisit. Theksojmë se kjo është një ndër ISOT më bazike që disponohet pothuajse nga pjesa më e madhe e OE.

2. Në piken 2.3.2 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar “Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimi e punimeve duhet të disponojë fuqi puntore mesatare prej minimalisht 60 persona per periudhën korrik 2021 –shtator 2021”.

Referuar kësaj kërkesë të AK, sqarojmë që rezultati i numrit të punonjësve të kërkuar është rrjedhojë e ditëve të punës për realizimin e të gjitha zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e ofertës dhe të kohëzgjatjes së kërkuar të punimeve (afati i realizimit të punimeve).

Afati i realizimit të punimeve është parashikuar 45 (dyzet e pesë) ditë, afat ky i kondicionuar nga periudha e mbetur në dispozicion deri në fund të vitit 2021, periudhë kjo e përcaktuar në Ligjin Nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, mbështetur në VKM Nr. 488, datë 17.06.2020 “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit 950 295 959 lekë, në programin “Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit”.

Si rezultat i këtij afati dhe zberthimit analitik të zërave të punës për ditët e punës së nevojshme për realizimin e tyre (mbi bazën e VKM Nr 629 datë 15.07.2015) kemi:

Pra nevojiten 3 637 ditë pune puntori dhe specialiste. Bazuar ne afatin 45 ditë pune, rezulton që operatori duhet të angazhojë mesatarisht 80 punonjës. Duke vlerësuar që, nga ana e operatoreve, në disa zëra punimesh do të perdoren procese të mekanizuara, nga ato të parashikuara në VKM Nr 629 datë 15.07.2015, u vlerësua që ky numër të jetë 60 punonjës.

3.Ne piken 2.3.2 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatori ekonomik pjesëmarës duhet te kete te punesuar punonjes te pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik leshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial dhe te figurojne ne listpagesat e shoqerise per periudhën korrik 2021 –shtator 2021 si me poshte:

1. 4 (kater) punonjes mekanikë
2. 4 (kater) punonjes saldatorë

Referuar afatit te perfundimit te punimeve 45 dite dhe zberthimit analitik te punimeve qe parashikojne perfshirjen e punonjesve mekanik dhe saldator, rezulton qe keto per keto punime nevojiten 109 dite pune.

4	An	F.V.Porte dige (ujeleshuese) komplet	komplet	1	42	42	5
5	An	Konstruksioni mbajtes i mekanizmit te portes	copë	1	42	31	4
6	An	F.V. Reduktor burme rrote shoqe i=50	copë	2	42	84	11
7	An	F.V.Aksi i Filetuar(Vida me fileto katrore) se bashku elementet bashkues)	copë	2	42	84	11
8	An	Materiale ndihmese	komplet	1	42	42	5
9	4,1+4,1/p	F.V.+perg Konstruksion metalik per uren qe lidh digen me pusin e komandimit	ton	1,5	42	63	8
10	4,1+4,1/p	F.V.+perg shkalle per zbritjen tek saracineska e pusit te komandimit me hekur d=22mm h=5m	ton	0,557	42	23	3
12	4,123/11	F.V.Saracineska gize + fllanxha, d=400 Pn~16bar	copë	2	24,2	48	6
13	4,123/12	F.V.Fllanxha celiku cift Pn 16, d=400	copë	2	24,2	48	6
14	4,112	Bojatisje mbi metal 1m2,me nje dore minio e dy duar boje	m ²	284	1,43	406	51

		vaji, konstruksione me profile					
--	--	--------------------------------	--	--	--	--	--

Keto punime jane komplekse dhe kerkojne nderthurjen e punimeve te kryera nga punonjes mekanikë dhe saldatore. Ne grafikun total te punimeve, keto operacione jane vleresuar te kryhen ne rreth 12 – 14 dite. Si rezultat, perfundimi i ketyre punimeve do te kerkonte impenjimin e 8 punonjesve (109/8=13.6 dite kalendarike) te specialiteti mekanik dhe saldator. Specifikojme qe nje pjese e madhe e punimeve do te kryhen ne pusin e komandimit, i cili eshte nje ambient i mbyllur, gje e cila kerkon zevendesimin e shpeshte te punonjesve gjate 8 orareshit, per te siguruar kushte te sigurta dhe optimale per ta.

4.Sipas Auditit të KLSH-se kerkesa ne piken 2.3.7 ne te cilen Ak ka kerkuar 2 autopompa betoni nuk eshte e argumentuar sepse ne kerkesat e vecanta jane kerkuar 3 autobetoniera dhe referuar grafikut te punimeve dhe volumit te punimeve eshte e mjaftueshme 1 autopompe betoni.

Referuar plan organizimit te punimeve, volumeve te punimeve dhe vendndodhjen e nenobjekteve qe do te kerkojne perdorimin e autopompave te betoni, kemi vleresuar qe:

Kerkesa e vecante per 3 autobetoniera eshte e lidhur ngushte me vendndodhjen gjeografike te Rezervuarit Gjyslikanje (13 km nga rruga nacionale Tirane-Plepa dhe 30 km nga fabrikat e prodhimit te betonit ne rrethinat e Tiranës). Kjo distance shume e madhe, volumi i betonit te kerkuar dhe kohezgjatja e punimeve, kondicionojne numrin e autobetonierave te kerkuara

Ne kete kontekst, duke qene se hedhja e betonit ne veper eshte ne disa pika te vecanta te diges, nisur dhe nga mungesa e rrugeve alternative te furnizimit, eshte e pamundur spostimi brenda dites i autopompes ne pozicione diferente. Per kete eshte menduar pozicionimi permanent i dy autopompave ne 2 (dy) pika me gravitet me te larte te betonimeve.

5. Mjetet e përmendura nga auditi janë mjete të marra me qira nga operatori ekonomik fitues. KVO gjykon se per sa kohe nje kontrate qiraje mjeti eshte hartuar nga noteri eshte plotesisht e vlefshme dhe e rregullt pasi verifikimet e dokumentacionit te mjetit behen nga noteri. Nese nuk lejohet te jepet me qira nje mjet per shkak te pengeses ne dokumentacion kjo eshte pergjegjesi drejperdrejte e noterit si personi kompetent. Ne keto kushte KVO ka vepruar me siguri te plote duke u bazuar tek kontratat e qirase per 3 mjetet e permendura nga auditi.

6.Punonjësi z. I.H , i punësuar si mekanik disponon çertifikatë të vlefshme të sigurimit teknik me afat vlefshmërie deri në datë 09.02.2022. Bashkëlidhur do të gjeni kopje të çertifikatës me numër serie 0017685.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z.H.G, z.V.K, dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z.S.GJ, znj.M.N, z.R.S.

1. Kërkesa për Çertifikatën ISO 14001:2015 “Sistemi i Menaxhimit Mjedisor”, ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit **dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

Kërkesa për Çertifikatë ISO 45001-2018 “Sigurimi në punë”.Kjo kërkesë nuk është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.Në Republikën e Shqipërisë janë krijuar institucione të posaçme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë për punonjësit.Eshtë detyrë e këtyre institucioneve për të garantuar sigurinë. **Observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Ne piken 2.3.2 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar “Operatori ekonomik pjesëmarës për realizimi e punimeve duhet të disponojë fuqi puntore mesatare prej minimalisht 60 persona per periudhën korrik 2021 –shtator 2021”. Për këtë kërkesë autoriteti kontraktor ka paraqitur analizën e fuqisë punëtore sipas zërave të preventivit të punimeve duke llogaritur orë/pune. Sipas analizës së mësipërme nevojiten 3,637 ditë pune puntori dhe specialiste. Bazuar ne afatin 45 ditë pune, rezulton që operatori duhet të angazhojë mesatarisht 80 punonjës. Duke vlerësuar që, nga ana e operatoreve, në disa zëra punimesh do të perdoren proçese të mekanizuara, nga ato të parashikuara në VKM Nr 629 datë 15.07.2015, u vlerësua që ky numër të jetë 60 punonjës. **Observacioni i mësipërm merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

3. Pretendimi i sjellë në observacion nuk është i argumentuar teknikisht **dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

4. Pretendimi i sjellë në observacion nuk është i argumentuar teknikisht **dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

5. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik fitues për mjetet nuk është në përputhje me kërkesat e DST. Sipas VKM Nr.285, datë 19.05.2021, neni 82 “Shqyrtimi i ofertave” citon Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme në këto kushte **observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

6. Për çertifikatën e vlefshme të sigurimit teknik për punonjës të z. I.H, i punësuar si mekanik, u administrua dokumentacioni bashkëlidhur observacionit. **Observacioni i mësipërm merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit**

9-Proçedura e prokurimit me objekt: “Blerje zgara dhe puseta” Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

Zhvillimi i Proçedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje zgara dhe puseta” për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.2583/3, datë 14.10.2021	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.2583/3, datë 14.10.2021	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.2583/4, datë 14.10.2021
4. Lloji i Proçedurës së Prokurimit: ‘E hapur’	1. M.M –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. H.XH - (Anëtar) 3. I.M (Anëtar)	1. A.M – (Kryetar) 2. J.P - (Anëtar) 3. M.N – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 30,675,000- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E ‘P’ sh.p.k me ofertë 28,962,000 lekë pa tvsh, me lidhje kontrate nr.3195/18 datë 09/02/2022	7.Diferenca me fondin limit: 1,713,000 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 05.11.2021	9.Burimi Financimit: Transferta nga buxheti i Bashkisë Tiranë 2021- 30,675,000 lekë	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: 1-“M” shpk Nr.2583/6 prot, datë 27.10.2021 2-“T” shpk Nr.2583/7 prot, datë 27.10.2021	12. Përgjigje ankesës nga AK: 1-“M ” shpk Nr.2583/12 prot, datë 01.11.2021. 2-“T ” shpk Nr.2583/13 prot, datë 02.11.2021.	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: 1-Vendim K.P.P 871/2021 datë 09.11.2021 2-Vendim K.P.P 948/2021 datë 25.11.2021

Hartimi i kriterëve: Më datë 20.10.2021 është mbajtur procesverbali Nr.1 për hartimin e dokumenteve të tenderit dhe hartimin e kriterëve të veçanta.

Ankesa nga operatori M : Operatori ekonomik “M” shpk me shkresën e protokolluar tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Nr.2583/6 prot, datë 27.10.2021 ka paraqitur ankesë për kriteret e vëna në procedurën “*Blerje zgara dhe puseta*” me fondin limit 30,675,000 lekë pa tvsh.

Ankesa nga operatori T : Operatori ekonomik “T” shpk me shkresën e protokolluar tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Nr.2583/7 prot, datë 27.10.2021, ka paraqitur ankesë për kriteret e vëna në procedurën “*Blerje zgara dhe puseta*” me fondin limit 30,675,000 lekë pa tvsh.

Ngritja e komisionit të shqyrtimit të ankesave: Me urdhër Nr.2583/9 prot, datë 27.10.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës për procedurën “*Blerje zgara dhe puseta*” i përbërë nga z. A.M, z. J.P,znj. M.N.

Me shkresën Nr.2583/12 prot, datë 01.11.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i ka kthyer përgjigje ankesës së OE “M” shpk të cilën pranon pjesërisht pretendimet e operatorit ekonomik.

Me shkresën Nr.2583/13 prot, datë 02.11.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i ka kthyer përgjigje ankesës së OE “T” shpk të cilën nuk pranon pretendimet e operatorit ekonomik.

Komisioni i Prokurimit Publik:

Me shkresën Nr.2583/14 prot, datë 08.11.2021 protokolluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është kërkuar informacion për ankesën e operatorëve ekonomikë “M” dhe “T” shpk.

Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik me shkresën Nr.2583/15 prot, datë 09.11.2021 i ka kthyer përgjigje Komisionit të Prokurimit Publik.

Me vendim Nr.2111/3 prot, datë 09.11.2021 KPP vendosi:

1-Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. Ref-08885-10-20-2021, me objekt “Blerje zgare dhe puseta” për Drejtorinë e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik me fond limit 30,675,000 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 05.11.2021 nga autoriteti kontraktor.

2-Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

K.P.P me shkresën Nr.2110/4 prot, datë 16.11.2021 i është drejtuar, 1) Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, 2) OE “T” shpk dhe 3) OE “M” shpk për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Me shkresën Nr.3195/1 prot, datë 23.11.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka dërguar sqarimet përkatëse për procedurën me objekt prokurimi “Blerje zgara dhe puseta” me REF-08885-10-20-2021.

Me vendimin Nr.948/2021 KPP për procedurën me objekt prokurimi “Blerje zgara dhe puseta” me REF-08885-10-20-2021 vendosi.

1-Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “T” shpk.

2-Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “M” shpk.

3-Autoriteti Kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha

ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

Në datën 02.12.2021 është mbajtur shtojca për modifikimin e dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit “Blerje zgara dhe puseta”.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosuar kritere të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht

1.Pika 2.3.7. Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

b)Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr. 1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Bazuar në Akt Konstatimin nr. 19 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se ne lidhje me mjetet e marra me qera nuk është kërkuar që në kontratë të specifikohet objekti i tenderit por vlefshmeria e saj të mbulojë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, sipas afatit të parashikuar për këtë objekt prokurimi.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

2. Në lidhje me pikën 2.3.9. sipas DST-ve, dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre. **Observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022:

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë kryer gjithsej 51 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 934,404,014 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur 830,313,906 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 104,090,108 lekë pa TVSh ose 11.1%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën më poshtë:

Procedura 01.01.2022-31.12.2022	Nr.	Vlera e Fondit Limit	Vlera e Kontraktuar	Diferenca me Fondin Limit
Gjithsej	51	934,404,014	830,313,906	104,090,108
Kërkesë për propozim/ E hapur e thjeshtuar	14	43,163,945	42,608,752	552,193
E hapur	15	390,854,429	288,150,264	102,704,165

E Hapur Ndërkombëtare	5	492,730,558	492,730,558	0
Me vlerë të ulët	17	7,655,082	6,824,332	830,750
Sipas objekteve	51			
Objekte në fushën e investimeve	1	34,497,400	32,986,001	1,511,399
Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	50	899,906,614	797,327,905	102,578,709

U audituan gjithsej 5 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit 292,432,231 lekë dhe vlerë të kontratave 277,549,466 lekë ose 94.9% e fondit limit total. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej 11 OE/BOE, nga të cilat janë s'kualifikuar 5 OE/BOE. Me 1 OE të kualifikuar kanë qenë 4 procedura. Procedurat e zgjedhura për auditim janë paraqitur në tabelën më poshtë. Vlerat e paraqitura janë pa TVSh.

Nr.	Objekti	Lloji i procedurës	OE fitues	Fondi limit	Vlera e kontratës
1	Blerje karburanti (gasoil 10ppm) Loti I	E hapur (Marrëveshje kuadër)	BOE "R" sha dhe "K"	99,832,500	90,881,082
2	Blerje Bitumi	E Hapur (Marrëveshje kuadër)	R Sha	106,575,000	106,575,000
3	Përmirësimi i ndriçimit publik në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhe ndërtimi i korsive të biçikletave në sheshin "Nënë Tereza" deri në hyrjen e liqenit Artificial	E Hapur	I shpk	33,194,112	31,368,235
4	Blerje zgara dhe puseta	E Hapur (Marrëveshje kuadër)	P shpk	34,497,400	32,986,001
5	Blerje lëndë djegëse për përdorim termik, civil dhe industrial	E Hapur (Marrëveshje kuadër)	R Sha	18,333,219	15,739,148
Totali				292,432,231	277,549,466

Procedurat e audituara për periudhën 01.01.2022-31.12.2022

1-Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Bitumi" Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje Bitumi" për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.200/3, datë 01.02.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.200/3, datë 01.02.2022	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.200/4, datë 01.02.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Marrëveshje kuadër me 1 operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 mujor"	1. M.M –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. K.I - (Anëtar) 3. B.S (Anëtar)	1. SH.M – (Kryetar) 2. J.J - (Anëtar) 3. M.N – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 106,575,000- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E 'R' sh.p.k me ofertë 106,575,000 lekë me lidhje kontrate datë 08/04/2022, me afat 12 muaj	7.Diferenca me fondin limit: 0 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 11.03.2022	9.Burimi Financimit: Transferta nga buxheti i Bashkisë Tiranë 2021- 106,575,000 lekë	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE

11. Ankimime AK:
Nuk ka

12. Përgjigje ankesës nga AK:
Nuk ka

13. Përgjigje Ankesës nga KPP:
Nuk ka

Fondi limit: Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nr.200/1 prot, datë 26.01.2022 është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimin dhe llogaritjen e fondit limit i përbërë nga z. B.S, z.K.I, z. Q.X.

Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimin dhe llogaritjen e fondit limit ka mbajtur procesverbalin nr.200/2 prot, datë 31.01.2022 ku ka përcaktuar specifikimet teknike për bitumin. Komisioni për procedurën e mësipërme ka kryer testimin e tregut duke marrë 3 oferta,

1-Shoqëria “A” sha me NIPT K...O me çmim 93 lekë pa tvsh/kg.

2-Shoqëria “R” sha me NIPT L...V me çmim 85 lekë pa tvsh/kg.

3-Shoqëria “E” sha me NIPT K...J me çmim 83 lekë pa tvsh/kg.

Komisioni nga vlerësimi i tregut ka përlllogaritur mesataren aritmetike nga tre ofertat e tregut në vlerën 87 lekë pa tvsh/kg. Sasia e pritshme për procedurën e mësipërme është 1,200,000 kg. Komisioni i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor për përlllogaritjen e fondit limit ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, “Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.285, datë 19.05.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” pas pikës 2 shtohet pika 2.1 si më poshtë:

“2.1. Për furnizimin me karburant, G , benzol dhe karburant për ngrohje në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

a)Çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletin e Njoftime Publike.

b)Elementet Fiskale.

c)Normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi komisionin e përlllogaritjes së fondit limit z. B.S, z. K.I dhe z. Q.X.

Hartimi i kriterëve: Në datë 08.02.2022 është administruar procesverbali nr.1 për hartimin e dokumenteve të tenderit. DST janë firmosur nga gjithë NJP, në përputhje me Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosuar kriteret e paargumentuara e të pambështetura, konkretisht:

1.Pika 2.3.9. Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

a) *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit (kriteret e veçanta):

1.Në kriterin e vendosur për mundësinë e marrjes me qera të mjeteve që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, ku në kontratën noteriale duhet të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, Njësia e Prokurimit sqaron se nuk ka qenë qëllimi për specifikimin e objektit të prokurimit ose të tenderit në kontratë. Nëse do të ishte ky qëllimi do të ishte parashikuar të specifikohet objekti i tenderit apo i procedurës së prokurimit.

Megjithatë duke e parë në këndvështrimin e auditit, njësia arsyeton se Autoriteti Kontraktor ka ndër të tjera, një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj, mirëmbajtjen e shtresave asfaltike rrugore në të gjithë territorin e Bashkisë së Tiranës. Në funksion të kësaj veprimtarie AK-ja disponon një impiant për prodhimin e asfaltit, ku bitumi është një nga komponentët kryesor dhe të domosdoshëm për prodhimin e asfaltit. Drejtoria prodhon asfalt në mënyrë të vazhdueshme dhe nevoja për bitum është shumë e shpeshtë, me frekuencë mesatarisht 3-4 herë në javë, ka raste dhe çdo ditë.

Për shkak të rëndësisë se vecante që ka furnizimi me bitum, AK i lind e drejta të kerkoje qe OE te disponoje nje mjet (jo vetem ne pronesi por edhe me kontrate qiraje) në menyre qe te garantohet dhe ti ofrohet siguri AK se furnizimi nuk do te deshtoje, do te realizohet ne kohe sipas kerkeses se AK. Kerkesa e AK per specifikimin e objektit te tenderit ne kontraten e qirasë eshte e justifikuar pasi AK kerkon siguri dhe garanci se mjeti nuk do të jetë i angazhuar në kontratë apo punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti duke mos sjelle vonesa në kryerjen e furnizimit dhe si rezultat mosrealizimin e prodhimit sipas objektivave të AK-së.

Theksojmë se në lidhje me këtë kriter nuk është paraqitur ankesë nga ndonjë operator ekonomik dhe as nuk është dërguar rekomandim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik si autoriteti që mbikqyr, monitoron dhe jep asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

Për sa më lart gjykojmë se ky kriter është plotësisht i argumentuar dhe nuk është përjashtues.

2.Temperatura e kërkuar e bitumit mbi 150 °C në momentin e furnizimit është e nevojshme pasi furnizimi bëhet me ajër dhe lënda duhet të jetë sa më e lëngshme në mënyrë që të shkarkohet lehtë për tu magazinuar në depozitën e caktuar.

3.Komisioni i ngritur me Urdhërin e Titullarit Nr.200/1 Prot. datë 26.01.2022 për hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit të kontratës dhe argumentimin e tij si dhe përcaktimin e grafikut të lëvrimit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje bitumi” e ka llogaritur atë jo me marzh fitimi, si nënprodukt i naftës por e ka llogaritur me çmim fiks në përputhje me VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Qëndrimi i Grupit të auditimit (kriteret e veçanta):

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z.K.I, z. B.S.

1. Në lidhje me pikën 2.3.9. sipas DST-ve ,dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre. Pika e mësipërme është trajtuar në Akt Konstatimin Nr.16, datë 21.03.2024 dhe

nga subjekti i audituar nuk janë sjellë argumenta shtesë për argumentimin e kësaj kërkesë në DST dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

2. Në lidhje me temperaturën e bitumit, argumenti merret në konsideratë.

3. Për pikën 3 për përlogaritjen e fondit limit komisioni nuk ka vepruar me marzh fitimi por me çmimin mesatar të marrë nga 3 ofertat e tregut. Siç është trajtuar në projekt raportin e auditimit Komisioni i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor për përlogaritjen e fondit limit ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, “Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.285, datë 19.05.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” pas pikës 2 shtohet pika 2.1 si mëposhtë:

“2.1. Për furnizimin me karburant, G , benzol dhe karburant për ngrohje në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlogaritet bazuar në:

a) Çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletin e Njoftime Publike.

b) Elementet Fiskale

c) Normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

Observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

2-Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje karburanti (gasoil 10ppm) për “Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburanti (gasoil 10ppm)		
1. Urdhër Prokurimi Nr.1820/3 prot., datë 22.06.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Urdhër nr. 1820/3, datë 22.06.2022 1. M.M –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. K.I - (Specialist) 3. B.S –(Specialist)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër Nr.1820/4 prot, datë 22.06.2022 1. SH.M (Kryetar) 2. M.K (Anëtar) 3. M.N (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur”, e tipit Marreveshje Kuader		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 99,832,500 lekë	6. Oferta fituese: BOE “R” sha dhe “K” shpk me ofertë ekonomike 90,881,082 lekë dhe me marzh fitimi 14.4 lekë/litër marreveshje kuadër me datë kontrate 07.09.2022 me afat 12 mujor.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 8,951,418 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 22.06.2022	9. Burimi Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Tiranë	10. Operatorët Ekonomike: a) Pjesëmarrës në tender: 3 BOE -BOE “A”, “A” dhe O” shpk - BOE “G” shpk dhe “G” sha - BOE “R” sha dhe “K” shpk
11. Ankimime në AK	12. Përgjigje ankesës nga AK	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP

Fondi limit: Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nr.1820/1 prot, datë 21.06.2021 është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimin dhe llogaritjen e fondit limit i përbërë nga z. B.S, z. K.I, z. G.Q.

Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimin dhe llogaritjen e fondit limit ka mbajtur procesverbalin nr.1820/2 prot, datë 22.06.2021 ku ka përcaktuar specifikimet teknike për karburantet.

Hartimi i kriterëve: Me urdhër prokurimi të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së

Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nr.1820/3 prot, datë 22.06.2021, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga zj.M.M, z.K.I dhe z.B.S në procedurën “Blerje Karburanti Loti I”, me fondin limit 99,832,000 lekë pa tvsh.

-Në datë 22.06.2022 është administruar procesverbali për hartimin e dokumenteve të tenderit. Dokumentat e tenderit janë hartuar në kundërshtim me Vendimin Nr.710, datë 24.11.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.285, datë 19.05.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” shtohet pika 2.1 me përmbajtje.

2.1. Për furnizimin me karburant, G , benzol dhe karburant për ngrohje në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

a)Çmimin e bursës, lëvrrur sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike

b)Elementët fiskalë

c)Normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Për parashikimin e zërit blerje karburanti viti 2022 jemi bazuar si më poshtë:

Për vitin 2021 konsumi i karburantit gaz-oil është 506,063 lit. Nga këto një sasi prej 18,390 lit është konsum karburantit për Administratën dhe 74,023 lit është konsumi i kaldajës së asfaltit (fabrika). Konsumi i përlllogaritur për harxhimin e mjeteve të transportit për vitin 2021 është 413,650 lit dhe një mesatare mujore 34,470 lit.

- Kemi parashikuar konsumin e karburantit edhe për mjetet e reja qe do te blihen me anë të prokurimit gjatë vitit 2022 me një konsum shtesë prej 26,960 lit.

a- Kamioncin, fletë-hyrje nr.1,datë 21.12.2021 për konsumin e këtij mjeti i jemi referuar mjetit të ngjashme me targë AB 052 BC dhe AA 855 UZ, me një konsum 20 dhe 21 Litra për 100km. Këto mjete në vit bëjnë afërsisht 18,000-20,000km, referuar kjo vitit 2021. Referuar këtyre të dhënave kemi përlllogaritur me afërsi normativën 18Lit/100km dhe afërsisht 18,000 km në vit me një konsum mesatar 3,240 Lit/vit.

b- Kamion Mercedes-Benz 814, fletë-hyrje nr.1,datë 13.01.2022 për konsumin e këtij mjeti i jemi referuar mjetit të ngjashme me targë TR 6443 M, TR 1980 I, me një normativë konsumi 28Litra për 100km. Këto mjete në vit bëjnë afërsisht 18,000-20,000km, referuar kjo vitit 2021. Referuar këtyre të dhënave kemi përlllogaritur një normativë me afërsi 25L/100km dhe afërsisht 15,000km në vit me një konsum mesatar 3,750 Lit/vit.

c- Kamion vinc, fletë-hyrje nr.2,datë 13.01.2022 për konsumin e këtij mjeti i jemi referuar mjetit të ngjashme me targë AA 496 TA (vinc), me konsum 28Lit/100km dhe ka kryer 23,725 km për vitin 2021. Referuar këtyre të dhënave si dhe mjeti që ne kërkojmë ka fuqi motorrike më të madhe kemi përlllogaritur me afërsi 35Lit/100km dhe afërsisht 18,000km në vit me një konsum mesatar 6,300 Lit/vit.

d- Kama, fletë-hyrje nr.1,datë 12.12.2022 për konsumin e këtij mjeti i jemi referuar mjeteve të ngjashme me targë TR 5369 R, AA 038 CY, TR 5375 R.

TR 5327R me konsum 13Lit/100km. Këto mjete kryejnë 12,000-14,000km për vitin 2021. Referuar këtyre të dhënave kemi përlllogaritur një normativë me afërsi 13Lit/100km dhe afërsisht 10,000km në vit me një konsum mesatar 1,300 Lit/vit.

e- Fadrom Hidromek, fletë-hyrje nr.3, datë 12.12.2022 për konsumin e këtij mjete i jemi referuar mjetit të ngjashme me targë AHMT 84, AHMT 85, këto mjete kanë konsum 11Lit/orë pune dhe gjatë vitit 2021 përkatësisht kanë kryer.

AHMT 85 1,465 orë punë 16,115 Lit dhe AHMT84 ka kryer 1446 orë pune 15906L. Referuar këtyre të dhënave kemi përlogaritur 10Lit/orë pune, 1237 orë pune në vit dhe konsum mesatar 12,370 Lit.

Referuar llogaritjeve të mësipërme:

-Kuota për administratën 18,390 litra.

-Konsum mjetesh gjatë vitit 2021,413,650 litra.

- Konsum shtesë për mjetet e reja 26,960 litra.

Me nje total prej 459,000 litra.

2. Në lidhje me numrin e stacioneve te shitjes se karburanteve me pakice (loti 1 dhe 3) te percaktuara ne DST sqarojme se:

Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale, e rrjetit të ndriçimit publik, e sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale, me apo pa ndriçim) si dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse në territorin e Bashkisë Tiranë. Kjo veprimtari voluminoze ushtrohet në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Ju sjellim në vëmendje se territori i Bashkisë Tiranë arrin një sipërfaqe prej 1,120.91 km². Në përbërje të saj Bashkia Tiranë ka 11 njësi administrative urbane, 13 njësi rurale dhe 3 lagje si mëposhtë vijon:

Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor disponon një flotë prej rreth 70-80 mjetesh, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga kamionçinat, kamion me akse të ndryshme, transportier rimorkio, fadroma, ekskavator me goma dhe me zinxhir, rula, autokulla, frezë asfalti, shtruese asfalti, motoçikleta etj.

Duke marrë në konsideratë territorin e gjerë ku operohet dhe dinamikën e punimeve që kryhen është i domosdoshem aksesimi në pika të shumta karburanti duke shmangur humbjen në kohë dhe koston që do të sillte për Autoritetin Kontraktor mungesa e aksesit nga pikat e furnizimit.

-Nga verifikimi që ka bërë Njësia e Prokurimit si në terren ashtu edhe në faqen e QKB-së, rezulton se brenda territorit të Bashkisë Tiranë operojnë minimalisht 5 shoqëri tregtare që disponojnë nje numer te larte stacionesh të shitjes së karburanteve me pakicë d.m.th me pistoletë publike si mëposhtë vijon:

Shoqëria K sh.p.k rreth 11 stacione

Shoqëria S sh.p.k (E) rreth 10 stacione

Shoqëria D sh.p.k (A) rreth 12 stacione

Shoqëria G sh.p.k rreth 12 stacione

Shoqëria O sh.p.k (B) rreth 8 stacione

- Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon instrumenta të tjerë në mënyrë që operatorët ekonomikë të bëhen pjesë e procedurave të prokurimit publik që zhvillojnë Autoritetet Kontraktore. Konkretisht në nenin 88 të VKM nr.285, datë 19.05.2021”Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar i jepet mundësia operatorëve ekonomikë që të bëhen pjesë e procedurave të prokurimit të zhvilluara nga AK edhe nëpërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë.

- Autoriteti Kontraktor i ka dhene mundesine operatoreve ekonomik pjesëmarrës qe te disponojne stacionet e shitjes së karburanteve me pakicë jo vetëm me akt pronësie ose qeraje por edhe me kontratë bashkepunimi noteriale.

Duke marrë për baze faktet e mësipërme, siç është territori i gjerë ku operohet (shume e rendesishme), numri i larte i mjeteve, numri i shoqerive qe tregetojne karburant me pakice dhe numri i pikave qe ata disponojne brenda territorit te Bashkise Tiranë, mundesia e bashkimit te operatoreve dhe mundesia e disponimit te stacioneve edhe me kontrate bashkepunimi, AK gjykon se kërkesa per minimalisht 7 stacione është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e

kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale, e rrjetit të ndriçimit publik, e sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale, me apo pa ndriçim) si dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse në territorin e Bashkisë Tiranë.

Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor disponon një flotë prej rreth 70-80 mjetesh, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga kamionçinat, kamion me akse të ndryshme, transportier rimorkio, fadroma, ekskavator me goma dhe me zinxhir, rula, autokulla, frezë asfalti, shtruese asfalti etj.

Disa nga mjetet e Autoritetit janë mjete teknologjike të tonazhit të rëndë, të cilat stacionohen në kantieri pune që ndodhen në zona rurale të ndryshme dhe kryejnë procese pune të vazhdueshme siç është pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditëse, heqja e dherave nga rrëshkitjet etj. dhe për këtë arsye e kanë të pamundur furnizimin me karburant në stacionet e furnizimit për shkak të largësisë së tyre. Përveç largësisë nga pikat e furnizimit, lëvizja dhe transporti (eskavatorët me zinxhir transportohen vetem me rimorkiator) i këtyre mjeteve nga kantieri drejt këtyre pikave do të sillte humbje në kohë dhe kosto për Autoritetin Kontraktor.

Mjetet kryesore teknologjike që disponon Autoriteti, të cilat kanë nevojë të furnizohen me autobot janë:

-Eskavator me zinxhir (Volvo), rreth 24 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 350 litra.

-Eskavator me zinxhir (Volvo), rreth 10 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 100 litra.

-Eskavator me goma (Terex), rreth 18 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 250 litra.

-Eskavator me goma nati), rreth 12.5 ton, me kapacitet të depozitës së karburantit rreth 250 litra.

Nga një përlllogaritje e përafërt rezulton që sasia e karburantit për furnizimin e mjeteve të mësipërme varion rreth 1000 litra.

Në këto kushte dhe përsa u argumentua më lart, Autoritetit Kontraktor gjykon se kjo kërkesë për furnizim me autobot me kapacitet mbajtës minimumi 1000 litra është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

3. Llogaritja dhe argumentimi i fondit limit të prokurimit:

Njësia e Prokurimit ka përzgjedhur si kriter për përzgjedhjen e fituesit ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në çmim në përputhje me VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në DST-në e miratuar nga APP-ja, në rastin e prokurimit të karburanteve janë parashikuar dy shtojca për t’u plotësuar njëkohësisht, përkatësisht shtojca 1/1 dhe shtojca 2. Shtojca 1/1 kërkon ofertimin e normës së fitimit e shprehur në vlerë absolute kurse shtojca 2 ofertimin e çmimit për njësi shumëzuar me sasinë e pritshme. Siç del edhe nga parashikimi në gërmën ç), pika 7 të shtojcës 1/1, shtojca 2 është e detyrueshme për t’u plotësuar duke qenë pjesë të pandashme të njëra-tjetrës.

Për efekt vlerësimi të tenderit do të merret parasysh si nomra e fitimit, edhe vlera totale e ofertes që del nga shumëzimi i sasisë së pritshme dhe çmimit për njësi pa tvsh. Ndërsa për efekt zbatimi të kontratës norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute, do të mbetet e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës sipas nenit 107 të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Më poshtë do të gjeni dy shtojcat e sipërcituara me markimin e tekstit shpjegues.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z. K.I, z. B.S dhe Komisioni i llogaritjes së fondit limit z.B.S, z.K.I, z.G.Q.

1. Në lidhje me dokumentimin e përllogaritjes së fondit limit Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik i është referuar kontratës së mëparshme të vitit 2021. Veprimet e mësipërme janë në përputhje me VKM Nr.914, datë 29.12.2014. Observacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor paraqet argumenta shtesë dhe si i tillë **merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Në lidhje me numrin e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice (loti 1 dhe 3) të percaktuara në DST sqarohet se: Nga verifikimi në QKB dhe faqet eeb të kompanive të cilat tregtojnë hidrokarburë në territorin e Bashkisë së Tiranës rezultoi se më shumë se 3 kompaninë në territorin e Bashkisë së Tiranës disponojnë më shumë se 7 pika shitje karburanti. Në këto kushte kriteri i vendosur në DST nuk ndikon në ulje të konkurrencës dhe si i tillë **merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

3. Hartimi i DST ka ndikuar në vlerësimin e ofertave sepse është shpallur fituese oferta me çmimin më të ulët dhe jo oferta me marzhin më të ulët. Sasia e pritshme e cila është pjesë e shtojcës Nr.2 është sasi orientuese sepse sasia përfundimtare që do të përfitohet nga autoriteti kontraktor do të varet nga marzhi të cilët do të ofertojnë operatorët ekonomik.

Observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.

3-Proçedura e prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse për përdorim termik, civil dhe industrial”

Zhvillimi i Proçedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse për përdorim termik, civil dhe industrial” për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.1677/3, datë 16.06.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.1677/3, datë 16.06.2022	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.1677/4, datë 16.06.2022
4. Lloji i Proçedurës së Prokurimit: ‘E hapur’ Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara me afat 12 mujor.	1. A.P –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. K.I - (Anëtar) 3. B.S (Anëtar)	1. SH.M – (Kryetar) 2. S.S - (Anëtar) 3. A.V – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 18,333,219- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E ‘R’ sh.p.k me ofertë 15,739,148 lekë pa tvsh, me lidhje draft marrëveshje kuadër nr.1677/9 datë 15/08/2022, me afat 12 mujor	7.Diferenca me fondin limit: 2,594,071 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 13.07.2022	9.Burimi Financimit: Transferta nga buxheti i Bashkisë Tiranë 2021- 18,333,219 lekë	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Hartimi i kriterëve: Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nr.1677/1 prot, datë 09.06.2022 është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit dhe llogaritjen e fondit limit i përbërë nga z. B.S, z. K.I, z. J.J.

Në dokumentat e procedurës të hartuara nga NJP me përbërje z. A.P , z. K.I dhe z. B.S në pikën 4.4 kriteret e përzgjedhjes së fituesit është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e

favorshme bazuar në çmim në kundërshtim me VKM Nr.710, datë 24.11.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.285, datë 19.05.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45, pika 2.1.

Neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” shtohet pika 2.1 me përmbajtje.

2.1. Për furnizimin me karburant, G, benzol dhe karburant për ngrohje në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllongaritet bazuar në:

a)Çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike

b)Elementët fiskalë

c)Normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosuar kritere të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht:

1.Pika 2.3.9. Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

a) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre.

Specifikimet teknike:

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1.Njësia e Prokurimit ka përzgjedhur si kriter për përzgjedhjen e fituesit ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në çmim në përputhje me VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në DST-në e miratuar nga APP-ja, në rastin e prokurimit të karburanteve janë parashikuar dy shtojca për t’u plotësuar njëkohësisht, përkatësisht shtojca 1/1 dhe shtojca 2. Shtojca 1/1 kërkon ofertimin e normës së fitimit e shprehur në vlerë absolute kurse shtojca 2 ofertimin e çmimit për njësi shumëzuar me sasinë e pritshme. Siç del edhe nga parashikimi në gërmën ç), pika 7 të shtojcës 1/1, shtojca 2 është e detyrueshme për t’u plotësuar duke qenë pjesë të pandashme të njëra- tjetrës.

Për efekt vlerësimi të tenderit do te merret parasysh si nomra e fitimit, edhe vlera totale e ofertes qe del nga shumezimi i sasise se pritshme dhe cmimit per njesi pa tvsh. Ndersa per efekt zbatimi te kontrates norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute, do të mbetet e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës sipas nenit 107 të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar . Më poshtë do të gjeni dy shtojcat e sipërcituara me markimin e tekstit shpjegues.

2.Autoriteti Kontraktor ka ndër të tjera, një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj, mirëmbajtjen e shtresave asfaltike rrugore në të gjithë territorin e Bashkisë së Tiranës. Në funksion të kësaj veprimtarie AK-ja disponon një impiant për prodhimin e asfaltit, ku lenda djegese

është e domosdoshme për funksionimin e impiantit. Drejtoria prodhon asfalt në mënyrë të vazhdueshme dhe nevoja për lende djegese është e shpeshtë.

Për shkak të rëndësisë së vecante që ka furnizimi me lende djegese, AK ka kërkuar që OE të disponojë një mjet (jo vetëm në pronësi por edhe me kontratë qiraje) në mënyrë që të garantohet dhe të ofrohet siguri AK se furnizimi nuk do të deshtojë, do të realizohet në kohë sipas kërkesës së AK. Kërkesa e AK për specifikimin e objektit të tenderit në kontratën e qirasë është e justifikuar pasi AK kërkon siguri dhe garanci se mjeti nuk do të jetë i angazhuar në kontratë apo punëmartje tjetër dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti duke mos sjelle vonesa në kryerjen e furnizimit dhe si rezultat mosrealizimin e prodhimit sipas objektivave të AK-së.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit **znj.A.P, z. K.I, z. B.S.**

1.Hartmi i DST ka ndikuar në vlerësimin e ofertave sepse është shpallur fituese oferta me çmimin më të ulët dhe jo oferta me marzhin më të ulët.Sasia e pritshme e cila është pjesë e shtojcës Nr.2 është sasi orientuese sepse sasia përfundimtare që do të përfitohet nga autoriteti kontraktor do të varet nga marzhi të cilët do të ofertojnë operatorët ekonomik.

Observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë në hartimin e Raporti Përfundimtar të Auditimit.

2. Në lidhje me pikën 2.3.9. sipas DST-ve ,dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre. **Observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

4-Proçedura e prokurimit me objekt: “Përmirësimi i ndriçimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi i korsive të biçikletave në sheshin “Nënë Tereza” deri në hyrjen e liqenit Artificial”.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësimi i ndriçimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi i korsive të biçikletave në sheshin “Nënë Tereza” deri në hyrjen e liqenit Artificial.”		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.1767/2, datë 24.06.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.1767/2, datë 24.06.2022	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.1767/2, datë 24.06.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ‘E hapur’	1. A.P –(Anëtar) 2. E.C - (Anëtar) 3. J.J (Anëtar)	1. M.M – (Kryetar) 2. I.B - (Anëtar) 3. Y.L – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 33,194,112- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E ‘I ’’ sh.p.k me ofertë 31’368’235 lekë pa tvsh lekë, me lidhje kontrate datë 16/08/2028, me afat realizim kontrate 8 javë nga nënshkrimi i kontratës.	7.Diferenca me fondin limit: 1,825,877 - lekë pa tvsh

8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 20.07.2022	9. Burimi Financimit: Transferta nga Bashkia e Tiranës - 33,194,112 lekë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Më datë 27.06.2022 nga anëtarët e njësisë së prokurimit z. A.P person përgjegjës, znj. E.C anëtar dhe z. J.J anëtar është mbajtur procesverbal për hartimin e dokumenteve të tenderit dhe hartimin e kriterëve të veçanta.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosuar kriterë të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht:

1. Në pikën 2.3.4, të kapacitetit teknik AK ka kërkuar; “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme), lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin Maj 2022 si më poshtë:

- 1 (nje) punonjës teknik ndërtimi (minimumi Kategoria II)
- 1 (nje) punonjës te specializuar/kualifikuar per punimet elektrike (minimumi Kategoria I)
- 1 (nje) punonjës te specializuar/kualifikuar per punimet e sinjalistikes ndricuese (Semafore) (minimumi Kategoria I)
- 1 (dy) punonjës te specializuar/kualifikuar per punimet e betonit (minimumi Kategoria I)

Kërkesa e mësipërme 1 (nje) punonjës teknik ndërtimi (minimumi Kategoria II) është në kundërshtim me pikën 1 të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Autoriteti kontraktor ka kërkuar inxhinier ndërtimi për procedurën e mësipërme.

2. Në pikën 2.3.7, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e mëposhtme”:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues me kapacitet jo me pak se 20 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet jo me pak se 7 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë me kapacitet mbajtës jo me pak se 1,5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Prerëse (sharre) asfalti	2 copë	Pronësi ose me qera
Asfalto shtruese	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Greider	1 copë	Pronësi ose me qera
Rul	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 copë	Pronësi ose me qera
Freze asfalti	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Kompresor (i lëvizshëm)	2 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere 500 litra	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator Thellesie	2 copë	Pronësi ose me qera
Batipal per vendosje barriera metalike	1 copë	Pronësi ose me qera
Karrel per sinjalizim e punimeve ne rruge	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
Makineri vijëzimi me bojë bikomponente	2 copë	Pronësi ose me qera
Semafor te levizeshem per menaxhim trafiku	2 cope	Pronësi ose me qera
Mjet fshese per pastrimin e asfaltit	1 cope	Pronësi ose me qera

Kërkesa e mësipërme në pikën 2.3.7 në të cilën AK ka kërkuar 2 kamion vetëshkarkues me kapacitet jo më pak se 20 ton nuk është e argumentuar, punimet do të kryhen në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” e cila është rrugë jo me shtresa asfalti por me pllaka dhe këto makineri me tonazh të rëndë do të sjellin dëmtim të bulevardit.

Kërkesa e AK për 2 asfalto shtruese nuk është e argumentuar. Sipas grafikut të punimeve shtresa e asfalto betonit do të shtohet për 2 javë kalendarike dhe volumi i shtrimit do të jetë 4,716m², për këtë volum punimesh është e mjaftueshme vetëm 1 asfalto shtuese.

Kërkesa e AK për 1 mjet grejder nuk është e argumentuar. Sipas projekt zbatimit nuk do të ndryhet në nënshtresat e segmentin ekzistues së korsisë së biçikletave por vetëm për zgjerimin e korsisë me 50 cm do të ndryhet në nënshtresat me shtresa stabilizanti. Kërkesa për 1 mjet grejder për shpërndarjen e materialit stabilizant për 50 cm nuk argumentohet.

Kërkesa e AK për 1 batipal për vendosje barriere metalike nuk është e argumentuar, sipas preventivit nuk kemi vendosje barrierë rrugore por vetëm vazo mermeri me mbrojtëset metalike.

Kërkesa e AK për 1 batipal për vendosje barriere metalike nuk është e argumentuar, sipas preventivit nuk kemi vendosje barrierë rrugore por vetëm vazo mermeri me mbrojtëset metalike.

Kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me pikën 1 të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës

3.Pika 2.3.8. Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

b) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t’u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s’kualifikimin e tyre.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1.Njësia e Prokurimit e ka gjykuar të arsyeshme dhe në përpjestim të drejtë kërkesën për teknik ndërtimi si kriter i lidhur ngushtë me natyrën, vlerën e kontratës (fondi limit 33.194.112 lekë pa tvsh, pra mbi kufirin e ulët monetar, procedurë e hapur) dhe rëndësinë e tij (punime në një nga arteriet më të rëndësishme të qytetit të Tiranës siç është bulevardi “Dëshmorët e Kombit” dhe sheshi “Nënë Tereza”). Gjithashtu duke patur në konsideratë natyrën e kontratës (punë), nevoja e teknikut të ndërtimit si pjesë e personelit të OE është gjykuar thelbësore për shkak të detyrave dhe përgjegjësisive që ai ka gjatë zbatimit të punimeve .

2.Në lidhje me kërkesën për disponimin e kamionëve me kapacitet jo më pak se 20 ton sqarojmë se janë kërkuar për transportin e vazove dhe asfaltit në kantier, bazuar në kohën e përcaktuar në grafikun e punimeve duke marrë parasysh edhe vendndodhjen e kantierit në zemër të qytetit ku trafiku është i

rënduar dhe transporti me këto mjete është me i pershtatshem duke minimizuar levizjet e shpeshta. Nuk kemi informacion në lidhje me peshëmbajtjen e pllakave të bulevardit dhe si rrjedhojë nuk mund të gjykohej për rrezikun e dëmtimit të tyre pasi realisht nuk ka patur dëmtim të tyre nga mjetet e rënda gjatë punimeve të kryera.

3. Dy asfaltoshtrueset janë parashikuar për të punuar paralel në të dy korsi të biçikletave, kryesisht natën për të mos sjellë vështirësi në qarkullimin rrugor dhe njëkohësisht është menduar për rast avarie edhe pasja e një të tilla si back up (rezervë).

4. Në preventiv janë parashikuar disa procese pune si heqja e shtresave ekzistuese, mbushja me material, hapja me grejder, nivelim dhe asfaltim.

5. Batipali është kërkuar për përsheptimin e procesit të punës në vendosjen e bullonave për fiksimin dhe kapjen e mbrojtëseve metalike.

6. Vibratori i thellësisë është parashikuar për ngjeshjen e betonit në struktura monolite sipas preventivit.

7. Në kriterin e vendosur për mundësinë e marrjes me qera të mjeteve që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, ku në kontratën noteriale duhet të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, Njësia e Prokurimit sqaron se nuk ka qenë qëllimi për specifikimin e objektit të prokurimit ose të tenderit në kontratë. Nëse do të ishte ky qëllimi do të ishte parashikuar të specifikohet objekti i tenderit apo i procedurës së prokurimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj. A.P., z. E.C, z. J.J.

1. Në procedurën e mësipërme Përmirësimi i ndriçimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi i korsive të biçikletave në sheshin “Nënë Tereza” deri në hyrjen e liqenit Artificial do të kryhen punime për riparimin e korsive të biçikletave dhe shtesë e kësaj korsive të biçikletave me 0.5 m². Në këtë procedurë në DST është kërkuar inxhinier ndërtimi dhe kohëzgjatje e punimeve do të jetë 8 javë nga data e lidhjes së kontratës. Referuar zërave të preventivit të punimeve dhe volumit të tyre nuk është e nevojshme të kërkohej edhe inxhinier ndërtimi edhe teknik ndërtimi **dhe sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Kërkesa e mësipërme në pikën 2.3.7 në të cilën AK ka kërkuar 2 kamion vetëshkarkues me kapacitet jo më pak se 20 ton siç është trajtuar edhe në projekt raportin e auditimit këto mjete transporti me këtë kapacitet mbajtës janë factor për të dëmtuar trupin e rrugës. Sipas projektit shtresat e asfaltit janë parashikuar të shtorjen për 2 janë. Kjo periudhë kohe është e mjaftueshme për mos të sjell pengesa në sjelljen e materialit asfalt me mjete të tonazhit me të ulët.

3. Siç është trajtuar dhe në projekt raportin e auditimit kërkesa e AK për 2 asfalto shtruese nuk është në përputhje me grafik e punimeve dhe volumin e punimeve. Për këtë grafik dhe volum punimesh është e mjaftueshme vetëm 1 asfaltoshtruese. Nuk është përgjegjësi e AK për problematika të mjeteve gjatë procesit të punës është përgjegjësi i operatorit ekonomik fitues të përfundoj punimet sipas grafik të përcaktuar **dhe sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

4. Sipas preventivit është parashikuar shtresë stabilizanti por kjo shtresë stabilizanti është parashikuar vetëm për gjerësi 0.5 m për korsi. Mjeti grejder shërben për hapjen e shtresave të stabilizantit për rrugë dhe jo për këto gjerësi minimale sepse e ka të pamundur për të kryer këtë proces pune **dhe sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

5. Batipali është paisje e cila shërben për të instaluar barrierat mbrojtëse në autostrada dhe rrugë. Në procedurën e mësipërme nuk parashikohet në preventiv të vendosen barrier mbrojtëse. Gjatë fazës së kryerjes së punimeve do të vendoset vetëm sinjalistikë orientuese për menaxhimin e qarkullimit të mjeteve **dhe sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

6. Vibratori i thellësisë është mjet i cili shërben gjatë procesit të punimeve të ndërtimit për ngjeshjen e betonit. Refuar zërave të preventivit ky mjet është I domosdoshëm për kryerjen e punimeve **dhe sa më sipër observacioni merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

7. Në lidhje me pikën 2.3.8. sipas DST-ve, dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t'u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikimin e tyre. **Observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

5-Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje zgara dhe puseta” Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje zgara dhe puseta” për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik		
1.Urdhër Prokurimi: Nr.2069/3, datë 10.08.2022	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr.2069/3, datë 10.08.2022	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr.2069/4, datë 10.08.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Marrëveshje kuadër me 1 operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 mujor”	1. M.M –(Përgjegjës Prokurimesh Publike, Drejtoria Juridike) 2. K.I - (Anëtar) 3. I.M (Anëtar)	1. A.M – (Kryetar) 2. H.XH - (Anëtar) 3. A.P – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 34,497,400- lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: O.E ‘P’ sh.p.k me ofertë ekonomike 32,986,001 lekë dhe, me lidhje draft marrëveshje kuadër datë 19/10/2022, me afat 12 mujor	7.Diferenca me fondin limit: 1,511,399 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: - Data e zhvillimit: 12.09.2022	9.Burimi Financimit: Transferta nga buxheti i Bashkisë Tiranë 2022- 34,497,400 lekë	10.Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

Më datë 17.08.2022 është mbajtur procesverbali Nr.1 për hartimin e dokumenteve të tenderit dhe hartimin e kriterëve të veçanta.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosuar kriterë të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht:

1.Pika 2.3.7. Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

b)Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t'u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto

kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikimin e tyre.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr. 24 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarojmë se ne lidhje me mjetet e marra me qera nuk është kërkuar që në kontratë të specifikohet objekti i tenderit por vlefshmeria e saj të mbulojë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, sipas afatit të parashikuar për këtë objekt prokurimi.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.M.M, z. K.I, z. I.M.

Në lidhje me pikën 2.3.8. sipas DST-ve ,dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Pjesa në të cilët kërkohet që në kontratë të specifikohet objekti i saj, është kërkesë e tepërt dhe e paargumentuar nga AK. OE nuk t'u kërkohet që të lidhin kontrata të reja për mjete të cilat i disponojnë me kontrata ekzistuese, vetëm për të shtuar në të objektin e prokurimit. Këto kërkesa janë kosto të panevojshme për OE dhe nuk i shërbejnë procedurës por mund të përbëjnë shkak jo cilësor për s'kualifikimin e tyre. **Observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve buxhetore të DPRr.NP Tiranë.

Për periudhën 01.01.2019 -31.12.2022 nga DPRr.NP. Tiranë, referuar të dhënave të regjistrave të prokurimeve janë kryer gjithsej 62 procedura prokurimi me vlerë të vogël me vlerë limit 25,193,775 lekë pa TVSH dhe me vlerë kontarte 22,223,790 lekë pa TVSH procedura të mbuluara nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

	Objekti I Prokurimit	Fondit Limit	Vlera e Kontratës	OE fitueses
1	Blerje kancelarie	250,000	215,000	I
2	Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën Kocaj-Veski,Baldush	330.000	255,668	D
3	Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën Vilez Zall-Bastar”	220,000	172,142	M
4	BlerjeTuba Betoni	603,900	525,393	GJ
5	Blerje Skorje	666,667	590,000	J
6	Blerje materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës	197,170	164,000	E.H

7	Blerje kancelari	35.000	32,292	I
---	------------------	--------	--------	---

Në vijim, po trajtojmë problematikat e konstatuara në 7 (shtatë) procedura prokurimi me vlerë të vogël, si vijon:

1. “Blerje kancelari”

Me shkresën nr.643 datë, datë 27.02.2019 të Titullarit të AK Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë është bërë kërkesë për nisjen e procedurave për “Blerje kancelari” me REF-11017-02-27-2019 me vlerë të vogël 250,000 lekë mbështetur në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit Tiranë.Me shkresën nr.643/1 datë 27/02/2019 është argumentuar fondi limit bazuar në vlerën më të vogël të studimit të tregut dhe ka marrë treguesit e çmimit për mallrat nga tre operatorët ekonomik si vijon:

1. “C” sh.p.k. 2. ”I” sh.p.k. 3. “O” sh.p.k.

Nga perlllogaritja aritmetike e mesatares së tre ofertave rezulton vlera 250,000 lekë pa tvsh.

Me urdher nr.643/1 date 27/02/2019 është miratuar Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga M.M Kryetare, B.B Anetar, R.B Anetar si dhe kriteret kualifikuese me qëllim vlerësimin korrekt të përmbushjes së kriteve.

Me urdhër nr.643/2 datë 27.02.2019 është miratuar nga AK Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve të Qytetit Tiranë urdhëri prokurimet me vlerë të vogël e firmosur nga Kryetari AK E.K.

KVO ka hapur procedurën, pranimit të ofertave me datë 28.02.2019 ndërsa kanë paraqitur interes me pjesmarje gjithsej 17 OE konkurrues.

Në procesverbalin datë 01.03.2019 ne Oren 09.00 pasqyron dhe listen e klasifikimit perfundimtar. Operatori i renditur i pari është shoqëria “I” sh.p.k., me ofertë ekonomike 215,000 lekë pa tvsh.

Perfaqesuesi i shoqërisë “I” sh.p.k., u paraqit në datën 04.03.2019 dhe dorëzoi dokumentacionin si vijon:

Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2018 lëshuar nga Zyra e Tatim Taksave, Bashkia Tiranë.

Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, lëshuar nga OSHE Tiranë.

Vërtetim që ka shlyer detyrimet tatimore nga administratata tatimore.

Në datë 05.03.2019 OE “I” sh.p.k. Fituese levroi të gjithë sasinë e mallit.

E vërtetuar kjo nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël KVO i përbërë nga M.M Kryetar, R.B anëtar, B.B anëtar.

Konfirmuar me faturën e blerjes me nr.228969239 date 05.03.2019 konfirmuar nga blerësi, Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve të Qytetit perfaqësuar nga M.M, shitësi B.S, magazinieri K.B. dhe transportuesi R.B.

Nga verifikimi i dokumentacionit të OE të shpallur fituese, rezultoi se kishte plotësuar kriteret e kualifikimit të shpallura nga DT.

2. “Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën Kocaj-Veski,Baldushk”-1.Me kërkesë për nisje procedure prokurimi nr.2222 datë 25.02.2019 të Titullarit të AK Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë është bërë kërkesë për nisjen e procedurave,“Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën

Kocaj-Veski,Baldushk” me REF-11017-02-27-2019 me vlerë të vogël, 330.000 lekë mbështetur në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit Tiranë.

2.Me shkresën nr.2222/1 datë 26/07/2019 “Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën Kocaj-Veski, Baldushk” është argumentuar fondi limit bazuar në vlerën më të vogël të studimit të tregut dhe ka marrë treguesit e cmimit të për mallra bazuar në rekomandimitt ngae APP-se me nr.5585 prot date 25.07.2017 “ Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM -në nr.354 datë 11.05.2016 “ Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim.” Nga përlllogaritja aritmetike e mesatares të manualit të tarifave rezulton vlera maksimale e lejuar është 322,384 lekë pa tvsh.

OE përpara se të shpallet fitues duhet të dorëzoje dokumentacionin për përmbushjen e kapaciteteve teknike si me poshtë:

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të pushtetit vendor për vitin 2019.

Vërtetim që ka shlyer detyrimet tatimore nga administrata tatimore.

Licensën “Për mbikqyrjen e kolaudimit punimesh, zbatimi”, sipas modelit të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi, për kategorine e mëposhtme;

-N.P-1 A (Punime gërmimi në toke)

-N.P-4 A”Rruge, autostrada, ure, mbikalimi, hekuradha, linja tranvaji, metro, hekurudhe me kavo dhe pistona aeroportuale”

-N.P-5 A (Punime, nëntokësore, urad he vepra arti)

-N.P.-9 A (Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime)

-N.S- 1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve)

-N.S-1&A (Punime topogjeodezike)

Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga M.M Kryetar, I. B. anëtar, R.B anëtar. Nga verifikimi i dokumentacionit të OE i shpallur fitues rezultoi se kishte plotësuar kriteret e kualifikimit të shpallura nga DT.

3. Me urdhër nr.2222/2 datë 26.07.2019 është miratuar nga AK Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve të Qytetit Tirane urdhëri prokurimet me vlerë të vogël për “Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën Kocaj-Veski, Baldushk” me REF-11017-02-27-2019 e firmosur nga Kryetari AK E.K.

Me urdhër nr.2222/3 date 26.07.2029 të AK të firmosur ftesa për ofertë prokurimet me vlerë të vogël për “Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën Kocaj-Veski, Baldushk” me REF-11017-02-27-2019 me vlerë e fondit limit 18,249.229 lekë nga Kryetari AK z.E.K.

KVO ka hapur procedurën, pranimit të ofertave me datë 28.02.2019 ndërsa kanë paraqitur interes me pjesmarje gjithsej 13 OE konkurrues, nga të cilat janë skualifikuar 6 OE pasi ofertat e tyre rezultojnë mbi vlerën e fondit limit ose nën vlerën minimale dhe janë kualifikuar 7 OE

Në procesverbalin datë 30.07.2019 në orën 15.00 pasqyron dhe listën e klasifikimit përfundimtar. Operatori i renditur i pari është shoqëria “D” sh.p.k., me ofertë ekonomike me vlerë të vogël 255,668.00 leke pa tvsh.

Perfaqësuesi i shoqërisë “D” sh.p.k. u paraqit në datën 31.07.2019 dhe dorëzoi dokumentacionin si vijon:

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të pushtetit vendor për vitin 2019.

Vërtetim që ka shlyer detyrimet tatimore nga administrata tatimore.

Licensën “Për mbikqyrjen e kolaudimit punimesh, zbatimi” sipas modelit të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi, për kategorinë e mëposhtme;

-N.P-1 A (Punime germimi në tokë)

-N.P-4 A”Rruge, autostrada, urë, mbikalimi, hekuradha, linja tranvaji, metro, hekurudhe me kavo dhe pistona aeroportuale”

-N.P-5 A (Punime, nëntokësore, URA dhe vepra arti)

-N.P.-9 A (Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime)

-N.S- 1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve)

-N.S-1&A (Punime topogjeodezike)

E vërtetuar kjo nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël KVO i përbërë nga M.M Kryetar, R.B anëtar, I. B anëtar.

Kontrata për mbikqyrjen e punimeve me nr.2222/4 date 01/08/2019 me objekt ‘Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën Kocaj-Veski, Baldushk” me REF-11017-02-27-2019 me vlerë 255,668 lekë e firmosur nga administratori i OE “D” shpk, B.D dhe Kryetari AK E.K. Nga verifikimi i dokumentacionit të OE të shpallur fitues, rezultoi se kishte plotësuar kriteret e kualifikimit të shpallura nga DT.

3. Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën Vilez Zall-Bastar”

1. Me kërkesë për nisje procedurë prokurimi nr.2223, datë 25.07.2019 të Drejtorit të Drejtorisë së Kullimit dhe Rrugëve Rurale S.GJ është bërë kërkesë për nisjen e procedurave për “Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën Vilez Zall-Bastar” me REF-24169-05-28-2019 me vlerë të vogël, 220,000 lekë mbështetur në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit Tiranë.

2.Me shkresën nr.2223/1 datë 26/07/2019 “Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën Vilez Zall-Bastar ” është argumentuar fondi limit bazuar në vlerën më të vogël të studimit të tregut dhe ka marrë treguesit e cmimit për mallra bazuar në rekomandimet nga APP-së me nr.5585 prot datë 25.07.2017 “Mbi menyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në VKM -në nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim.”

Nga përlllogaritja aritmetike e mesatares të manualit të tarifave rezultoi vlera minimale e lejuar është 167,517 lekë pa tvsh, vlera maksimale e lejuar është 21,617 leke pa tvsh.

OE përpara se të shpallet fitues duhet të dorëzojë dokumentacionin për përmbushjen e kapaciteteve teknike si më poshtë:

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të pushtetit vendor për vitin 2019.

Vërtetim që ka shlyer detyrimet tatimore nga administrata tatimore.

Licensën “Për mbikqyrjen e kolaudimit punimesh, zbatimi” sipas modelit të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi, për kategorinë e mëposhtme;

-N.P-1 A (Punime germimi në tokë)

-N.P-4 A”Rrugë, autostrada, urë, mbikalimi, hekuradha, linja tranvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pistona aeroportuale”

- N.P-5 A (Punime, nëntokesore, URA dhe vepra arti)
- N.P.-9 A (Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime)
- N.S- 1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve)
- N.S-1&A (Punime topogjeodezike)

Të firmosura nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël i perbërë nga M.M Kryetar, I. B. anëtar, R.B anëtar.

Me urdhër nr.2223/2 date 26.07.2019 është miratuar nga AK Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve të Qytetit Tirane urdhëri prokurimet me vlerë të vogël për “Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën Vilez Zall-Bastar” me REF-24169-05-28-2019 e firmosur nga Kryetari AK E.K.

Me urdhër nr.2222/3 date 26.07.2029 të AK është firmosur ftesa për ofertë prokurimet me vlerë të vogël për “Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën Vilez Zall-Bastar” me REF-24169-05-28-2019 e fondit limit nga Kryetari AK z.E.K.

3.KVO ka hapur procedurën, pranimit të ofertave me date 28.02.2019 ndërsa kanë paraqitur interes me pjesmarje gjithsej 13 OE konkurrues, nga të cilat janë skualifikuar 6 OE pasi ofertat e tyre rezultojnë mbi vlerën e fondit limit ose nën vlerën minimale dhe janë kualifikuar 7 BOE Në procesverbalin datë 30.07.2019 në orën 15.30 pasqyron dhe listën e klasifikimit përfundimtar. Operatori i renditur i pari është shoqëria “M” sh.p.k, me oferte ekonomike me vlerë më të vogël 172,142.00 lekë pa tvsh.

Perfaqesuesi i shoqërisë “M” sh.p.k. Paraqit në datën 31.07.2019 dhe dorëzoi dokumentacionin si vijon:

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të pushtetit vendor për vitin 2019.

Vërtetim që ka shlyer detyrimet tatimore nga administrata tatimore.

Licensën “Për mbikqyrjen e kolaudimit punimesh, zbatimi” sipas modelit të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi, për kategorinë e mëposhtme:

- N.P-1 A (Punime gjurmimi në tokë)
- N.P-4 A”Rrugë, autostrada, urë, mbikalimi, hekuradha, linja tranvaji, metro, hekurudhe me kavo dhe pistona aeroportuale”
- N.P-5 A (Punime, nëntokesore, URA dhe vepra arti)
- N.P.-9 A (Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime)
- N.S- 1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve)
- N.S-1&A (Punime topogjeodezike)

E vërtetuar kjo nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël KVO i përberë nga M.M Kryetar, R.B anëtar, I. B. anëtar.

Kontrata për mbikqyrjen e punimeve me nr.2223/4 datë 02/08/2019 me objekt ‘Mbikqyrja e punimeve për objektin “Ndërtimi i urës në rrugën Vilez Zall-Bastar” me REF-24169-05-28-2019 me vlerë 255.668 lekë e firmosur nga administratori i OE ”D” shpk, B.D dhe Kryetari AK E.K.

Nga verifikimi i dokumentacionit të OE i shpallur fitues rezultoi se kishte plotësuar kriteret e kualifikimit të shpallura nga DT.

4. “Blerje Tuba Betoni”

1. Me shkresën nr.2580 datë ,11.09.2019 të Drejtorit të Drejtorisë së Kullimit dhe Rrugëve Rurale S.GJ është bërë kërkesë për nisjen e procedurave për “Blerje Tuba Betoni” me REF-

40332-10-21-2019 me vlerë të vogël 603,900 leke mbështetur në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 te Punëtorëve te Qytetit Tiranë.

2. Me shkresën nr.2580/1 datë 11.09.2019 është argumentuar fondi limit bazuar në vlerën më të vogël të studimit të tregut me objekt, "Blerje Tuba Betoni" dhe ka marrë treguesit e çmimit për mallrat me objekt prokurimi nga tre operatorët ekonomik si vijon

1."GJ" sh.p.k. 2."I" sh.p.k.3. "R" sh.p.k. firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga M.M Kryetare, I.B Anëtar, R.B Anëtar.

Nga përlllogaritja aritmetike e mesatares së tre ofertave rezulton vlera 603,900 lekë pa tvsh.

Me urdhër nr.2580/2 datë 11/09/2019 është miratuar urdhëri për fillimin e prokurimit me vlerë të vogël i firmosur nga titullari i AK z. E.K.

Me urdhër nr.2580/3 datë 11/09/2019 është miratuar nga AK Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve të Qytetit Tirane ftesa për ofertë "Blerje tuba beton", data e zhvillimit do të jetë më 12.09.2019 ora 11.00 .Urdhëri i prokurimit me vlerë të vogël i firmosur nga Kryetari AK E.K.

Operatori ekonomik i renditur i pari përpara se të shpallet fitues duhet te dorëzoje pranë autoritetit kontraktor dokumentet si më poshte:

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga administrata tatimore.

KVO ka hapur procedurën, pranimit të ofertave me date 12/09/2019 ndërsa kanë paraqitur interes me pjesmarje gjithsej 21 OE konkurrues.

3. Në procesverbalin datë 12/09/2019 në orën 11.00 pasqyron dhe listën e klasifikimit përfundimtar. Operatori i renditur i pari është shoqëria "B" sh.p.k, me ofertë ekonomike 420,400.00 lekë pa tvsh ju dërgua njoftim më datë 12.09.2019 ora 11:29 por nuk u paraqit Brenda 24 orëve nga momenti i publikimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Në procesverbalin datë 13/03/2019 në orën 11:47 pasqyron dhe listën e klasifikimit përfundimtar. Operatori i renditur i dyti është shoqëria "N" sh.p.k., me ofertë ekonomike 440,000.00 lekë pa tvsh ju dërgua njoftim më datë 16.09.2019 ora 15:12 por nuk u paraqit Brenda 24 orëve nga momenti i publikimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik

Në datat 16, 17, 18, shtator 2019 është dërguar njoftim fituesve të rradhës por nuk janë paraqitur Brenda 24 orëve mbas njoftimit ne SPE.

Më datë 20.09.2019 ora 14:59 u dërgua njoftim fituesit OE të rradhës i renditur në vendin e shtatë "GJ" sh.p.k. me ofertë 525,393.00 lekë pa tvsh i cili u paraqit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar ne ftesë ofertë.

Procesverbali i firmosur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël i përbere nga M.M Kryetare, I.B Anetar, R.B Anetar.

Me vendim nr.2580/4 date 23/09/2019 është ngritur komisioni i marrjes ne dorëzim të mallit i përbërë nga V.K, I.K, S.L.

Përfaqesuesi i shoqërisë "GJ" sh.p.k. Ka dorëzuar dokumentacionin si vijon;

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor per vitin 2019, Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga administrate tatimore.

Konfirmuar me faturën e blerjes nr.273 date 25.09.2019 është bërë pagesa në vlerën 63,671 lekë pa tvsh nga AK Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve te Qytetit ndaj "GJ" Shpk.

Nga verifikimi i dokumentacionit të OE i shpallur fitues rezultoi se kishte plotësuar kriteret e kualifikimit të shpallura nga DT.

5. “Blerje Skorje”

1.Me shkresë nr.3139 datë, datë 21.10.2019 të Drejtorit të Drejtorisë së Kullimit dhe Rrugeve Rurale S.GJ është bërë kërkesë për nisjen e procedurave për “Blerje Skorje ” me REF-40529-10-22-2019 me vlerë të vogël 666,667 lekë pa tvsh mbështetur në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit Tiranë.

2.Me shkresën nr.3139/1 datë 21.10.2019 është argumentuar fondi limit bazuar në vlerën më të vogël të studimit të tregut me objekt ”Blerje Skorje” dhe ka marrë treguesit e cmimit për mallrat me objekt prokurimi nga blerja e fundit e OE ”R” sh.p.k. e bërë më datë ,12.12.2018 me fature nr.21 për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje skorje”, firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga M.M Kryetare, I.B Anëtar, R.B Anëtar.

Nga përlllogaritja aritmetike e mesatares së tre ofertave rezulton vlera 666,667 lekë pa tvsh.

Me urdhër nr.3139/2 datë 21.10.2019 është miratuar urdhëri për fillimin e prokurimit me vlerë të vogël i i firmosur nga titullari i AK z. E.K.

3.Me urdhër nr.3139/3 datë 21.10.2019 është miratuar nga AK Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve të Qytetit Tiranë ftesa për ofertë “Blerje skorje”.data e zhvillimit do të jetë më 23.10.2019 ,ora 14:30 .Urdhëri i prokurimet me vlerë të vogël e firmosur nga Kryetari AK E.K.

Operatori ekonomik i renditur i pari përpara se të shpallet fitues duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentet si më poshtë:

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga administrata tatimore.

KVO ka hapur procedurën, pranimit të ofertave me datë 12/09/2019 ndërsa kanë paraqitur interes me pjesmarje gjithsej 11 OE konkurrues.

Në procesverbalin datë 23.10.2019 në orën 15:04 pasqyron dhe listën e klasifikimit përfundimtar. Operatori i renditur i pari është shoqëria “B” sh.p.k sh.p.k., me ofertë ekonomike 150,000.00 lekë pa tvsh ju dergua njoftim me datë 12.09.2019 ora 11:29 por nuk u paraqit brenda 24 orëve nga momenti i publikimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Në procesverbalin datë 13/03/2019 në orën 11:47 pasqyron dhe listën e klasifikimit përfundimtar. Operatori i renditur i dyti është shoqëria “N” sh.p.k., me ofertë ekonomike 440,000.00 lekë pa tvsh ju dërgua njoftim më datë 16.09.2019 ora 15:12 por nuk u paraqit Brenda 24 orëve nga momenti i publikimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Ne datat 24 dhe 25 tetor 2019 është dërguar njoftim fituesve të rradhës por nuk janë paraqitur brenda 24 orëve mbas njoftimit në SPE.

Më datë 28.10.2019 ora 10:02 u dërgua njoftim fituesit OE të rradhës i renditur në vendin e katërt “J” sh.p.k. Me ofertë 590,000.00 lekë pa tvsh i cili u paraqit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në ftesë ofertë.

Procesverbali firmosur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël i përberë nga M.M Kryetare, I.B Anëtar, R.B Anëtar.

Me vendim nr.3139/5 datë 28.10.2019 është ngritur komisioni marrjes në dorëzim të mallit i përbërë nga V.K, H.G, S.L.

Perfaqësuesi i shoqërisë “GJ” sh.p.k. Ka dorëzuar dokumentacionin si vijon;

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga administrata tatimore.

Konfirmuar me faturën e blerjes nr.655 datë 04.11.2019 është bërë pagesa në vlerën 590,000 lekë pa tvsh nga AK Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit ndaj “ ”Shpk.

Nga verifikimi i dokumentacionit të OE i shpallur fitues rezultoi se kishte plotësuar kriteret e kualifikimit të shpallura nga DT.

6. “Blerje materiale per funksionimin e pajisjeve të zyrës”

1.Me shkresën nr.2941 date, datë 08.10.2019 të Përgjegjës së Sektorit Administrates znj.R.L është bërë kërkesë për nisjen e procedurave për “Blerje materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës” me REF-38588-10-08-2019 me vlerë të vogël 200,000 lekë mbështetur në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit Tiranë.

2. Me shkresën nr.2941/1 datë 08.10.2019 është argumentuar fondi limit bazuar në vlerën më të vogël të studimit të tregut me objekt “Blerje materiale per funksionimin e pajisjeve te zyrës” dhe ka marrë treguesit e cmimit te për mallrat me objekt prokurimi nga nga blerja e fundit e OE ”B” sh.p.k e bërë me datë,12.04.2019 me faturë nr.368 për procedure e prokurimit me vlere te vogel me object “Blerje skorje”, firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga M.M Kryetare, I.B Anëtar, R.B Anëtar.

Nga përlllogaritja aritmetike e mesatares rezulton vlera 197.17 lekë pa tvsh.

3. Me shkresën nr.2941/2 datë 08.10.2019 është miratuar urdhri për fillimin e prokurimit me vlerë të vogël i firmosur nga titullari i AK z. E.K.

Me urdhër nr.2941/3 datë 08.10.2019 është miratuar nga AK Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve të Qytetit Tiranë ftesa për ofertë “Blerje materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës”, data e zhvillimit do të jetë me 09.10.2019, ora 12:30. Urdhëri i prokurimit me vlerë të vogël e firmosur nga Kryetari AK E.K.

Operatori ekonomik i renditur i pari përpara se të shpallet fitues duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentet si me poshtë:

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga administrata tatimore.

KVO ka hapur procedurën, pranimit të ofertave me date 12/09/2019 ndërsa kanë paraqitur interes me pjesmarje gjithsej 22 OE konkurrues.

Në procesverbalin datë 09.10.2019 në orën 13:43 pasqyron dhe listen e klasifikimit përfundimtar. Operatori i renditur i pari është shoqëria “J” sh.p.k., me ofertë ekonomike 85,000 lekë pa tvsh ju dërgua njoftim më datë, 09.10.2019 ora 13:29 por ka bërë kërkesë për tërheqje brenda 24 orëve nga momenti i publikimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Në procesverbalin datë 13/03/2019 në orën 11:47 pasqyron dhe listen e klasifikimit përfundimtar. Operatori i renditur i dyti është shoqëria “O” sh.p.k., me ofertë ekonomike 97,500.00 leke pa tvsh ju dërgua njoftim më datë 10.10.2019 ora 08:14 por nuk u paraqit brenda 24 orëve nga momenti i publikimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Në datat 10,11,14,15, tetor 2019 është dërguar njoftim fituesve të radhës por nuk janë paraqitur brenda 24 orëve mbas njoftimit në SPE.

Më datë 14.10.2019 ora 10:51 u dërgua njoftim fituesit OE të rradhës i renditur ne vendin e shtatë “E.H” sh.p.k. Me ofertë 164,000.00 lekë pa tvsh i cili u paraqit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar ne ftesë ofertë.

Procesverbali firmosur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga M.M Kryetare, I.B Anëtar, R.B Anëtar.

Me vendim nr.2941/5 date 17.10.2019 është ngritur komisioni marrjes në dorëzim të mallit i përbërë nga, V.K , H.G , S.L.

Perfaqesuesi i shoqërisë “E.H” sh.p.k. ka dorëzuar dokumentatacionin si vijon:

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga administrata tatimore.

Konfirmuar me faturen e blerjes nr.268 date 22.10.2019 është bërë pagesa ne vlerën 590,000 lekë pa tvsh nga AK Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve te Qytetit ndaj “E.H” sh.p.k. Nga verifikimi i dokumentacionit të OE i shpallur fitues rezultoi se kishte plotësuar kriteret e kualifikimit të shpallura nga DT.

7. Blerje kancelarie

1. Me shkresë nr.3454 datë ,18.11.2019 te Përgjegjës së Sektorit Administratës znj.R.L është bërë kërkesë për nisjen e procedurave për “Blerje kancelari” me REF-44147-11-20-2019 me vlerë të vogël 35.000 lekë, mbështetur në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 të Punëtorëve te Qytetit Tiranë.

2.Me shkresën nr.2454/1 date 18.11.2019 është argumentuar fondi limit bazuar në vlerën më të vogël të studimit te tregut me objekt “Blerje kancelarie” dhe ka marrë treguesit e çmimit për mallrat me objekt prokurimi nga nga blerja e fundit e OE ”I” sh.p.k.e bërë më datë 05.03.2019 me faturë me nr.228969239 për procedure e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje kancelarie”, firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga M.M Kryetare, I.B Anëtar, R.B Anëtar.

Nga përlllogaritja aritmetike e mesatares rezulton vlera 35.000 lekë pa tvsh.

Me urdhër nr.2454/2 datë 08.11.2019 është miratuar urdhëri për fillimin e prokurimit me vlerë të vogël i firmosur nga titullari i AK z. E.K.

3. Me urdhër nr.2454/3 datë 18.11.2019 është miratuar nga AK Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve të Qytetit Tiranë ftesa për ofertë “Blerje kancelarie”, data e zhvillimit dotë jeteë më 21.11.2019, ora 09.00.

Bazuar në urdhërin i prokurimet me vlerë të vogël e firmosur nga Kryetari AK E.K.

Operatori ekonomik i renditur i pari përpara se të shpallet fitues duhet të dorëzoje pranë autoritetit kontraktor dokumentet si më poshtë:

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore te parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga administrata tatimore.

KVO ka hapur procedurën, pranimit te ofertave më datë 12/09/2019 ndërsa kanë paraqitur interes me pjesmarje gjithsej 17 OE konkurrenente, janë skualifikuar 12-BOE dhe janë kualifikuar 5-BOE.

Në procesverbalin datë 21.11.2019 në orën 09:00, pasqyron dhe listën e klasifikimit përfundimtar. Operatori i renditur i pari është shoqëria "I" sh.p.k., me ofertë ekonomike më të vogël 32,292.00 lekë pa tvsh.

Më datë 21.11.2019 ora 09; 28 minuta u dergua njoftim fituesit OE të rradhës i renditur në vendin e shtatë "I" sh.p.k. me ofertë 32,292.00 leke pa tvsh i cili u paraqit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në ftesë ofertë.

Procesverbali firmosur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga M.M Kryetare, I.B Anëtar, R.B Anëtar.

Me vendim me nr.2454/4 date 21.11.2019 është ngritur komisioni marrjes në dorëzim të mallit i përbërë nga V.K, H.G, S.L.

Perfaqesuesi i shoqërisë "E.H" sh.p.k. ka dorëzuar dokumentacionin si vijon;

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore Te parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga administrata tatimore.

Konfirmuar me faturën e blerjes nr.2454/4 datë 21.11.2019 është bërë pagesa në vlerën 590,000 lekë pa tvsh nga AK Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve te Qytetit ndaj "E.H" sh.p.k.

Nga verifikimi i dokumentacionit te OE i shpallur fitues rezultoi se kishte plotësuar kriteret e kualifikimit të shpallura nga DT.

Konkluzion Marrja në dorëzim e mallrave objekt prokurime të vogla pa procesverbalin e marrjes në dorëzim, ngarkon me përgjegjësi, anëtarët e komisionin e marrjes së mallrave në dorëzim i përbërë nga V.K, H.G, S.L dhe Drejtori i Drejtorisë së Financës znj. L.C.

Në përfundim të procesit të auditimit në lidhje me 9 procedurat e prokurimit të marra me zgjedhje, dhe të realizuara me "vlerë e vogël" u konstatua se; Në të gjitha rastet e blerjeve mall, shërbime e punë publike, me OE i shpallur fitues, është lidhur kontrata e shërbimit dhe blerjes me afate dhe kushtet e realizimit ndërsa në rastet për procesin e marrjes në dorëzim të mallrave nuk është marrë në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim në përputhshmëri me kërkesat ligjore. Mallrat e blera kanë kaluar nga furnitori duke u bërë hyrje në magazinë pa pasurr një hallkë kontrolli mbi sasinë, llojin dhe cilësinë e kërkuar sipas kërkesave së procedurës e prokuruar.

Veprime në mospërputhje me Pikën 42, 43, 52, 53, 54 të UMF 30 datë 27.11.20212 ku qartësishtë citohet se; Titullari i njesise miraton urdherin per ngritjen e komisionit per marrjen ne dorezim te aktiveve te furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotesine e tyre dhe te dokumentacionit shoqerues. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushes sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë Jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi material.

Veprimet që kryejnë strukturat e Nepunesit Zbatues:

-Strukturat e Nepunësit Zbatues para marrjes në dorëzim të dokumentave nga personat me përgjegjësi materiale, kryejnë kontrollin paraprak të tyre. KY kontroll përfshin kontrollin e rregullshmërisë së jashtme, kontrollin nga pikpamja e zbatimit të ligjshmërisë dhe kontrollin e saktësisë së veprimeve aritmetike.

- Kontrollohet numri rendor i dokumentit, si për flete hyrje dhe flete dalje, të cilat duhet të ndjekin rendin kronologjik dhe të mos kenë kapërcim numri, të ketë adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli. Kur konstatohet kapërcim i numrit rendor apo data Jo kronologjike, nënpunësi

zbatues mban procesverbal me personat me përgjegjësi materiale, dokumenton dhe sinjalizon cdo parregullsi.

Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se flete hyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletë hyrje origjinale, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr. 33 dhe në Rekomandimin nr. 10.1, 11.1, të Projekt Raportit (faqe 239-240) sqarojmë se:

1. Në lidhje me procedurën “Blerje kancelari” nuk është kërkuar vërtetimi i taksave leshuar nga Bashkia Tirane por nga zyra e tatim taksave ku ka seline OE. (Bashkelidhur gjeni ftesen per oferte me nr.643/3 prot., date 27.03.2019.

2. Per tre procedurat (Blerje tuba betoni, Blerje skorje dhe Blerje kancelari) qe nuk kane pasur ne dosjen e prokurimit procesverbalin e marrjes ne dorezim te mallit sqarojme se keta procesverbalë janë pjesë e dosjeve që mban Sektori i Financës, bashkëlidhur me Urdher Shpenzimin përkatës, mungesa e të cilëve nuk do të pranohej nga Thesari dhe rrjedhimisht nuk do të kalohej pagesa e faturës. Zyra e Thesarit nuk pranon dhe nuk ben asnje pagese pa patur bashkelidhur procesverbalet e siperpermendur. Bashkelidhur do te gjeni procesverbalet e tre procedurave te nxjerra nga Sektori i Finances. Komisioni i marrjes ne dorezim të mallit ka vepruar ne perputhje me parashikimet ligjore.

3. Ne lidhje me sistemimin e dosjeve te blerjeve me vlere të vogël të vitit 2019 sqarojme se cdo dosje e çdo procedure ka qene e numerizuar dhe e shoqeruar me fleten e detajuar te inventarit te saj. Ne zbatim te rekomandimit nr 10.1 të Projekt Raportit u be arkivimi i tyre ne perputhje me ligjin e arkivave. Bashkelidhur do te gjeni procesverbalin e dorezimit te tyre me Nr.1836 prot., date 08.05.2024.

4. Ne lidhje me deklaratat e konfliktit te interesit sqarojme se anetaret e komisionit te blerjeve te vogla kane nenshkruar deklaratat e konfliktit te interesit per cdo procedure prokurimi dhe jane pjesë e dosjeve perkatese..

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 1063/3 prot., datë 03.06.2024, është observuar nga subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nga Njësia e Prokurimit znj.A.P, z. E.C, z. J.J.

1. Nga ana e grupit të auditimit, nuk është cituar ajo që pretendohet në observacion.

2. Bazuar në dokumentet e paraqitur bashkëlidhur observacionit, ky pretendim **merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2. Kërkesa e mësipërme në pikën 2.3.7 në të cilën AK ka kërkuar 2 kamion vetëshkarkues me kapacitet jo më pak se 20 ton siç është trajtuar edhe në projekt raportin e auditimit këto mjete transporti me këtë kapacitet mbajtës janë factor për të dëmtuar trupin e rrugës.Sipas projektit shtresat e asfaltit janë parashikuar të shtorjen për 2 janë.Kjo periudhë kohe është e mjaftueshme për mos të sjell pengesa në sjelljen e materialit asfalt me mjete të tonazhit me të ulët.

3. Nisur nga dokumentacioni i paraqitur bashkëlidhur observacionit, grupi i auditimit sqaron se ky rekomandim do të mbetet për tu patur në konsideratë për të ardhmen.

4. Në lidhje me deklaratat për konfliktin e interes, bashkëlidhur observacionit nuk gjendet dokumentacion që të vërtetojë të kundërtën e konstatimit të grupit të auditimit **dhe sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit nr. 870/1, datë 10.10.2023, i ndryshuar, në Bashkinë Tiranë, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, janë përzgjedhur për auditim objektet:

Nr	Objekti	Vlera e kontrates	Kontraktori
1	“Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlshuesit dhe shkarkuesit katastrofik të rezervuarit Gjyslikonjë”	39,858,552	OE “I” SHPK
2	“Përmirësimi i ndriçimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi i korsive të biçikletave në sheshin “Nënë Tereza”, deri në hyrjen e Liqenit Artificial”, DPRrNP	37,641,882.6	OE “I” ShPK

1. “Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlshuesit dhe shkarkuesit katastrofik të rezervuarit Gjyslikonjë”, DPRrNP, Bashkia Tiranë

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 2997/8 prot., datë 23.12.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor DPRrNP, të përfaqësuar nga Drejtori z. H.RR dhe të OE “I” SHPK, me përfaqësues ligjor z. F.C me licencë profesionale NZ 3142/16. Vlera e kontratës është 39,858,552 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 45 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Pas kërkesës të sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit datë 03.02.2022 për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për shkak të motit të keq dhe temperaturave të ulëta, është hartuar Aneks kontrate me nr. 2997/21 prot., datë 04.02.2022, i cili miraton shtyrjen e afatit të punimeve me 30 ditë. Po për të njëjtat arsye, pas kërkesës së datës 04.03.2022 të mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit, është hartuar Aneks kontrate me nr. 724/2 prot., datë 16.03.2022, i cili miraton shtyrjen e afatit të punimeve me 30 ditë të tjera, nga data e lidhjes së Aneks-kontratës. Pas kërkesës së datës 04.03.2022 të mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit datë 19.04.2022 për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për shkak të rrëshqitjeve të masivit në pjesën fundore të shkarkuesit, është hartuar Aneks kontrate me nr. 1219/4 prot., datë 29.04.2022, i cili miraton shtyrjen e afatit të punimeve me 3 javë të tjera, nga data e lidhjes së Aneks-kontratës. Shtyrja e afatit të punimeve me 81 ditë, ose 36 ditë më shumë se afati kontraktual i përfundimit të punimeve (sikur të mos jetë punuar asnjë ditë deri në miratimin e Amendamenteve), është fiktive dhe e paargumentuar teknikisht nga ana e Investitorit. Ky veprim, ngarkon me përgjegjësi titullarin e DPRrNP z. H.RR, pasi me veprimin

e mësipërm është shmangur zbatimi i mundshëm i nenit 20, pika a të Kontratës (Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve).

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3241/9, datë 23.12.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “N” SHPK, me përfaqësues z. E.N, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1846/7 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 1,301,624.4 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3549/5 prot., datë 30.12.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me shoqëria “M” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3522/4 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 181,042 lekë me tvsh. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 27.06.2022.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, nuk administrohet Leje ndërtimi/Infrastrukturore. Ky mosveprim ngarkon me përgjegjësi titullarin e DPRrNP z. H.RR.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike**, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”.

- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga Shoqëria “N” ShPK në vitin 2021.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 23.12.2021 dhe kanë përfunduar me datë 19.05.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

- Nga auditimi i dosjes teknike, rezulton se pas kërkesës së mbikëqyrësit për saktësim të projektit me datë 15.04.2022 (edhe shtyrjen trejavore), Investitori i ka shprehur dakordësinë për ndërtimin e një muri fundor me shkresën nr. 1219, datë 26.04.2022, duke kërkuar detajimin e zërave që hiqen dhe shtohen. Me shkresën nr. 33/1, datë 27.04.2022 nga ana e mbikëqyrësit është sjellë preventivi i përdorimit të fondit rezervë, i cili është miratuar nga Investitori me shkresën nr. 1219/3, datë 29.04.2022. Është mbajtur proceverbale datë 12.04.2022 për ndryshimin e volumeve, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi i punimeve dhe nga Investitori, në të cilën janë përcaktuar ndryshimet në volumet e punimeve. Këto procesverbale janë shoqëruar nga tabela e ndryshimeve (+/-), ku rezultojnë 8,232,971 lekë pa TVSh punime që shtohen dhe 6,679,339 lekë pa TVSh punime që hiqen, duke përdorur edhe fondin rezervë në vlerën 1,553,632 lekë pa TVSh. Është bërë edhe miratimi i zërit të ri “FV tub drenazhi Ø 150 mm”.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar
3. Situacionet pjesore dhe situacioni përfundimtar
4. Libreza e masave
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlshuesit dhe shkarkuesit katastrofik të rezervuarit Gjyslikonjë", DPRrNP				
14. Lidhja e kontratës Nr. 2997/8 prot., datë 23.12.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 39,858,552 lekë OE fitues "I" SHPK		16. Likuiduar deri	
17- Situacioni Përfundimtar Vlera me tvsh 39,824,884 lekë Vlera pa tvsh 33,187,404 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 45 ditë, Zbatuar 147 ditë. Fillimi punimeve: 23.12.2021 Përfundimi punimeve: 19.05.2022		19. Zgjatja e kontratës Aneks kontrate nr. 1, me nr. 2997/21 prot., datë 04.02.2022, Aneks kontrate nr. 2 me nr. 724/2 prot., datë 16.03.2022 dhe Aneks kontrate nr. 3 me nr. 1219/4 prot., datë 29.04.2022, shtyrja gjithsej 81 ditë.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "N" SHPK	Licenca Nr: MK 1846/7	Kontrata nr. 3241/9, datë 23.12.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve M" ShPK	Licenca Nr: MK 3522/4	Kontrata nr. 3549/5 prot., datë 30.12.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (.....lekë)
22. Akt Kolaudimi Datë 27.06.2022	23. Akt i marrjes në dorëzim Nuk ka			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **737,880 lekë pa tvsh.**

Tabela nr. 1

	Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
								Vol.	Vlera
I		Punime në trupin e digës							
1	1	Shkulje e rrënjëve bimëve të vogla	m ²	25	13796	13796	3180	10616	265,400
2	10	Hekur me D> 10 mm	ton	97500	24.02	24.02	22.6	1.4	136,500
III		Rehabilitimi i shkarkuesit katastrofik							
4		Gërmim dheu + Transport 5 km	m ³	785 (540+245)	4420	4420	3992	428	335,980
Total									737,880

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

I. Punime në trupin e digës

1. Zëri 1. Shkulje rrënjëve të bimëve të vogla. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 13753 m². Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 13796 m², ose 43 m² më shumë se në preventivin bazë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune figuron në sasinë totale 13796 m², i detajuar për skarpatat e digës, kurorën e digës, përgjatë shkarkuesit, në rrugën provizore, në rezervuar në afërsi të shkarkuesit dhe në bregun perëndimor të liqenit në zonën afër tombinos së vjetër. Nisur nga fakti që volumet janë llogaritur në të gjitha zonat e gërmuara, ky zë pune nuk duhej situacionuar, pasi në specifikimet

teknike, hyn tek zëri “Gërmim”. Për pasojë, vlera e këtij zëri pune është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri 10. Hekur D>10 mm. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 16 ton. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 24.02, ose 8.02 ton më shumë se në preventivin bazë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune figuron në sasinë totale 24.023 ton, i detajuar për hekurin e vendosur në murin e parapetit mbi kurorën e digës. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar rezulton se shufra gjatësore është marrë 30 cm më shumë (350 ml nga 320 ml), si dhe shufra nr 2 tërthore është marrë me gjatësi 2.75 m, nga 2.45 m që duhet në fakt. Nga rillogaritja, sasia e këtij volumi pune është 22.6 ton, ose 1.4 ton më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e kësaj diference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

III. Rehabilitimi i shkarkuesit katastrofik

3. Zëri 1+9. Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale me gjerësi deri në 2 m, kategoria III, me shkarkim në tokë + Transport 5 km.

Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 2890 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 4420 m³, ose 1650 m³ më shumë se në preventivin bazë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune figuron në sasinë totale 4420 m³, i detajuar për gërmim gjatë shkarkuesit, gërmim dy rrugë paralele (majtas djathtas), gërmim rruga në fund të shkarkuesit për akses dhe gërmim nivelim i përroit për devijimin e rrjedhës sipas gjurmës së re. Nisur nga fakti që rrugët provizore tek specifikimet teknike hyjnë në shpenzimet e sipërmarrësit, sasia prej 1072 m³ e libëzuar për ndërtimin e rrugëve provizore (672 + 140 + 260 m³), nuk duhej të ishte llogaritur në sasinë totale. Nga rillogaritja, sasia e këtij volumi pune është 3348 m³, ose 1072 m³ më pak se sasia e situacionuar. Për pasojë, vlera e kësaj diference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 737,880 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E.N, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. F.M, me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga autoriteti kontraktor është paraqitur observacioni me nr.1775/3 prot., datë 03.06.2024, i administruar në KLSH me nr. 1063/3 prot., datë 03.06.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar në Akt Konstatimin nr.12 dhe në Rekomandimin nr. 12.1 të Projekt Raportit (faqe 240) sqarojmë se:

1. Shtyrja e afateve është bërë për shkaqe të argumentuara si moti i keq dhe rrëshqitje të masivit në pjesën fundore të shkarkuesit, të cilat janë dokumentuar me përpikmëri nga ana e Autoritetit Kontraktor sipas legjislacionit përkatës. Titullari nuk ka shmangur në asnjë moment zbatimin e detyrimeve kontraktore.

2. Procesverbali i marrjes në dorëzim (i përkohshmi) me Nr.1219/7 Prot., datë 13.07.2022 është dhe ka qenë pjesë e dosjes së prokurimit. Bashkëlidhur gjeni këtë procesverbal.
3. Projekti i zbatimit është miratuar me Vendim të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë .
Me Vendimin nr.128 prot., dt. 30.10.2001 të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e Këshillit Teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike” është krijuar Këshilli Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike.
Bazuar në këtë vendim, pika 2.2, 2.3 dhe 2.4, Këshilli Teknik ka për detyrë të bëjë miratimin e detyrave të projektimit të hartuara nga kjo Bashki, miratimin e projekteve të hartuara nga bashkia me specialistët e saj, ose me specialistë të jashtëm dhe miratimin e strategjive në drejtim të ndërhyrjes në infrastrukturën e rëndë dhe të lehtë.
Anëtarët e Këshillit Teknik janë Drejtorë të Përgjithshëm dhe përfaqësues të drejtorive të cilët janë teknike dhe aktiviteti i tyre administrativ lidhet ngushtësisht me zhvillimin e projekteve, dhe secili mbulon fushën e tij të ekspertizës.
Vendimi i Këshillit Teknik miraton të gjitha fazat e hartimit të një projekti (projekt ide paraprake, projekt ide përfundimtare) dhe Projektin e Zbatimit pasi ky i fundit ka kaluar dhe të gjitha miratimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.
Projektet hartohen në bazë të standarteve dhe ligjeve në fuqi sipas cdo kategorie, infrastrukturë, objekte kulturore, arsimore etj. **Projekti dhe preventivat për investimet publike miratohen nga Këshilli Teknik dhe firmosen nga Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe procedura e miratimit është e njëvlefshme me lejen e ndërtimit, që firmoset po nga Kryetari i Bashkisë Tiranë.**
Për këtë arsye, për të gjithë projektet e miratuara në juridiksionin territorial të Bashkisë Tiranë, janë ezaruar të gjitha hallkat e realizimit të projektit sipas standarteve dhe kontroleve teknike për fillimin e punimeve. Më pas ndjekja ose ndryshimet gjatë zbatimit në terren të këtyre projekteve, bëhen sërish nëpërmjet këtij Këshilli Teknik.
4. Në lidhje me oponencën teknike, Autoriteti Kontraktor i është referuar legjislacionit në fuqi të kohës, Ligjit Nr. 8402, date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Neni 6 “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve”, si dhe Vendimit Nr. 1055, datë 22.12.2010, “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, pikes 1: “Për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, që realizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga subjekte fizike dhe private, vendas ose të huaj, për të cilat vlera e preventivuar e punimeve të ndërtimit është jo më pak se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, të bëhet oponencë teknike”. Vlera e fondit limit është 37.675.320 lekë pa tvsh, më pak se vlera e përcaktuar në nenin e mësipërm.
5. Autoriteti Kontraktor është duke marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 1,322,920 leke pa tvsh nga OE “I” sh.p.k , në cilësinë e sipërmarresit në kontratën me nr. 2997/8 prot., date 23.12.2021 me objekt “Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik të rezervuarit Gjyslikonjë”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me sa sipër, sqarojmë:

1. Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve, duhet të argumentohet teknikisht dhe me fakte që duhet të dokumentohen në dosjen teknike, që në këtë rast nuk janë dhe as nuk janë sjellë bashkëlidhur observacionit. Sa sipër ky pretendim nuk merret në konsideratë.
2. Procesverbali i marrjes në dorëzim është paraqitur bashkëlidhur observacionit.

3. Në lidhje me lejen e ndërtimit dhe oponencën, pretendimi i sjellë nuk është i argumentuar ligjërisht, pasi objektet e realizuara nga Bashkia Tiranë, nuk janë të përjashtuar nga ligji për dhënien e lejes së ndërtimit dhe oponencës teknike.

Bashkëlidhur këtij observacioni është edhe observacioni i mbikëqyrësit të punimeve z. E.N, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Zëri 1. Shkulje rrënjëve të bimëve vogla

Është e vërtetë që në specifikimet teknike, tek “punimet e gërmimit” është e specifikuar që në volumet e gërmimit përfshihet bimësia që ndodhet në pjesën që gërmohet, por në disa raste dhe kjo sidomos gjatë shkarkimit të ri katastrofik, si dhe në pjesën e digës në afërsi të shkarkuesit në formë kulle, nuk jemi në rastin që kemi të bëjmë me “përfshirje të bimësisë në sipërfaqe”, por me një rast specifik. Kështu, duke qenë se gjurma e shkarkuesit katastrofik, është tërësisht e mbuluar me pemë dhe shkurre të larta, gjatë punimeve ka dalë fillimisht domosdoshmëri, pastrimi i sipërfaqeve nëpërmjet shkuljes së pemëve dhe shkurreve, pastaj fillimi i punimeve të gërmimit.

2. Zëri 10. Hekur D>10 mm.

Jemi dakord me konstatimin e ngritur nga ana juaj.

3. Zëri 1+9. Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale me gjerësi deri në 2 m, kategoria III, me shkarkim në tokë + Transport 5 km

Është e vërtetë që bazuar në specifikimet teknike, rrugët e kantierit nuk duhet të përfshihen tek volumet e situacioneshme të punës dhe kjo qëndron plotësisht për sasinë prej 260 m³ të libëzuar si “gërmim dhe nivelim sistemim përroi për të devijuar rrjedhën sipas gjurmës së re”, por në dy rastet e tjera prej 812 m³ (672 + 140), përkatësisht rrugë paralele në të majtë e në të djathtë të rrjedhës, të paraqitura skematikisht edhe në fletën A1-1 të projektit të azhurnuar, pavarësisht se në këtë vizatim dhe në librezë janë të emërtuara “rrugë shërbimi”, gërmimet e masiveve në këto vende janë efektivisht edhe sistemim i skarpateve të usekut të kanalit të shkarkuesit katastrofik, i cili në disa vende arrin edhe lartësinë 4 m, çka bën që skarpara e kanalit të ketë njëfarë thyerje.

Në foton e marrë nga kurora e digës, ku në sfond duket pjesa e sipërfaqes ku pozicionohet shkarkuesi i ri katastrofik, sipërfaqe e mbuluar me pemë e shkurre të larta dhe foto e pastrimit fillimisht të sipërfaqes nga pemët dhe shkurret, para fillimit të procesit të gërmimit, tek shkarkuesi katastrofik dhe në afërsi të shkarkuesit në formë kulle.

Nga sa sipër, jemi të mendimit që kjo pikë e aktkonstatimit duhet rishikuar në lidhje me volumet e punës që kanë të bëjnë me “Shkulje rrënjëve të vogla”, në pjesën e librit të masave me S=1980 m² përgjatë shkarkuesit katastrofik, në rrugën provizore në krahë të djathtë të shkarkuesit S=1200 m² dhe në rezervuar në afërsi të shkarkuesit në formë kulle me S=3300 m², pra me sipërfaqe totale 6480 m². Kjo sasi duhet të merret në konsideratë si punë e kryer.

Sa më sipër, jemi të mendimit të rishikohet përfundimi i arritur në aktkonstatimi për zërat:²

- “Shkulje rrënjëve të bimëve vogla”, sasia 6480 m² x 25 lekë/m² =162,000 lekë

- “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale me gjerësi deri në 2 m, kategoria III, me shkarkim në tokë + Transport 5 km”, 812 m³ x 540 lekë/m³ = 438,480 lekë. Në total, duhet të rishikohet sasia prej 600,480 lekë, ndërsa për pjesët e tjera jemi dakord me konstatimet e ngritura.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me sa është observuar më sipër, pas shqyrtimit të pretendimeve, sqarojmë:

1. Për zërin “Shkulje rrënjëve të bimëve vogla”, marrim në konsideratë S=1980 m² përgjatë shkarkuesit katastrofik dhe S=1200 m² në rrugën provizore në krahë të djathtë të shkarkuesit dhe nuk marrim në konsideratë S= 3300 m² në rezervuar, në afërsi të shkarkuesit në formë kulle, për të

cilën nuk ka argument teknik. Nga rillogaritja, diferenca në volum e këtij zëri pune është 10616 m², e cila do të reflektohet në tabelën e dëmit ekonomik.

2. Për zërin 10. Hekur D>10 mm, konkuzionet e grupit të auditimit janë pranuar.

3. Për zërin “Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale me gjerësi deri në 2 m, kategoria III, me shkarkim në tokë + Transport 5 km”, merret në konsideratë gërmim rruga paralele në krah të majtë 50 x 4 x 0.7 m = 140 m³. Gërmim rruga paralele në krah të majtë është marrë 120 x 4 x 1.4 m = 672 m³, ndërkohë që edhe nga vizatimi duket që është 90 x 4 x 1.4 m = 504 m³. Volumi prej 260 m³ për “gërmim dhe nivelim sistemim përroi për të devijuar rrjedhën sipas gjurmës së re”, është pranuar.

Nga rillogaritja diferenca e këtij volumi është 428 m³, e cila do të reflektohet në tabelën e dëmit ekonomik.

2. “Përmirësimi i ndriçimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi i korsive të biçikletave në sheshin “Nënë Tereza”, deri në hyrjen e Liqenit Artificial”, DPRrNP, Bashkia Tiranë

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 1767/8 prot., datë 16.08.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor DPRrNP, të përfaqësuar nga Drejtori z. H.RR dhe të OE “I” SHPK, me përfaqësues ligjor z. G.D me licencë profesionale NZ 4776/12. Vlera e kontratës është 37,641,882.6 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 56 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1913/8, datë 16.08.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “G” SHPK, me përfaqësues z. L.H, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2928/9 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 558,569 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3120 prot., datë 24.10.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me shoqëria “R” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1506/10 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 45,254 lekë me tvsh. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 23.11.2022.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, nuk administrohet Leje Infrastrukturore. Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. H.RR.

-Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike**, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”.

- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga shoqëria “I” ShPK në vitin 2022 dhe miratuar nga Bashkia Tiranë.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 17.08.2022 dhe kanë përfunduar me datë 10.10.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Nga auditimi i dosjes teknike, rezulton se pas kërkesës së mbikëqyrësit për saktësim të projektit me datë 20.09.2022, Investitori i ka shprehur dakordësinë për ndryshimet e propozuara, vendosjen e fidanëve shkurre dekorative “Oleandër”, me shkresën nr. 2723/2, datë 26.09.2022 dhe përdorimin e fondit rezervë në shumën 1,492,700 lekë pa TVSh. Është mbajtur proceverbale datë 20.09.2022 për ndryshimin e volumeve, i nënshkruar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve dhe nga Investitori, në të cilën janë përcaktuar ndryshimet në volumet e punimeve. Këto procesverbale janë shoqëruar nga tabela e ndryshimeve (+/-), ku rezultojnë 2,978,065 lekë pa TVSh punime që shtohen dhe 2,977,912 lekë pa TVSh punime që hiqen.

Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren të punimeve, u konstatua që zëri i punës “FV lampadarë biçiklete + shtyllë + aksesoret” është shtuar nga 9 në 29 copë, ku 9 copë janë lampadarët dhe 20 copë janë semaforë të rinj. Vendosja e semaforëve të rinj është zë i ri pune dhe si i tillë duhet të kishte sjellë negociimin e çmimit. Ky mosveprim është në kundërshtim me UKM Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 8.3, sipas të cilës “8.3 Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e AK dhe mbikëqyrësin e punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar
4. Libreza e masave
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Përmirësimi i ndriçimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi i korsive të biçikletave në sheshin “Nënë Tereza”, deri në hyrjen e Ligenit Artificial”, DPRrNP				
14.Lidhja e kontratës Nr. 1767/8 prot., datë 16.08.2022	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 37,641,882.6 lekë OE fitues “I” SHPK		16.Likuiduar deri	
17- Situacioni Përfundimtar Vlera me tvsh 37,640,835 lekë Vlera pa tvsh 31,367,362.5 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 56 ditë, Zbatuar 54 ditë. Fillimi punimeve: 17.08.2022 Përfundimi punimeve : 10.10.2022		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “G” SHPK	Licenca Nr: MK 2928/9	Kontrata nr. 1913/8, datë 16.08.2022	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve “R” ShPK	Licenca Nr: MK 1506/10	Kontrata nr. 3120 prot., datë 24.10.2022	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 23.11.2022	23.Akt i marrjes në dorëzim Nuk ka			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të

kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **158,400 lekë pa tvsh**.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 158,400 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, por është pranuar dhe arkëtuar nga sipërmarrësi i punimeve në datën 23.05.2024, në favor të DPRrNP, në vlerën totale 190,080 lekë me TVSH.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. L.H, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. R.N, me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara.

Bazuar në Akt Konstatimin nr.13 dhe në Rekomandimin nr. 8.1 të Projekt Raportit (faqe 238) sqarohet se:

1. Procesverbali i marrjes në dorëzim (i përkohshmi) me Nr.1767/19 Prot., datë 12.11.2022 është pjesë e dosjes së prokurimit. Bashkëlidhur gjeni këtë procesverbal.

2. Projekti i zbatimit është miratuar me Vendim të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë. Me Vendimin nr.128 prot., dt. 30.10.2001 të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e Këshillit Teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike” është krijuar Këshilli Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike.

Bazuar në këtë vendim, pika 2.2, 2.3 dhe 2.4, Këshilli Teknik ka për detyrë të bëjë miratimin e detyrave të projektimit të hartuara nga kjo Bashki, miratimin e projekteve të hartuara nga bashkia me specialistët e saj, ose me specialistë të jashtëm dhe miratimin e strategjive në drejtim të ndërhyrjes në infrastrukturën e rëndë dhe të lehtë.

Anëtarët e Këshillit Teknik janë Drejtorë të Përgjithshëm dhe përfaqësues të drejtorive të cilët janë teknike dhe aktiviteti i tyre administrativ lidhet ngushtësisht me zhvillimin e projekteve, dhe secili mbulon fushën e tij të ekspertizës.

Vendimi i Këshillit Teknik miraton të gjitha fazat e hartimit të një projekti (projekt ide paraprake, projekt ide përfundimtare) dhe Projektin e Zbatimit pasi ky i fundit ka kaluar dhe të gjitha miratimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.

Projektet hartohen në bazë të standarteve dhe ligjeve në fuqi sipas cdo kategorie, infrastrukturë, objekte kulturore, arsimore etj. **Projekti dhe preventivat për investimet publike miratohen nga Këshilli Teknik dhe firmosen nga Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe procedura e miratimit është e njëvlefshme me lejen e ndërtimit, që firmoset po nga Kryetari i Bashkisë Tiranë.**

Për këtë arsye, për të gjithë projektet e miratuara në juridiksionin territorial të Bashkisë Tiranë, janë ezaruar të gjitha hallkat e realizimit të projektit sipas standarteve dhe kontroleve teknike për fillimin e punimeve . Më pas ndjekja ose ndryshimet gjatë zbatimit në terren të këtyre projekteve, bëhen sërish nëpërmjet këtij Këshilli Teknik.

3. Në lidhje me oponentin teknik, Autoriteti Kontraktor i është referuar legjislacionit në fuqi të kohës, Ligjit Nr. 8402, date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Neni 6 “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve”, si dhe Vendimit Nr. 1055, datë 22.12.2010, “Për vendosjen e oponentit teknik për projektet e veprave të ndërtimit”, pikes 1 : “Për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, që

realizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga subjekte fizike dhe private, vendas ose të huaj, për të cilat vlera e preventivuar e punimeve të ndërtimit është jo më pak se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, të bëhet oponencë teknike”. Vlera e fondit limit prej 37.675.320 lekë pa tvsh është më pak se vlera e përcaktuar në nenin e mësipërm.

4. Në lidhje me zërin e punës “FV llampadarë biçiklete + shtyllë + aksesorët” sqarojmë se nga 9 copë që kanë qenë parashikuar në preventivin fillestar janë shtuar dhe 20 të tillë dhe totali ka arritur në 29 copë. Nuk kemi të bëjmë me semaforë të rinj si zë i ri pune por vetëm shtim të numrit të zërit ekzistues. Këto ndryshime nuk sjellin kosto shtesë në realizimin kontratës dhe nuk sjellin zëra të rinj punimesh që nuk janë të ofertuar në preventiv.

5. Autoriteti Kontraktor mori masa për arkëtimin e vlerës prej 158.400 leke pa tvsh nga OE “I” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarresit në kontraten me nr. 1767/8 prot., date 16.08.2022 me objekt “Përmirësimi i ndriçimit publik në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhe ndërtimi i korsive të biçikletave në sheshin "Nënë Tereza" deri në hyrjen e liqenit Artificial”. Bashkëlidhur njoftim debitimi për detyrimin e ngarkuar sipas projekt raportit të auditit Nr.1063/2 Prot., datë 29.04.2024.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me sa sipër, sqarojmë:

1. Procesverbali i marrjes në dorëzim është paraqitur bashkëlidhur observacionit.
2. Në lidhje me lejen e ndërtimit dhe oponencën, pretendimi i sjellë nuk është i argumentuar ligjërisht, pasi objektet e realizuara nga Bashkia Tiranë, nuk janë të përjashtuar nga ligji për dhënien e lejes së ndërtimit dhe oponencës teknike.
3. Në lidhje me zërin e punës “FV llampadarë biçiklete + shtyllë + aksesorët”, sqarojmë se nga verifikimi në terren, kemi të bëjmë me semaforë të rinj. Pretendimi nuk merret në konsideratë.
4. Arkëtimi i vlerës së dëmit ekonomik të konstatuar nga grupi i auditimit, do të konsiderohet si rekomandim i zbatuar.

2.5 Të ndryshme të dala gjatë auditimit

Nga auditimi në terren, nuk ka dalë asnjë problem për tu trajtuar në këtë kapitull.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, nga auditimi mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit”, rezultoi se:

- Rregullorja e Brendshme e institucionit, nuk ka qenë e përditësuar me ndryshimet që kanë ndodhur në strukturën organizative të institucionit, ku gjatë këtyre viteve është vënë re se numri dhe përbërja e drejtorive të DPRrNP ka ndryshuar.
- Nuk është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik.
- Nuk është përgatitur harta e proceseve të punës dhe gjurmët standarde të auditimit për procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore të DPRrNP.

- Nuk është hartuar një rregullore specifike për ndjekjen e procedurave të ruajtjes, mbrojtjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, nuk është hartuar asnjë manual apo rregullore specifike për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve të IT-së, si dhe nuk është hartuar Rregullorja e Posaçme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.
 - Kodi i etikës së institucionit nuk është hartuar si dokument më vete, por disa pika të tij kanë qenë të përfshira në Nenin 12, të Rregullores së Brendshme të DPRrNP.
 - Shpalljet për vende të lira pune, nuk janë dërguar zyrtarisht për tu publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
 - Në strukturën organizative të miratuar, nuk ka pasur të parashikuara dhe përcaktuara pozicione me prioritet, për kategorinë e personave të cilësuar me statusin PAK.
 - Sektori i Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar dhe miratuar një program trajnimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore, si dhe nuk ka pasur të planifikuara fonde të dedikuara për trajnimin e punonjësve.
 - Regjistri i riskut i përgatitur për secilin nga sektorët e drejtorive të DPRrNP, nuk ka pasur përditësime, duke mos evidentuar dhe përfshirë risqe të reja, të cilat mund të jenë konstatuar nga njëri vit në tjetrin.
 - Në planet vjetore të punës të përgatitura nga drejtoritë e DPRrNP për vitet 2019 - 2022, identifikimi dhe formulimi i një pjese të madhe të objektivave të drejtorive dhe sektorëve, nuk ka qenë specifik duke adresuar mënyrën për realizimin e secilit objektiv. Nuk është përcaktuar periudha/ koha e parashikuar e realizimit për secilin prej objektivave, në mënyrë që t'i bëjë këto objektiva të matshëm, të arritshëm, të përshtatshëm dhe të përcaktuar në kohë, me qëllim që monitorimi i zbatueshmërisë së tyre të jetë efektiv.
 - Shumica dokumenteve shkresore të përgatitura për periudhën objekt auditimi, nuk janë ndjekur rregullat dhe normat tekniko-profesionale të protokoll arkivës. Kjo pasi në disa raste, shkresa e parë e dokumentit të përgatitur rezulton të ketë marrë një numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të nuk janë identifikuar me të njëjtin numër rendor dhe renditjen progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.
- (Trajtuar më hollësisht në faqen nr19-41, pika 2.1, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
- 1.1.Rekomandim:** Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masat në vijimësi, me qëllim që:
- Të përditësohet Rregullorja e Brendshme e institucionit, në përputhje me strukturën organizative, duke paraqitur në mënyrë të plotë e të saktë detyrat specifike të punonjësve, duke bërë edhe përditësime të vijueshme në rastet e ndryshimit të strukturës.
 - Të hartohet Kodi i Etikës së institucionit dhe Rregullorja e Posaçme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, si dhe të hartohet një manual apo rregullore specifike për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve të IT-së.
 - Të krijohet Grupi i Menaxhimit Strategjik, si dhe të përcaktohet koordinatori i GMS dhe koordinatori i riskut, për të bërë të mundur funksionimin dhe mbarëvajtjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe kryerjen e detyrave në raport me të gjitha aktivitetet e njësisë.
 - Të hartohet në mënyrë periodike plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, pyetëtori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, plani i veprimit për kontrollin e brendshëm, plani i veprimit për arritjen e objektivave.
 - Të hartohen dhe përgatiten programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit, bazuar në nevojat e kualifikimit periodik të tyre, si dhe dosjet e personelit të kenë dokumentacionin e plotë duke përfshirë edhe raportin e aftësisë në punë të përditësuar në mënyrë periodike.

- Të hartohen gjurmët standarde të auditimit për procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore të DPRrNP, si dhe harta e proceseve të punës.
- Të hartohet një rregullore specifike për ndjekjen e procedurave të ruajtjes, mbrojtjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike.
- Të përditësohet në mënyrë periodike regjistri i riskut për secilën nga drejtoritë e DPRrNP, duke ndihmuar në përcaktimin dhe identifikimin e risqeve kryesore dhe gjithashtu të hartohet në mënyrë periodike strategjia e menaxhimit të riskut, që ndihmon për të minimizuar nivelin e riskut të brendshëm të institucionit.
- Të hartohen planet vjetore të punës të drejtorive të DPRrNP duke garantuar, përcaktimin dhe identifikimin e objektivave të drejtorive dhe sektorëve përkatës, kjo me qëllim që monitorimi i zbatueshmërisë së tyre të jetë i mundur dhe efektiv.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, të marrin masa në vijimësi, me qëllim që:

- Të garantohet se njoftimi/ shpallja e vendeve të lira të punës në DPRrNP, të dërgohet zyrtarisht për tu publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
- Gjatë hartimit dhe përgatitjes së strukturës organizative të punonjësve, duke marrë në konsideratë nevojat e institucionit, të parashikohen dhe përcaktohen pozicione me prioritet për kategorinë e personave të cilësuar me statusin PAK.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi faturat e palikujduara për detyrimet e prapambetura nga viti 2012 në 2015 në ish- Drejtorinë e Përgjithshme të Qytetit (sot Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe e Ndriçimit Publik), paraqiten në vlerën 4,931,589 lekë, ku 80 % të totalit të detyrimeve e zë blerja e karburantit. Këto detyrime janë të periudhën 2012-2015. Duke filluar nga viti 2016 e deri në fund të vitit 2022, detyrimet arrijnë në vlerën 15,999,698 lekë (vlerë e faturave të vitit 2022). Në total detyrimet deri më datë 31.12.2022 rezultojnë në vlerën **20,931,287 lekë**. Në vlerën e detyrimit 20,931,287 lekë përfshihen detyrimet për periudhën 2012- 2015 në vlerën 4,31,589 lekë dhe detyrimet e periudhës 2016-2022 në vlerën 15,999,698 lekë. Mos pagesa e këtyre vjen për mungesë të fondeve nga të ardhurat e Drejtorisë së Përgjithshme e Rrugëve dhe e Ndriçimit Publik.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, pika 101 “Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti I mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim”.

(Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 41-60, pika 2.2, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe e Ndriçimit Publik të marrë masa që stokun e detyrimeve të prapambetura ta raportojë sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara me qëllim planifikimin për shlyerjen e tyre në buxhetin viti pasardhës.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se janë paguar 3 fatura të kontratave të punëve të lidhura në vitin 2021 (2) dhe 2022 (1), për të cilat janë ngurtësuar 5% e vlerës së tyre, nga

të cilat për kontratën nr. 1767/8 datë 16.08.2022 në vlerën 37,641,883 lekë vlera e llog.466 është llogaritur në shumën 1,100,000 lekë kur në fakt duhet të ishte në shumën 1,882,094 lekë. Me një diferencë prej (-) 782,094 lekë është nënvlerësuar llog. 466 si vlera 5% e garancisë për këtë kontratë.

- Nga analiza e llog.468 "*debitorë të ndryshëm*" e pasqyruar në mbyllje të vitit 2022 në shumën 14,382,457 lekë, rezultoi se vlera e kësaj llogarie është e trashëguar nga viti 2016 për dëmtime në rrugë e rrjete. Për këtë shumë te pasqyra e konfirmimit është shënuar se nuk ka asnjë evidencë. Shuma e detyrimeve debitohet në llog. 468 "*debitorë të ndryshëm*" dhe kreditohet në llog. 4341 "*Të tjera operacione me shtetin (kreditor)*". Llog. 468 ka si kundërparti llog.470 "*Të ardhura për t'u marrë*" në pasiv. U konstatua se nga ana e Drejtorisë së financës nuk është bërë asnjë analizë apo verifikim, si dhe nuk është marrë asnjë masë për të siguruar arkëtimin e detyrimit deri në vlerë të plotë të tij, pasi dhe periudha e lindjes së detyrimit nuk është e hershme, për të mos u bërë e mundur arkëtimi i vlerës.

- Nga analiza e llog. 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" që paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 20,931,287 lekë, përfshihet edhe shuma e mbartur ndër vite 4,931,589 lekë për mallra e shërbime të kryera nga 2011-2015 dhe të papaguara. Nga auditimi u konstatua se për këto detyrime nuk është bërë asnjë analizë mbi arsyet e mbartjes nga viti në vit në vlerën e tij të plotë pa bërë pagesa qoftë edhe pjesore, me qëllim minimizimin e vlerës deri në likuidim të saj në fund të periudhës 7 vjeçare.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe regjistrit të aktiveve rezultoi se për periudhën nën auditim 2019-2022, nuk është llogaritur amortizimi i aktiveve të llog. 202 "*studime dhe kërkime*" me normën përkatëse të amortizimit (15%), në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" pika 36 i ndryshuar.

- Nga analiza e llog. 218 "*inventar ekonomik*" rezultoi se, kategoria "*pajisje kompjuterike*" nisur nga karakteristikat specifike të aktivitetit, nuk është ndarë si kategori më vete llog. 218/1, duke pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj për të saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit. Por nga verifikimi i analizës së llogarisë dhe regjistrit të inventarëve rezultoi se llogaritja e amortizimit për pajisjet kompjuterike vetëm në vitet 2021 dhe 2022 është llogaritur saktë prej 25% të vlerës së mbetur.

- Për vitin 2022 llog.24 "*aktive të dëmtuara*" paraqitet në vlerën 61,893,470 lekë përbëhet nga nëntë dhjetë e nëntë (99) aktive të cilësuar të dëmtuara, nga të cilat: njëzetë e tetë (28) aktive i përkasin llog.218 në vlerë kontabël 61,893,470 lekë dhe vlerë të mbetur 514,926, prej të cilave tetë (8) aktive e kanë vlerën e mbetur zero (0); tridhjetë e një (31) aktive i përkasin llog.215 në vlerë kontabël 37,719,663 lekë dhe vlerë të mbetur 11,898,064 lekë, prej të cilave tre (3) aktive e kanë vlerën e mbetur zero (0); njëzetë e tetë (28) aktive i përkasin llog.214 në vlerë kontabël 15,683,210 lekë dhe vlerë të mbetur 4,368,213 lekë; pesë (5) aktive i përkasin llog.212 në vlerën kontabël 603,978 lekë dhe vlerë të mbetur 238,592 lekë; ka dhe një grup aktivesh të dëmtuara përdorur nga administrata në vlerën kontabël totale 4,434,245 lekë dhe vlera e mbetur 139,807 lekë. Nuk janë dhënë specifikime mbi llogarinë kontabël së cilës i përkasin dhe rrjedhimisht dhe llogaritja e amortizimit nuk është bërë sipas normës përkatëse të amortizimit.

- Llog. 28 "*Caktime*" në mbyllje të viteve 2021 dhe 2022 njësitë publike nuk ka caktuar AAGJ në përdorim për të tjerë, pra kjo llogari nuk ka vlerë. Nga auditimi u konstatua se DPRRNP Tiranë ka marrë në përdorim një objekt në pronësi të ish Bordit të Kullimit. Mungesa e hartimit

të akt marrëveshjes apo kontratës së përdorimit mes dy institucione, ka rezultuar me mosevidentimin e vlerës së këtij aktivi në llog.107 “aktive të caktuara në përdorim”, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. Pra llog.107 “Aktive të caktuara në përdorim” merr në kredi vlerën neto të aktivitetit që institucioni merr në përdorim nga të tretët me kundërparti debitin e llogarive përkatëse të grupit 21 të AAGJM. Teprica e saj tregon që aktivet nuk janë të vetat.

- Llog. 209 & 219 “Amortizimi i AAM & AAJM” sipas pasqyrave financiare të DPRRNP Tiranë në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën 8,777,758,316 lekë; Në mbyllje të vitit 2022 paraqiten në vlerën 9,827,261,219 lekë, ku rezulton se kjo vlerë është shtuar për 1,215,510,802 lekë dhe pakësuar për shumën 166,007,899 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit, pasqyrave dhe evidencave të miratuara, u konstatua se nga ana e sektorit të financës për vitet 2021 dhe 2022 nuk është hartuar një evidencë e veçantë vetëm për llog. 209 dhe 219 “Amortizimi i AAJM & AAM”, me qëllim mbajtjen nën kontroll të vlerës së mbetur të aktiveve të njësisë publike;

- Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të regjistruar në kontabilitet, u konstatua se një pjesë e këtyre aktiveve pasi i është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite, vlera e tyre është e papërfillshme (më e vogël se “100” lekë ose “0” lekë). Këto aktive vazhdojnë të jenë në përdorim dhe gjendje pune pa shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve.

- Llog. 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 54,038,817 lekë, e cila nuk kuadron me gjendjen e llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” e cila është në shumën 33,107,530 lekë, me një diferencë prej 20,931,287 lekë vlerë e cila është e barabartë me shumën e “Të tjera aktive afatshkurtra”, të llog. 486 “Shpenzime në periudha të ardhshme”. Pra llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është nënvlerësuar për shumë 20,931,287 lekë.

- Llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”, përfshin faturat e palikuiduara në kohë si detyrime ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera, por të papaguara për mungesë fondesh. Gjendja në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 40,562 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në po këtë vlerë. Nga auditimi u konstatua se vlera e llog.467 “kreditorë të ndryshëm” është nënvlerësuar për shumën 29,566,365 lekë.

- Në pasiv të bilancit grupi “Të tjera aktive afatshkurtra” paraqitet në vlerën zero. Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet vlerë në llog. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llog. 468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Pra llog. 470 është nënvlerësuar për shumën 14,382,457 lekë.

- Llog. 600 “Paga dhe përfitime e punonjësve” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 311,622,461 lekë, dhe rakordon me akt rakordimin me thesarin; vlera e kësaj llogarie përbëhet nga “Paga personeli i përhershëm”, “Shpërblime”. U Konstatua se në pasqyrat e viteve 2019, 2020 dhe 2021 (viti 2022 nuk ka patur punonjës provizorë), nuk është plotësuar nënlllog. 6002 “Paga personel i Përkohshëm”, por shuma e pagave të 50 punonjësve të përkohshëm është pasqyruar së bashku në nënlllog. 6001 “Paga personel i përhershëm”.

- Nga analiza e llog. 602/ nënlllog. 6026 “Shpenzime qiraje” me prishjen e pesë objekteve, nga DPRRNP Tiranë për nevojat e saj është lidhur një kontratë qiraje me nr. rep. 3112/nr. kol. 1971 datë 01.06.2022, ndërmjet DPRRNP Tiranë dhe bashkëpronarëve z. T.P dhe znj. M.P. Nga auditimi rezulton se kontrata në fjalë ka mangësi në përmbajtje, pasi nga ana e noterit E. H. me licencë profesionale nr. 511, nuk ka të përcaktuar bazën ligjore të cilës i është referuar

për hartimin e kontratës dhe bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur për llogaritjen e vlerës së qirasë. Për këtë konstatim nuk është zbatuar neni 659, neni 660 dhe neni 662 të Kodit Civil. Përcaktimi i bazës ligjore referuese përveçse garanton të drejtat dhe detyrimet e palëve, rrit edhe përgjegjshmërinë për mbrojtjen e sendit objekt kontrate nga dëmtimi, humbja apo tjetërsimi.

(Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 60-124, pika 2.3, të Projekt Raportit të Auditimit).

4.1 Rekomandimi 1: Drejtoria e Financës, burimeve njerëzore dhe shërbimeve dhe sektori i financës të tregojë kujdes në llogaritjen e 5% të vlerës së çdo investimi, për të cilën kjo llogari është nënvlerësuar për shumën 782,094 lekë;

- Të analizojë situatën e llog. 468 "Debitorë të tjerë" të marrë masa konkrete për arkëtimin e shumës 14,382,457 lekë;

- Të analizojë situatën e Llog. 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" dhe të marrë masa për likuidimin e shumës së mbartur ndër vite 4,931,589 lekë për mallra e shërbime të kryera nga 2011-2015 dhe të papaguara deri më sot;

- Të llogarisë amortizimin e llog. 202 "Studime dhe kërkime" dhe të sistemojë vlerën e amortizimit për secilin vit në pasqyrat financiare për periudhën nga 2018 e në vijim me normën e amortizimit të përcaktuar në Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022 pika 36;

- Në llog. 218 "Inventari ekonomik" të klasifikojë veçmas llog. 218/1 "Pajisjet kompjuterike" në regjistrin e asetëve të njësisë dhe pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive;

- Në llog. 24 "Aktive të dëmtuara" të specifikojë sipas llogarive përkatëse aktivet e grupuara në vlerën kontabël totale 4,434,245 lekë;

- Të hartojë një evidencë e veçantë vetëm për llog. 209 dhe 219 "Amortizimi i AAJM & AAM", nga viti 2021 e në vijim me qëllim mbajtjen nën kontroll të vlerës së mbetur të aktiveve të njësisë publike për menaxhim efektiv të tyre në dobi të njësisë publike;

- Ti propozojë titullarit të njësisë ngritjen e një grupi pune me ekspertë të fushës për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të atyre aktiveve vlera e mbetur e të cilave është e papërfillshme por që janë në gjendje pune;

- Të sistemohet vlera e llog. 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" e cila në pasqyrat e vitit 2022 është nënvlerësuar për shumë 20,931,287 lekë.

- Të sistemohet vlera e llog.467 "Kreditorë të ndryshëm" në pasiv të bilancit, e cila është nënvlerësuar për shumën 29,566,365 lekë;

- Të sistemohet vlera e llog.470 "Llogari në pritje – të ardhura për t'u marrë" në shumën 14,382,457 lekë;

- Në pasqyrën e performancës financiare / grupi B -Shpenzimet të pasqyrojë veçmas shumën pagave të punonjësve të përkohshëm në nënlllog. 6002 "Paga personel i Përkohshëm", nënlllogari e cila për vitet 2019, 2020 dhe 2021 ka qenë e nënvlerësuar.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 31.03.2025

4.2 Rekomandimi: Titullari i DPRRNP Tiranë, Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin menjëherë masa për lidhjen e marrëveshjes apo akt përdorimit me Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit (ish Bordi i kullimit) mbështetur në

shkresën nr. 832/3 datë 18.02.2022 të MBZHR, me qëllim pasqyrimin e vlerës së aktivitetit në llog.107 "Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim".

- Të rihartohet kontrata nr. Rep. 3112 dhe kol. 1971 e datës 01.06.2022 (në rast se është në proces rinovimi) duke vendosur bazën ligjore si për hartimin e saj ashtu edhe atë mbi të cilën është llogaritur vlera e qirasë;

- Në kontratat e qiradhënies që do të lidhen në periudhën në vijim, në asnjë rast të mos mungojë baza ligjore referuese.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi i dokumenteve dhe informacioni i pasqyruar në tabelat përmbledhëse të Inventarizimit, rezulton se në dy raste është krijuar komisioni i inventarizimit të [Pajisjet/Inventari ekonomik në zyra/korridor/magazinë 1] me të njëjtët anëtarë për tre vite radhazi, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" pika 84;

- DPRRNP Tiranë nuk ka hartuar dhe miratuar Strategji dhe Rregullore për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve (inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve), në kundërshtim me Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" pikat 6,7,8,9 dhe 17,18,19.

- Për vitet 2019, 2020, 2021, komisionet e inventarit fizik dhe të vlerësimit paraprak, kanë përpiluar relacionin me listën e aktiveve të dëmtuara për procedura të mëtejshme (tabela 1) – në vlerat respektive: 28,305,143 lekë, 2,114,840 lekë, 3,219,960 lekë. Nga ana e NA dhe NZ nuk është marrë asnjë masë për vijimin e procedurave me ngritjen e komisioneve të vlerësimit përfundimtar të tyre, me qëllim nxjerrjen e aktiveve të dëmtuara për jashtë përdorimit/asgjësimit, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30/2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", kreu IV paragrafi 3 pika 96;

- Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën e mjeteve të vlerësuara jashtë funksioni për nxjerrje jashtë përdorimit/skrup, rezulton se nga komisioni janë vlerësuar njëzetë mjete transporti jashtë funksionimit, nga të cilat konstatohet se: dhjetë (10) mjete janë çregjistruar përgjithmonë nga sistemi i mjeteve në DRSHTRR Tiranë para periudhës së ngritjes së këtij komisioni, duke shmangur kështu pagesën e panevojshme të taksave, kolaudimit dhe siguracionit për periudhën vijuese, por që kanë qenë prezente në regjistrin e aktiveve të njësisë, në kontabilitetin e saj në llog.215; pesë (5) mjete janë pa targa, që ka sjellë shmangien nga pagesa të detyrimeve ndaj shtetit dhe riskun e humbjes së tyre si aktiv; për dhjetë (10) mjete (përfshirë edhe pesë (5) mjetet pa targa), nuk është vijuar me procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit duke bërë verifikimin dhe çregjistrimin në DRSHTRR Tiranë. Këto problematika nuk janë pasqyruar në asnjë regjistër aktivesh apo procedurash dhe nuk i janë nënshtruar procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit, duke i lënë prezent në regjistrin e aktiveve.

- Edhe pse i është dërguar relacion gjithëpërfshirës Strukturave përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, për këto mjete nga ana e Titullarit të njësisë dhe Nëpunësit zbatues nuk janë marrë masat për ndjekjen e hapave vijuese të procedurës së inventarizimit, me ngritjen e komisionit për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjësimit dhe dokumentimin e saj.

Të gjitha sa më lart në moszbatim të Ligjit nr. 10296/2010 "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 8 "përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit" pika 8/ç; neni 9 "përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues"; neni 10 "përgjegjshmëria

menaxheriale e koordinatorit të riskut”; neni 11 “përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë” pika 4; neni 12 “përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit zbatues” pikat ë- f ; Udhëzimit nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kapitulli I pika 2; 5,6,7,8,9/a,b,c 10; kapitulli IV pika 73, pika 81, pika 96, pika 99, pika 100, pika 101, pika 102, pika 103-106; pika 107-120; VKB nr. 135/2018.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi korrespondencën e DPRRNP Tiranë me Bashkinë Tiranë, rezultoi se me shkresën nr. 24328/1 prot., datë 02.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë i është kthyer përgjigje "memos" së DPRRNP nëpërmjet së cilës ka kërkuar konfirmim mbi përmbylljen e procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjësim të mjeteve të vlerësuara jashtë funksioni dhe të amortizuara teknikisht. U konstatua se arsyet e radhitura për mos përmbushjen e kërkesës së DPRRNP Tiranë, nuk janë bindëse, pasi sipas argumentimit në shkresë, rezulton se kriteret e VKB nr. 135/2018 prevalojnë mbi ato të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”; si dhe komisioni qendror nuk ka monitoruar punën e komisioneve të nivelit të dytë para, gjatë dhe në mbyllje të procedurës së vlerësimit, me qëllim kryerjen sa më me efektivitet të procedurës së vlerësimit të teknikës së transportit nga komisionet e njësisive vartëse sipas kuadrit ligjor dhe akteve rregullatore të Bashkisë Tiranë, duke mos zbatuar detyrimin e përcaktuar në pikën A/b të Urdhrit nr. 39418 datë 13.10.2019.

- Mbi inventarizimin e objekteve “Ndërtesa” (12 objekte-godina & kabina elektrike - llog. 212) në pronësi të DPRRNP Tiranë, me UB nr. 3823 dt. 28.12.2022, si çdo vit është ngritur komisioni prej 3 anëtarësh, nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultoi se:

- Komisioni i inventarit fizik të ndërtesa/godinave ka bërë edhe nxjerrjen jashtë regjistrit të aktiveve objektet e përfshira në [PdyV], pa qenë i autorizuar të realizojë atë procedurë;

- Nga ana e Titullarit nuk ka dalë Urdhri i Brendshëm për vlerësimin dhe për nxjerrjen jashtë përdorimit të objekteve (llog. 212);

- Nëpunësi zbatues nuk ka ndjekur dhe dokumentuar hapat e procedurës sipas radhës së tyre për çdo objekt, pjesë e saj;

- Komisioni i verifikimit fizik i cili është vetautorizuar për të nxjerrë nga regjistri i aktiveve pesë (5) objektet e përshkuara mësipërm, nuk ka verifikuar paraprakisht objektet në listën e publikuar bashkëngjitur Vendimit nr. 533 datë 22.09.2021; si dhe nuk ka kërkuar praktikën e plotë dokumentare për procedurat e ndjekura nga Bashkia Tiranë, mbi të cilën do të mbështetej komisioni i ngritur në DPRRNP për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit të objekteve për arsye tjetërsimi, në zonën e “5 Majit”, për sa konstatuar më lart këto mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 8,9,10,11,12; Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;

- Komisioni ka nxjerrë jashtë regjistrit të aktiveve pesë objektet e evidentuara edhe në tabelën përkatëse, në vlerën totale të tyre prej 603,928 lekë. Kjo vlerë nuk është vlera reale e këtyre objekteve, pasi këto objekte duhet ti nënshtroheshin më parë procedurës së vlerësimit të tyre nga ekspertë të fushës. Nga titullari i njësisë nuk është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve “ndërtesa/godina” në mungesë të komunikimit dhe bashkëveprimit edhe me Nëpunësin Zbatues të njësisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Rubrika “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi” pikat 95-106;

- Nga titullari i njësisë nuk është ngritur komisioni për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit për arsye tjetërsimi në këtë rast të pesë objekteve në mungesë të komunikimit dhe bashkëveprimit edhe me Nëpunësin Zbatues të njësisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Rubrika “Dhënia në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve” pika 107-120.

(Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 60-124, pika 2.3, të Projekt Raportit të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve në DPRRNP Tiranë, të marrin masa për:

- Të zbatuar të gjitha hallkat e procedurës standard të Inventarizimit të aktiveve të njësisë, kryesisht atë të nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjësimit të atyre të amortizuara sipas kuadrit ligjor në fuqi;

- Miratimin e një strategjie dhe rregulloreje për menaxhimin e aktiveve, risqeve që ato mbartin dhe për minimizimin e tyre, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi;

- Nisjen e procedurave pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për pajisjen me certifikata pronësie të aktiveve dhe të rivlerësojnë aktivitetet e DPRRNP, me qëllim kontabilizimin e vlerave të sakta të tyre në llogaritë 210 dhe 212 të AAGJM në pasqyrat financiare;

- Verifikimin e pesë mjetet pa targa dhe të përfundojë procedurën e çregjistrimit të përhershëm të dhjetë mjeteve, të cilat nga auditimi kanë rezultuar pa informacion në sistemin e mjeteve.

- Plotësimin e praktikës me dokumentacionin përkatës apo të argumentojnë çdo kërkesë të mos përmbushjes së saj dhe t’i rikërkojnë Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, të Aseteve dhe Liçensimit/Bashkia Tiranë, konfirmimin për të vijuar me procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimit/me tjetërsim apo asgjësim të mjeteve të amortizuara teknikisht, me qëllim largimin e tyre nga territori i njësisë për skrap dhe shkarkimin nga kontabiliteti; të ngrenë grup pune për vlerësimin e aktiveve dhe inventarëve me vlerë të mbetur të papërfillshme ose "zero", të cilat janë në përdorim dhe në gjendje pune për shërbimet që ofron njësia publike.

Menjëherë

5.2 Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve në DPRRNP Tiranë t’i kërkojë Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, të Aseteve dhe Liçensimit/Bashkia Tiranë praktikën e plotë dokumentare të ndjekur nga Bashkia Tiranë lidhur me përfshirjen e pesë objekteve të saj në [PdyV], lidhjen e një marrëveshjeje mes tyre ku të qartësohen efektet e vendimmarrjes së Bashkisë Tiranë për pesë objektet ndaj DPRRNP Tiranë; si dhe për t’i hapur rrugë Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve/Sektorit të financës për sistemin e vlerës së tyre në llogarinë kontabël përkatëse të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor të kontabilitetit, deri në shkarkimin e tyre nga kontabiliteti i njësisë.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:

- Nga DPRRNP Tiranë ndryshimet në strukturat e ri kompozuar, nuk janë shoqëruar me përshkrimet e punës të miratuara për çdo njësi të saj drejtori apo sektor dhe për çdo pozicion të ri, si dhe nuk janë reflektuar në Rregulloren e brendshme të institucionit;

- Nevojat për punësim trajtohen verbalisht në analizat dhe takimet e punës që zhvillohen;

- Rezultoi se nuk është ndarë numri i nevojave për zëvendësim të stafit për arsye të “daljes në pension” nga numri i nevojave për staf të ri duke iu referuar strukturës organizative të miratuar apo në pritje për miratim;

- Njoftimet për vendet vakante publikohen në stendat e institucionit dhe në Web-in e Bashkisë Tiranë, si organ epror i saj. Rezultoi se DPRRNP Tiranë nuk ka faqen e vet zyrtare ku të përfshijë programin e transparencës në kundërshtim me Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën për informim" neni 1 pika 2,3; neni 2 pika 1/a; neni 4 pika 1,2; neni 7; dhe për rrjedhojë të bëhet dhe publikimi i vendeve vakante në të sipas nenit 7;

- DPRRNP Tiranë ndonëse ka punësuar persona me status nga “grupi i veçantë” nuk ka përcaktuar në strukturë pozicione nga kjo kategori, në moszbatim kjo të Ligjit nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjit nr. 15/2019 dt. 13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”, VKM-ja nr. 535/2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet” etj.

- Trajtimi nga DPRRNP Tiranë i punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u ka përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, nuk është sipas të VKM nr. 68/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”.

(Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 60-124, pika 2.3, të Projekt Raportit të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Titullari i njësisë dhe Drejtoria e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve dhe me Drejtorinë përgjegjëse të shërbimeve IT të Bashkisë Tiranë, të marrin masa për krijimin e faqes zyrtare në internet të vet DPRRNP Tiranë dhe programit të transparencës;

- Të marrin masa në hartimin e formularëve të përshkrimit të punës të çdo pozicioni në strukturë dhe planit vjetor të punësimeve sipas kërkesave ligjore dhe miratimin e tyre në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Tiranë; të caktojnë në strukturën organizative pozicione për kategorinë “grup i veçantë”; si dhe të mundësohet trajtimi i punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u janë përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, të gjitha këto për motivimin e punonjësve rritjen e efektivitetit të shërbimeve nga ana e tyre për arritjen e objektivave institucionale në dobi të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i **28** procedurave prokurimi të zhvilluara për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2022, me fond limit 1,199,572,751 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në aplikimin e kriterëve jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- Në **25** procedura nga **28** të audituara, u konstatua se janë aplikuar kriteret të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.

- Në **6** procedura nga **28** të audituara, me vlerë totale të fondit limit 269,151 mijë lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave **258,764** mijë lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të

vendosura në DT.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 39, “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike”; neni 34 “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; neni 98, “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; neni 36 “Specifikimet teknike”, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5; neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 67, “Klasifikimi i ofertave” neni 78, pika 4, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”; neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit; neni 85 “Lidhja e kontratës”, pika 2, etj.

- Në 3 (tre) raste, nga auditimi mbi përputhshmërinë e dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit të blerjeve të vogla me vlerë kontrate 1,651,771 lekë pa TVSH; në DPRrNP Bashkia Tiranë, u konstatua se dosjet e procedurave të prokurimit të audituara nuk janë inventarizuar dhe arkivuar me numër fletësh, duke sjellë pasiguri në plotësinë dhe administrimin e dokumentacionit të prokurimeve, veprim ky në kundërshtim me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe nenet 3, 29 të “Normave Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

8.2 Rekomandimi: DPRrNP Tiranë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, të marrë masa për sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimin dhe arkivimin e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike me qëllim saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit në përputhje me ligjin e arkivave.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave me vlerë të vogël në DPRrNP Bashkia Tiranë, rezulton se në 3 (tre) raste, me vlerë kontrate 1,651,771 lekë pa TVSH, dosjet e procedurave të prokurimit të audituara nuk janë inventarizuar dhe arkivuar me numër fletësh, duke sjellë pasiguri në plotësinë dhe administrimin e dokumentacionit të prokurimeve, veprim ky në kundërshtim me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe nenet 3, 29 të “Normave Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”; Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 124-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Bashkia Tiranë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimin dhe arkivimin e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike me qëllim saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit në përputhje me ligjin e arkivave.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave për punë publike, u konstatua se në **4 (katër) raste**, nga AK DPRrNP Bashkia Tiranë, **nuk është kryer oponencia teknike**, respektivisht për objektet:

- *“Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik të rezervuarit Gjyslikonjë”* fituar nga shoqëria “I” SHPK me kontratë me nr. 2997/8 prot., datë 23.12.2021 dhe me vlerë 39,858,552 lekë;

- *“Përmirësimi i ndriçimit publik në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe ndërtimi i korsive të biçikletave në sheshin “Nënë Tereza”* fituar nga shoqëria “I” SHPK me kontratë me nr. 1767/8 prot., datë 16.08.2022 dhe me vlerë 37,641,882.6 lekë.

Mos kryerja e oponencës teknike nga AK DPRrNP Bashkia Tiranë, vjen në kundërshtim me pikën 1 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 *“Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”*, sipas të cilës: *“Për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, që realizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga subjekte fizike dhe juridike, vendas ose të huaj, për të cilat vlera e preventivuar e punimeve të ndërtimit është jo më pak se 100,000,000 lekë, të bëhet oponencë teknike”*, si dhe me pikën 3 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 *“Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”*, sipas të cilës: *“Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike...”*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.4. faqe 100-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: DPRrNP Bashkia Tiranë të marrë masa që të pajisë me Oponencë Teknike çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për furnizimin me mallra, u konstatua se fletëdaljet dhe fletëhyrjen e mallrave në disa raste ishin të padukshme dhe të korigjuara. Mallrat e blera kanë kaluar nga furnitori duke u bërë hyrje në magazinë pa pasur një hallkë kontrolli mbi sasinë, llojin dhe cilësinë e kërkuar sipas kërkesave së procedurës e prokuruar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 124-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: Titullari i AK të marrë masa për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim me specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe në rast nevojë edhe nga ekspertë të jashtëm, jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale, si dhe të marrë masa që të kontrollojë komisionin për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Të merren masa të menjëhershme për pajisjen e magazinës me blloqe fletëhyrje/fletëdalje, ku të jenë të saktësuara të gjitha të dhënat formale, si numër serial, datë, sasi, etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik të rezervuarit Gjyslikonjë*”, me vlerë të kontratës (pa TVSh) 39,858,552 lekë me TVSH, fituar nga OE “I” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 737,880 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2997/8 prot., datë 23.12.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Drejtoria Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Rrugor, Bashkia Tiranë dhe OE “I” ShPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 217-224 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Rrugor, Bashkia Tiranë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **737,880 lekë pa TVSh** nga OE “I” ShPK, në cilësinë e sipërmarrjes në kontratën me nr. 2997/8 prot., datë 23.12.2021, me objekt “*Rehabilitimi i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik të rezervuarit Gjyslikonjë*”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.9.2024

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Rrugor, Bashkia Tiranë, nuk janë marrë masa për zbatimin rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme nga KLSH lekë dhe Auditi i brendshëm i Bashkisë Tiranë në vlerën totale 14,801,939 lekë, mbi mbledhjen e detyrimeve që vijnë si pasojë e ndalesave të llogaritura për shtesat mbi pagë për turnin e tretë të punonjësve të këtij institucioni, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Shtetit*”, neni 15, germa j; neni 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 41-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tiranë, të nxjerrë përgjegjësisë ndajë personave përgjegjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, për mos marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve që vijnë si pasojë e ndalesave të llogaritura nga KLSH dhe Auditi i Brendshëm i Bashkisë Tiranë në vlerën e mbetur pa paguar prej **14,801,939 lekë**, mbi mbledhjen e detyrimeve të pambajtura, që vijnë si pasojë e ndalesave të llogaritura për shtesat mbi pagë për turnin e tretë të punonjësve të këtij institucioni.

Brenda datës 31.12.2024

E. MASA DISIPLINORE.

Bazuar në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, i rekomandojmë **Kryetarit të Bashkisë Tiranë**, marrjen e masave si më poshtë:

a. Bazuar në nenin 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të vijojë me marrjen e masave disiplinore përkatëse në proporcion me shkallën e shkeljes.

b. Bazuar në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” dhe kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara, fillimin e dhënies së masave disiplinore për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkallën e shkeljes.

Brenda datës 31.12.2024

V. ANEKSET

Aneksi nr. 1

VITI 2019

MUAJI	NR PUNONJES/PLAN			NR PUNONJES/FAKT		
	NR PUN. DEFINITIV	NR PUN. SEZONALE	NR PUN. TOTAL	NR PUN. DEFINITIV	NR PUN. SEZONALE	NR PUN. TOTAL
Janar	434		434	429		429
Shkurt	448		448	427		427
Mars	448		448	431		431
Prill	448		448	429		429
Maj	448	50	498	432	50	482
Qershor	448	50	498	439	49	488
Korrik	448	50	498	437	49	486
Gusht	448		448	437		437
Shtator	448		448	436		436
Tetor	448		448	438		438
Nentor	448		448	441		441
Dhjetor	448		448	445		445

VITI 2020

MUAJI	NR PUNONJES/PLAN			NR PUNONJES/FAKT		
	NR PUN. DEFINITIV	NR PUN. SEZONALE	NR PUN. TOTAL	NR PUN. DEFINITIV	NR PUN. SEZONALE	NR PUN. TOTAL
Janar	448		448	442		442
Shkurt	448		448	443		443
Mars	468		468	444		444
Prill	468		468	450		450
Maj	468		468	453		453
Qershor	468	50	518	454	50	504
Korrik	468	50	518	458	50	508
Gusht	468	50	518	461	50	511
Shtator	468		468	462		462
Tetor	468		468	464		464

Nentor	468		468	464		464
Dhjetor	468		468	466		466

VITI 2021

MUAJI	NR PUNONJES/PLAN			NR PUNONJES/FAKT		
	NR PUN. DEFINITIV	NR PUN. SEZONALE	NR PUN. TOTAL	NR PUN. DEFINITIV	NR PUN. SEZONALE	NR PUN. TOTAL
Janar	468		468	466		466
Shkurt	475		475	468		468
Mars	475		475	468		468
Prill	475		475	466		466
Maj	475	15	490	467	15	482
Qershor	475	15	490	468	15	483
Korrik	475	15	490	466	15	481
Gusht	475		475	475		475
Shtator	475		475	473		473
Tetor	475		475	471		471
Nentor	475		475	471		471
Dhjetor	475		475	475		475

VITI 2022

MUAJI	NR PUNONJES/PLAN	NR PUNONJES/FAKT
Janar	475	475
Shkurt	495	480
Mars	495	486
Prill	495	491
Maj	505	503
Qershor	505	497
Korrik	505	499
Gusht	505	498
Shtator	505	499
Tetor	525	500
Nentor	525	503
Dhjetor	525	522

Investimet viti 2019

Artikulli	Kodi Projektit	Emertimi I Objektiv	KostoProjekti	Plan Vjetor 2019	Plan irihikuar 12/M	Fakt 12/M
231	1011238	MjetTransportikama	76,340	76,340		
231	1010827	ZgaradhePuseta ne rruge e trotuare	23,780,400	7,000,000	7,000,000	7,000,000
231	1010198	Pajisjedhemakerini per konstruksion (matrapik,trapanetj)	1,500,000	1,500,000		

Artikulli	Kodi Projektit	Emertimi I Objektivit	KostoProjekti	Plan Vjetor 2019	Plan irihikuar 12/M	Fakt 12/M
231	1010201	Rehabilitimi i ndricimit ne disarrugekryesore	26,634,240	14,634,240	14,634,240	14,634,240
231	1010202	Rehabilitimi i sinjalistikës rrugore	19,534,020	11,534,020	11,534,020	11,534,020
231	1010827	Zgaradhe Pusete ne rrugedhetrotuare	29,680,800	14,680,800	14,680,800	14,680,800
231	1011356	Sinjalistike per korsibicikletash	65,440,080	57,440,080	57,440,080	57,440,080
231	1011562	Rehabilitimi i sinjalistikës rrugore per akset "Mbikalim-Kombinat"	2,950,500	2,950,500	2,950,500	2,920,260
231	1011563	Rehabilitimi i ndricimit rrugor per akset "Mbikalim-Kombinat"	20,724,000	10,362,000	10,362,000	10,362,000
231	1011564	Rehabilitim i rrjetit semaforikë zistuesdhendertim i nyjevetere jasemaforike per akset "Mbikalim- Kombinat"	28,518,800	14,259,400	14,259,400	14,259,400
231	1010199	Autokulle	3,459,600	3,459,600	3,459,600	3,342,000
231	1011551	Qender Kontrolli	3,108,000	3,108,000	3,108,000	3,032,640
231	1010827	Zgara/Puseta	29,520,000	14,760,000	14,760,000	14,760,000
231	1010206	Makinere Frezealfalti e kompletuar	14,300,000	13,104,000	13,104,000	13,104,000
231	1011224	Blerjemjetetransporti me tonazhtendryshem	20,000,000	20,000,000	20,000,000	18,513,600
231	1011593	Transportier per makinere e mjetet teknologjike 25 ton	2,200,000	2,200,000		
231	1011238	Mjetetransporti tip kama	2,000,000	2,000,000		
231	1010205	Mjet tip pirun (ngarkimshkarkim materialesh 3 ton)	1,200,000	1,200,000		
231	1010329	Matrapik per fadrome	1,300,000	1,300,000		
231	1011594	fadroma per rruget rurale	26,000,000	26,000,000	26,000,000	25,185,600
231	1011353	Motocikleta	550,000	550,000		
231	1010825	Veglamjetepune	4,650,000	4,650,000		
231	1010204	Mini-eskavator 0.15 M ³	4,500,000	4,500,000	4,500,000	4,064,400
231	1011595	Materiale per ndricim	29,892,000	14,946,000	14,946,000	14,946,000
231	1011596	Materiale per sinjalistike (Semafore)	13,805,824	13,805,824	13,805,824	13,356,960
231	1011597	Materiale per sinjalistike (Tabela)	20,037,600	18,037,200	18,037,200	18,037,200
231	1010824	Makinere vijezimibikomponentekocolate	2,400,000	2,400,000	2,400,000	1,680,000
231	1010926	Autovinc	4,800,000	4,800,000	4,800,000	4,680,000
231	1011598	Qender Kontrolli (fazadyte)	3,000,000	3,000,000	3,000,000	2,820,000
231	1011599	Ndertimmirembajtjeurash	37,120,178	18,560,089	11,722,566	11,722,560
231	1011351	Blerjekamion 4 aks	6,350,000	6,350,000	6,350,000	6,118,800
231	1010713	Blerje Eskavator	19,050,000	13,885,200	13,885,200	13,885,200
Totali			468,082,382	327,053,293	306,739,430	302,079,760

Burimi: DPRRNP, përpunoi Grupi i Auditimit

c. Investimet viti 2020

Artikulli	Kodi Projektit	Emertimi I Objektivit	KostoProjekti	Plan Vjetor 2020	Plan irihikuar 12/M	Fakt 12/M
231	1011563	Rehabilitimi i ndricimit rrugor per akset "Mbikalim-Kombinat"	19,024,200	8,662,200	8,662,200	8,662,200
231	1011564	Rehabilitim i rrjetit semaforikë zistuesdhendertim i nyjevetere jasemaforike per akset "Mbikalim- Kombinat"	27,016,800	12,757,400	12,757,400	12,757,400
231	1010827	Zgara/Puseta	29,210,280	14,450,280	14,450,280	14,450,280
231	1011871	Blerje Ruli	7,250,000	7,250,000	7,104,000	7,104,000
231	1010825	Veglamjetepune	4,558,800	4,558,800	4,558,800	4,558,800
231	1011595	Materiale per ndricim	26,119,200	11,173,200	11,173,200	11,173,200

Artikulli	Kodi Projektit	Emertimi I Objektivit	KostoProjekti	Plan Vjetor 2020	Plan irihikuar 12/M	Fakt 12/M
231	1011599	Ndertimmirembajtjeurash	31,475,544	19,752,978	19,751,247	19,751,247
231	1010208	BlerjeZgaradhePuseta	30,000,000	30,000,000	29,531,520	29,531,520
231	1010199	BlerjeMjeteknologjikAutokulle	5,400,000	5,400,000	5,400,000	5,400,000
231	1011748	Gabineelektrike per nyjen e asfalto-betonit	7,000,000	7,000,000	6,209,640	6,209,640
231	1010825	BlerjeVeglaMjetepune	4,000,000	4,000,000	3,946,800	3,946,800
231	1011595	Materiale per ndricim	38,000,000	38,000,000	36,770,400	36,770,400
231	1011596	Materiale per Sinjalistike (Semafore per nyjetereja)	14,000,000	14,000,000	13,834,800	13,834,800
231	1011749	Materiale per Sinjalistike (shtylla LED)	26,600,000	26,600,000	25,002,000	25,002,000
231	1011593	Transportier per makineri e mjeteknologjikembi 25 ton	5,000,000	5,000,000	4,884,000	4,884,000
231	1011597	Materiale per sinjalistike (Tabela)	18,000,000	18,000,000	16,686,720	16,686,720
231	1011750	Materiale per sinjalistike (birila, grezeza, kangjella)	18,000,000	18,000,000	17,546,880	17,546,880
231	1011752	Mjetetransporti me tonazhtendryshem	13,000,000	13,000,000	12,300,000	12,300,000
231	1010329	Gjenerator	6,000,000	6,000,000	5,280,000	5,280,000
231	1011751	Rikonstruksion I shkarkuesvekatastrofikteujembledhesve ne tegjitheterritorin e BashkiseTirane	15,000,000	15,000,000		
231	1012014	Rehabilitimi I ndricimitrugor ,Rruga e Durresit	22,225,680	22,225,680		
231	1012015	Rehabilitimi I sinjalistikesrrugore ,Rruga e Durresit	6,753,600	6,753,600		
Totali			373,634,104	307,584,138	255,849,887	255,849,887

Burimi: DPRRNP, përpunoi Grupi i Auditimit

d. Investimet viti 2021

Artikulli	Kodi Projektit	Emertimi I Objektivit	KostoProjekti	Plan Vjetor 2021	Plan irihikuar 12/M	Fakt 12/M
231	1011751	Rikonstruksion I ShkarkuesitKatastrofikteUjesjellesit ,RezervuariAllgjate	14,475,000	9,882,652	9,882,651	9,882,651
231	1011751	Rikonstruksion I ShkarkuesitKatastrofikteUjesjellesit ,RezervuariAllgjate	450,000	450,000	272,761	272,761
231	1011751	Rikonstruksion I ShkarkuesitKatastrofikteUjesjellesit ,RezervuariAllgjate	75,000	75,000	75,000	75,000
231	1012014	Rehabilitimi I ndricimitrugor ,Rruga e Durresit	22,225,680	17,617,540	17,617,486	17,617,486
231	1012015	Rehabilitimi I sinjalistikesrrugore ,Rruga e Durresit	6,753,600	6,033,456	6,033,456	6,033,456
231	1010208	BlerjeZgaradhePuseta	37,000,000	37,000,000		
231	1010825	BlerjeVeglamjetepune	5,000,000	5,000,000	4,932,600	4,932,600
231	1011890	Pajisjezyre	920,000	920,000	910,080	910,080
231	1011595	Materiale per ndricim	53,000,000	41,431,200	41,431,200	41,431,200
231	1011596	Materiale per sinjalistike (Semafore per nyjetereja)	14,000,000	13,917,600	13,917,600	13,917,600
231	1011597	Materiale per sinjalistike (Tabela)	18,850,000	13,151,185	13,151,185	13,151,185

Artikulli	Kodi Projektit	Emertimi I Objektivit	KostoProjekti	Plan Vjetor 2021	Plan irihikuar 12/M	Fakt 12/M
231	1011750	Materiale per sinjalistike (birila, grezeza, kangjella)	14,000,000	14,000,000	12,927,360	12,927,360
231	1012134	Kamion tip Kama	900,000	900,000		
231	1012135	Kamionveteshkarkues 814	8,924,682	8,924,682		
231	1012136	Kamionveteshkarkues 4+1	3,840,000	3,840,000	3,264,000	3,264,000
231	1012143	Blerjendriçuesdheshtyllandriçimi	11,651,200	11,651,200		
231	19AF305	Rehabilitimi I mekanizmitteportaveteujeleshuesitdheshkarkuesitkatastrofikerezervuaritGjyslikonje	45,364,334	45,364,334		
231	19AF305	Mbikëqyrja e punimevepërobjektin "Rehabilitimi I mekanizmittekomandimittëportavetëujëlëshuesitdheshkarkuesitkatastrofikaneësorërezervuaritGjyslikonjë"	1,301,624	1,301,624		
231	19AF305	Kolaudimipunimevepërobjektin "Rehabilitimi I mekanizmittekomandimittëportavetëujëlëshuesitdheshkarkuesitkatastrofikaneësorërezervuaritGjyslikonjë"	181,042	181,042		
Totali			258,912,162	231,641,515	124,415,379	124,415,379

Burimi: DPRRNP, përpunoi Grupi i Auditimit

e. Investimet viti 2022

Artikulli	Kodi Projektit	Emertimi I Objektivit	KostoProjekti	Plan Vjetor 2022	Plan irihikuar 12/M	Fakt 12/M
231	19AF305	RehabilitimiimekanizmittekomandimittëportavetëujëlëshuesitdheshkarkuesitkatastrofikaneësorërezervuaritGjyslikonjë	41,307,550	41,307,550	41,307,550	41,307,550
230	1010208	BlerjeZgaradhePuseta	34,754,640	34,754,640	34,754,640	34,754,640
231	1012134	Kamion tip Kama	900,000	900,000	873,600	873,600
231	1012135	Kamionveteshkarkues 814	8,924,682	8,924,682	8,400,000	8,400,000
231	1012143	Blerjendriçuesdheshtyllandriçimi	11,651,200	11,651,200	8,163,360	8,163,360
231	1010208	BlerjeZgaradhePuseta	41,400,000	41,400,000	9,844,531	9,844,531
231	1012160	Sinjalistikevertikale (tabela+tuba e atrecatura)	17,016,000	17,016,000	17,007,360	17,007,360
231	1012161	Sinjalistikehorizontale (kangjella,birila,grerëza)	15,780,000	15,780,000	15,778,320	15,778,320
231	1011596	MaterialetërrjetitSemaforik	28,998,000	28,998,000	28,895,400	28,895,400
231	1011595	Materialepërrjetin e Ndriçimit	59,352,000	59,352,000	59,339,160	59,339,160
231	1010825	Veglapune	3,360,000	3,360,000	3,219,600	3,219,600
231	1011890	Pajisjezyre	1,500,000	1,500,000	1,488,000	1,488,000
231	1011280	Blerjemjetetransporti	22,594,000	22,594,000	21,583,200	21,583,200
231	1012247	PermiresimiindricimitpubliknëBulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhendërtimi I	110,000,000	22,000,000	22,000,000	22,000,000

Artikulli	Kodi Projektit	Emertimi I Objektivit	KostoProjekti	Plan Vjetor 2022	Plan irihikuar 12/M	Fakt 12/M
		korsivetëbicycleletavenësheshin "Nënë Tereza" deritekyrja e liqenit Artificial.				
231	1012247	Permiresimi I ndricimitpubliknëBulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhendërtimi I korsivetëbicycleletavenësheshin "Nënë Tereza" deritekyrja e liqenit Artificial.	1,224,800	244,960	244,960	244,960
231	1012247	Permiresimi I ndricimitpubliknëBulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhendërtimi I korsivetëbicycleletavenësheshin "Nënë Tereza" deritekyrja e liqenit Artificial.	58,100			
230	1012246	Permiresimi I ndricimitpubliknëBulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhendërtimi I korsivetëbicycleletavenësheshin "Nënë Tereza" deritekyrja e liqenit Artificial.	130,000	130,000		
Totali			398,950,972	309,913,032	272,899,681	272,899,681

Burimi: DPRRNP, përpunoi Grupi i Auditimit

Materialiteti për shpenzimet, DPRRNP Tiranë 2022			
Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	315,981,017	0.70	8
Sigurime Shoqërore (601)	51,968,954	0.70	1
Mallra e Shërbime (602)	991,296,013	0.70	26
Investime të brend. (230-231)	309,913,032	2.00	23
Te tjera transfer. korrente (604-606)	10,482,469	0.70	0
Total	1,679,641,485		58
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	33,592,830		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	33,592,830		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	3,359,283		
Nëntotali	30,233,547		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	27,210,192		

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT